Vilhelm Bush

JEZUSI FATI YNË

JEZUSI
FATI YNË

Dashamirët
e Ungjillit

Shkup, 1999

Vilhelm Bush

Jezusi fati ynë

(Исус наша судбина)

Превод на албански

Нико Нолте

Наслов на оригиналот

Jesus our destiny

Лектура

Исмаил Хамити

Коректура

Ристо Петровски

Исмет Идризи

Издавач

"Љубители на Христијанското Евангелие"

(Dashamirët e Ungjillit)

во Република Македонија

Поштенски фах 698, 91001 Скопје

Сите права на ова издание ги задржува издавачот

Печатено со одобрение

© Copyright 1999 - ЉХЕ

Печат

"Маринг" - Скопје

Тираж

5.000 примероци

CIP - Каталогизација во публикација

Народна и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски"

Скопје

284.991

BUSCH, Wilhelm

Jezusi fat ynë / Vilhelm Bush; (përktheu nga Niko Nollte).

Shkup: Dashamirët e Ungjillit, 1999. - 322 стр: 21 см

Превод на делото: Jezus our destiny.

Kush është Vilhelm Bushi: стр. (5)-6

ISBN 9989-837-06-6

а) Христијанство - Евангелизам - Популарна литература

Мислење од Министерството за култура на РМ

бр. 07-668/2 од 01.02.1999 година.

PËRMBJATJA

Parathanjë 3

1. Perëndia – Po, Por për se Jezusi? 5
2. Cili është kuptimi i jetëts sime? 27
3. Nuk kam kohë! 43
4. Vëretje! – rrezik për jetën! 61
5. Çka duhet që të bëni? 79
6. Si mund ti lejdjë Perëndia gjëra të tilla? 97
7. E drejta jonë për dashurinë? 121
8. A mundet të flitet me Perëndinë? 139
9. Ja – që nuk mund të besoj! 155
10. Si mundemi ta shijojmë jetën nëse fajet dhe dhështimet tona na rëndojnë? 175
11. Si mund ta gëzdjë jetën – kur njerzit e tjerë më nervikosin! 193
12. Gjërat – duhet të ndryshojmë – por si? 209
13. Faleminderit – "Jo për mua!" 227
14. A ka ndonjë siguri në ç`është jet religioze?..... 243
15. A`është krishterimi ç`eshtje private? 263
16. Kur do të vijë fundi? 283
17. Ç`farë është kuptimi i jetës – me Perëndinë? 305

Vilhelm Bush

JEZUSI fati ynë

Jezusi Fati Ynë - kjo ishte tema qendrore e shërbesës së gjatë të Vilhelm Bushit në Gjermani si pastor dhe udhëheqës të rinjsh, ungjilltar shëtitës dhe autor.

Ai ishte i bindur se Ungjilli i Jezu Krishtit është mesazhi më i jashtëzakonshëm i të gjitha kohërave. Ja përse ai ndiente gëzim t'ua shpallte atë turmave të mëdha nëpër gjithë Evropën. Pastor Bushi ua bënte të qartë të gjithëve se Jezusi është qëllimi përfundimtar i kërkimit të njeriut për të vërtetën.

Libri origjinal, "Jesus unser Schicksal", është libri i shitur shumë më tepër se çdo libër tjetër në tërë literaturën e krishterë gjermane.

Në këtë libër shumë të popullarizuar me predikime të zgjedhura, do të zbuloni çfarë ka dashur të thotë Pastor Bushi mbi temën e rëndësishme "Jezusi Fati Ynë". Dhe nëse e zbuloni këtë, një këndvështrim krejtësisht i ri për çështjet më qenësore të jetës do të hapet para jush.

Kush është Vilhelm Bushi?

Pothuajse i panjohur në vendet anglishtfolëse, Vilhelm Bushi ishte një nga ungjilltarët më të mirënjohur dhe më të popullarizuar në Gjermani në vitet para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Mënyra e tij e drejtpërdrejtë, e hapur dhe personale e predikimit të së vërtetës biblike tërhiqte mijëra njerëz që mblidheshin për ta dëgjuar.

Vilhelm Bushi ishte i bindur se mesazhi i Ungjillit është mesazhi më i jashtëzakonshëm i të gjitha kohërave. Predikimet dhe shkrimet e tij, në të cilat ai me forcë por në

mënyrë të thjeshtë paraqet përgjigjen biblike për pyetjet që lidhen në mënyrë më të drejtpërdrejtë me njeriun e sotëm, mund të vlerësohen njëlloj, si nga i riu ashtu edhe nga i moshuari, i pasuri dhe i varfëri, i mirë-arsimuari dhe njeriu i rrugës.

I lindur në Vupertal-Elbervelt, Gjermani, në vitin 1897, Vilhelm Bushi e kaloi rininë e tij në Frankfurt në Majn, ku ndoqi dhe mbaroi studimet e shkollës së mesme.

Bushi shërbeu në ushtrinë gjermane gjatë Luftës së Parë Botërore. Megjithëse ende i ri, ai mbante gradën e togerit. Atje në fushën e betejës, ai takoi Shpëtimtarin e gjallë dhe ia dhuroi jetën e tij Perëndisë. Ky hap vendimtar do ta ndryshonte rrjedhën e jetës së tij dhe do të ndikonte në jetën e mijëra e mijëra të tjerëve në vitet që do të vinin.

Kur mbaroi lufta, Vilhelm Bushi studioi teologjinë në Tybingen, pas së cilës ai hyri në shërbesë dhe shërbeu si pastor në kishën luterane në fillim në Bilvelt, pastaj në një rajon minatorësh, dhe më në fund në qytetin e Esenit. Ai ishte pastor dhe udhëheqës të rinjsh atje deri sa vdiq. Por gjatë tërë shërbesës së tij, ai udhëtoi mjaft nëpër gjithë Gjermaninë dhe në vende të tjera evropiane, duke predikuar Fjalën e Perëndisë kudo.

Për shkak se përkrahu pozicionin e fortë të pakompromis të Kishës Gjermane të Rrëfimit kundër intrigave të Rajhut të Tretë në jetën e kishës, dhe guxoi ta shpallë hapur besimin e tij, Bushi u burgos disa herë nga nazistët.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Vilhelm Bushi edhe një herë nisi udhëtimet e tij si një ungjilltar shëtitës. Dhe në vitin 1966, pas disa dekadash pune të pandërprerë, Zoti e thirri shërbëtorin e tij pranë vetes.

Pse kam nevojë për Jezusin?

PERËNDIA, PO; POR PSE JEZUSI?

Jam një pastor plak. Kam punuar në qytete të mëdha gjithë jetën time. Për vite me radhë të njëjtat pyetje vazhdojnë të bëhen. Ka pyetje të çiltra si, "Si mund ta lejojë Perëndia?" Por ka edhe gjëra bajate si, "Cila ishte gruaja e Kainit?" Por pyetja që njerëzit duket se ma thonë me më pak vështirësi është kjo: "Pastor, ti flet gjithmonë për Jezusin. Ti je fanatik! S'ka rëndësi se cilës fe i përket. Ajo që ka rëndësi është që të kesh respekt për gjërat e shenjta."

Kjo është e qartë si drita e diellit, apo jo? Gëtja, që ishte nga Frankfurti ashtu si unë, thoshte diçka të ngjashme: "Ndjenjat janë gjithçka; emri është vetëm zhurmë dhe tym...". Çështja nëse ne flasim për Allahun, Budën, fatin apo "Qenien Supreme" është fare e parëndësishme. Besimi në *diçka* është ajo që ka rëndësi. Të duash t'i specifikosh besimet është fanatizëm. A nuk është kjo ajo që besojnë shumica e njerëzve? Mbaj mend një mesogrua që më tha njëherë, "Pastor, ti na mërzit me të folurën tënde për Jezusin. A nuk tha Ai, ***Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa***? Të gjithë do ta gjejnë një vend!" Miqtë e mi, ky është një gabim tepër serioz.

Isha në Berlin një ditë, në aeroportin Tempelhofer Feld. Para se të hipnim në aeroplan duhej të kalonim nëpër kontrollin e pasaportave. Para meje ishte një burrë trupmadh, shpatullgjerë, me një qilim shumë të madh udhëtimi, të mbështjellë nën sqetull. Ai ia vuri përpara në mënyrë të pasjellshme pasaportën e tij nëpunësit të doganës. "Një moment" tha nëpunësi. "Pasaportës sate i ka skaduar afati!" "Hajde tani! Mos u bëj i bezdisur," ia ktheu burri. "Kryesorja është të kesh pasaportë." "Këtu qëndron gabimi yt!" u shpreh nëpunësi. "Kryesorja është të kesh një pasaportë që është e

vlefshme."

E njëjta gjë ka të bëjë me besimin. Fakti i besimit - i besimit në çdo gjë të rëndomtë - nuk është ajo që ka rëndësi në fund. Sepse çdo njeri sipas mënyrës së tij beson në diçka. Dikush më tha një ditë, "Besoj se mund të bëj një gjellë të mirë me dy paund[1] mish lope." Epo, ky është një besim - i një lloji! Ajo që ka rëndësi nuk është vetëm të kesh një lloj besimi, por të kesh besimin e vërtetë, një besim që të aftëson të jetosh kur çdo gjë përreth bëhet e errët, që të mbështet kur rrezikon të biesh në tundim, dhe që të ndihmon të përballosh vdekjen. Vdekja është një provë e mirë e vërtetësisë së besimit tënd. Do t'i qëndrojë besimi yt provës?

Tani, ka vetëm një besim të vërtetë. Një të vetëm i cili na aftëson të jetojmë dhe të vdesim denjësisht. Është besimi në Zotin Jezu Krisht, Birin e Perëndisë. Është e vërtetë se Jezusi tha: ***Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa***. Por ai tha gjithashtu se ka vetëm një derë për të hyrë: ***Unë jam dera; nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet***.

Jezusi është dera. Unë e di shumë mirë se njerëzit nuk duan ta dëgjojnë këtë. Ata janë të gatshëm të diskutojnë për Perëndinë për orë të tëra, për të shkëmbyer ide të mençura se si mund të jetë Ai. Por Jezusi nuk mund të jetë një temë për diskutim.

E përsëris: është vetëm besimi në Jezusin, Birin e Perëndisë, që mund të na shpëtojë dhe të na bëjë që të jetojmë dhe të vdesim në paqe.

E kuptova tamam se sa qesharake u duket kjo disa njerëzve, kur po shëtisja një ditë në qytetin e Esenit. Takova dy burra, që ka të ngjarë se ishin minatorë, të cilët po qëndronin në trotuar. Njëri prej tyre më përshëndeti,

---

[1] Funt - masë peshe afërsisht gjysmë kilogram (454 gram).

"Tungjatjeta pastor!"

Kur erdha më afër, e pyeta, " Më njeh?" Ai filloi të qeshë dhe i tha shokut të tij, "Ky është pastor Bushi! Njeri i mirë!" E falënderova. "Po, njeri i mirë," përsëriti ai, "por ka lajthitur!" Unë u indinjova dhe bërtita tepër i nxehur, "Çfarë? I lajthitur? Si ta nxë goja këtë?" Por ai tha përsëri, "Pastor Bushi! Njeri i mirë! Vetëm se s'pushon së foluri për Jezusin." Unë u kënaqa. "Miku im, nuk jam i lajthitur!" i thashë. "Pas njëqind vjetësh, ti do të jesh në përjetësi. E vetmja gjë që do të ketë rëndësi atëherë do të jetë nëse ti e ke njohur apo jo Jezusin. Kjo është ajo që e vendos nëse do të jesh në parajsë apo në ferr. Më thuaj, e njeh Jezusin?" Duke qeshur, ai u kthye nga minatori tjetër, "E shikon, ia filloi prapë avazit!"

Dhe kjo është pikërisht ajo që dua të bëj unë tani. Ka një varg në Bibël që do të shërbejë si trampolinë. Ai thotë kështu: ***Ai që ka Birin*** (e Perëndisë), ***ka jetën***. Ju mund të keni dëgjuar për Jezusin në Shkollën e së Dielës, por kjo nuk do të thotë se ju e *keni* Atë. ***Ai që KA Birin*** e Perëndisë - dëgjoni me kujdes! - ***KA jetën*** - që fillon tani e vazhdon në përjetësi! ***Ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën***. Është Fjala e Perëndisë që thotë kështu. E dini proverbin e vjetër: "Një zog në dorë vlen sa për dy në shkurre!" Mirë - për interesin tuaj - do të doja t'ju bindja ta pranonit Jezu Krishtin dhe ta vinit jetën tuaj në duart e Tij. Sepse pa të jeta mund të bëhet vërtet e mjerueshme.

Po pse vetëm Jezusi merret në konsideratë? Pse është besimi në të i vetmi besim i vërtetë? A mund të jem më personal? Do të doja t'ju tregoja se përse *unë* kam nevojë për Jezusin dhe pse *unë* besoj tek ai.

1. Jezusi na zbulon Perëndinë

Kur dikush më thotë, "Unë besoj në Perëndinë por përse më duhet Jezusi?" përgjigjja ime është se ky është budallallëk! Perëndia është një Perëndi i fshehur. Pa Jezusin ne nuk mund të dimë asgjë fare për të.

Njerëzit mund ta shpikin perëndinë e tyre, të jemi të sigurt; ja "Zoti i mirë" që nuk do ta lërë në baltë një djalosh të hijshëm për sa kohë që ai nuk pi më shumë se pesë pinta[2] birrë në ditë! Por ky nuk është Perëndia! Allahu, Buda - këta janë vetëm projeksione të dëshirave tona. Po Perëndia? Pa Jezusin ne nuk do të dinim asgjë për Të. Jezusi e zbulon Atë. Në personin e Jezusit, Perëndia erdhi te ne.

Imagjinoni një mbulesë të dendur mjegulle. Prapa saj është Perëndia. Meqenëse njerëzit nuk mund të jetojnë pa Të, ata nisen në kërkim të Tij. Ata përpiqen të depërtojnë nëpër mjegull. Kjo është ajo që bëjnë fetë e ndryshme. Nëpërmjet tyre njerëzit përpiqen të gjejnë Perëndinë. Por të gjitha ato kanë këtë të përbashkët: ato të gjitha kanë humbur rrugën në mjegull dhe nuk kanë mundur ta zbulojnë Perëndinë.

Perëndia është një Perëndi i fshehur. Profeti jude Isaia e kishte kuptuar këtë. Prandaj ai thërriste, "Ne nuk mund të të arrijmë. ***Oh, sikur t'i shqyeje qiejtë dhe të zbrisje!***" Dhe gjëja që të çudit është kjo: Perëndia e dëgjoi atë thirrje! Ai e çau tej për tej mbulesën e mjegullës dhe zbriti te ne - në personin e Jezu Krishtit. Në fushat e Betlehemit, kur kori i engjëjve këndoi, ***Lindi për ju një Shpëtimtar. Lavdi Perëndisë në vendet më të larta***! - Perëndia kishte ardhur te ne. Dhe tani Jezusi na thotë, ***Kush më ka parë mua, ka parë Atin***. Pa Jezusin unë nuk do të dija gjë prej gjëje për Perëndinë. Ai është i vetmi person nga i cili unë mund të

[2] Pintë - masë lëngjesh afërsisht gjysmë litri (0.5679 litra).

marr një njohuri të sigurt për Perëndinë. Si mundet që ndonjë njeri qoftë edhe të guxojë të thotë, "Unë mund të bëj pa Jezusin"?

2. Jezusi është dashuria çliruese e Perëndisë

Para disa kohësh u intervistova nga një gazetar. Kur më pyeti pse mbaja takime si ai në të cilin ndodheshim, iu përgjigja, "E bëj këtë sepse kam frikë se njerëzit do të shkojnë në ferr!" "Lëri këto," më tha duke buzëqeshur. "Nuk ka një vend të tillë si për shembull ferri!" Kështu që i thashë, "Do ta shohim. Brenda njëqind vetë ju do të bindeni nëse ju keni të drejtë – apo fjala e Perëndisë ka të drejtë. Më thuaj," e pyeta, "ke patur ndonjëherë frikë nga Perëndia?" "Çfarë!" bërtiti ai, " nuk është nevoja që askush të ketë frikë nga Zoti i mirë!" "Or mik" i thashë, "ti nuk ke as edhe idenë më të vogël se përse bëhet fjalë. Në qoftë se do të kishe konceptin e drejtë për Perëndinë, do ta dije se asgjë nuk është më e tmerrshme se sa Perëndia i shenjtë dhe i drejtë, gjykatësi i mëkateve tona. A mos mendon se ai do t'i lërë pa ndëshkuar fajet e tua? Ti flet për 'Zotin e mirë'. Bibla flet për Të ndryshe: ***Gjë e tmerrshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë.***"

Keni patur ndonjëherë frikë nga Perëndia? Nëse jo, atëherë ju s'keni filluar madje as ta perceptoni realitetin e tmerrshëm të shenjtërisë së Perëndisë dhe realitetin e tmerrshëm të mëkatit tuaj. Por nëse po, ju nuk do të vononi të pyesni,

"Si mund të qëndroj para Perëndisë?" Unë besoj se marrëzia më e madhe e epokës sonë është se ne nuk kemi më frikë nga Perëndia. Kur një komb pushon së marri seriozisht Perëndinë dhe zemërimin e Tij ndaj mëkatit, kjo është një simptomë e një ngurtësimi të tmerrshëm.

Profesor Karl Hajm më tregoi njëherë për një udhëtim që bëri në Kinë. Në Pekin, atë e çuan me makinë në majë të një mali ku ishte një altar që quhej "altari i qiellit". Udhërrëfyesi i tha se në "natën e pajtimit", qindra mijëra njerëz i ngjiteshin malit, secili duke mbajtur një fener. Pastaj perandori do të ngjitej në majë - kjo ndodhte para revolucionit - dhe do të ofronte një flijim pajtimi për popullin e tij. Profesor Hajm tha, "Këta paganë e dinin se ç'është zemërimi i Perëndisë, dhe e kuptonin se njeriu duhet të pajtohet me Të."

Dhe perëndimori i kulturuar mendon se ai mund të flasë në mënyrë të shkujdesur për "Zotin e mirë" dhe se Perëndia do të jetë i lumtur për sa kohë që njerëzit e japin lëmoshën e tyre pa u ankuar! Është koha që të fillonim të kishim frikë nga Perëndia përsëri! Sepse ne të gjithë kemi mëkatuar. Po, që të gjithë.

Me të mësuar t'i kemi përsëri frikë Perëndisë, do të pyesim, "Si mund t'i shpëtojmë zemërimit të Perëndisë? Kush do të na shpëtojë?" Tamam atëherë sytë tanë do të hapen dhe do ta kuptojmë se Jezusi është dashuria çliruese e Perëndisë. Perëndia ***dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen***. Por Ai nuk mund të na shpëtojë në kurriz të drejtësisë. Perëndia nuk mund ta mbyllë një sy ndaj mëkatit. Është kjo arsyeja që ai dha Birin e tij për shpëtimin dhe pajtimin e botës.

Ejani me mua në Jeruzalem. Në rrethinat e qytetit është një kodër. Mijëra njerëz janë mbledhur atje. Lart, sipër kokave të turmës ndodhen tri kryqe. Njeriu në kryqin në të majtë është, ashtu si ne, mëkatar. Po kështu dhe ai në të djathtë. Por shikoni njeriun në mes. Ai nuk është tjetër përveçse Biri i Perëndisë.

O Kokë e shenjtë e plagosur
E varur nga dhembja e brenga

Me plot përbuzje rrethohesh
Kurora Jote bërë me gjemba!
Sa i zbehtë që je nga dhembjet
Nga përbuzja dhe fyerjet e rënda!
Sa dergjet ajo fytyrë
Që dikur, ndriste si hëna.

Pse u gozhdua ai në kryq? Sepse ky kryq është altari i Perëndisë! Dhe Jezusi është Qengji i Perëndisë që mbart mëkatin e botës dhe na pajton ne me Perëndinë.

Deri sa ta keni gjetur Jezusin, zemërimi i Perëndisë qëndron mbi ju, edhe në qoftë se ju nuk e dini këtë, edhe në qoftë se ju e mohoni këtë. Vetëm personi që vjen te Jezusi mund ta gëzojë paqen e Perëndisë. ***Ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të.***

Më lejoni të përdor një ilustrim. Gjatë Luftës së Parë Botërore unë shërbeja si artilier. Topat tanë kishin mburoja në secilën anë. Një ditë u gjendëm të pozicionuar në vijën e frontit pa as edhe një batalion këmbësorie në fushën e shikimit. Dhe pikërisht atë ditë të veçantë ne u sulmuam nga tanket! Një breshër plumbash nga vijat e armikut binte mbi mburojat e topave, por veshja mbrojtëse ishte aq e trashë sa që ne u strehuam prapa tyre. Dhe unë në atë moment mendova, "Sikur vetëm ta nxirrja dorën, do të më bëhej shoshë nga plumbat - dhe do të më rridhte gjak deri sa të vdisja. Por këtu, prapa mburojës, jam i sigurt."

Kjo portretizon pikërisht atë se ç'kuptim ka Jezusi për mua. Unë e di se pa Jezusin unë do të shkatërrohesha nga gjykimi i Perëndisë. Pa Jezusin, pavarësisht se çfarë bëra unë, kurrë nuk do të kisha paqen e zemrës. Pa Jezusin, unë nuk mund të vdisja pa një ankth të tmerrshëm. Pa Jezusin, unë do të ecja drejt e në dënimin e përjetshëm.

Dhe dënimi i përjetshëm ekziston vërtet, pa asnjë hije dyshimi. Prisni pak dhe do të shihni se ajo që thotë Bibla është e vërtetë!

Por në qoftë se unë gjej strehë prapa kryqit të Jezusit, jam po aq i sigurt sa isha prapa veshjes mbrojtëse. Unë mund të di me siguri se ai është shpenguesi im, Shpëtimtari im. Po, Jezusi është dashuria çliruese e Perëndisë.

Më dëgjoni me kujdes. Perëndia dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen. Për këtë arsye, Ai dha Birin e Tij për shpëtimin tuaj, për pajtimin tuaj me Të. Mos pushoni deri sa ta keni marrë këtë paqe nga Perëndia, këtë shpëtim!

Pse kam nevojë për Jezusin?

3. Jezusi është i vetmi që mund ta zgjidhë problemin më të madh të jetës

A e dini se cili është problemi më i madh i jetës? Për të moshuarit mund të duket se është sëmundja e fshikëzës së urinës apo e veshkëve! Ose për të rinjtë, i dashuri apo e dashura e tyre. Çdo njeri e ka një problem. Por, më besoni, problemi më i madh në jetë është faji ynë para Perëndisë.

Për shumë vite punova mes të rinjve. Dhe gjithmonë gjurmoja për ilustrime të reja për t'i ndihmuar ata që ta kuptonin këtë të vërtetë. Do të dëshiroja të përdorja një nga këto përfytyrime përsëri. Imagjinoni se që nga lindja ne mbajmë një hallkë të rëndë çeliku rreth qafës sonë. Supozoni se sa herë që unë kryej një mëkat një hallkë saldohet mbi të. Unë kam një mendim të papastër: shtohet një hallkë. Unë sillem keq me nënën time: shtohet një hallkë tjetër. Unë flas keq për një person tjetër: dhe shtohet edhe një hallkë tjetër. Unë kaloj një ditë pa u lutur, duke vepruar sikur Perëndia të mos ekzistonte: shtohet një hallkë e re. Unë jam i pandershëm, them gënjeshtra: edhe një hallkë më tepër

shtohet.

Përpiquni të imagjinoni gjatësinë e zinxhirit që ne tërheqim prapa nesh - zinxhirin e fajit tonë. Megjithëse ky zinxhir nuk mund të shihet, faji ynë prapëseprapë është shumë real.

Në fakt, ai është i pamatë. Dhe ne e tërheqim atë me vete kudo që shkojmë. Unë shpesh kam pyetur veten pse njerëzit nuk janë më të lumtur
dhe më të kënaqur. Gjërat nuk po shkojnë aq keq. Duket sikur ata kanë çdo arsye për të qenë të lumtur. Por ata nuk janë. Dhe nuk mund të jenë sepse janë kërrusur nga zinxhiri i rëndë i fajit të tyre. Tani askush nuk mund t'i lirojë ata prej tij, madje asnjë pastor, apo një prift apo një engjëll. Vetë Perëndia nuk mund ta heqë atë kaq thjesht sepse Ai është i drejtë: ***Ç'të mbjellë njeriu, atë edhe do ta korrë.***

Por ja tek është Jezusi. Ai është i vetmi që mund ta zgjidhë problemin më të madh të jetës sepse Ai vdiq për mëkatet tona. Duke vdekur, Ai i drejti për ne të padrejtët, Jezusi ka shlyer mëkatet tona. Prandaj Ai është në gjendje të na çlirojë nga zinxhiri i fajit tonë - dhe vetëm Ai është në gjendje ta bëjë këtë. Unë mund ta them nga përvoja se është një çlirim i vërtetë ta dish se mëkatet tona janë falur. Është çlirimi më i madh që mund të përjetojë dikush. Dhe kjo transformon jo vetëm jetën tonë por edhe vdekjen tonë. Ju njerëz të thyer në moshë do ta kuptoni këtë; është një gjë të vdesësh dhe ta dish se mëkatet të janë falur, dhe një gjë tjetër të hysh në përjetësi me gjithë peshën e keqbërjes suaj. Është një gjë serioze dhe e tmerrshme ta mendosh.

Njoh shumë njerëz që gjatë gjithë jetës së tyre kanë deklaruar se janë të mirë, se bëjnë atë që është e drejtë. Por një ditë ata do të vdesin dhe do të zbulojnë – shohin se për herë të fundit e humbën dorën e zgjature – shtrirë miqësisht dhe do të shohin – zbulojnë se gjëmia e jetes së tyre po

përfshihet nga rryma e përjetësisë për ta takuar Perëndinë. Ata nuk mund të marrin asgjë me vete: as shtëpinë e tyre të vogël, as llogarinë e tyre bankare. Asgjë, përveç fajësisë së tyre. Kjo është mënyra që ata do të shkojnë të paraqiten para Perëndisë! Sa tmerruese! Por kjo është fati i njerëzimit. Ju mund të thoni, "Kështu vdesin të gjithë njerëzit. Kjo është e gjitha s'kemi ç' të bëjmë." Miqtë e mi, ju nuk duhet të vdisni kështu. Jezusi ofron falje të mëkateve. Është çlirimi më i madh që ju ka mundësi ta përjetoni. Dhe është e mundshme pikërisht tani.

Isha tetëmbëdhjetë vjeç kur mësova nga përvoja se ç'do të thotë falje e mëkateve. Zinxhiri im u këput dhe ra.

Pastaj, siç thotë himni: "Zemra ime ishte në liri. U ngrita, bëra përpara dhe të ndoqa Ty!"

Dëshira ime është që edhe ju të mund t'u vinit veshin këtyre fjalëve të jetës. Afrohuni pranë Jezusit sot. Ai po ju pret. Dhe i thoni atij, "Jeta ime është një rrëmujë e madhe. Kam bërë kaq shumë gabime. Kurrë nuk kam dashur ta pranoj këtë. Përkundrazi, gjithmonë kam lavdëruar vetveten. Tani po t'i sjell ty të gjitha gabimet e mia. Dhe dua të besoj se gjaku yt mund ta largojë mëkatin tim."

Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, jetonte në Angli një njeri me emrin Gjon Bunjan. Ai kaloi shumë vite të gjata në burg për shkak të besimit të tij. Disa gjëra nuk ndryshojnë kurrë! Pas Fjalës së Perëndisë, gjëja tjetër më e qëndrueshme në botë është burgu! Atje në qelinë e tij të burgut, Bunjani shkroi një libër të mrekullueshëm i cili është ende aktual sot - *Rruga e Shtegtarit.* Në të, ai e krahasonte jetën e të krishterit me një udhëtim plot me aventura dhe kurthe. Libri fillon kështu: Një njeri që jetonte në Qytetin e Shkatërrimit papritur pushtohet nga ankthi. Ai thotë me vete, "Çfarë nuk shkon? Unë nuk kam paqe dhe jam i mërzitur. Duhet të largohem nga këtu!" Ai ia thotë shqetësimin e tij së shoqes, por ajo

përgjigjet je bërë shunë nervoz. Ke nevojë për një pushim të mirë." Por kjo nuk i sjell atij ndonjë të mirë. Ankthi vazhdon. Pastaj një ditë ai thotë me vete, "S' vlen! Unë duhet të largohem nga ky qytet me çdo kusht!" Dhe largohet. Pas hapave të parë, ai bëhet i dijshëm për një barrë të rëndë mbi shpinën e tij. Kërkon ta heqë qafe por nuk mundet. Derisa nxiton, barra i bëhet më e rëndë. Para se të fillonte udhëtimin, ai veshtëri se e kishte ndier ndonjëherë peshën e saj. Ajo i dukej vetëm normale. Por kur ai largohet me nxitim nga Qyteti i Shkatërrimit, barra bëhet gjithnjë e më e rëndë. Më në fund ai me vështërsi e hedh njërën këmbë para tjetrës. Me mundim të madh, ai arrin t'i ngjitet një shtegu malor. Barra është pothuajse e padurueshme. Pastaj papritur, në një kthesë të shtegut, ai shikon një kryq para tij. Duke u ndier i pafuqishëm, ai rrëzohet përpara kryqit dhe duke e kapur atë fort, ngre sytë. Pikërisht në këtë moment, ai ndien barrën t'i rrokulliset nga shpina dhe e shikon atë të zhduket në humnerë me zhurmë të madhe.

Kjo histori është një ilustrim shumë i bukur i asaj që përjeton një njeri kur i afrohet kryqit të Jezu Krishtit.

Mbi atë kryq të Jezusit
Syri im shpesh shikon
Tamam formën që po vdes të Atij
Që vuajti atje për mua;
Dhe prej zemrës së goditur, në lot,
Dy çudira unë rrëfej -
Çudinë e dashurisë së Tij të lavdishme,
Dhe atë që unë nuk vlej.

Unë kam faljen e mëkateve sepse Shpëtimtari im vuajti në vendin tim. Zinxhiri i fajit tim është hequr. Barra ime është zhdukur. Vërtet, askush tjetër, por vetëm Jezusi është në gjendje të japë një dhuratë të këtillë: faljen e mëkateve tona.

Pse kam unë nevojë për Jezusin? Duhet të sjell para jush

akoma edhe një arsye tjetër se përse besoj në Të.

4. Jezusi është Bariu i Mirë

Në një moment apo në një tjetër, çdokush ndihet tmerrësisht i vetmuar dhe jeta duket tmerrësisht boshe. Pastaj ne papritur kuptojmë këtë: "Diçka mungon në jetën time. Por çfarë?" Ja t'jua tregoj unë. Juve ju mungon Shpëtimtari i gjallë!

Sapo ju kam thënë se Jezusi vdiq në kryq për të shlyer mëkatet tona. Vini re këtë varg: ***Ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të.*** Pasi ai vdiq, e shtrinë në një varr që ishte hapur në një shkëmb. Pastaj rrokullisën një rrasë të rëndë guri para hyrjes së varrit. Dhe për të qenë absolutisht i sigurtë, guvernatori romak vuri vulën e tij mbi të dhe vuri një skuadër ushtarësh romakë për ta ruajtur. Unë e marr me mend se kishte disa luftëtarë të paepur ndër ta të cilët kishin luftuar në të gjitha vendet e botës së njohur deri atëherë: Gali, Gjermani, Azi, Afrikë. Trupat e tyre ndoshta ishin dërmosur keq. Ditën e tretë, në agim, ata ishin të gjithë duke qëndruar përreth, me mburojat në krahë, me shtizat në dorën e djathtë dhe me helmetat në kokë. Një ushtari romak mund t'i besoje kur ishte rojë. Tani, Bibla thotë: ***Një engjëll i Zotit... rrokullisi gurin.*** Dhe Jezusi doli nga varri. Ishte një pamje kaq e tmerrshme sa që këtyre ushtarëve të paepur u ra të fikët. Disa orë më vonë Jezusi takoi një vajzë të varfër. Bibla thotë se Jezusi kishte larguar më parë prej saj shtatë demonë. Atë mëngjes vajza po qante me lot. Jezusi iu afrua. Por *asaj* nuk i ra të fikët! Përkundrazi, lotët e saj u kthyen në gëzim kur e njohu Zotin e ngritur dhe thirri ***Mësues!*** Ajo u qetësua sepse e dinte se Jezusi, Bariu i Mirë, jetonte dhe se ai ishte pranë saj.

E shikoni, është pikërisht për këtë arsye që edhe unë, dëshiroj kaq shumë ta kem Jezusin. Unë kam nevojë për dikë që të më zërë për dore. Jeta më ka tërhequr në ujëra të thella. Jam futur në burg nga nazistët për shkak të besimit tim. Atje, ndonjëherë, mendoja, "Një hap më tej, dhe ti do të fundosesh në errësirën e çmendurisë - dhe nuk do të jesh kurrë në gjendje t'u shpëtosh atyre." Por Jezusi më erdhi afër. Dhe çdo gjë u kthye në normale përsëri. Këtë mund ta dëshmoj.

Kalova një natë në burg kur dukej sikur gjithë djajtë kishin dalë nga skëterra. Kishte ardhur një grup të burgosurish të cilët ishin tranzit për në një kamp përqëndrimi. Njerëzve nuk u kishte mbetur asnjë shpresë. Ndër ta kishte edhe kriminelë edhe njerëz të pafajshëm - judenj. Atë natë të veçantë, ishte e shtunë, zemrat e tyre ishin mbushur me dëshpërim të thellë. Papritur ata të gjithë filluan të ulërinin me sa kishin në kokë. Nuk mund ta imagjinoni atë skenë. Një ndërtesë e tërë e mbushur me njerëz të dëshpëruar që bërtisnin dhe godisnin muret dhe dyert e qelive të tyre. Rojat qëlluan me armë në tavan dhe pastaj duke kaluar nga një qeli në tjetrën, filluan të fshikullonin me kamxhik majtas dhe djathtas. I ulur në qelinë time, thashë me vete, "Kështu duhet të jetë në ferr!" Është e vështirë ta përshkruash një skenë të tillë. Por pikërisht në atë moment, më erdhi mendimi, "Jezusi! Sigurisht që ai është këtu!" Më besoni, e kam përjetuar gjithë këtë që po ju tregoj. Brenda qelisë sime të burgut, pështpërita lehtë, shumë lehtë, "Jezus! Jezus! Jezus!" Dhe brenda tri minutash u rivendos qetësia.

E kuptoni? Unë i thirra atij. Askush përveç Jezusit nuk e dëgjoi atë - dhe demonëve iu desh të tërhiqeshin. Pastaj, megjithëse ishte rreptësisht e ndaluar, unë këndova me zë të lartë:

Jezus, i dashuri i shpirtit tim,
Më lër, në gjirin Tënd të fluturoj,

Kur ujërat përplasen me nxitim,
Kur shtrëngata ende të vazhdojë:
Më streho, O Shpëtimtari im, më streho,
Deri sa stuhia e jetës të marrë fund;
Të sigurt në strehim më drejto,
Oh, merre shpirtin tim më në fund!

Të gjithë të burgosurit e dëgjuan këtë këngë. Rojat nuk nxorën asnjë fjalë, madje as kur unë fillova të këndoja strofën e dytë:

Strehim tjetër unë s'kam
Shpirti im i pandihmë varet tek Ti;
Mos më lër vetëm aman,
Akoma më mbështet, m'jep rehati
Tërë besimi im tek Ti qëndron
Gjithë ndihma nga Ti m'vjen
Kokën pa mbrojtje ma mbulon
Me hijen e krahut Tënd.

Miqtë e mi, në atë rast, unë isha në gjendje të provoja se ç'do të thotë të kesh një Shpëtimtar të gjallë.

Unë tashmë kam përmendur tërthorazi faktin se ne të gjithë, një ditë, duhet të kalojmë nëpër atë krizë të gjithërëndësishme, vdekjen. Dikush një herë më qortoi duke më thënë, "Ju pastorët, gjithmonë i trembni njerëzit duke u folur për vdekjen." "Unë nuk kam nevojë ta nxit këtë lloj frike tek askush," iu përgjigja. "Ne të gjithë, nga natyra, kemi frikë të vdesim." Ç'ngushëllim, në momentin e vdekjes, të kesh mundësi të mbash dorën e Bariut të Mirë! Por njerëzit thonë - edhe unë besoj se është e vërtetë - "Sot, njeriu ka më pak frikë të vdesë se sa të jetojë. Jeta është shumë më e keqe për të se sa vdekja." Megjithatë, unë mund t'ju siguroj ju, miqtë e mi, se Jezusi gjithashtu do t'ju ndihmojë të jetoni.

Ka një histori tjetër të cilën duhet t'jua tregoj. Shpesh e kam përdorur atë si ilustrim. Është një tregim i pabesueshëm, e megjithatë është i vërtetë. U njoha me një industrialist në qytetin e Esenit. Ai ishte një nga ata njerëz që janë gjithmonë gjithë humor. Ai më thoshte, "Pastor, ti ke të drejtë që inkurajon të rinjtë për të jetuar në mënyrë të hijshme. Ja ku e ke një dhuratë prej 100 markash për punën tënde!" Por kur unë e pyesja se ku qëndronte ai përsa i përket besimit, ai do të përgjigjej shpejt, "Mos më bezdis, pastor. Kam nxjerrë konkluzionet e mia për botën!" Ai ishte një tip njeriu i tillë: njeri i mirë por, aq larg nga Perëndia sa ç'është lindja nga perëndimi.

Një ditë, m'u desh të bëja një martesë, gjë e cila nuk është gjithmonë shumë e këndshme në kishat tona të mëdha, të zbrazëta. Erdhi çifti i ri i shoqëruar nga rreth dhjetë njerëz të tjerë. Ata s'dukeshin hiç në atë kishë të stërmadhe. Miku im gazmor, industrialisti, ishte njëri nga dëshmitarët e çiftit. Më erdhi vërtet keq për të shkretin. Ai qëndronte atje me veshjen e tij elegante të mëngjesit, me kapelën cilindër në dorë, pa patur aspak dijeni se si duhej të sillej në kishë. Mund ta lexoje në fytyrën e tij se çfarë po mendonte: "Duhet të bie në gjunjë? Apo të bëj kryqin? As e di fare!" U përpoqa ta bëja të ndihej rehat duke ia marrë kapelën dhe duke e vënë mënjanë. Pastaj filluam të këndonim një himn. Ai nuk kishte as idenë më të vogël se si këndohej, por të paktën bëri gjoja sikur u bashkua me të tjerët! Vetëm përfytyrojeni. E megjithatë ai ndihej përsosmërisht rehat në çdo rreth të modës që shkonte.

Pastaj ndodhi një gjë tepër e jashtëzakonshme. Nusja ishte mësuese e Shkollës së së Dielës, kështu gjatë ceremonisë rreth tridhjetë vajza të vogla, lart në ballkon, filluan të këndonin një himn për të. Me zërat e tyre të ëmbël, fëminorë, ato filluan vargun e parë:

Shpëtimtar, si bari na udhëhiq ne,

Për kujdesin Tënd nevojë kem' shumë;
N'kullotat e Tua na ushqe ne...

I hodha një vështrim mikut tim dhe krejt papritur mendova, "Çfarë ka ai? Mos është i sëmurë?" Ai kishte pësuar një tronditje të thellë. Kishte mbuluar fytyrën me duar dhe dridhej. Mendimi im i parë ishte, "Diçka i ka ndodhur! Duhet të thërras shpejt një mjek." Por pikërisht atëherë vura re se po qante me ngashërim. Fëmijët vazhdonin të këndonin:

N'kullotat e Tua na ushqe ne,
Përgatit për ne vathet e Tua,
Jemi të Tutë: na miqëso ne,
Bëhu Rojtari i rrugës sonë;
Ruaje tufën Tënde, nga mëkati na mbro ne,
Na kërko kur rrugën e ngatërrojmë.

Dhe ja ku ishte ky njeri, ky biznesmen i madh, i ulur në stol, duke qarë.

Menjëherë e kuptova ç'kishte ndodhur. Ai duhet të ketë thënë me vete, "Këta fëmijë kanë diçka që unë nuk e kam: një Bari të Mirë. Unë jam një njeri i shkretë, i vetmuar, një njeri i humbur!"

Dhe ju gjithashtu, çfarëdo që të jeni, burrë apo grua, nuk do të shkoni shumë larg në qoftë se nuk mund të thoni me këta fëmijë: "Jam i lumtur që i përkas tufës së Zotit Jezus, që e kam atë Shpëtimtar e Bari." Jo, nuk do të shkoni shumë larg. Kështu përse nuk e merrni atë vendim jetësor i cili do t'ju japë mundësi t'i bëni këto fjalë tuajat?

Pse kam besuar unë në Jezu Krishtin? Sepse ai është Bariu i Mirë, Miku më i mirë, Shpëtimtari im i gjallë.

Pse kam nevojë për Jezusin? Do të doja të tërhiqja vëmendjen për një arsye të fundit:

5. Jezusi është Princi i Jetës

Shumë vjet më parë, organizova një kamp në pyllin e Bohemisë. Pasi ishin larguar të rinjtë, m'u desh të prisja një ditë të tërë që dikush të vinte dhe të më merrte me veturë. E kalova natën në një shtëpi të vjetër gjuetarësh, e cila, në kohët e shkuara, kishte qenë e një mbreti. Në atë kohë, banori i vetëm i saj ishte një rojtar pyjesh. Ndërtesa ishte gjysmë e rrënuar. Nuk kishte rrymë elektrike. Por kishte një dhomë pritjeje jashtëzakonisht të madhe, me një oxhak ku ishte ndezur një zjarr i vogël. Rojtari vuri një llambë me vajguri mbi tavolinë dhe më uroi natën e mirë. Jashtë stuhia ulërinte. Shiu binte me gjyma nëpër bredhat përreth shtëpisë. Ishte vendi dhe koha e përshtatshme që të përjetohet një rast misterioz.

Në fakt, pikërisht atë mbrëmje të veçantë, s'kisha asgjë me vete për të lexuar. Por pastaj zbulova një libër të vogël mbi buzën e oxhakut. Fillova t'i hedh një sy nëpër të në dritën e dobët dhe të valëvitur të llambës me vajguri. Kurrë nuk kisha lexuar ndonjë gjë kaq të frikshme. Në faqet e librit, një mjek zbrazte zemërimin e tij ndaj vdekjes. Faqe pas faqeje, kishte fragmente si: "O Vdekje, armiku më i keq i racës njerëzore! Luftova një javë të tërë për të rrëmbyer një jetë njerëzore nga kthetrat e tua dhe pikërisht kur unë mendova se ia kisha dalë mbanë, ti u ngrite në këmbë në anë të shtratit të tij dhe e mbërtheve atë me një ngërdheshje - dhe asgjë s'pati asnjë vlerë. Sado i shëroj njerëz, unë e di se kur ti vjen me dorën tënde skelet, lufta është e kotë. O Vdekje, ti je një mashtruese, një armike!" Ai shprehte kështu urrejtjen e tij të pashuar ndaj vdekjes në çdo faqe.

Pastaj vinte fragmenti më i keq: "O Vdekje, pikë, pikëçuditje!" Po e citoj me përpikmëri: "Mallkim! Ah sikur të ishe vetëm një pikëçuditje! Por kur të vështroj, ti kthehesh në një pikëpyetje. Dhe unë pyes veten nëse ti je ose jo një pikë! Nëse jo, atëherë çfarë? O Vdekje, pikëpyetje e neveritshme!"

Ja se deri ku mund të arrini! Por unë mund t'ju siguroj se jo çdo gjë mbaron me vdekjen. Jezusi, që dinte gjithçka për të, tha, ***E hapur është udha që të çon në shkatërrim... dhe e vështirë është rruga që të çon në jetë***. Shorti ynë vendoset këtu në tokë. Prandaj unë jam i kënaqur që kam një Shpëtimtar që jep jetë këtu tani - që është jeta dhe që të çon në jetë. Për këtë arsye unë dua t'ua predikoj këtë mesazh të tjerëve.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, ne luftuam për javë të tëra afër Verdunit në kohën kur zhvillohej një nga betejat më të tmerrshme. Kishte pirgje kufomash midis dy vijave kundërshtare. Dhe unë kurrë, gjatë gjithë jetës time, nuk kam mundur ta largoj atë erë të rëndë të atyre kufomave nga flegrat e hundës. Sa herë që qëndroj para një përmendo-reje lufte, e ndiej atë erë të keqe të Verdunit, atë kundërmim kufomash. Dhe sa herë që them me vete, "Brenda njëqind vjetësh, askush prej nesh nuk do të jetë më këtu," po e njëjta erë e tmerrshme e vdekjes më zë frymën. A nuk e ndieni edhe ju?

Por në këtë botë të vdekshme, është njëri që u ngrit nga të vdekurit! Dhe ai na thotë, "Unë jetoj, dhe ju do të jetoni gjithashtu! Besoni në mua! Ejani tek unë! Kthehuni tek unë! Hyni në mbretërinë time! Dhe unë do t'ju çoj në jetë."

A nuk është kjo e mrekullueshme? Si mund të jetoni ju në këtë botë të vdekshme pa këtë Shpëtimtar që është jetë dhe që të çon në jetën e përjetshme?

Para disa ditësh, lexova një letër të vjetër që e kishte

botuar profesor Karl Hajm. Ajo ishte shkruar nga një ushtar i krishterë që kishte dhënë jetën në Rusi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Letra thotë diçka të tillë: "Ajo që po ndodh përreth nesh është mizore. Kur rusët qëllojnë me raketat e tyre, ne na zë paniku. Dhe në këtë të ftohtë! Dhe me gjithë këtë dëborë! Është e tmerrshme. Por unë nuk kam frikë! Në qoftë se do të vdisja kjo do të ishte e mrekullueshme. Me një kërcim, do të hyja në lavdi. Trazira do të merrte fund - unë do ta shihja Zotin tim ballë për ballë dhe do të mbështillesha në shkëlqimin e tij. Jo, nuk do të kisha kundërshtim të vdisja këtu në fushën e betejës." Dhe pikërisht kjo gjë i ndodhi atij pak kohë më vonë. Nuk mund të mos mendoja, kur e lexova këtë letër, se ç'gjë e habitshme ishte që një i ri nuk kishte as frikën më të vogël nga vdekja, thjesht sepse ai e njihte Jezusin.

Po, Jezusi është Princi i Jetës. Dhe ai u jep të vetëve sigurinë e jetës së përjetshme.

Një vit, në ditën e përvjetorit të kishës në Lajpcig, u organizua një pritje në bashkinë e qytetit. Të gjithë njerëzit e rëndësishëm të qytetit dhe funksionarët e lartë të kishës ishin mbledhur aty së bashku. Fjalimet ishin sa të ishte e mundur të paanshme për të shmangur shkeljet në kallo të njëri-tjetrit. Hajnrih Gizen, i cili ishte atëherë sekretar i përgjithshëm i përvjetorit të kishës, kishte për ta mbyllur ceremoninë. Akoma e kam para sysh se si u ngrit në këmbë dhe tha, "Ju na pyesni, zotërinj, se ç'lloj njerëzish jemi ne? Po jua them me një fjali të shkurtër. Ne jemi njerëz që lutemi: 'Zoti im, më bëj të shenjtë që të mund të shkoj në qiell!'" Pastaj u ul. Ishte vërtet habitëse të shikoje se si një deklaratë e tillë e thjeshtë kishte trazuar thellësisht ata që ishin të pranishëm.

Vite më parë, një poet i krishterë shkroi këtë lutje:

Oh, lërmë t'i shoh gjurmët e Tua,
Dhe këmbët e mia të vë në ato vende;
Shpresa për të të ndjekur si duhet
Është vetëm në fuqinë Tënde.

Oh, drejtomë, thërritmë, tërhiqmë,
Më mbro deri në fund pa ngurrim;
Dhe pastaj në parajsë pritmë,
O Shpëtimtari im dhe Miku im!

Dëshira ime është që edhe ju, e vazhdofshi në këtë mënyrë udhëtimin nëpër këtë botë.

Pse keni nevojë për Jezusin? Sepse çdo gjë, absolutisht çdo gjë, varet nga marrëdhënia juaj me të!

CILI ËSHTË KURTIMI I JETËS SIME?

Gjithçka rrotullohet rreth kësaj pyetjeje: Ç'është jeta? Cili është kuptimi i jetës sime?

Një ditë mora një telefonatë nga një industrialist i pasur nga qyteti i Esenit. Ai ishte shumë i shqetësuar. "Pastor, të lutem eja menjëherë!" Sa hap e mbyll sytë u nisa dhe kur arrita më përshëndeti me këto fjalë, "Djali im ka vrarë veten!"

E njihja këtë të ri. Ishte student. Ai kishte çdo gjë që gjithkush mund të dëshironte në jetë: ishte i ri, i pasur dhe i pashëm, me shëndet shumë të mirë, kishte veturë personale, dhe kurrë nuk ishte përzier me ndonjë punë të dyshimtë. Dhe ishte ky i ri që sapo ia kishte futur kokës me plumb! Ai la këta pak rreshta për ta shpjeguar aktin e tij: "S'kam asnjë arsye të vazhdoj të jetoj më. Kështu po i jap fund jetës. Ajo s'ka aspak kuptim." A nuk është kjo një deklaratë që të shtang?

Shikoni shtrohet pyetja për kuptimin e jetës sonë – është me rëndesi të madhe?

Ajo bëhet akoma më e rëndësishme sepse ne kemi vetëm një jetë për të jetuar. Keni menduar ndonjëherë për pasojat personale të këtij fakti? Vetëm *një* jetë për të jetuar!

Kur isha nxënës shkolle, nuk isha shumë i mirë në aritmetikë. Mësuesi im nuk mundej ta kuptonte mënyrën time të gjetjes së zgjidhjes së problemeve. Kur e mbaroja detyrën e shtëpisë, ai ma shënonte fletoren me bojë të kuqe për të më treguar se sa pak e çmonte talentin tim për gjetjen e përgjigjeve të gabuara. Kur një fletore mbushej krejtësisht me të kuqe, unë e flakja tej, ndonjëherë edhe para se të mbarohej. Pastaj blija një tjetër. Ajo do të ishte e mirë, e re... dhe e pastër! Kështu mund të filloja sërish.

A nuk do të ishte e mrekullueshme në qoftë se do ta bënim

këtë me jetën tonë? Më besoni, miliona qenie njerëzore në portat e vdekjes u është dashur të pohojnë,
"Ah sikur ta filloja gjithçka edhe një herë nga fillimi! Do t'i bëja gjërat krejt ndryshe." Ne mund të blejmë një fletore të re dhe ta nisim nga fillimi, por nuk mund të bëjmë kështu me jetën tonë. *Ne kemi vetëm një jetë për të jetuar.* Sa e tmerrshme ta prishësh atë duke e përdorur në mënyrë të gabuar. Ne kemi vetëm një jetë për të jetuar. Në qoftë se e kemi humbur atë, e kemi humbur përgjithmonë. Ajo që kam për të thënë duhet të merret seriozisht. Ajo është një çështje jete a vdekjeje!

Sot në mëngjes një kope e madhe lopësh kaloi pranë hotelit ku rri unë. Mendova, "Këto lopë janë me fat. Ato s'kanë për të pyetur se pse janë në këtë botë. Për to është e qartë: ato janë këtu për të dhënë qumësht dhe kur nuk mund të japin më, sigurojnë mish." E kuptoni se ç'dua të them? Një kafshë s'ka pse të pyesë se ç'është jeta. Ky është ndryshimi midis njeriut dhe kafshës. Për fat të keq, një numër i madh njerëzish jetojnë - dhe vdesin - pa e pyetur ndonjëherë veten, "Cili është qëllimi i vërtetë i jetës sime?" Midis tyre dhe kafshëve, nuk ka ndryshim. Një njeri nuk do të jetë kurrë njeri i vërtetë deri sa ai ta ketë pyetur veten, "Ç'është jeta? Pse jam unë njeri? Cili është qëllimi i jetës sime?"

1. Përgjigjet e cekëta dhe pamend

Cili është qëllimi i jetës sime? Një varg i tërë përgjigjesh të cekëta dhe pamend mund të jepen për këtë pyetje. Shumë vjet më parë i dëgjova të gjitha në të njëjtën kohë. Ishte në vitin 1936 në kohën e Rajhut të Tretë. Disa studentë nga Mynsteri, në Vestfali, më kishin thënë të vija dhe të mbaja tek ata një diskutim grupi mbi temën: *Cili është qëllimi i jetës sime?* Ata ma bënë të qartë që në fillim se nuk donin një

predikim por një diskutim të hapur mbi këtë temë. "Mirë," u thashë, "do t'ju lë juve të filloni. Cili është qëllimi i jetës sonë? Pse jemi ne në tokë?"

Me që nazistët ishin në pushtet në kohën e këtij takimi, ishte e natyrshme që një i ri të çohej në këmbë dhe të deklaronte, "Unë jetoj për popullin tim. Është diçka si puna e gjethes me pemën. Gjethja nuk është asgjë, pema është gjithçka. Unë jetoj për popullin tim."

"Ashtu mund të jetë," iu përgjigja, "por më thuaj: përse është pema, për ç'qëllim ekziston *ajo*? Po njerëzit, pse ekzistojnë *ata*?" Heshtje. Ai nuk kishte përgjigje për këtë! Në vend që ta zgjidhte problemin, ai vetëm e kishte spostuar atë. Kështu u thashë atyre, "Miqtë e mi, ju po e shmangni pyetjen me përgjigje të tilla!"

"Cili është kuptimi i jetës? Pse jemi ne këtu në tokë?" pyeta përsëri. Një student tjetër deklaroi, "Unë jetoj për të bërë detyrën time." Kësaj iu përgjigja, "Kjo është rrënja e problemit. Pikërisht cila është detyra ime? Unë vetë, jam i bindur se detyra ime është t'ju predikoj juve Fjalën e Perëndisë. Matilda Ludendorf mendon se detyra e saj është të mohojë pikërisht ekzistencën e Perëndisë. Kështu ç'është detyra?"

Një zyrtar i lartë qeveritar më tha një ditë, "Pastor, ta themi midis nesh, unë nuk bëj asgjë por vetëm firmos letra nga mëngjesi deri në darkë. Por unë e di se në qoftë se të gjitha këto letra do të ndodhte që të digjeshin një ditë, bota do të vazhdonte të ekzistonte. Me të vërtetë më shqetëson fakti që kohën dhe energjitë e mia më duhet t'ia kushtoj një pune kaq pa kuptim."

Në fakt çfarë është detyra? Nën Rajhun e Tretë, mijëra esesë vranë qindra mijëra qenie njerëzore. Dhe kur dolën në gjyq, ata të gjithë thanë, "Ne bëmë vetëm detyrën. Kishim

urdhëra." A mendoni se është detyrë e një njeriu të vrasë qeniet si vetvetja? Unë vetë këtë nuk mund ta pranoj.

Pastaj u thashë këtyre studentëve, "Kjo është rrënja e çështjes. Ç'është detyra? Kush mund të ma thotë? Ja ku dolëm përsëri në një rrugë pa krye!"

Të rinjtë dukej sikur ranë në mendime. Pastaj njëri prej tyre u çua dhe me krenari u mburr, "Unë jam pjesëtar i një familjeje të vjetër aristokrate. Unë mund ta gjej prejardhjen e gjenealogjisë sime që në shekullin e gjashtëmbëdhjetë. Stërgjyshërit e mi ishin fisnikë nga origjina më e pastër. Përjetësimi i një prejardhjeje të tillë fisnike, a s'është një punë e mjaftueshme sa për të mbushur një jetë të tërë?" Nuk mund të rrija pa u përgjigjur, "Më fal! Por në qoftë se ti nuk e di se përse jetuan brezat e kaluar, atëherë nuk vlen të krijosh një tjetër!"

Është e qartë se mund të gjenden shumë përgjigje të cekëta dhe pa mend për pyetjen tonë.

Disa njoftime vdekjesh në gazetat tona fillojnë kështu:

Gjatë gjithë jetës kaq shumë punove,
Detyrën për ta shmangur,
kurrë s'e ëndërrove.
Veten tënde krejt e harrove
Dhe vetëm për të tjerët mendove.

Këto rreshta gjithmonë më luajnë mendsh! Nuk mund të mos mendoj, "Eh, kjo është një nekrologji për kuaj!" Mos e kam gabim? Një kalë s'mund të bëjë gjë tjetër por vetëm të punojë. Mua më duket se një qenie njerëzore nuk ndodhet në tokë vetëm të punojë si skllav gjatë gjithë jetës së tij. Kjo do të ishte vërtet shumë e trishtueshme. Në qoftë se kjo është jeta, atëherë do të ishte më mirë të vrisnim veten që në moshën dhjetë vjeçare. "Gjatë gjithë jetës kaq shumë punove...". Kjo më fut të dridhurat! Jo as kjo nuk është jeta!

Një student tjetër më tha gjatë diskutimit, "Shiko, unë do të bëhem mjek. Dhe nëse unë shpëtoj jetë njerëzore, a nuk është kjo një arsye e mirë për të jetuar?" Unë ia ktheva aty për aty, "Ajo që thua ti është e bukur, por, në qoftë se ti nuk e di se për ç'qëllim jeton një njeri, atëherë është pa kuptim të kërkosh t'i shpëtosh jetën atij. Do të ishte shumë më mirë t'i jepje atij një gjilpërë që të vdiste menjëherë." Tani, mos e keqinterpretoni atë që sapo thashë! Ajo që dua të them është se përgjigjja që dha studenti i mjekësisë nuk ishte vërtet një zgjidhje për problemin tonë - problemin se ç'është jeta.

I rrethuar nga gjithë këta studentë, u trondita vërtet kur kuptova se edhe të rinjtë e shkolluar si duhet, sot e lënë veten e tyre t'i rrëmbejë rryma pa e marrë vesh se pse janë në këtë botë.

E shihni, kur të keni kaluar atë që kaluam ne në Gjermani - vetëm dua ta përmend këtë kalimthi - është tunduese të përgjigjesh, si bënë disa studentë atje në Mynster, "Sidoqoftë jeta nuk ka asnjë kuptim të thellë. Ishte thjesht rastësi që unë linda. Kështu që pse të shqetësohesh për të kërkuar një arsye? Le ta shijojmë jetën plotësisht; kjo është gjëja më e mirë për të bërë."

Ky qëndrim është tundues për njeriun që papritur fillon të mendojë, "Jeta ime është absurde, është pa kuptim. Në qoftë se prindërit e mi nuk do të ishin martuar, unë nuk do të isha ngjizur dhe s'do të kisha lindur. Është thjesht rastësi që unë ekzistoj. Në të vërtetë, jeta ime është komplet absurde." Dhe në qoftë se ky njeri has vështirësi në jetë, ai është vetëm një hap larg nga vetëvrasja. Argumenti është: Pse të vazhdoj të jetoj? Nëse jeta nuk është asgjë por thjesht rastësi dhe absurditet, atëherë edhe unë më mirë po i jap fund.

A e dini se në Gjermaninë perëndimore përqindja e vetëvrasjeve është më e lartë se përqindja e aksidenteve fatale

rrugore? A e dinit se rreth 50% e viktimave janë të rinj nën moshën tridhjetë vjeçe? Kjo është dëshmia më rrënqethëse që brezi ynë nuk ka zbuluar se ç'është jeta.

Shpesh kam folur me njerëz që thonë, "Jeta është fare pa kuptim. Kështu që unë ose do ta kaloj atë duke e shijuar ose do t'i jap fund asaj duke bërë vetëvrasje." "Por," i kam pyetur unë, "sikur të supozojmë se në fund të fundit jeta ka një kuptim? Vetëm supozoni se ajo *ka* një qëllim dhe ju e keni kaluar jetën sikur ajo të mos kishte një të tillë? Ç'do të ndodhë me ju në fund të jetës suaj?"

Ka një varg në Bibël që do të na mbushte me frikë: ***Është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjykimi.*** Asnjë njeri nuk mund ta shqyrtojë me ndershmëri jetën e vet në qoftë se nuk është njohur me këtë të vërtetë biblike.

Cili është në fakt qëllimi i jetës sime? Si mund të vdes unë dhe të përballoj gjykimin e Perëndisë në qoftë se nuk kam arritur të shoh pikërisht kuptimin e jetës sime?

Kjo është ajo që përbën rrezik.

2. Kush mund të na japë një përgjigje?

Ç'është jeta? Kush mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje? Kisha ime? Jo. Prifti apo pastori im? Jo. Ai është në të njëjtën gjendje të vështirë që jam dhe unë. Shkencëtarët? Filozofët? Ata gjithashtu nuk janë në gjendje t'i përgjigjen pyetjes sonë. Vetëm njëri mund të na e tregojë. Ne ia detyrojmë vetë ekzistencën tonë atij. Ai është poai që na krijoi: *Perëndia.*

Do ta përdor një ilustrim tepër të trashë. Mendoni që një ditë unë hyj në apartament dhe gjej atje një djalë që po rri ulur, duke u marrë me disa tela dhe llamba. "Më thuaj," i them, "ç'lloj mekanizmi skëterre po bën? Çdo të dalë më në fund?" Ai përpiqet të më shpjegojë gjithçka, por duhet të

pranoj se nuk kuptoj asgjë. Dhe nga brenda mendoj, "Askush nuk mund ta kuptojë se çfarë do të jetë. Vetëm shpikësi mund ta dijë se përse është dhe si duhet të përdoret."

E njëjta gjë ndodh edhe me jetën tonë. Vetëm ai që na krijoi mund të thotë pse na krijoi. Me fjalë të tjera, është vetëm me anë të zbulesës që marrim një përgjigje për pyetjen tonë: Ç'është jeta? Perëndia duhet të na e japë atë.

Në qoftë se tashmë nuk do të isha një lexues i kujdesshëm i Biblës, vetë kjo pyetje do të më detyronte ta lexoja atë. Personalisht, për mua do të ishte e padurueshme të mos e dija se përse ndodhem në këtë botë të mallkuar. Mos vallë shprehja "botë e mallkuar" duket tepër e fortë për ju? Ajo gjendet në Bibël. Nga ana tjetër, ju vetëm duhet të kaloni gjashtë muaj me një pastor në një nga qytetet tona të mëdha për ta kuptuar se çfarë dua të them kur deklaroj se bota është nën një mallkim të madh. Nuk do të mund ta duroja jetën nëse nuk e dija përgjigjen e dhënë nëpërmjet zbulesës së Perëndisë.

Po, Perëndia i përgjigjet pyetjes sonë se ç'është jeta. Ai e bën këtë në Bibël. Dhe kjo është arsyeja që Bibla është kaq e rëndësishme. Njoh njerëz që marrin një pamje superioriteti dhe thonë, "Por ne nuk e lexojmë Biblën!" Atyre unë vetëm mund t'u them, "Atëherë me sa shoh unë, ju kurrë nuk keni menduar seriozisht për pyetjen se ç'është jeta." Budallallëku është një sëmundje shumë e përhapur dhe në qoftë se do të shkaktonte dhimbje, gjithë bota do të oshëtinte nga klithmat e dhimbjes.

Do ta përmbledh përgjigjen e Biblës në një fjali: Perëndia na krijoi që ne të mund të bëhemi fëmijët e tij. Ashtu si një baba që kërkon ta shohë veten e tij tek i biri, po ashtu ai e bëri njeriun ***sipas shëmbëlltyrës së vet***. Perëndia kërkon që ne të bëhemi fëmijët e tij, fëmijë që do të flasin me të dhe me

të cilët ai do të flasë; fëmijë që do ta duan atë dhe të cilët ai do t'i dojë. A luteni ndonjëherë? Është një gjë e tmerrshme për një baba në qoftë se i biri nuk i ka folur për vite të tëra. Dhe në qoftë se një njeri nuk lutet, atëherë ai nuk flet me Atin e tij qiellor. Po, Perëndia do të donte që ne të ishim fëmijët e tij: fëmijë që të flisnim me të, që ta donim atë dhe që ai të na donte. Ky është kuptimi i ekzistencës sonë. Unë nuk po flas për kishën, për doktrinën apo për fenë. Unë po flas për Perëndinë e gjallë!

Perëndia të krijoi që të mund të bëhesh fëmija i tij. A je ti fëmija i tij?

Duhet të shkoj një hap më tej. Ne duhet të *bëhemi* fëmijët e Perëndisë. Ne nuk jemi lindur fëmijë të Perëndisë. Pikërisht në fillim të Biblës, thuhet: ***Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet***. Pastaj vazhdon për të treguar për një fatkeqësi të madhe: Perëndia e kishte krijuar njeriun një qenie të lirë, me aftësinë për të zgjedhur midis së mirës dhe së keqes. Por njeriu zgjodhi të ishte kundër Perëndisë. Ai hëngri frutën e ndaluar. Kjo qe mënyra e tij për t'i thënë Perëndisë, "Dua të jem i pavarur. Unë mund të bëj edhe pa ty." Adami nuk e vuri në dyshim ekzistencën e Perëndisë. Ai vetëm donte t'i shpëtonte autoritetit të tij. "Dua të shikoj punën time!"

Një ditë më ndaloi një njeri në rrugë. "Ti flet gjithë kohën për Perëndinë," më tha. "Por unë nuk mund ta shoh Perëndinë. Më thuaj si ta gjej." Iu përgjigja, "Dëgjo me kujdes atë që do të të them. Vetëm supozo se ka një makinë që do të mund të më çonte mua prapa në kohë. Supozo se unë u ktheva pikërisht në fillim të historisë njerëzore dhe se një mbrëmje po shëtis në kopshtin e Perëndisë. (Ti ndoshta e di historinë e Rënies.) Mirë, aty takoj Adamin, njeriun e parë. 'Mirëmbrëma Adam,' i them. 'Mirëmbrëma pastor Bush,' përgjigjet ai. Pastaj unë i shpjegoj se si erdha në Kopshtin e

Edenit. 'Më dukesh i menduar,' thotë Adami. 'Ç'po mendon?' Unë i përgjigjem, 'Oh, sapo isha duke menduar për një pyetje që më bëri një njeri kohët e fundit: Si mund ta gjej Perëndinë?' Adami ia shkrep të qeshurit. 'Si ta *gjesh* Perëndinë nuk është problem në të vërtetë. Ai është këtu. Tregohu i sinqertë. Ajo që ju preokupon ju të gjithëve është se si ta *hiqni qafe*! Por ju nuk mund ta hiqni qafe atë. Ky është problemi më i madh!'"

A mund të kishte të drejtë Adami? Perëndia është këtu. Ne mund ta gjejmë atë. Por nuk mund ta heqim qafe atë.

Kur mendoj për evolucionin e mendimit njerëzor në tre shekujt e kaluar, mund të shoh se ne kemi provuar çdo gjë për t'u çliruar nga Perëndia. Por nuk kemi patur sukses. Në realitet ne të gjithë besojmë se Perëndia ekziston, por ne thjesht nuk duam të kemi të bëjmë me të. Ne vetëm kopjojmë gjithë të tjerët: E lëmë pyetjen për Perëndinë pa përgjigje. Ne nuk e mohojmë ekzistencën e Perëndisë, por nuk duam ta vrasim mendjen për të. Ne nuk do ta përshkruanim veten tonë si armiq të tij, por as miqtë e tij nuk jemi.

Problemi më i madh në jetë ende mbetet për t'u zgjidhur.

Një mjek zviceran deklaron në një nga librat e tij se në qoftë se një njeri nuk e zgjidh çështjen e rëndësishme të jetës, ai do të pësojë shqetësime të thella mendore dhe emocionale. Ai vazhdon duke thënë, "Ne perëndimorët, vuajmë nga mungesa e Perëndisë. Ne nuk e mohojmë ekzistencën e tij, por nuk kemi asnjë marrëdhënie me të. Ne nuk duam të kemi të bëjmë me të dhe prandaj vuajmë nga mungesa e Perëndisë." Unë kam të njëjtin mendim me të.

Pothuajse kudo dëgjoj njerëz të thonë, "Njeriu modern nuk interesohet për Perëndinë." Unë vetëm mund të përgjigjem kështu, "Gjendja e njeriut modern është shumë serioze. Edhe unë jam njeri modern, por interesohem për

Perëndinë. Unë nuk besoj se jam i modës së vjetër për këtë gjë! Është një fakt shumë alarmues që njerëzit sot nuk e marrin çështjen e shpëtimit aspak seriozisht."

Do të përdor edhe një herë një ilustrim tepër të trashë. Përpiquni të përfytyroni një kuzhinier nxënës në zanat. Një ditë unë dëgjoj kryekuzhinierin të thotë, "Ai djalë nuk interesohet aspak për gatimin!" Kështu unë pyes, "Mirë, përse interesohet ai atëherë?" Ai përgjigjet, "Për muzikën pop dhe për vajza!" "Duhet ta ulësh veten në nivelin e tij," i them, "dhe që tani e tutje bisedo me të vetëm për muzikën pop dhe për vajza!" "Jo për kokën tënde!" ma kthen kryekuzhinieri. "Në qoftë se ai djalë nuk ka interes për gatimin, atëherë ai nuk e ka arritur zanatin që i duhej."

A mund ta kuptoni çështjen që dua ta prek? Zanati ynë është që të bëhemi fëmijë të Perëndisë. Kur njeriu modern nuk tregon asnjë interes për këtë, atëherë ai nuk e ka arritur "zanatin" e tij si njeri. Në këto rrethana është pa vlerë të diskutosh të gjitha llojet e gjërave të mundshme dhe të pamundshme me të, madje edhe në qoftë se kjo temë i intereson atij. Atij i duhet thënë herë pas here: "Ti do të fillosh të jesh njeri i vërtetë vetëm kur të jesh bërë fëmijë i Perëndisë."

3. Përgjigja e Perëndisë

Dua të përsëris se ne nuk jemi lindur fëmijë të Perëndisë, por që të*lindemi* i jetës është të *bëhemi* fëmijë të Perëndisë. Atëherë, neve, ka për të na ndodhur diçka.

Mendoni seriozisht për gjithë këtë.

Duhet t'i bëjmë ballë kësaj: ne nuk jemi fëmijë të Perëndisë, nuk e duam Perëndinë, i thyejmë urdhërimet e tij, nuk pyesim fare për të, nuk lutemi - megjithëse në rast nevoje mund t'i biem ziles së alarmit! Kështu është e domosdoshme

për ne të dimë përgjigjen e pyetjes më të madhe nga të gjitha: Si mund të bëhem unë fëmijë i Perëndisë?

Disa do të thoshin, "Duke qenë i mirë." Të tjerë, "Duke besuar te Perëndia." Por e gjithë kjo nuk mjafton!

Pyetja jonë nuk ka marrë përgjigje.

Si bëhem unë fëmijë i Perëndisë?

Përgjigjja për këtë pyetje tejet të rëndësishme mund të merret vetëm nëpërmjet zbulesës. Kjo do të thotë se vetë Perëndia duhet të më tregojë mua se si mund të bëhem fëmija i tij. Asnjë njeri - madje as një pastor - nuk mund ta sajojë atë. Bibla jep një përgjigje shumë të qartë. Ja tek është: vetëm nëpërmjet Jezusit! Po; për t'u bërë fëmijë i Perëndisë, unë duhet t'i afrohem Perëndisë nëpërmjet Jezusit.

Ka një varg në Bibël i cili, i përkthyer fjalë për fjalë, lexohet kështu: "Jezusi erdhi nga bota e Perëndisë në këtë botë." Sot ne dëgjojmë në mënyrë të përsëritur se Bibla bazohet mbi një pikëpamje të vjetëruar për botën. Çfarë gabimi! Ajo na tregon gjëra të domosdoshme për Perëndinë dhe për veten tonë. Ajo na tregon se Perëndia është i pranishëm kudo. Edhe në qoftë se fshihesha në thellësitë e tokës, Perëndia do të ishte atje. Bibla përmban atë që ne e quajmë në gjuhë moderne një pikëpamje shumë-dimensionale të botës. Ne jetojmë në një botë tri-dimensionale. Ka gjatësi, lartësi dhe thellësi. Por ekzistojnë dimensione të tjera. Dhe Perëndia është një dimension tjetër. Ai është shumë afër, sa një e zgjatur e dorës. Ai na shoqëron. Ai na shikon kur ecim në rrugë të gabuar. Por është e pamundur për ne që ta shembim pengesën që na ndan prej këtij dimensioni tjetër. Vetëm Perëndia është në gjendje ta bëjë këtë. Dhe ai e shembi atë duke ardhur te ne në personin e Jezusit.

Një varg tjetër në Dhiatën e Re, i përkthyer fjalë për fjalë,

thotë kështu për Jezusin: ***Ai erdhi në shtëpinë e vet***, - dhe vërtet bota i përket atij - ***dhe të vetët nuk e pranuan***. Këtu kemi tërë historinë e ungjillit deri në ditët tona. Jezusi vjen dhe njeriu refuzon ta lërë atë të hyjë. ***Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan***. Nga këndvështrimi njerëzor, kjo është pa rrugëdalje dhe duhet t'u jepet fund marrëdhënieve të Perëndisë me njeriun. Por - sa e habitshme - historia nuk ndalon aty! ***Por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë***. Pra, duke pranuar Jezusin, ne mund të bëhemi fëmijë të Perëndisë.

A ia keni hapur deri tani derën e jetës suaj atij? ***Të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë***.

Gjatë Luftës së Parë Botërore unë isha oficer i ri dhe jetoja larg nga Perëndia. Megjithatë, në atë periudhë të veçantë të jetës sime ia hapa zemrën Jezusit dhe e lashë të hynte. Kjo përvojë e ndryshoi plotësisht ekzistencën time. Qysh atëherë nuk kam pasur as brejtjen më të vogël të ndërgjegjes për këtë gjë. Edhe pse për të ndjekur Jezusin më është dashur të shkel në shumë shtigje të vështira. Kam qenë në burg. Dhe në mjaft raste kam qenë në gjendje shqetësimi. Por edhe sikur të kisha njëqind jetë për të jetuar, sapo të kisha aftësinë për të menduar drejt, çdo herë do të kapesha pas këtij vargu: ***Të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë***. Pse? Sepse që nga çasti që unë bëhem fëmijë i Perëndisë, jeta ime merr kuptim. Nuk përbën asnjë ndryshim ajo se kush jam: qofsha pastor apo pastrues rrugësh, menaxher apo bravapunues, grua shtëpiake apo mësues, jeta ime merr kuptim vetëm nga momenti që bëhem fëmijë i Perëndisë.

Po, ju duhet ta lini Jezusin të hyjë në jetën tuaj. Vetëm atëherë ajo do të ketë qëllim të vërtetë.

Është interesante t'i studiosh karakteret e Dhiatës së Re

nën dritën e kësaj çështjeje. Merrni për shembull Maria Magdalenën. Jeta e saj nuk kishte asnjë kuptim fare. Thuhet për të - i vetmi aluzion për të kaluarën e saj - se ajo ishte e pushtuar nga shtatë frymëra të këqija. (Unë personalisht njoh disa njerëz të cilët janë të pushtuar nga shumë më tepër se shtatë frymëra të këqija.) Duhet të ketë qenë e tmerrshme: një jetë e dominuar nga shqisat, një jetë skllavërie. Gruaja e shkretë duhet të ketë vuajtur shumë duke përjetuar një ekzistencë kaq pa kuptim. Dhe pastaj një ditë, Jezusi, Shpëtimtari, Biri i Perëndisë, hyri në jetën e saj dhe i përzuri frymërat e këqija. Ai mund ta bëjë dhe e bëri këtë gjë! Që nga ai moment, Maria i përkiste Jezusit. Më në fund jeta e saj kishte një qëllim. Por erdhi dita kur Maria Magdalena qe dëshmitare e kryqëzimit dhe vdekjes së Jezusit. Atë ditë asaj i hyri një frikë e papritur - një frikë se mos fillonte përsëri jeta e saj e kaluar. Mëngjesin e ditës së tretë pas kryqëzimit, ajo ishte në gjunjë, duke qarë, në kopshtin ku Jezusi ishte varrosur në një varr në shkëmb. Ajo kishte ardhur te varri dhe e kishte gjetur atë të zbrazët. Guri ishte rrokullisur tej dhe nuk kishte asnjë gjurmë të trupit të Jezusit. Prandaj ajo po qante.

Unë e kuptoj atë fare mirë. Sepse nëse do ta humbisja Jezusin, kjo gjë do të më çonte edhe mua në thellësirat e një ekzistence pa kuptim. Po, unë e kuptoj atë. "Zoti shkoi e vate! Jeta ime s'ka më kuptim."

Por papritur, ajo dëgjoi një zë nga pas, ***Mari!*** Ajo u kthye dhe pa Jezusin e ngritur që qëndronte para saj. Lotët e dëshpërimit që u rridhnin faqeve u kthyen në lotë gëzimi. Dhe një britmë i doli nga thellësia e shpirtit, ***Rabboni!... Mësues!***

Historia e kësaj gruaje është konfirmim që ne nuk kemi nevojë për teoritë e mëdha të filozofisë për të gjetur

përgjigjen e problemit se ç'është jeta. Edhe një analfabet e di si fakt se jeta e tij nuk ka asnjë kuptim. Dhe ai gjithashtu pyet veten, "Cili është qëllimi i jetës sime?" Mos vallë ai kërkon përgjigje për këtë pyetje? Atij i duhet vetëm të pranojë Jezusin. Pastaj, ashtu si ajo, ai do të bëhet fëmijë i Perëndisë. Dhe jeta e tij, si e Marisë, do të jetohet që atëherë e tutje në dritën e një plani të thellë ngazëllues, pra plani i Perëndisë.

Miku im, unë të nxit që edhe ti ta pranosh Jezusin. Ai po të pret. Fol me të. Ai është shumë afër teje. Ti vetëm duhet të thuash, "Zoti Jezus, jeta ime nuk ka kuptim! Eja tek unë."

Kur e pranoj Jezusin, një revolucion i vërtetë fillon në jetën time. Unë korr gjithë të mirat që vijnë nga vdekja e Jezusit: vdekja e tij i jep një goditje përfundimtare jetës sime të kaluar; unë gjithashtu ngrihem bashkë me të dhe jetoj një jetë të re, jetën e një fëmije të Perëndisë; ai më jep Frymën e tij, i cili m'i ndryshon dëshirat dhe madje edhe mënyrën time të të menduarit. Pranojeni Jezusin, dhe do të mësoni për këto gjëra nga përvoja.

Po, është e vërtetë; ai që e pranon Jezusin fillon një jetë plotësisht të re. Të bëhesh një fëmijë i Perëndisë do të thotë se ndryshon jo vetëm mënyra jonë e të menduarit, por gjithashtu e tërë mënyra jonë e të jetuarit.

Në shekullin e kaluar, jetonte në Vestfali një këpucar me emrin Rahlenbek. Njerëzit ia kishin vënë nofkën "Predikuesi i devotshëm" për shkak të dëshirës së tij të madhe për të ndjekur Jezusin. Ai ishte një njeri me një mprehtësi të madhe shpirtërore, një njeri i bekuar nga Perëndia. Një pastor i ri i erdhi një ditë për vizitë. "Pastor," i tha Rahlenbeku, "studimet e tua teologjike nuk garantojnë shpëtim. Ti duhet të pranosh Jezusin!" Pastori i ri u përgjigj, "Po unë e kam Jezusin. Piktura e tij varet në murin e studios sime." Rahlenbeku plak ia kthehu, "Jezusi është shumë i heshtur dhe i qetë në murin e studios sate. Por në qoftë se e lë atë të hyjë në jetën tënde,

atëherë do të ketë shumë zhurmë!"

Shpresoj se do të ketë shumë zhurmë në jetën tuaj. Shpresoj se do të jeni në gjendje t'i vini kryq së kaluarës suaj dhe të lavdëroni Atin tuaj qiellor që ju bëri fëmijën e tij, që i dha qëllim jetës suaj dhe që ju jep mundësi që tani e tutje ta nderoni atë në fjalë, mendim dhe vepër.

A e keni kuptuar se kjo për të cilën po flas nuk është një çmenduri fetare apo mendim personal i një pastori, por një çështje jete a vdekjeje, jete të përjetshme a dënimi të përjetshëm?

Zoti Jezus thotë, ***Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai.*** Ai jua thotë këtë edhe juve.

Një ditë erdhi më kërkoi një minator i vjetër dhe më tha, "Pastor, duhet të bisedoj me ty." Ai i kishte kaluar të shtatëdhjetat. "Kam marrë pjesë në një takim ungjillor kur isha shtatëmbëdhjetë vjeç. Atje ndjeva se Jezusi po trokiste në derë. Por mendova, 'Patjetër që të gjithë shokët e mi do të tallen me mua nëse i marr seriozisht të gjitha këto gjëra dhe e pranoj Jezusin! Jo, s'e bëj dot!' Dhe dola me vrap jashtë." Si përfundim ai tha, "Ja ku jam në fund të jetës sime. Jam plak dhe e kuptoj se jeta ime ka qenë një dështim. Është dështim sepse në atë rast të veçantë unë nuk ia hapa derën Jezusit."

Ne kemi vetëm një jetë për të jetuar! Pikërisht për këtë arsye pyetja jonë - Ç'është jeta? - është me rëndësi parësore. Perëndia i ka dhënë asaj një përgjigje të qartë dhe të thjeshtë. Përgjigjja është në Jezusin, të Kryqëzuarin dhe të Ngriturin.

Ky Jezus po qëndron tani te dera juaj. Ai po troket. Hapjani derën dhe faljani jetën tuaj atij.

Kurrë nuk do të pendoheni për këtë!

NUK KAM KOHË!

"Duhet të vish të dëgjosh pastor Bushin kur flet!" Sa shpesh një ftesë si kjo ndeshet me përgjigjen: "Më vjen keq, por nuk kam kohë!"

Një herë m'u desh të rrija për pak kohë në një shtëpi konvaleshence. Një zotëri i thyer në moshë ulej përballë meje në kohën e ngrënies së ushqimit. Ia kalonim shumë mirë së bashku. "Ja ku është një që e shijon jetën!" mendoja gjithmonë kur shikoja se sa shumë e shijonte ky plak hijerëndë ushqimin, ose kur e vështroja se si kotej qetësisht në diell. Megjithatë, derisa koha kalonte, cektësia e bisedave tona filloi të rëndonte mbi mua.

Ju mund të pyesni, "Ç'të keqe ka kjo?" Epo, puna është kështu: për mua, Perëndia është realiteti më i madh në jetë. Jeta ime ndryshoi tërësisht kur kuptova veprën e madhe që kishte kryer ai: ***Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.*** Është e vështirë të shohësh dikë që ta lërë pas dore një shpëtim të tillë ditë për ditë. Me sa dukej kështu ishte puna me mikun tim të moshuar. Pyesja veten se si do të ndihej ai kur t'i vinte radha për të qëndruar para Perëndisë të Plotfuqishëm.

Një ditë në tavolinën e ngrënies, i dhashë një broshurë të vogël që kisha shkruar dhe i thashë, "Do të dëshiroja që ta lexoje këtë libër të vogël. Është një koleksion tregimesh mbi disa përvoja njerëzish në lidhje me Perëndinë. Ai duhet të të japë diçka për të cilën të shtyn të mendosh." A e dini se si qe reagimi i tij? Më falënderoi ngrohtësisht e pastaj tha, "Unë kam ardhur këtu për të rimarrë veten. Por ndoshta kur të kthehem në shtëpi do të gjej një moment për ta lexuar broshurën tënde." Dhe e la atë mënjanë.

U trishtova shumë, sepse e dija se ky njeri nuk do të kishte

kurrë aq shumë kohë të lirë sa kishte atëherë. E vërteta e problemit ishte se ai thjesht nuk donte të zinte kohë për Perëndinë.

1. Një situatë e çuditshme

Pse ndodh që ne kurrë nuk kemi kohë? Para së gjithash dua t'ju tërheq vëmendjen për një situatë të çuditshme që gjithmonë më ka bërë të vras mendjen dhe që askush nuk ka qenë në gjendje të ma shpjegojë.

Para njëqind vjetësh kur një tregtar që jetonte në Shtutgart kishte për të bërë disa punë tregtie në Esen, i duheshin pesë ditë për të shkuar atje me karrocën e postës dhe pesë ditë për t'u kthyer. Kjo bënte gjithsej dhjetë ditë udhëtim, dhe le të themi, edhe dy ditë të tjera bisedime për të përfunduar biznesin e tij. Sot, një biznesmen, bën vetëm një telefonatë dhe ka kursyer dymbëdhjetë ditë. E megjithatë, kam përshtypjen se as edhe një i vetëm nga biznesmenët që njoh unë ka dymbëdhjetë ditë për t'i patur kohë të lirë! Ata gjithë e më tepër më thonë, "Nuk kam kohë!" Pse ndodh kjo?

Kur isha i vogël shkoja te gjyshërit e mi. Ata jetonin në Jurën Svabiane. Ishte ekspeditë e vërtetë në ato ditë të shkoje me tren nga Elbervelti në Urah. Sot, me ekspresin trans-evropian, i njëjti udhëtim mund të bëhet për pesë orë.

Sigurisht njerëzit sot duhet të kenë shumë më tepër kohë të lirë! Vite më parë kishim javën gjashtëdhjetë orëshe të punës. Tani kemi një javë dyzet orëshe (madje ndonjëherë edhe më pak). Megjithatë, askush nuk ka kohë! Pse ndodh kjo?

Në ditët tona, çdo gjë është bërë për ta bërë jetën më të lehtë. Mamaja ime lexonte katër kapituj nga Bibla çdo ditë dhe gjithashtu gjente kohë çdo ditë për t'u lutur për familjen e saj. Atëherë nuk kishte as makina larëse apo pajisje elektro-

shtëpiake. Asaj i duhej të kujdesej për tetë fëmijë. Rrobat e tyre nuk liheshin të thaheshin pa u shpëlarë e shtrydhur mirë. Asaj i duhej të arnonte edhe gjithë çorapet e tyre! E megjithatë ajo kishte kohë për të lexuar katër kapitujt e saj të Biblës çdo ditë.

A e keni ju kohën për ta bërë këtë? Ndoshta jo!

Pse ndodh kjo?

Përpjekje të mëdha bëhen sot për të na kursyer kohë - e megjithatë askush nuk ka kohë të lirë! A mund ta shpjegoni këtë? Kam menduar për këtë problem herë pas here, por thjesht nuk mund ta kuptoj atë në mënyrë të qartë.

I vetmi shpjegim që mund të gjej - e di që njerëzit nuk do të duan ta dëgjojnë, por unë nuk mund të sugjeroj tjetër - është se në prapaskenë ndodhet Dikush që nuk na lë të qetë. Ky Dikushi i rregullon rrethanat në mënyrë të atillë që të mos kemi kurrë kohë. Ky Dikushi, si një zbutës luanësh në cirk, kurrë nuk pushon së fshikulluari kamxhikun për të na mbajtur "në lëvizje".

Bibla thotë pikërisht të njëjtën gjë. Ky Dikushi ekziston vërtet... ai është Djalli! Pavarësisht se cili mund të jetë mendimi juaj për këtë, "fuqitë e errësirës" ekzistojnë në fakt.

Një njeri më tha tani së fundi se kishte hequr dorë nga krishterimi. I thashë, "Po bën një gabim të madh. Djalli të ka vënë nën kontrollin e tij. Ai do të të marrë në qafë!" Duke buzëqeshur, ai m'u përgjigj, "Djalli as që ekziston more!"

Bibla na tregon se Jezusi u çua nga Djalli deri në majën e një mali shumë të lartë. Para tyre shtrihej një pamje e gjithë rajonit. Djalli "hapi perdet" dhe Jezusi qe në gjendje të shikonte, në frymë, të gjitha mbretëritë e botës dhe lavdinë e tyre. Pastaj Djalli i tha Jezusit, ***Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse m'u dha mua në dorë dhe unë ia jap kujt të dua. Në qoftë***

se ti, pra... më adhuron, do të jetë krejt jotja. Kjo pjesë e Biblës më prek thellë. Zoti Jezus nuk e kundërshtoi Djallin. Ai e pranoi që Djalli sundon mbi këtë botë.

Le t'ju jap dy a tre shembuj për të ilustruar këtë. Mendoj për numrin e madh të burrave dhe grave që janë skllevër të veseve të tyre. Një herë më trokitën në derë në mes të natës. Aty qëndronte menaxheri i një fabrike lokale. Ishte e qartë se kishte pirë rëndë, por mendjen e kishte ende aq të kthjellët sa për të qenë në gjendje të thërriste, "Të lutem, më ndihmo! *Duhet* të pi, nuk kam se ç'të bëj! Im at ka qenë alkoolist. E kam trashëguar prej tij. Nuk kam se çfarë të bëj!"

Kurrë nuk do ta marrim vesh se sa njerëz psherëtijnë thellë në zemrat e tyre, "Nuk kam se ç'të bëj!" Kush sundon mbi ta me shkop të hekurt? Vëzhgoni më nga afër gjithë mjerimin e botës sot dhe do të konkludoni se ajo që thotë Bibla është e vërtetë: forcat e errësirës ekzistojnë!

Mendoni për një çast për gjithë çrregullimin seksual të ditëve tona. Njihja një burrë që kishte një familje të këndshme dhe një grua të dashur. Një ditë ai ra nën aftësinë tërheqëse të njërës prej punonjëseve të tij. Shkova për një vizitë tek ai. "Miku im," i thashë, "ti je në procesin e shkatërrimit të jetës dhe të familjes sate, dhe të humbjes së respektit të fëmijëve të tu." Ende e kam parasysh këtë menaxher industrialist të ulur para meje, dhe ende dëgjoj përgjigjen e tij të mjerë. "Pastor, nuk e lë dot atë vajzë. Vërtet nuk mundem!" Në situata të tilla, a nuk mund ta ndiejmë lakun e forcave të errësirës?

Shkrimtari i njohur anglez, Somerset Mom, shkroi një libër të rëndësishëm me titull: *Mbi Skllavërinë Njerëzore*. Sa me lehtësi e lënë njerëzit veten të jetojnë në gjendje të nënshtruar. Ju të moshuarit mund ta mbani mend se si iu nënshtruat Hitlerit. "Besova se dy herë dy bënin njëzet," kanë pranuar shumë veta qysh atëherë. "E besova këtë sepse

kështu kishte thënë Fyhreri!"

Nuk mund ta mohoni ekzistencën e forcave të errësirës. Nuk mund ta mohoni ekzistencën e Djallit.

Gëtja, poeti i madh gjerman, shkroi një dramë që të hyn në zemër që quhet *Fausti.* Një vajzë e re, Greçeni, është një nga personazhet kryesore në dramë. Ajo ishte një vajzë e re e pastër. Pastaj dikush e joshi duke kryer marrëdhënie me të. Vëllai i saj, duke dashur të hakmerrej për nderin e saj, u vra në dyluftim me mashtruesin e motrës së tij. Më vonë, me qëllim që dashnori i saj të vinte tek ajo, Greçeni i dha së ëmës për të pirë një ilaç qetësues. Por pija i shkaktoi vdekjen. Dhe kur i lindi fëmija që priste, Greçeni e vrau.

(Gratë në ditët tona, me që ra fjala, bëjnë pikërisht të njëjtën gjë kur abortojnë. Ato janë fajtore për një shkelje shumë të rëndë.)

Në fund të dramës, vajza e re qëndron atje - ajo ka qenë përgjegjëse për tri vdekje - dhe thotë një gjë tronditëse, "Pse më shtyre ta bëj këtë, Perëndia im, ishte aq bukur, aq mirë!"

Gëtja nuk ishte budalla. Ai e bëri të qartë te *Fausti* se Djalli e kishte manipuluar tërë punën.

Si pastor që punoj në një qytet të madh, vazhdimisht ndeshem me këtë lloj problemi. Kur dikush më thotë, "Nuk ka Djall," nuk mund të rri pa e pyetur, "Nga cila zonë e thellë e vendit vjen ti?" Dhe unë e di, sigurisht, se Djalli është pa dyshim veprues edhe atje.

Për fat të keq, jam i detyruar të pranoj realitetin e Djallit kur vërej se sa të verbër mund të jenë të krishterët e vërtetë kur vjen puna për të parë gabimet e tyre. Mendoj për një grua të krishterë në veçanti. Ajo ishte jashtëzakonisht egoiste. Ajo e mundonte të renë e saj deri sa e shkreta nuse pothuajse luajti nga mendja. Vjehrra s'ishte aspak e dijshme për të keqen që po bënte. E prapëseprapë ajo ishte një besimtare e

devotshme! Ju, njerëzit e devotshëm, mos harroni kurrë t'i kërkoni Perëndisë t'ju mbrojë nga forcat
e errësirës.

Është krejtësisht e pamundur ta kuptojmë gjendjen e tanishme të botës në qoftë se nuk kemi pranuar faktin që në prapaskenë qëndrojnë Djalli dhe forcat e errësirës. Forcat e errësirës punojnë me një qëllim shumë të përcaktuar në mendje. Ato na mbajnë në lëvizje - dhe prandaj ne nuk kemi kurrë kohë. Çdo mjet që mund të imagjinohet përdoret nga Djalli për të na penguar që të gjejmë kohë të mendojmë - sepse nëse e bënim këtë do të zbulonim se mund të shpëtohemi nga kurthi i tij.

2. Një realitet i mrekullueshëm

Po, ka një mënyrë që ne të çlirohemi!

Në Gjermani, gjatë festimit të karnavaleve, ndonjë aktor komik gjithmonë jep një shfaqje. Gjithmonë kam pyetur veten se çfarë mendon ai për shakatë e tija kur është në dhomën e tij në mbarim të ditës dhe ka mbaruar së hequri makijazhin. Në qoftë se është i ndershëm me veten, ka shumë mundësi që të pranojë, "Unë e siguroj jetesën duke thënë budallallëqe, duke treguar shakara të pista që i ndotin mendjet e njerëzve." Ai madje mund të përfundojë deri atje sa t'i neveritet vetja!

Sa i kënaqur jam që jam në gjendje t'ju tregoj për një realitet madhështor dhe të mrekullueshëm: ka një mundësi shpëtimi për ata që duan t'i shpëtojnë lakut të forcave të errësirës.

Apostulli Pal e përshkruan të krishterin me këta terma: ***Perëndia... na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur, në të cilin ne kemi shpengimin... faljen e mëkateve.*** I krishterë nuk është ai që

është pagëzuar dhe që e shpall hapur atë, apo ai që jep të dhjetat dhe ofertat. Jo! I krishterë është ai jeta e të cilit është transformuar. Ai i cili është shkëputur nga kthetrat e forcave të errësirës dhe ka filluar një jetë krejt të re nën udhëheqjen e një Zotërie të ri.

Për ta ilustruar këtë pikë, dua t'ju tregoj një histori që ma tregoi një nga punonjësit e Misionit Qytetar të Berlinit. Për disa kohë ai ishte përpjekur të ndihmonte një burrë që ishte alkoolist. Vargonj të tillë janë të vështirë për t'u këputur. Një ditë punonjësi i krishterë mësoi se gjatë një rasti kur kishte pirë shumë miku i tij kishte bërë copë-copë mobiljet e shtëpisë dhe kishte rrahur të shoqen. Kështu ai shkoi t'i bënte një vizitë. Ishte ora pesë e pasdites. E gjeti të shkretin ulur në kuzhinë, duke pirë një kafe. Djali i tij i vogël pesë vjeçar ishte ulur pranë tij. Misionari e përshëndeti pijanecin me përzemërsi. Pastaj pyeti, "Gjërat kanë shkuar përsëri keq ë?" Duke kërcëllitur dhëmbët, burri u ngrit shigjetë nga vendi. Pa thënë asnjë fjalë, shkoi në dhomën tjetër dhe u kthye me një tel në duar, që përdorej për të nderur rroba. Ende pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja, filloi ta lidhte djalin e vogël pas karriges së tij. Misionari mendoi, "Po tani çfarë po bën? Akoma është i dehur?" E la të vazhdonte. Kur mbaroi së lidhuri të birin, burri i bëri një nyjë telit e pastaj thirri, "Çohu!"

I vogli filloi të qajë. "Po s'mund të çohem!" tha me ngashërim. Atëherë pijaneci u kthye nga misionari dhe me një shprehje të dhimbshme në fytyrë i tha, "E dëgjove: 'Po s'mund!' Epo, njësoj është edhe për mua. As unë s'mund!"

A s'ta copton zemrën kjo?

Pas një çasti, misionari futi dorën në xhep dhe nxori një thikë të vogël. Pastaj duke mos pyetur për dëmin që po shkaktonte, e preu telin e ri fringo të rrobave. Me qetësi i tha djalit, "Çohu!" dhe djali u çua! Duke iu kthyer pijanecit,

misionari tha, "Hë, e shikon!" "Sigurisht," iu kthye me ashpërsi ai, "ti preve telin." Misionari u përgjigj, "Dikush erdhi për të prerë të gjithë vargonjtë e mëkatit që na mbajnë ne. Jezusi!"

Mijëra e mijëra njerëz në gjithë botën e paanë mund të dëshmojnë për këtë.

Ç'realitet i mrekullueshëm! Ne mund të shpëtohemi nga forcat e errësirës.

3. Thelbi i çështjes

Ka ardhur momenti për t'ju folur për Jezusin. Dhe duke folur për të unë vij në vetë zemrën e temës sime.

Mbaj mend se një herë jam ftuar në një klub të zezakve në Nju Jork. Të gjithë jeni të dijshëm për tensionet raciale që ekzistojnë në Amerikë. Në dhomën e çlodhjes të klubit ndodhej një statujë mermeri e vendosur mbi një piedestal. Statuja dukej qartë që nuk ishte e një zezaku. U habita që zezaket i kishin ngritur një monument një njeriu të bardhë në këtë vend të veçantë. Kështu pyeta një zotëri zezak. "Or mik," i thashë, "kush është ky njeri?" Nuk do ta harroj kurrë atë që pasoi. Burri qëndroi një çast pa lëvizur para statujës, pastaj deklaroi solemnisht, "Ky njeri është Abraham Linkolni, çliruesi im!" Dhe unë kujtova se si, me çmimin e viteve të luftës civile, presidenti Linkoln kishte fituar lirinë për skllevërit.

Burri me të cilin fola as nuk kishte lindur në atë kohë; megjithatë ai ishte një njeri i lirë atë ditë për shkak të të drejtave që Abraham Linkolni kishte fituar për të në fushat e përgjakura të betejës.

Ndërsa ngjitja shkallët, munda ta shoh atë që qëndronte ende para monumentit dhe munda ta dëgjoj të murmuriste, "Abraham Linkoln, çliruesi im!"

Në të njëjtën mënyrë, unë mund të qëndroj para kryqit të Jezu Krishtit dhe të them, "Jezus, çliruesi im!"

Ka një varg tepër të çuditshëm në Bibël: ***Ligji i Frymës i jetës në Jezu Krishtin më çliroi nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes.*** Ka ligje të natyrës. Kur unë mbaj lart një shami dore, pastaj e lëshoj atë, ajo do të bjerë në tokë në mënyrë të pashmangshme për shkak të ligjit të gravitetit. Askush nuk mund ta ndryshojë këtë. Por nëse unë e kap shaminë ajo do të ndalojë së rëni. Kjo do të thotë se në qoftë se ndërhyn një forcë më e madhe, ligji i gravitetit mposhtet. Nga natyra ne jemi të prirur ndaj ligjit të mëkatit dhe vdekjes. Që të gjithë po biem, që të gjithë po rrëzohemi tatëpjetë kodrës që të çon në dënimin e përjetshëm. Dhe ne e dimë këtë mjaft mirë.

Në qoftë se rënia jonë duhet të ndalohet, atëherë duhet të ndërhyjë një forcë më e madhe. Kjo është e vetmja mënyrë që të mund të ndalohet ajo. Perëndia na e ka dhënë këtë forcë të madhe në personin e Jezusit. Ai e dha Jezusin për shpëtimin dhe çlirimin tonë. Jezusi largoi pushtetin e Djallit. Dhe me fuqinë e Frymës së Shenjtë që Jezusi na e jep, ne mund të jetojmë një jetë të re në liri.

A nuk është e çuditshme që bota nuk mund ta heqë qafe Jezusin? A e dini pse? Dikush tha dikur se Jezusi ishte si një trup i huaj në këtë botë. Po, pikërisht kështu është ai - një trup i huaj i ardhur drejt nga qielli!

Kush në fakt është ky Jezus?

Mos kërkoni informacion për Jezusin në revistën e parë që ju bie në dorë. Mos e lini veten të çoheni në rrugë të shtrembër nga njerëz që madje as nuk e njohin atë. Vetëm Dhiata e Re mund të na japë faktet e sakta për Jezusin. Nga ajo çka kishte zbuluar në Bibël, Martin Luteri, Reformatori i madh, e përcaktonte kështu Jezusin: "Jezusi është Perëndi i vërtetë, i lindur prej Atit nga gjithë përjetësia; dhe njeri i

vërtetë, i lindur nga Virgjëresha Mari." Edhe Perëndi edhe njeri! Në Jezusin, qielli dhe toka bashkohen.

Jezusi është "*njeri i vertetë*".

Ai qau pranë varrit të Llazarit. Unë mund ta përfytyroj atë në një rast tjetër duke qeshur ndërsa u thoshte dishepujve, ***Vini re zogjtë e qiellit: ata nuk mbjellin, nuk korrin dhe nuk mbledhin në hambare; megjithatë Ati juaj qiellor i ushqen***. Oh po, unë pothuajse mund ta dëgjoj Jezusin duke nënqeshur, "Ata harabela të vegjël të pacipë! Ata nuk shqetësohen për asgjë, e prapëseprapë hanë sa ngopen dhe rriten e shëndoshen!" Ç'njeri i jashtëzakonshëm ishte Jezusi!

Bibla shkruan se menjëherë pas një predikimi një ditë, Jezusi ushqeu 5000 burra pa llogaritur gratë dhe fëmijët. Gjithë atë turmë! Dhe nuk kishte as mikrofona apo altoparlantë! Duhet të ketë patur një zë të jashtëzakonshëm.

Jezusi ishte vërtet një njeri fantastik!

Dhe tani vijmë në një nga skenat më përshtypjelënëse të Dhiatës së Re. Ponc Pilati, guvernatori romak që sundoi në kohën e shërbesës së Jezusit, sapo kishte bërë që Jezusi të rrihej me kamxhik. Mbi kokë i kishin vënë një kurorë me gjemba; fytyrën e kishte tërë gjak; kurrizin e kishte të mavijosur; kishte akoma gjurmë të pështymës në fytyrë. Ishte kthyer në një rrënojë njerëzore. Dhe ishte pikërisht në këtë gjendje të mjerë që Jezusi u nxor jashtë para turmës.

Pilati ia nguli sytë për një moment Jezusit. Pastaj duke u kthyer nga populli, drejtoi gishtin kah Jezusi dhe tha me një ton prekës, ***Ja njeriu!*** Ç'donte të thoshte Pilati? "Kam parë shumë krijesa të tilla dykëmbëshe, por ata ishin të gjithë ujq të uritur, tigra të etur për gjak, dhelpra dinake, pallonj të krekosur, majmunë. Por Jezusi, është *njeri*!"

Jezusi ishte gjithashtu "*Perëndi i vërtetë*, i lindur prej Atit nga gjithë përjetësia." Vetëm kjo pikë mund të diskutohet për orë të tëra pa fund.

Për ta ilustruar këtë, po përshkruaj një skenë që ndodhi në Liqenin e Galilesë. Një stuhi i zuri befas dishepujt derisa po udhëtonin me anijen e tyre. Pas pak minutash, kuverta u mbush me ujë. Pastaj u thye direku. "Kjo gjë nuk e tremb aspak peshkatarin!" ndoshta thanë ata me njëri-tjetrin me një nuancë krenarie. (Mes tyre kishte disa peshkatarë me përvojë.) Por më në fund të gjithëve u hyri frika. Madje i zuri paniku. Dhe thirrën, "Ku është Jezusi? Oh po, është duke fjetur në kabinë!" Dhe me vrap shkuan në kabinë - me ujin që u vërshonte nga pas - dhe filluan ta shkundin Jezusin për ta zgjuar! "Mësues, po mbytemi!" bërtitën.

Mund ta përfytyroj Jezusin duke u ngjitur në kuvertë, pikërisht në zemër të stuhisë. Ne na pëlqen ta mbajmë Jezusin të mbyllur në ndërtesat e rehatshme të kishave tona. Por këtu ai shkoi drejt e në zemër të stuhisë! Dukej se stuhia gati do ta hidhte në det. Por ai shtriu dorën dhe me një zë të lartë, madhështor i tha detit të zemëruar, ***Pusho dhe fashitu!*** Menjëherë deti u qetësua dhe retë u çanë. Dhe dielli filloi të shkëlqejë përsëri. Të përfshirë nga tmerri, dishepujt ranë në gjunjë duke thirrur, "Kush është ky njeri? Ai nuk është si ndonjë njeri prej nesh!"

Më vonë ata e gjetën përgjigjen e pyetjes së tyre: Jezusi është Perëndia në mish. Dishepujt nuk e kuptuan këtë plotësisht deri në mëngjesin e Pashkës kur Jezusi doli i gjallë nga varri!

Nuk po ju tregoj përralla me mbret. Kurrë nuk do të guxoja t'i shpallja këto gjëra në qoftë se nuk do të isha absolutisht i sigurt se me të vërtetë Perëndia i gjallë zbriti te ne në personin e Jezusit, të Ngriturit.

Por është vegimi i Jezusit të varur në kryq që më prek më shumë. Atje ai është me të vërtetë "***Perëndi dhe njeri***". Si mundem unë madje edhe të përpiqem ta përshkruaj? Këtë që

u kurorëzua, por me një kurorë gjembash - objekt talljeje! Duart e tij, dikur aq të fuqishme, u shpuan nga gozhdët. Dhe pas shumë vuajtjesh, e hedhur në letër në mënyrë kaq prekëse nga shkruesi i himnit, ai vari kokën dhe vdiq.

O Kokë e shenjtë e plagosur
E rënduar nga dhembja e brenga
Me plot përbuzje rrethohesh
Kurora Jote bërë me gjemba!
Sa i zbehtë që je nga dhembjet
Nga përbuzja dhe fyerjet e rënda!
Sa dergjet ajo fytyrë
Që dikur, ndriste si hënë.

O Kokë e shenjtë, lavdi e pasosur,
Ç'lumturi që gjer tani ish Jotja!
E megjith'se e përbuzur, e gjakosur
Të të quaj timen ma ka ënda:
Dhembshuria jote dhe gjithë brenga
Të gjithë për mëkatarët ishte fitimprurëse;
E imja, e imja ishte shkelja,
Por Jotja, dhimbja vdekjeprurëse.

Shikojeni, këtë Jezus! Qëndroni para tij dhe pyesni, "Pse rri varur ai atje?" Vazhdoni t'ia bëni vetes këtë pyetje deri sa të gjeni një përgjigje.

Kjo është përgjigjja: Me anë të sakrificës së tij në kryq Jezusi na shpëton ne nga forcat e errësirës. Ai na shkëput me forcë nga kthetrat e Djallit. Duke e identifikuar veten me Jezusin në kryq nëpërmjet besimit tek ai, mund ta kuptosh dhe të jesh i sigurt për të vërtetën se atje në kryq ti je çliruar nga forcat e errësirës dhe je bërë fëmijë i Perëndisë, njeri i liruar. Nuk është më nevoja ta lini veten të torturoheni nga Djalli. Për shkak të kryqit mund të keni siguri të plotë se laku

i Djallit ka marrë fund; se Jezusi është fitimtari; dhe se ai ju ka çliruar përgjithmonë dhe ju ka bërë fëmijë të Perëndisë!

Harrojini të gjitha teoritë pa kuptim të kohës sonë. Duhet t'u bëni ballë fakteve: ne *mund* të çlirohemi nga forcat e errësirës dhe të bëhemi fëmijë të Perëndisë. Vetë Perëndia plotësoi të gjitha kushtet e nevojshme në mënyrë që të arrihej kjo. Ai dhuroi Jezusin. Dhe Jezusi u kryqëzua dhe u ngrit përsëri nga të vdekurit për ne.

E di që njerëzit zakonisht nuk ndjhen mirë kur fillojmë të flasim për "Perëndinë". Pse ndodh kjo?

Kjo ndodh sepse ne të gjithë jemi në të njëjtën pozitë si djali plangprishës në tregimin në Bibël. Ai ishte larguar nga shtëpia. Dhe larg shtëpisë ai ishte mërzitur shumë. Ai digjej nga dëshira për t'u kthyer në familjen e tij, por kishte frikë dhe nuk guxonte. Pse? Sepse shumë gjëra e ndanin nga babai i tij. Kështu ndodh me shumë njerëz. Ata nuk guxojnë t'i afrohen Perëndisë. Ata mendojnë, "Shumë gjëra më ndajnë nga Perëndia. Nuk kemi më asgjë të përbashkët." Ata kanë absolutisht të drejtë. Në fakt, ata janë nën dominimin e forcave të errësirës dhe kjo i pengon të kenë bashkësi me Perëndinë.

Por në qoftë se Jezusi erdhi për të na shpëtuar nga forcat e errësirës dhe për të na bërë fëmijë të Perëndisë, a nuk mendoni se ai gjithashtu mund të heqë mënjanë pengesat që na ndajnë nga Perëndia? Pikërisht këtë bëri ai kur vdiq në kryq. Tek ai ne mund të gjejmë faljen e mëkateve. Po, është e vërtetë: Shpëtimtari i kryqëzuar i fal *të gjitha* mëkatet tona.

Pali e kuptoi këtë të vërtetë të madhe kur shkroi: ***Ai na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur***.

Ne jemi nga natyra lodra në duart e Djallit. Por Jezusi, Biri i Perëndisë, na çliron prej tij duke na ofruar falje të

mëkateve.

Dhe Perëndia na jep kohën e mjaftueshme për ta pranuar këtë shpëtim.

4. Dikush që nuk kishte kohë

Në Dhiatën e Re lexojmë për dikë që nuk kishte kohë. Ai ishte njeri me influencë, guvernator romak. E kishte emrin Feliks. Kishte një grua me emrin Druzila, dhe nën kujdesin e tij ndodhej një i burgosur që quhej Pal.

Meqenëse kishte ca kohë të lirë një ditë, i tha gruas së tij, "Eja të shkojmë ta pyesim pak këtë Palin." Kështu së bashku shkuan në sallën e gjyqit dhe u rehatuan me ceremoni dhe salltanet të madh. Në të djathtë dhe në të majtë të tyre bënin rojë ushtarë romakë. E sollën të burgosurin dhe guvernatori bëri shenjë që ai mund të fliste për t'u mbrojtur. Kështu Pali filloi një nga ato ligjëratat e tij të fuqishme. Ndërsa ai vazhdonte të fliste, toni i ligjëratës bëhej gjithnjë e më serioz dhe prania e Perëndisë të Plotfuqishëm mund të ndihej në dhomë. Pali foli për drejtësinë që duhej të karakterizonte funksionet e një gjykatësi. Kjo gjë shkoi drejt e në zemër të Feliksit. Ai nuk mund të mos mendonte për të gjitha rastet kur kishte pranuar ryshfete. Pastaj Pali foli për dëlirësinë. Këtë radhë ishte Druzila që gati sa s'u rrëzua nga karrigja! "Epo", mendoi ajo, "ja dikush që me sa duket është prapa në kohë!" Edhe Feliksit edhe Druzilës iu desh të skuqeshin kur Pali tha, "Perëndia kërkon që të jemi të drejtë dhe të kemi vetëkontroll."

Pali pastaj vazhdoi të flasë për gjykimin e Perëndisë dhe për shkatërrimin e përjetshëm që mund ta pasojë. I frikësuar, Feliksi kërceu pa pritur nga vendi dhe i tha Palit, "Ndal! Mjaft për tani! Ajo që po thua është interesante dhe ndoshta

ka rëndësinë e vet. ***Dhe kur të kem rast, do të dërgoj të të thërrasin. Për tani shko.*** Nuk kam më kohë të të dëgjoj." Dhe Feliksi urdhëroi që Pali të kthehej në qeli.

Ai nuk pati më kurrë kohë....

Kam frikë se në qoftë se ne nuk i lëmë kohë Perëndisë të na flasë për drejtësi, dëlirësi dhe për gjykimin që do të vijë gjërat për ne do të jenë njëlloj siç ishin për Feliksin. Ne nuk ndihemi të qetë kur gjendemi ballë për ballë me realitetin e Perëndisë, apo jo? Kështu që çfarë bëjmë? Vrapojmë për në kinema ose ndezim televizorin. Me fjalë të tjera, ne zgjedhim të rrimë në një atmosferë më të gëzueshme që nuk na e prish qetësinë - dhe i lëmë gjërat ashtu siç janë.

A nuk është e tmerrshme të të duhet të thuash për dikë se gjatë gjithë jetës i ka lënë gjërat pa lëvizur? Biri i Perëndisë vjen dhe na thotë, "***Ja, unë i bëj të gjitha gjërat të reja!*** Unë e fal të kaluarën tuaj. Me vdekjen time unë ju shpengoj dhe ju lejoj të hyni në Mbretërinë e Perëndisë. Unë ju jap dhuratën e Frymës së Shenjtë që të mund të bëheni njerëz të rinj." Çfarë themi ne atëherë? "Bah!" Dhe i lëmë gjërat siç janë!

Oh, miqtë e mi, shpresoj që të mos jetë kështu me ju.

5. Dikush që ka kohë

Për sa kohë që Satani sundon mbi ne, do të jemi nën presion dhe nuk do të kemi kohë. Ka gra që gjithmonë ankohen: "Burri im nuk ka kurrë kohë për mua." Burrat, gjithashtu mund t'i dëgjosh të qahen: "Gruaja ime nuk ka kurrë kohë për mua." Dhe përsa u përket të rinjve, shumë protestojnë me zë të lartë se prindërit e tyre nuk kanë kurrë kohë për ta.

Por Jezusi ka kohë - dhe ai ka kohë për JU!

E zbulova këtë të vërtetë në një mënyrë krejt të re një ditë.

Po përjetoja vështirësi të mëdha. Isha kaq i dekurajuar sa që gruaja ime nuk mundi të rrinte pa thënë, "Dukesh në pikë të hallit! Por unë e kuptoj, ti e di!" U skuqa dhe ika me vrap në pyll. Atje, në qetësinë e drurëve, fola me Shpëtimtarin tim. "Zoti Jezus, le të ta shpjegoj gjithë këtë çështje dëshpëruese...". Dhe ia zbraza zemrën atij. Ai gjeti kohë për të më dëgjuar - dhe unë isha në gjendje t'i tregoja çdo detaj. Dy orë rrëshqitën që u dukën si një çast i vetëm. Pastaj hapa Dhiatën e Re. Ndërsa e lexoja, ndieja se çdo fjalë ishte përgjigjja e Perëndisë e adresuar personalisht për mua.

Sa i lumtur isha kur shkova në shtëpi. Sapo kisha bërë një zbulim të mrekullueshëm - Jezusi kishte kohë edhe për *mua*!

Në Dhiatën e Re ka një histori shumë prekëse. Një i verbër ishte ulur në anë të rrugës dhe lypte. Kishte në dorë një enë prej druri dhe sa herë që ndokush kalonte aty pranë, ai zgjaste dorën dhe bërtiste, "Lëmoshë të lutem!" Papritur ai dëgjoi nga larg zhurmën e një turme të madhe që po afrohej. "Ç'po ndodh?" mendoi. "Është ndonjë procesion apo mos është paradë ushtarake?" Më në fund ulëriti me sa kishte në kokë, "Hej, ç'bëhet?" Dhe dikush aty afër ia ktheu, "Jezusi sapo ka ardhur në qytet." Diçka i erdhi në mend... Jezusi! Ai tashmë kishte dëgjuar për të. Ai besonte se ky Jezus ishte Biri i Perëndisë! S'kishte dyshim për këtë! Kështu që ai filloi të therët më zë të lartë, "Jezus, Bir i Perëndisë, ki mëshirë për mua! Jezus, Bir i Perëndisë, më ndihmo!"

Zhurma filloi tua ngritë nervat njerëzve, kështu ata i thanë të verbërit, "Epo mbylle de! Na lër të dëgjojmë se ç'po thotë Jezusi." Por i verbëri nuk ua vuri veshin dhe vazhdoi të thërriste, "Jezus, Bir i Perëndisë, ki mëshirë për mua!" Ai bërtiti më fort se herët tjera. Turma filloi të zemërohej dhe ta kërcënonte. "Në qoftë se nuk hesht, do të të rrahim!" Një turmë e zemëruar mund të jetë shumë e rrezikshme siç e dini. Por i verbëri as nuk u shqetësua fare dhe vazhdoi, "Jezus, Bir

i Perëndisë, ki mëshirë për mua!"

Në qoftë se unë do të isha atje dhe i verbëri do të kishte folur me mua, ndoshta do t'i thosha këtë, "Dëgjo! Ka diçka që duhet ta kuptosh. Jezusi është gjatë rrugës për në Kalvar! Atje ai ka ndër mend të vdesë për njerëzimin. Bota po shkon drejt shkatërrimit për shkak të mëkateve të saj, por Jezusi kërkon ta zgjidhë problemin e mëkatit duke i duruar në trupin e tij shkeljet e gjithë botës. Ja se si do të bëjë ai paqe me Perëndinë për ne. Pastaj ai do të ngrihet nga të vdekurit dhe të triumfojë mbi vdekjen. A nuk e shikon se ky është një moment kritik? S'është koha për ta shqetësuar!"

Por i verbëri vazhdoi të bërtasë me sa fuqi kishte, "Jezus, Bir i Perëndisë, ki mëshirë për mua!" Pastaj vjen një nga fjalitë më të bukura të Dhiatës së Re: "Jezusi ndaloi."

Sa shpesh them kur kam për të shkuar në ndonjë mbledhje të rëndësishme, "O Zoti Jezus! Të lutem, nuk dua që të më shqetësojë njeri tani për tani."

Por Jezusi ndaloi! Pastaj tha, "Thirreni!" Jezusi ishte në prag të ndeshjes me problemin më serioz të botës – dhe prapëseprapë ai pati kohë të merrej me një të verbër të shkretë. Ja se sa shumë e vlerëson Ai një njeri të vetëm.

Edhe ju, gjithashtu keni vlerë të madhe në sytë e Jezusit. A njihni ndonjë person tjetër në botë që t'ju vlerësojë kaq shumë? Por ju nuk keni kohë për të! Djalli sigurisht ia ka arritur t'ju bëjë për vete!

Më kanë treguar një histori të pabesueshme. Një anije ishte gati duke u mbytur. Një nga punëtorët e shërbimit po vraponte përgjatë salloneve duke bërtitur, "Të gjithë në kuvertë! Anija po fundoset!" Ai zbriti edhe poshtë në kuzhinë. Kryekuzhinieri, i padijshëm për çdo gjë, po merrej me pjekjen e pulave. "Kam për të gatuar drekën njëherë," qe përgjigjja. Ai u kthye te pulat dhe, me këtë rast u fundos

bashkë me to!

Kam përshtypjen se njerëzit sot janë pikërisht si ai njeri. "Jezusi" thonë ata, "ai nuk është për brezin tonë. Ai nuk më intereson. Sidoqoftë, nuk kam kohë!" Kjo është mënyra që bota vërshon në rrugën e saj - pa Jezusin - drejt e në ferr!

Besoj se përparësitë duhet të respektohen. Nëse Perëndia na ofron shpëtim, atëherë është përparësi absolute ta pranosh atë. Pse nuk përkuleni që tani para kryqit të Jezusit dhe ndërsa bëni këtë gjë t'i shpallni këto fjalë të himnit si tuajat?

(Why rhymes if not rhythm also?)

Unë ia lë mëkatet, Jezusit që më shpëton,
Qengjit të Perëndisë ar i kulluar;
Ai i mban ato të gjitha dhe na çliron
Nga barra e mallkuar.
Ia sjell fajin tim Jezusit të Shenjtë,
Që njollat të m'i pastrojë mirë,
Me gjakun e tij aq të shtrenjtë,
Sa asnjë pikë të mos mbetet e pafshirë.
Ia lë Jezusit gjithë nevojat;
Gjithë plotësia në Të banon;
Ai më shëron gjithë plagët,
Dhe shpirtin ma shpengon.
Ia lë Jezusit gjithë brengat,
Ngarkesat, preokupimin tim;
Ai i liron prej të gjithë
Merr pjesë në hidhërimin tim.
Dëshiroj të jem si Jezusi,
I urtë, i dashur, i përulur, i shtruar;
Dëshiroj të jem si Jezusi,
Biri i shenjtë i Atit.
Dëshiroj të jem me Jezusin,
Mes turmës qiellore të qëndroj,
Me shenjtorët t'i këndoj lavd'rimet
Këngën e engjëjve të mësoj.

VËRETJE! – RREZIK PËR JETËH!

Derisa po ngisja përgjatë autostradës me shpejtësi të madhe para disa orësh, tërë kohën më vërtitej në mendje një temë: Ruhuni - Përpara ka rrezik!

Ju e dini ashtu si edhe unë se në brezin tonë njerëzit zakonisht nuk vdesin në shtrat në moshën e pleqërisë së thellë. Sot ne vdesim në aksidente ose nga infarkti. Në kohët e vjetra, njerëzit jetonin deri në moshën e plakur prej nëntëdhjetë vjetësh, dhe pastaj shtriheshin e vdisnin. Por sot gjërat janë ndryshe. Rrëzohet një aeroplan; ka shumë viktima. Një autobus nuk merr dot kthesën në rrugë dhe shkon e rrokulliset poshtë faqes së kodrës; ka të paktën dyzet të vdekur. Ndodh një shpërthim në një fabrikë; akoma më shumë vdekje. Në thellësitë e minierave të qymyrit ka gjithmonë njerëz që humbin jetën. Dhe në hapësirën prej tridhjetë vjetësh kanë shpërthyer dy luftëra botërore. Lufta e Parë Botërore kërkoi dy milionë viktima. Lufta e Dytë Botërore kërkoi pesë milionë vetëm në Gjermani. Ne jemi të rrethuar nga rreziku me kuptimin e vërtetë të fjalës. Kur mendoj me gjakftohtësi për këto gjëra, shpesh them me vete, "Shanset që unë të vdes paqësisht në shtrat janë me të vërtetë të pakta."

Përpiquni të imagjinoni për një çast se sonte në orën dhjetë do të pësoni një aksident fatal. Mund të ndodhë. Ku do të ishit në orën njëmbëdhjetë? Ç'do të ndodhte me ju? Keni menduar ndonjëherë për këtë?

1. Një situatë serioze

Gjyshi im, që ka qenë një tregues i shkëlqyer historish, më tregonte një përrallë interesante. Një i ri shkoi një ditë të vizitonte xhaxhanë e tij të moshuar. I tha, "Xhaxha, mund të

më urosh. Sapo mbarova gjimnazin." "Shumë mirë!" iu përgjigj xhaxhai. "Merri këto para. Shko dhe bli ç'të duash. Por tani, më thuaj, ç'plane ke për të ardhmen?" "Sa për fillim," u përgjigj djaloshi, "do të vazhdoj studimet. Dua të shkoj në juridik." "Bukur," tha xhaxhai, "dhe pas kësaj?" "Epo, pas kësaj do të doja të merrja pak eksperiencë në gjykatën e rrethit." "Bukur" tha xhaxhai, "e pas kësaj?" "Pas kësaj do të bëhem këshilltar në Gjykatën e Apelit." "Bukur," tha xhaxhai, "e pas kësaj?" "Epo, pas kësaj, që thua ti xhaxha, do të martohem dhe do të krijoj familje." "Bukur," tha xhaxhai, "e pas kësaj?" "Shpresoj të bëhem njeri me influencë - gjykatës në Gjykatën e Apelit, ndoshta, ose prokuror." "Shumë bukur," tha xhaxhai, "e pas kësaj?" I riu po fillonte të mërzitej, por u përgjigj, "Them se në këtë kohë do të më ketë ardhur pleqëria dhe do të më duhet të dal në pension." "Bukur," tha xhaxhai, "e pas kësaj?" "Kur të dal në pension, do të vendosem në ndonjë pjesë të bukur të vendit, do të ndërtoj një shtëpi për vete dhe do të rrit luleshtrydhe!" "Bukur," tha xhaxhai, "e pas kësaj?" Tani nipi ishte bërë tym. "Pas kësaj një ditë do të vdes!" "Ashtu?" pyeti xhaxhai, "Po pastaj?" I riu nuk po qeshte më. E kishte zënë paniku. Xhaxhai plak këmbëngulte, "Po pastaj?" "Xhaxha, në të vërtetë kurrë nuk kam menduar për këtë." "Çfarë," thirri plaku, "sapo ke mbaruar gjimnazin dhe akoma nuk je i zgjuar aq sa të shikosh më tej majës së hundës sate? A nuk duhet që një djalë të cilit Perëndia i ka dhënë një mendje të shëndoshë të ketë më shumë largpamësi se kaq? *Ç'do të ndodhë më pas?*" Djaloshi u përgjigj me nxitim, "Por, more xhaxha, askush nuk e di se ç'ndodh pas vdekjes!" "E ke gabim mor djalë," tha plaku. "Ka një person që e di me saktësi se çfarë ndodh pas vdekjes. Ky është Jezusi. Dhe Jezusi tha: ***E gjerë është dera dhe e hapur është udha që të çon në shkatërrim, dhe shumë janë ata që hyjnë nëpër të.***

Përkundrazi sa e ngushtë është dera dhe sa e vështirë është udha që të çon në jetë! Pas vdekjes vjen gjykimi i Perëndisë. Njerëzit ose humbin ose shpëtojnë."

Të bësh plane për jetën tënde deri në varr nuk mjafton. Duhet të planifikosh gjithashtu për atë që ndodh përtej varrit.

Kur punoja me të rinjtë, shpesh u thosha miqve të mi rinorë, "Në qoftë se do të kisha një palë këpucë që kishin nevojë për riparim, nuk do të shkoja në një stacion servisi. Mekanikët janë njerëz të mirë, por ata nuk marrin vesh fare nga riparimi i këpucëve. Unë do t'i çoja këpucët te këpu-ctari. Në qoftë se, nga ana tjetër, do të kisha problem me makinën, nuk do ta rregulloja atë te këputcari por te mekaniku. Në qoftë se do të blija disa simite, nuk do të shkoja te kasapi apo te shitësi i fruta-perimeve. Ata janë të gjithë njerëz të mirë, por nuk dinë asgjë përsa i përket pjekjes së simiteve. Në qoftë se do të më merrte malli për simite, do të shkoja te bukëpjekësi. Në qoftë se do të më pikonte tubi i ujit do të shkoja të merrja hidraulikun. Me fjalë të tjera, do të shikoja për dikë të zanatit të duhur.

"Por kur vjen puna për të zbuluar se çfarë ndodh pas vdekjes, ne dëgjojmë tërë hasanët dhe hysenët; ose mbështetemi në mendimet tona të paqarta dhe të ngatërruara. A nuk duhet që për këtë çështje, më tepër se për çdo gjë tjetër, ne të pyesim një specialist? Ku mund ta gjejmë një specialist? Ka vetëm një. Ai është Biri i Perëndisë që erdhi nga qielli dhe që shkoi në mbretërinë e të vdekurve. Ai vdiq në kryq, por u kthye përsëri në jetë. Ai i di të gjitha faktet për të mëtejmen. Dhe ai na thotë: 'Ju mund të shkoni në ferr ose mund të shkoni në parajsë.'

"Edhe sikur njëzet e pesë profesorë të ma provonin me anë të logjikës se nuk ka asgjë pas vdekjes, unë do t'u thosha, 'Më falni, por pavarësisht nga diplomat tuaja universitare, ju

nuk jeni ekspertë për këtë çështje; për arsyen e thjeshtë se ju nuk keni qenë kurrë në botën tjetër. Por unë njoh dikë që ka qenë atje: Jezusin. Dhe ai ka një mendim krejt të ndryshëm nga juaji.'"

Njerëzit sot veprojnë sikur vdekja të ishte fundi. Ata gjithashtu duken të mendojnë se ne do të shkojmë automatikisht në parajsë në qoftë se jemi pagëzuar dhe varrosur nga një prift. Sikur të mund t'ju bindja se jeni në një rrezik të madh! Ferri do të mbushet me njerëz që janë pagëzuar dhe që janë varrosur nga klerikët. Herët a vonë secili prej nesh duhet të dalë para gjyqit të Perëndisë.

Më duhet ta pranoj se ishte mendimi i gjykimit të ardhshëm që më detyroi të bëhesha i krishterë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, isha oficer i ri në ushtrinë gjermane. Regjimenti ynë kishte pësuar humbje të rënda. Unë isha si të gjithë oficerët e tjerë, as më i mirë, as më i keq. Në qoftë se dikush do të më kishte thënë atëherë, "Një ditë do të bëhesh predikues", do t'ia kisha dhënë të qeshurit. Në atë kohë jetoja shumë larg Perëndisë. Një ditë im at më pyeti, "Nuk beson te Perëndia?" "Nuk jam aq budalla sa të mohoj ekzistencën e Perëndisë," u përgjigja. "Duhet të kesh një dozë të mirë budallallëku që të jesh ateist. Por," shtova, "deri tani nuk e kam takuar Perëndinë personalisht, kështu që ai thjesht nuk më intereson."

Pak kohë pas kësaj bisede me tim at - ndodhi gjatë ofensivës gjermane në Francë - isha ulur pranë një mikut tim, toger i ri ashtu si dhe unë, në një transhe afër Verdunit. Po prisnim urdhërin për sulm. Për të vrarë kohën, filluam të tregonim histori të pista. (Kushdo që ka qenë në ushtri e di me saktësi se ku e kam fjalën.) Sapo kisha mbaruar së treguari një barceletë kapanonesh, kur, për habinë time të madhe, kuptova se shoku im nuk kishte qeshur. "Kusher," i thashë, "hej, Kusher, a nuk t'u duk për të qeshur kjo?"

Pikërisht në këtë kohë ai u shemb përtokë mënjanë. Kishte vdekur! Një copë e vogël predhe e kishte goditur dhe i kishte hyrë thellë në zemër. Dhe ja ku isha unë, një djalë i ri vetëm tetëmbëdhjetë vjeç, duke qëndruar mbi kufomën e shokut tim.

Kjo në të vërtetë nuk më preku në fillim. Me shaka thashë, "Shiko këtu, or djalë, ç'ishte kjo ide e madhe që t'ia mbathësh në këtë mënyrë, madje para se të mbaroja barceletën?" Por një sekondë më vonë po pyesja veten: "Ku është ai tani?" Akoma mund ta shoh veten time në atë transhe në çastin kur kjo e vërtetë agoi tek unë si një dritë verbuese, më e shkëlqyeshme se flakërima e një shpërthimi bërthamor: "Ai po qëndron para Perëndisë të shenjtë." Pastaj më përfshiu një mendim tjetër: "Po të isha ulur unë atje ku ishte ai, do të isha unë ai që do të goditej - dhe pikërisht tani do të isha unë duke qëndruar para Perëndisë të Plotfuqishëm."

Jo duke qëndruar thjesht para ndonjë Perëndie dosido, por para Perëndisë që ka zbuluar vullnetin e tij dhe ka nxjerrë ligje të cilat unë i kisha thyer, që të gjitha! Atëherë e mora vesh se i kisha thyer të gjitha ligjet e Perëndisë dhe se në qoftë se do të isha vrarë me plumb do të dilja menjëherë në praninë e Perëndisë. Dhe nuk kishte asnjë fije dyshimi në mendjen time se unë isha nisur për në ferr.

Ardhja e djemve tanë me kuaj i ndërpreu mendimet e mia. "Para marsh!" erdhi urdhëri. I hipa kalit. Por para se ta lija shokun e vdekur, bëra një gjë që nuk e kisha bërë për vite me radhë: *u luta.* "O Perëndi," thirra, "të lutem mos më lër të vdes në fushën e betejës para se të sigurohem se nuk do të shkoj në ferr!"

Pak më vonë shkova te kapelani[1]. E pyeta, "Kapelan, ç'duhet të bëj që të mos shkoj në ferr?" Përgjigjja e tij ishte:

[1] Kapelan - Prift a pastor që shërben në forcat e armatosura

"Toger, ajo që ka rëndësi tani është të fitojmë, të fitojmë, të fitojmë!" Unë thirra, "Po ti nuk e ditke as vetë!"

A nuk është e tmerrshme të mendosh që mijëra të rinj do të vdisnin brenda pak javëve pas kësaj pa dikë që të ishte në gjendje t'u thoshte se si të shpëtoheshin? E megjithatë ne jetonim në një vend të ashtuquajtur të krishterë!

Unë ndoshta do të dëshpërohesha shumë në qoftë se një ditë nuk do të më kishte rënë në dorë një Dhiatë e Re. Akoma e sjell ndër mend vendin ku po rrija atë ditë: ishte në një fermë në Francë prapa frontit. "Dhiata e Re!" mendova. "Në qoftë se e lexoj, ndoshta mund ta zbuloj se çfarë të bëj që të mos dënohem." Por meqenëse Dhiata e Re nuk ishte e njohur për mua, fillova ta lexoj kuturu: një pjesë këtu, një pjesë atje. Pastaj sytë e mi ranë mbi këtë varg: ***Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët.*** Kjo më goditi si vetëtimë. *Mëkatar.* Pikërisht i tillë isha unë! Askush s'kishte pse të më bindte për këtë. *Unë isha mëkatar!* Kjo ishte shumë e qartë për mua. Dhe unë kërkoja me ngulm të "shpëtohesha". Por nuk e dija me saktësi se ç'do të thoshte kjo. Të paktën kisha kuptuar se "të shpëtohesh" do të thoshte të dilje nga gjendja në të cilën ndodhesha unë dhe të bëje paqe me Perëndinë. ***Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët.*** Në qoftë se Jezusi mund ta bënte këtë me të vërtetë, atëherë unë duhet ta gjeja atë me çdo kusht!

Kjo vazhdoi për javë të tëra. Kërkoja dikë që të më ndihmonte të gjeja Jezusin; por nuk gjeta asnjë.

Pastaj bëra diçka që do të dëshiroja ta bënit të gjithë. Megjithëse një ofensivë e re vazhdonte, unë u largova një ditë dhe u fsheha në një shtëpi të vjetër ferme franceze. Pjesa më e madhe e saj ishte e shkatërruar dhe njerëzit ishin shpërngulur. Megjithatë, një dhomë ishte ende e padëmtuar. Çelësi ishte në derë. Kështu që hyra dhe e kyça derën nga brenda. Pastaj rashë në gjunjë dhe u luta: "Zoti Jezus! Në

Bibël shkruhet se ti u dërgove nga Perëndia ***për të shpëtuar mëkatarët***. Unë jam një nga ata mëkatarë. Unë nuk mund të të bëj ty ndonjë premtim për të ardhmen sepse kam një karakter shumë të keq. Por nuk dua të shkoj në ferr në qoftë se vritem. Prandaj, Zoti Jezus, dua të ta përkushtoj ty gjithë jetën time. Bëj çfarë të duash me mua!"

Nuk pati ndonjë veprim magjik. Nuk ndodhi asgjë e veçantë. Por kur dola nga ajo dhomë, kisha gjetur një udhëheqës, një udhëheqës të cilit i përkas qysh atëherë.

Ndërsa ditët kalonin, fillova të kuptoj se bota po jeton nën një kërcënim të madh. Njerëzit ndodhen në rrezikun e vdekjes. Burra e gra e kalojnë jetën pa kërkuar asnjëherë falje për mëkatet e tyre. Po mëkatet tuaja? Jeni të sigurt se ato ju janë falur? Jo? Atëherë si mund të shpresoni të qëndroni kur të vini për t'u gjykuar në gjyqin e Perëndisë?

Njerëzit e kalojnë jetën pa e njohur fare paqen e Perëndisë. Njerëzit e kalojnë jetën pa e rregulluar atë me Perëndinë. Ata veshin një lustër të hollë krishterimi, por nën të ndodhet një zemër e mjerë që nuk gjen paqe, sepse ajo nuk është ndryshuar kurrë as edhe një fije.

Perëndia do që askush të mos shkojë në ferr. Bibla thotë: ***Perëndia... dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen dhe t'ia arrijnë njohjes së së vërtetës***. Prandaj ai dërgoi Birin e tij. Por që të shpëtohemi, duhet të ndërmarrim një hap drejt Jezusit. Ne duhet t'i *përkasim* atij.

Ruhuni - Përpara ka rrezik! Po ecim drejt gjykimit të Perëndisë.

Ishte një djalë shumë i mirë në grupin tim të të rinjve. Për një kohë ai erdhi rregullisht në studimet tona biblike. Ishte koha e regjimit të Hitlerit. Pastaj një ditë autoritetet e detyruan të ndiqte një kurs nazist indoktrinimi. Atëherë ai u shkëput nga grupi i të rinjve. Unë i humba lidhjet me të për

një kohë të gjatë; pastaj papritur, një ditë sa s'u përplasa me të. "Tungjatjeta Gunter!" i thashë. "Hajl Hitler," qe përgjigjja. "Gunter," i thashë, "si je? S'të kemi parë për një kohë të gjatë!" Ai mori drejtqëndrim dhe u përgjigj, "Parulla ime është: 'Bëj detyrën tënde, të bëhet ç'të bëhet!' Dhe në qoftë se ndonjëherë ndodh të mos arrij ta bëj detyrën, dhe në qoftë se vërtet ka një Perëndi, atëherë do të jem aq i ndershëm sa t'i pranoj gabimet e mia para tij. Por nuk kam nevojë për një bedel, si Jezusi, që të vdesë në vendin tim."

Me sytë e mendjes mund të shikoj ata miliona burra e gra që mendojnë po kështu. Ata mburren, "Parulla ime është: "Bëj detyrën tënde, të bëhet ç'të bëhet', dhe përsa u përket të tjerave, do të arrij t'ia shpjegoj Perëndisë!" Për asnjë gjë nuk do të dëshiroja të vija para gjykimit të Perëndisë vetëm me fjalët "Kam bërë detyrën". E di që po shkoj drejt një dënimi të sigurt në qoftë se mbështetem në këtë bazë. Ju mund të mbështeteni në këtë: Do të vijë dita kur çdo njeri duhet të japë llogari për veten e vet te Perëndia.

Skulptori i madh Ernst Barlah ka shkruar edhe një dramë me titull, *Boll Pijaneci.* Personazhi kryesor, Bolli, ishte pronar tokash. Ai gjithmonë ishte pak i dehur. Një ditë, pasi kishte ngrënë e pirë mirë, ai shkoi në sheshin e fshatit në një orë kur dielli ishte në kulm. Dhe aty ai u gjend papritur në këmbë para kishës së fshatit. Në dyert e kishës kishte skulptura që paraqisnin katër kerubinë duke u fryrë borive. Kur i pa Bolli, pati përshtypjen e çuditshme se ata sapo kishin ardhur në jetë dhe po lajmëronin Gykimin e Fundit: "Ka ardhur koha për të gjithë njerëzit që të dalin para gjyqit të Perëndisë." Barlahu shkroi këto fjalë: "Ju të vdekur, dilni nga varret! Mos u përpiqni të përdorni kalbjen e trupave tuaj si justifikim! Jo! Dilni!" Boll Pijaneci kishte filluar të kuptonte. "Nuk mund t'i shpëtoj Perëndisë. Një ditë do të më duhet të dal para tij me gjithë të këqijat e mia."

Thellë brenda nesh, të gjithë e dimë se nuk mund të shkojmë shumë larg me vetë-quajtjen tonë të drejtë. Gjykimi i Perëndisë është fare afër. Atë ditë të gjitha veprat tona të mira do të shkrihen si dëbora nën rrezet e Diellit.

E di që njerëzit nuk duan të dëgjojnë nga këto lloj gjërash në ditët e sotme. Kur unë deklaroj se në qoftë se nuk kthehemi te Jezusi do të shkojmë në ferr, njerëzit vetëm qeshin dhe thonë, "Çfarë? Në ferr? Ky është një mendim mesjetar. Ferri as që ekziston!"

Kjo lloj deklarate gjithmonë më kujton një përvojë që kam patur gjatë luftës së fundit. Kisha për të bërë një vizitë, dhe u nisa; por gjatë rrugës u kapa në befasi nga një sulm ajror. Vrapova për në strehimin kundërajror më të afërt dhe qëndrova aty deri sa mbaroi alarmi. Pastaj vazhdova rrugën deri sa më në fund arrita në zonën ku do të bëja vizitën. Asnjë nga shtëpitë nuk ishte dëmtuar. E megjithatë kisha përshtypjen se e gjithë zona ishte braktisur tërësisht. Asnjë mace nuk të zinte syri! "Duhet të jesh në ëndërr," i thashë vetes. "Nuk është e mundur! Shtëpitë janë të padëmtuara e megjithatë të gjithë kanë ikur." Pak minuta më vonë rastesisht e takoj kryetarin e mbrojtjes civile të zonës. Kështu e pyeta, "Pse kanë ikur të gjithë?" Për të ma shpjeguar ai më kapi për krahu dhe më çoi brenda në një shtëpi. Më shpuri te një dritare që shikonte në pjesën e prapme. Nga aty mund të shikoja se shtëpitë rrethonin një livadh. Dhe pikërisht në mes të lëndinës ishte një bombë gjigante, afërsisht sa kazani i një lokomotive me avull! "S'ka plasur akoma?" e pyeta. "Jo," u përgjigj, "është një bombë me veprim të vonshëm." Këto ishin bombat më të pabesa. Ato nuk shpërthenin kur godisnin tokën, por pesë ose madje deri në njëzet orë më vonë. Zakonisht këto bomba shpërthenin kur njerëzit kishin dalë nga strehimet. "Të gjithë këtu kanë ikur," shpjegoi burri. "E

dëgjon si bën tik-tak?" Me lehtësi mund ta diktonim kohëmatësin e detonatorit. Bomba mund të shpërthente nga çasti në çast! "Eja," tha njeriu i mbrojtjes civile, "më mirë të mos rrimë më këtu." Bëmë disa hapa prapa ku të paktën do të strehoheshim nëse shpërthente bomba. Pikërisht atëherë pashë një pamje të pazakontë. Një tufë harabelash fluturoi dhe u ul butë mbi bombën! Një prej tyre shkoi e u ul drejt e mbi detonator. Bërtita, "Kujdes ju harabela se po talleni me vdekjen!" Por m'u duk sikur gjithë tufa po cicëronte në përgjigje të paralajmërimit tim, "Ha, ha, e dimë se ç'është! Kush beson akoma te bombat në ditët tona? Nuk ekziston as rreziku më i vogël!"

Njerëzit sot tregojnë po aq budallallëk kur qeshin për rrezikun që u kanoset. Perëndia tashmë u ka folur shumë seriozisht gjithë kombeve me anë të Fjalës së tij dhe me anë të gjykimeve që kanë rënë mbi ta.

Biri i Perëndisë erdhi, ai u kryqëzua dhe u ngrit përsëri nga të vdekurit. Atëherë, të gjithë, duhet ta kuptojnë se Perëndia është i vërtetë dhe ai është i shenjtë. Por kur një njeri çohet dhe u thotë njerëzve, "Ruhuni - Përpara ka rrezik! Mendoni për shpëtimin e shpirtit tuaj," ata vetëm qeshin dhe thonë, "Ha, ha, kush i beson sot këto gjepura?"

Edhe Perëndia bën disa vërejtje ironike kohë më kohë. Bibla i referohet vetëm një herë ateizmit, në këtë fjali të thjeshtë: ***I PAMENDI ka thënë në zemër të tij: 'Nuk ka Perëndi'***! Me botëkuptimin e Biblës mbi jetën, ç'gjë tjetër mund të thuhet?

2. Për shpëtim

Perëndia e goditi botën njëherë më parë me një gjykim të tmerrshëm. Vetëm një njeri dhe familja e tij u shpëtuan atë kohë. Ai quhej Noe. Perëndia i dha atij udhëzime për të

ndërtuar një arkë para se të fillonte katastrofa. Pikërisht para se të shpërthente kataklizma, ai e urdhëroi Noeun të hipte në arkë me tërë familjen. Dhe kur çdo pjesëtar i familjes ndodhej brenda, vetë Perëndia e mbylli derën nga pas.

Bota po ecën në rrugën e vet për të ndeshur gjykimin e drejtë të Perëndisë. Por ka një arkë për të na shpëtuar: është hiri që na ofrohet në Jezu Krishtin. Ai erdhi nga bota e Perëndisë në botën tonë të mjerimit. Ai vdiq për ne në kryq. Në qoftë se Perëndia e lejoi Birin e tij të vdiste një vdekje kaq të tmerrshme, shpëtimi që ai siguroi për ne nëpërmjet vdekjes së tij duhet të jetë mjaft i madh për të shpëtuar madje edhe mëkatarët më të mëdhenj. Jezusi u ngrit nga të vdekurit dhe na bën thirrje të shkojmë tek ai nëpërmjet Frymës së Shenjtë. *Jezusi është arka e shpëtimit.*

Ashtu si Perëndia që i tha dikur Noeut, ***Hyr në arkë bashkë me tërë familjen tënde***! po ju nxit tani juve me anë të fjalëve të mia për t'u futur nën strehën e hirit të Jezu Krishtit. Bëjeni atë hap drejt arritjes së paqes me Perëndinë. Lirohuni nga çdo gjë që ju pengon. I thoni Shpëtimtarit tuaj, "Një mëkatar shumë i madh po vjen te ti." Vërini mëkatet tuaja në këmbë të kryqit. Besoni se gjaku i Jezusit u derdh për ju personalisht dhe i thoni atij, "Zot, e vë gjithë jetën time në duart e tua." Ja se ç'do të thotë të hysh në arkë.

Ruhuni - Përpara ka rrezik!

Sa shumë prej nesh po shkojnë drejt gjykimit të Perëndisë pa shpëtim, pa mbrojtje. E megjithatë hiri i Perëndisë është kaq i madh sa që mund ta kapim kurdoherë. *Të besosh* do të thotë të dalësh nga sfera e gjykimit të Perëndisë dhe të hysh në sferën e hirit të Jezu Krishtit. Bërja e këtij hapi nuk është një lojë fëmijësh. Por ai na shpëton nga rreziku, nga rreziku i vdekjes.

Albert Hofman, nismëtari i mirënjohur i punës misionare

në Guinenë e Re, më tregoi një histori që nuk e harroj kurrë. I pata thënë, "Vëlla Hofman, për mua është luftë e vërtetë të jetosh jetën e krishterë. Nuk është shaka, qoftë edhe për një pastor, t'i përkasësh Jezusit në një botë si kjo e jona."

"Do të doja të të tregoj për një përvojë që kam patur," tha ai. "E kemi patur zakon në Guinenë e Re që t'u jepnim mësim për besimin e krishterë banorëve të fisit Papua që donin të bëheshin të krishterë. Kjo i ndihmonte ata që ta njihnin më mirë Jezusin. Pastaj në një të dielë të caktuar ata do të pagëzoheshin. Ishte gjithmonë një rast për një festë madhështore. Çdo herë merrnin pjesë shumë paganë. Ndizej një zjarr i madh flakadan. Kandidatët për t'u pagëzuar afroheshin, duke mbajtur në duar të gjitha mjetet për adhurim fetishesh: objekte magjie, statujëza, dhe hajmali. Kur vinin te zjarri ata i hidhnin në flakë këto relikte të jetës së tyre të mëparshme.

"Një mbrëmje, vështrova një grua të re vendase që po i afrohej zjarrit, me duart e ngarkuara me statujëza dhe hajmali. Por kur erdhi çasti vendimtar që t'i hidhte ato, ajo nuk mundi ta bënte këtë gjë. Ajo duhet të ketë menduar, 'E gjitha kjo është pjesë e pandarë e mënyrës së jetesës të stërgjyshërve të mi. Tërë e kaluara ime është rrënjosur në to. Nuk është e mundur që unë ta mohoj prejardhjen time.' Ajo bëri një hap prapa. Por në të njëjtën kohë një mendim tjetër duhet ta kishte pushtuar: 'Në këtë rast unë nuk mund t'i përkas Jezusit.' Kështu ajo bëri tre hapa përpara, por një sekondë më vonë, duke e ndier veten absolutisht të pazonjën për t'u ndarë nga këto objekte, u kthye tre hapa prapa përsëri. I shkova pranë," tha misionari, "dhe i thashë, 'E ke tepër të vështirë! Ndoshta duhet të mendosh pak më gjatë për këtë gjë. Ti mund të pagëzohesh në shërbesën e ardhshme të pagëzimit.' Gruaja u mendua për një çast, pastaj bëri me shpejtësi përpara, i hodhi tërë fetishet e saj në zjarr dhe i ra të fikët."

Kurrë nuk do ta harroj atë që tha ky misionar, me fytyrën e rrudhur sikur të ishte një skulpturë e bërë në dru, ndërsa e mbaroi tregimin e tij, "Jam i sigurt se vetëm ata që kanë përjetuar një konvertim[2] të mirëfilltë mund ta kuptojnë luftën e brendshme të kësaj gruaje."

Miqtë e mi, ka vetëm një hap midis jush dhe arkës. Shpëtoni nga rreziku i vdekjes dhe gjykimit duke u hedhur në krahët e Jezusit. Ky hap nuk është i lehtë për t'u bërë. Ai kërkon një shkëputje totale me të kaluarën. Asgjë më pak!

A kam qenë i qartë sa duhet?

Jam gjithmonë i shqetësuar kur shoh se sa njerëz vazhdojnë në rrugën e tyre drejt dënimit të përjetshëm pavarësisht nga paralajmërimet që kanë marrë. Perëndia nuk e do këtë gjë. Ai kërkon që ju të shpëtoheni. Dhe prandaj e dërgoi Birin e tij për të paguar dënimin për mëkatet tuaja. Gjithçka që duhet të bëni ju tani është ta njihni fajin tuaj dhe ta pranoni me anë të besimit veprën e shpëtimit që ka kryer Jezusi për ju.

Jam thirrur shumë herë nga Gestapua në kohën e Rajhut të Tretë. Në një rast, më bënë të prisja në një dhomë ku nuk kishte gjë tjetër por vetëm radhë të tëra sirtarësh të mbushura me gjithfarë dosjesh. Nga secila dosje dilte një etiketë dhe mbi çdo etiketë kishte një emër, si: "Karl Majer" apo "Fridrih Shulc". Gjatë asaj pritjeje pa fund, i rrethuar nga gjithë ato dosje, falënderova Perëndinë që nuk do të më duhej ta kaloja gjithë jetën time në shoqërinë e tyre. Por meqë po mërzitesha fillova të lexoj emrat në etiketa. "Karl Majer" të tjëra; "Fridrih Shulc" të tjetra. Papritur lexova: "Vilhelm Bush". Pra unë paskësha një dosje timen! Si me magji, dosjet nuk po

[2] Konvertim - (këtu): kalimi nga një besim jo të krishterë nëatë të krishterë; ndërrimi i besimit në besimin e krishterë.

më dukeshin më aspak të mërzitshme. Dosja ime personale ndodhej atje në një nga raftet! Duke u djegur nga kureshtja, u tundova ta ulja atë poshtë dhe të shikoja se ç'kishin shkruar ata njerëz për mua. Por nuk guxova ta ndërmerrja një rrezik të tillë. Ende, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës unë dridhesha nga mendimi: "Dosja ime qenka atje!"

Ka patur një periudhë në jetën time kur asgjë nuk më mërziste më shumë se krishterimi. Isha shumë më tepër i interesuar që ta kisha gotën e birrës të mbushur. Pastaj një ditë, për herë të parë, e pashë kryqin e Jezusit ashtu siç ishte në të vërtetë: kishte të bënte diçka me dosjen time. Kishte të bënte diçka me fajin dhe shpëtimin tim. Që nga ajo ditë kryqi i Jezusit ka interesin më të madh për mua.

Jezusi është vërtet Shpëtuesi i madh.

3. Nga vdekja në jetë

Le ta shohim këtë nga një këndvështrim tjetër. Kur po më vërtitej nëpër mend kjo temë (Kujdes! Je në rrezik vdekjeje! Ndal! Rrotullohu dhe kthehu prapa! Kërko shpëtimtarin tënd!), pa pritur më erdhi ky mendim: vetëm një njeri që është i gjallë mund të jetë në rrezik vdekjeje.

A e kuptoni se ku po përpiqem të dal?

Ju jeni në rrezikun se nuk do ta gjeni kurrë vërtetë jetën. Ju jeni në rrezikun e kalimit nëpër jetë si njeri i vdekur dhe më në fund të hidheni poshtë si njeri i vdekur. Rreziku përballë jush është se ju mund të mbeteni krejtësisht jashtë jetës. Bibla e thotë shumë qartë: ***Ai që ka Birin, ka jetën; Ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën.***

Jo shumë kohë më parë takova një grua beqare nga Berlini që jep mësim në gjuhët e huaja. "Më falni, zonjushë," i thashë, "ndoshta një pastor ka të drejtë që të jetë pa edukatë herë pas here! Më thuaj, sa vjeçe je?" Si rregull të pyesësh

një zonjë për moshën e saj nuk është gjë që bëhet; por një pastor plak mund të jetë i lirë ta bëjë këtë me raste. Pa hezitim ajo u përgjigj. "Tetë vjeçe...!" "Një minutë," i thashë i çuditur, "tetë vjeçe?" Ti u mëson të tjerëve tri gjuhë të huaja dhe je vetëm tetë vjeçe?" Ajo filloi të qeshë, pastaj shpjegoi, "Tetë vjet më parë unë njoha Jezu Krishtin." U habita. "Një mënyrë e çuditshme për ta shprehur!" i thashë. Ajo citoi vargun: ***Ai që ka Birin, ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën***. Ajo vazhdoi, "Në të kaluarën, unë nuk kisha një Shpëtimtar; nuk jetoja realisht. Isha e kënaqur duke fituar shumë para dhe duke ia kaluar mirë, por kjo nuk ishte jetë!"

A nuk është kjo një deklaratë inkurajuese? Në të vërtetë, ai që nuk ia ka dorëzuar jetën e tij Jezusit me anë të një akti të qëllimshëm të vullnetit nuk mund të thotë se jeton. Pa Jezusin ne as që e dimë se ç'është jeta. Vetëm një njeri që ka Birin ka jetën.

Shumë vjet më parë, një i ri erdhi të më takonte. "Ç'të solli këtu?" e pyeta. "Në të vërtetë as vetë nuk e di!" u përgjigj. "Vetëm kam përshtypjen se jeta që po bëj nuk është aspak jetë." I shtangur nga habia e pyeta, "Si ore? Ti ke punë të mirë si bravapunues dhe po fiton gjithë ato para." "Por s'është jetë kjo," ma ktheu. "Jo, jo, kjo s'është jetë aspak. Të hënën në punë si bravapunues, të martën në punë si bravapunues, të mërkurën në punë si bravapunues, të enjten në punë si bravapunues, të premten në punë si bravapunues, të shtunën është futbolli; dhe të dielën kinemaja dhe vajzat. Me të vërtetë kjo nuk është aspak jetë!" "Miku im," i thashë, "ke plotësisht të drejtë. Në qoftë se e ke kuptuar këtë gjë, tashmë ke bërë një rrugë të gjatë. Kjo *nuk* është jetë! Dal të të tregoj, miku im, se ç'do të thotë të jetosh. Në jetën time, ndodhi një ndryshim i plotë kur m'u bë i njohur Jezusi. Ai u bë

Shpëtimtari im; ai më pajtoi me Perëndinë. Kur e kuptova këtë, ia dhashë atij zemrën. Dhe qysh atëherë kam patur jetën."

Edhe i riu më në fund gjeti jetën. E pashë përsëri kohët e fundit në Frajburg. "Hë," i thashë "si shkojnë punët tani? A po jeton me të vërtetë më në fund?" Me fytyrën që i shkëlqente nga gëzimi, u përgjigj, "Po, tani po jetoj me të vërtetë!" Në fakt ai është një i krishterë shumë aktiv. Ai drejton një grup të rinjsh dhe u tregon njerëzve të tjerë rrugën për tek ai në të cilin ai vetë gjeti jetën - te Jezu Krishti.

Një nga miqtë e mi zotëron një biznes. Kohët e fundit ai u ftua në shtëpinë e një industrialisti me emër. Personi në fjalë kishte një shtëpi të bukur që ndodhej në një park të mrekullueshëm. Ndodheshin të paktën njëqind të ftuar. I shtyrë nga turma, miku im u gjend në një moment pranë atij që e kishte ftuar, kështu që i tha, "Qenke apo s'qenke me fat! Ti jetoke si mbret: ke një pronë të mrekullueshme, një fabrikë që të ecën mbarë, një grua të bukur dhe fëmijë të këndshëm." Personi iu përgjigj, "Po, është e vërtetë, jam me shumë fat." Pastaj papritur duke u bërë tepër serioz, tha, "Por prapëseprapë, mos më pyet se si i kam punët këtu brenda," dhe me këtë ai tregoi me gisht zemrën e tij.

Kur eci rrugës, shpesh mendoj, "Sikur njerëzit të ishin me të vërtetë të sinqertë, të gjithë do të ndalonin dhe do të thërrisnin, 'Mos më pyet se si i kam punët këtu brenda, në zemër!'" Ata nuk kanë paqe. Ndërgjegjet e tyre i akuzojnë. Ata ndihen fajtorë.

Dhe ka vetëm një person që mund të na shërojë. Mbani mend, Perëndia e shikon gjendjen tonë të mjerë. Ne, vetë, nuk mund të shkojmë tek ai. Por me dashurinë e tij ai erdhi te ne në personin e Jezu Krishtit. Ky është mesazhi mahnitës që duhet t'jua bëj të ditur. ***Perëndia e deshi aq botën***.... Unë nuk do të mund ta kisha dashur botën. Unë do t'i kisha rrahur

të gjithë me çomange; kjo botë e vjetër është plot ndotje, poshtërsi dhe budallallëk. E prapëseprapë Perëndia e deshi. Unë kam mbetur me gojë hapur! ***Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.***

Më thoni, a mund të bënte Perëndia më tepër se kaq - të dorëzonte Birin e tij për të vdekur - që ne të mund të kishim jetë?

Edhe një histori tjetër. Një mbrëmje, pas një shërbese në kishë, një i ri shkoi te predikuesi i madh anglez Çarls Hedon Spërxhën, dhe i tha, "Pastor, ke të drejtë. Edhe unë kam nevojë ta takoj njeriun e Kalvarit dhe të bëhem fëmijë i Perëndisë. Ndonjë ditë do të konvertohem." "Ndonjë ditë?" e pyeti Spërxhëni. "Po, por më vonë." "Më vonë? Pse jo sot?" Fytyra e të riut mori një pamje të turpëruar por ai u përgjigj, "Sigurisht unë dua të shpëtohem dhe prandaj kam për qëllim që të konvertohem ndonjë ditë, por para kësaj dua ta shijoj pak jetën." Spërxhëni ia dha të qeshurit, pastaj i tha, "Djalosh, ti nuk ke shumë ambicie në jetë. Unë nuk do të kënaqesha që ta shijoja jetën *vetëm pak*. Unë kërkoj shumë më tepër nga jeta. Unë e dua jetën *me bollëk*. Në Bibël thuhet (dhe ia tregoi atë pjesë): ***Jezusi tha... unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.***"

Perëndia lejoi që Jezusi të vdiste në kryq për mëkatarët e humbur dhe të shkretë si ti dhe unë, në mënyrë që ne këtu tani të mund të kemi jetë. Kur zgjohem në mëngjes, mund të këndoj nga gëzimi sepse jam fëmijë i Perëndisë dhe sepse kam gjetur jetë në të. Po, Jezusi erdhi për të na dhënë jetë këtu poshtë në tokë; ai erdhi për të na ruajtur nga gjykimi i Perëndisë dhe për të na dhënë jetën e përjetshme. Kur t'i kemi pranuar këto gjëra, mund të ecim nëpër rrugën e jetës me gëzim.

Vetëm një ilustrim të fundit. Është mbrëmje nëntori. Bie borë e lagësht. Dy burra po ecin në rrugë. I pari nuk ka pardesy, por ka ngritur jakën e xhaketës. Ai duket sikur s'pyet se po bëhet qull. Për të pak rëndësi ka se ku po shkon. Mund të vijë këtu, mund të shkojë atje - s'ka rëndësi - ai është i pastrehë. Kjo është mënyra se si shumica e njerëzve çapiten nëpër jetë. Ata s'kanë asnjë qëllim në jetë.

Po ju? Ku po shkoni?

Ateisti dhe filozofi gjerman Niçe shkroi këto fjalë në një nga poemat e tij: "Mjerë njeriu që nuk ka shtëpi!" Po ju a keni një shtëpi të përjetshme?

Dhe tani të marrim burrin e dytë që po ecën në rrugë. Ai duhet të përballojë të njëjtën stuhi, të njëjtën baltë, të njëjtin shi, të njëjtën borë. Por ai po fërshëllen një melodi dhe hapi i tij është i gjallë. Përse? Sepse që nga larg ai shikon të ndriçojnë dritat e shtëpisë së tij. Atje ai do të gjejë ngrohtësi. Atje ai do të qeshë me vështirësitë e rrugës. Kjo, miqtë e mi, është mënyra se si shkojnë nëpër botë njerëzit që ia kanë përkushtuar jetën e tyre Jezu Krishtit dhe kanë gjetur jetë në të.

Perëndia i tha Noeut: ***Hyr në arkë***. Unë ju nxit që të kërkoni një vend të qetë. Jezusi do të jetë atje. Bisedoni pak me të dhe i thoni çdo gjë që keni në mendje. Dikush më tha njëherë, "Mund të bisedoj pak me ty të lutem?" Por unë iu përgjigja, "E ç'dobi do të kishte? Jo me mua, por drejtpërdrejt me Jezusin duhet të flasin njerëzit!"

Dhe pikërisht këtë duhet të bëni edhe ju!

ÇKA DUHET QËTË BËNI?

Në një nga shumë letrat që janë dërguar në adresën time, më bëhet pyetja e mëposhtme: "A shpallni pikëpamjet tuaja në predikimet tuaja apo thjesht doktrinat e kishës suaj?" Në përgjigje shkrova: "Unë predikoj mesazhin e Biblës." Kurse për lexuesit e mi shtoj: Ju shpejt do të zhgënjeheni në qoftë se dëgjoni vetëm mendimet e pastor Bushit. Ato nuk do t'ju hyjnë shumë në punë. Ajo që ju duhet është ta dëgjoni zërin e Jezusit, zërin e Bariut të Mirë. Roli im është të ndihmoj të tjerët, me ato mjete të dobëta që zotëroj, për të dëgjuar zërin e Bariut të shpirtit tonë.

Ç'duhet të bëni?

1. Jepini fund mosbesimit tuaj

Gjatë shumë viteve të shërbesës në qytete të mëdha, kam dëgjuar të gjitha llojet e argumenteve kundër mesazhit të Biblës. Kam parë kaq shumë mosbesim saqë duhet t'ju nxit që në fillim - sepse shpëtimi i shpirtit tuaj është në rrezik - t'i jepni fund qëndrimit tuaj mosbesues.

Për një farë kohe gjatë luftës së fundit, përveç punës sime mes të rinjve, kisha dhe përgjegjësinë e kapelanit në një spital të madh. Një ditë, derisa po bëhesha gati të trokisja në dhomën teke të një pacienti, pashë një infermiere te re që po vraponte drejt meje nga ana tjetër e sallonit. Gati pa frymë, ajo tha, "Të lutem, Zoti Bush, mos hyr në atë dhomë." "Pse jo?" e pyeta. "Personi i asaj dhome," shpjegoi ajo, "refuzon krejtësisht çdo vizitë nga ndonjë pastor. Po të hysh, ai do të të përzërë!" Ajo bëri me dorë nga mbishkrimi mbi derë dhe unë njoha emrin e një biznesmeni të mirënjohur. "Infermiere," u përgjigja, "mos u shqetëso. I kam nervat prej hekuri." Dhe kështu trokita në derë. "Hyr!" tha një zë i lartë burri. Hyra.

Një plak me flokë të thinjur rrinte shtrirë në shtrat. "Tungjatjeta!" i thashë. "Quhem Bush, pastori Bush." "Aha" tha ai, "kam dëgjuar shumë gjëra për ty. Mund të vish për një vizitë të shkurtër." "Je shumë i sjellshëm," thirra i gëzuar. Shpejt ai shtoi, "Por mos fillo të më mërzitësh me krishterimin tënd!" Iu përgjigja me të qeshur, "Ç'fat i keq! Pikërisht për këtë erdha të të flas!" "Në asnjë mënyrë!" u përgjigj ai me vendosmëri duke ma bërë me dorë të largohesha. "E kam mbyllur me fenë. Kur isha fëmijë, prindërit më ngopnin me psalme dhe kur nuk mundja t'i recitoja ato si duhet, haja ndonjë shuplakë. Të gjitha këto i hoqa qafe kur u rrita. Tani kam krijuar filozofinë time për jetën. Janë mendimtarët si Darvini, Hegeli dhe Niçeja që më kanë frymëzuar."

Me këtë mora zjarr. Për fat të keq nxehem shpejt. "Dëgjo këtu, miku im," i thashë. "Kur një adoleshent gjashtëmbëdhjetë vjeçar më thotë se Niçeja është 'guru'[1] i tij, unë vetëm qesh me vete dhe mendoj, "Epo, ti po kalon një periudhë tranzicioni. Do të përfundosh me zbulimin se vetë filozofët modernë nuk besojnë më në ata që i mbanin si modelet e tyre.' Por kur një plak si ti, tashmë me një këmbë në varr thotë gjëra të tilla, është shumë serioze. Ti je i sëmurë rëndë. Mos mendon se do të jesh në gjendje të flasësh gjepura të tilla kur të dalësh para Perëndisë? Po të pyes!"

Ai më shikonte i shushatur. I dukej sheshit që nuk ishte mësuar t'i flitej kështu. "Kujdes," i thashë vetes, "mos u nxeh! Ky është spital dhe nuk kemi të drejtë të shpërthejmë." Pastaj më mbërtheu një dhembje e thellë për këtë njeri të shkretë. E ndryshova tonin dhe, pavarësisht nga refuzimi i tij në fillim, nisa t'i shpjegoj se si Jezusi donte të bëhej edhe Bariu i tij. I sëmuri psherëtiu thellë dhe tha, "Po, do të ishte shumë mirë.

[1] Guru: Mësues shpirtëror hindu.

Por ç'duhet të bëj me filozofinë e jetës? Mos duhet të hedh poshtë çdo gjë që kam besuar gjer tani?" "Tamam ashtu zotëri," i thashë dhe zemra m'u mbush me gëzim. "Flake tej çdo gjë që është e padobishme për ty në dritën e përjetësisë. Bëje që tani. Mos prit për nesër. As mund të jetosh, as mund të vdesësh në paqe me një mosbesim si ky yti. Kur t'i kesh lënë të gjitha, hidhu në krahët e hapur të Birit të Perëndisë që vdiq për të të shpenguar. Ai dëshiron të bëhet edhe Shpëtimtari yt."

Pikërisht në këtë kohë infermierja hyri në dhomë dhe u habit shumë që na gjeti duke biseduar si miq të vjetër. Ajo bëri shenjë me dorë dhe unë e kuptova se ishte koha për t'u larguar. Ia mbajta dorën plakut për një kohë të gjatë dhe pastaj u largova nga dhoma në heshtje. Nuk do ta marr vesh kurrë nëse ai e ndoqi këshillën time. Atë natë ai vdiq.

U tmerrova atë ditë kur pashë se si edhe njerëzit e shkolluar e lënë veten e tyre të tërhiqen për hunde nga njerëz të tillë si Darvini, Hegeli dhe Niçeja. Mosbesimi i tyre i bazuar në arsyetime të gabuara i fut në rrezikun e madh të lënies jashtë shpëtimit të përjetshëm. Prandaj unë, në radhë të parë, ju nxit të flakni tej gjithë mendimin sipërfaqësor mbi të cilin ju bazoni mosbesimin tuaj. Hiqeni qafe atë! Mosbesimi juaj nuk vlen asnjë grosh. Bibla thotë: ***Një është Perëndia dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve, Krishti Jezus njeri.***

Një ditë isha ulur përballë një burri të cilit i kisha vënë nofkën "njeriu i vijëzuar" për shkak të pulovrës së tij me vija. Ai ishte një njeri i madh e i fuqishëm, me trupin si një anije luftarake. Gruaja i kishte vdekur në një sulm ajror dhe dy djemtë i ishin vrarë në front. I shkreti! Atë ditë kisha ardhur t'i bëja një vizitë. Por s'isha ulur mirë akoma kur ai filloi të ma hedhë fajin mua. "Pastor Bush, mbylle tani me gjithë fenë

tënde! Kam parë shumë gjatë gjithë jetës sime dhe tani nuk besoj gjë prej gjëje."

Qesha dhe i thashë, "Kjo është e pamundur. Ti ndonjëherë udhëton me tren, apo jo?" "Po." "Mendoj," vazhdova, "se sa herë që e bën këtë, ti shkon gjen makinistin dhe i kërkon atij të të tregojë patentën?" "Sigurisht që jo!" qe përgjigjja. "Mund të kesh besim që hekurudhat punësojnë makinistë të cilët...". "Si," e ndërpreva, "mos do të thuash se ti hipën në tren pa u siguruar më parë nëse makinisti ka kualifikimin e duhur për ta drejtuar atë? Mos vallë e lë jetën tënde në duart e tij, pa më të voglën garanci? Aha! A e di se ta vësh jetën në duart e një tjetri është një formë të besuari? Kështu më mirë mos thuaj më se nuk beson në asgjë. Duhet të thuash, 'Nuk besoj në asgjë - përveç hekurudhave!'" "Ëhë...!"

Vazhdova ta pyesja. "A shkon ndonjëherë në farmaci?" "Po," u përgjigj, "kam shpeshherë dhimbje koke dhe më duhet të shkoj te farmacisti për ndonjë tabletë." "Ti ndoshta e di," i thashë, "se disa farmacistë u kanë dhënë gabimisht klientëve të tyre helm. Kështu mendoj se ti ua kërkon analizën tabletave para se t'i pish?" Ai u përgjigj, "Jo, pastor Bush. Një farmacist i vërtetuar e njeh profesionin e tij. Ai nuk do të ma punonte një rreng të tillë." "Si?" thashë i habitur. "Ti i pi ilaçet pa u kërkuar kontroll më parë? Ia beson jetën një farmacisti? I pi ilaçet e tij pa pikën më të vogël të dyshimit? Epo, këtë unë do ta quaja besim! Miku im, mjaft the se nuk beson në asgjë; por më mirë thuaj, 'Nuk besoj në asgjë - përveç hekurudhave dhe farmacistit.'"

Vazhdova t'i shtoja shembujt. Së fundi ndava përvojën time me të. "Një ditë takova Jezusin, atë që na dërgoi Perëndia. Po, Jezusin, që u ngrit nga të vdekurit dhe që akoma mban shenjat e gozhdëve në duar. Ato shenja provojnë shumë bukur se dashuria e tij për mua ishte kaq e madhe saqë Ai madje dha edhe jetën e tij për mua. Askush në

botë nuk ka bërë ndonjëherë kaq shumë për mua sa Je-zusi! Askush nuk e meriton besimin tim më tepër se sa Ai.

Mendon të ketë thënë ndonjë gënjeshtër Jezusi, qoftë edhe një herë të vetme?" "Jo," qe përgjigjja. "Nuk mund ta them këtë për asnjë tjetër. Por atë ditë, shumë vjet më parë, i thashë vetes, 'Ti mund t'ia besosh jetën tënde Jezusit. Ai e meriton besimin tënd.' Dhe këtë e bëra!"

"Kaq e thjeshtë qenka?" më pyeti burri. "Po," i thashë, "kaq e thjeshtë. Ti u beson gjithfarë njerëzve rreth teje - përveç Jezusit. Dhe ai është i vetmi që e meriton t'i besohet krejtësisht. Kështu hiqe qafe arsyetimin fals mbi të cilin është ngritur besimi yt. Pastaj dorëzoja jetën Zotit Jezus."

Një herë, në një takim, sfidova një grup të rinjsh në këtë mënyrë: "Do t'i jap një çmim prej një milion markash kujtdo që do të mund të më sjellë një burrë apo grua të vetme që ndien keqardhje që e ka lënë Jezu Krishtin të hyjë në jetën e tij apo të saj!" Është e kuptueshme që nuk kisha një shumë kaq të madhe parash. Por mund ta bëja ofertën pa hezitim - sepse asnjë person i tillë nuk mund të gjendet. Megjithatë, kam njohur shumë njerëz, që u ka ardhur keq që nuk e kanë pranuar Krishtin.

Kështu ju nxit edhe njëherë ta hiqni qafe mosbesimin. Besojini Jezusit që ka bërë kaq shumë për ju. Kjo është një çështje personale mes jush dhe atij. Shkoni vjedhurazi në një qoshe të qetë dhe i thoni, "Zoti Jezus, që tani e tutje dua të të përkas ty!"

2. Mendimi juaj i mirë për veten tuaj duhet të ikë!

Bibla thotë: ***Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët, ndër të cilët unë jam i pari.*** Shumë njerëz që lexojnë këtë varg zemërohen dhe deklarojnë: "*Unë* nuk jam

mëkatar. Nuk kam bërë ndonjë krim." Janë këta njerëz të cilëve do t'ju drejtoj vërejtjet e mia.

Ajo që sapo keni deklaruar është krejtësisht dhe absolutisht e gabuar. A mund ta imagjinoni veten tuaj në Ditën e Gjykimit duke i thënë Perëndisë, "*Unë* nuk jam mëkatar. I kam respektuar të gjitha urdhërimet e tua." Do të guxoni t'ia thoni këtë Perëndisë?

Hajt tani! Duhet t'i jepni fund atij mendimi të mirë që keni për vetveten. Pushoni së menduari - apo së pretenduari - se jeta juaj është në rregull. Asgjë nuk është në rregull, absolutisht asgjë!

Para shumë vjetësh, pata një bisedë me një të ri njëzet vjeçar. Kurrë nuk do ta harroj atë. Një ditë kur e ndesha në rrugë, i thashë, "Hajnc i dashur, nuk të kam parë për një kohë të gjatë në studimet biblike apo në takimet tona të të rinjve." "E vërtetë është," u përgjigj ai. "Pastor Bush, jam menduar gjatë për këtë. Ti gjithmonë flet për Jezusin që vdiq për mëkatarët. Përsa më përket mua, nuk ndiej nevojë për një bedel që të mbajë mëkatet e mia. Në qoftë se kam bërë diçka të keqe dhe në qoftë se Perëndia ekziston, atëherë do t'i përgjigjem atij për veten time. Mendimi i një Shpëtimtari që vdes në vendin tim më duket tepër qesharak." "Në rregull!" iu përgjigja. "Kur të thirresh para Perëndisë të shenjtë, ti ke ndër mend t'i drejtohesh drejtësisë. Kjo është e drejta jote. Ti je i lirë të mos e pranosh Jezusin dhe të thuash, 'i drejtohem drejtësisë.' Por duhet të kuptosh një gjë: në Angli, njerëzit gjykohen sipas ligjit anglez; në Gjermani, ata gjykohen sipas ligjit gjerman; dhe para Perëndisë, ne do të gjykohemi sipas ligjit hyjnor. Shpresoj që ti të mos kesh thyer asnjë nga ato ligje - ndryshe nuk ke asnjë shpresë. Mirë u pafshim!" "Prit një minutë!" thirri me habi i riu. "Perëndia nuk është aq cikrintar!"

"Ha! Si mendon ti se është Perëndia i shenjtë?" E pyeta.

"Le të supozojmë për një moment se pasi kam jetuar ndershmërisht për pesëdhjetë vjet, një ditë unë bëj një vjedhje të vogël e cila zgjat, maksimum tri minuta. Kjo gjë zbulohet më në fund dhe çështja ime shkon në gjyq. Gjatë gjykimit, unë i them gjykatësit, 'I nderuar gjykatës, mos u trego kaq strikt. Tri minuta vjedhje më se kundërpeshohen nga gjysmë shekulli ndershmëri. Kush do të ishte kaq i ndërgjegjshëm sa të më dënonte mua për kaq gjë?' A e di se ç'do të ndodhte? Gjykatësi do të përgjigjej, 'Një minutë! Ajo që më intereson mua tani nuk janë pesëdhjetë vitet e tua të ndershme, por tri minutat që u deshën për të bërë atë vjedhje. Ligji po të gjykon për atë shkelje të veçantë.' Nëse një gjykatës tokësor do të reagojë në këtë mënyrë, pse nuk duhet të shkojë dhe Perëndia deri aty?"

Pse nuk e pranoni fajësinë para Perëndisë? Pse nuk e njihni nevojën tuaj për falje? Pse nuk pranoni se jeni mëkatar? Hiqni qafe qëndrimin tuaj të të pretenduarit se jeni i mirë dhe kërkoni Shpëtimtarin. Ai vdiq për mëkatet tuaja dhe e pagoi borxhin tuaj. Pranojeni atë si Shpëtimtarin tuaj, rrëfejani atij mëkatet tuaja dhe i thoni, "Unë hidhem në këmbët e tua me gjithë të metat e mia. Ki mëshirë për mua dhe më pastro me gjakun tënd."

3. Bëni hapin vendimtar

Një ilustrim tjetër do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë po përpiqem të bëj të ditur.

Ishte fillimi i regjimit të Hitlerit. Kisha për t'u takuar me një zyrtar të lartë nazist. E bëra këtë me frikë e duke u dridhur sepse regjimi nuk i shikonte me sy të mirë pastorët. Për habinë time, zyrtari, në vend që të më flakte jashtë derës, më dëgjoi me vëmendje. I thashë në fund të intervistës,

"Rrallë jam trajtuar me kaq dashamirësi prej ndonjërit nga kolegët e tu. Do të doja të të falënderoj. Dhe meqë je treguar kaq i mirë me mua, a mund të të lë, si dhuratë, mesazhin që më është besuar: ***Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.***"

Ai më shikoi për një moment, pastaj u përgjigj, "S'është nevoja të thuash më shumë. Prindërit e mi janë besimtarë dhe m'i mësuan këto gjëra që në djep. Por...". Ai vuri një fletë të madhe letre të bardhë mbi tavolinë, mori një laps dhe hoqi një vijë përmes saj. Pastaj vazhdoi, "E sheh pastor, unë di gjithçka për të. Por për të marrë shpëtim, do të më duhej të kaloja një vijë si ajo që sapo bëra në letër. Jam shumë afër - dhe me gisht tregoi një pikë pak poshtë vijës - por hapi vendimtar përmbi vijë do akoma që të bëhet." Pastaj shtoi, pak i zënë ngushtë, "Sidoqoftë, pozita ime shoqërore, më pengon ta bëj atë hap."

U largova prej tij me trishtim në zemër. Ky njeri ka vdekur shumë kohë më parë. Por pozita e tij shoqërore nuk e ndihmoi atë kur kaloi në përjetësi. Sidoqoftë, ai e kishte kuptuar, se duhej të bënte një hap vendimtar, se duhej të kapërcente vijën, në mënyrë që të hynte në Mbretërine e Perëndisë.

E keni ju kurajën për ta bërë këtë? Ia vlen barra qiranë. Jezusi po ju pret me krahë hapur. Bëjeni hapin vendimtar; kapërcejeni vijën dhe do të gjendeni në krahët e Jezusit!

4. Ndërpritini të gjitha veprimet e këqija që i bëni me qëllim

Njoh një burrë që ka një dashnore. Një ditë e vura në pozitë të vështirë dhe i thashë, "Ti po jeton në kurorëshkelje. Po e bën gruan tënde shumë fatkeqe. Ti po shkon drejt ferrit."

Ai u përgjigj, "Ajo që thua ti është absurde. Ja të ta shpjegoj situatën. Gruaja ime nuk më kupton...". Pastaj më tregoi një histori të gjatë. Megjithatë, thellë në brendësi ai e dinte shumë mirë se sjellja e tij ishte e gabuar.

Shpesh dëgjojmë njerëz që zihen me dikë të thonë, "Ai (ajo) e filloi." Për çfarëdo gjëje të jetë grindja, është gjithmonë faji i tjetrit. Ngatërresën nuk e filloni kurrë *ju* apo jo? Jo! Tjetri duhet fajësuar gjithmonë!

Le t'ju kujtoj se në sytë e Perëndisë një grindje është po aq serioze sa një vrasje. Kështu pse të mos e zgjidhim atë debat? "E si ta bëj këtë?" mund të pyesni ju. Ja t'jua them unë se si: ndërprisni tani të gjitha veprimet e këqija të bëra me qëllim.

Sikur vetëm të rrinit për një çast dhe t'i bënit vetes këtë pyetje: "Çfarë është e gabuar në jetën time? Çfarë duhet rregulluar?" Në të vërtetë ju e dini shumë mirë se çfarë është e gabuar! Mos mendoni se Jezusi do t'ju falë në qoftë se vazhdoni të mëkatoni me qëllim? Bibla thotë: "Kthim i plotë!" Djali plangprishës, historia e të cilit tregohet në Bibël, i ktheu shpinën jetës së mëparshme.

Edhe ju mund të vini te Jezusi ashtu si jeni: mosbesues dhe të rënduar nga mëkatet. Por ju duhet të bëni një hap më tej dhe t'i jepni fund ç'do gjëje që ju tërheq poshtë drejt shkatërrimit dhe që ju e dini me ndërgjegje që është e keqe.

Në letrat e shumta që marr përditë, njerëzit ndonjëherë zemërohen dhe shkruajnë: "Je shumë i ashpër në ato që thua. Kjo e kjo gjë nuk është mëkat." Dhe pastaj bëjnë një listë gjërash për të cilat nuk kam folur kurrë! Në raste të tilla, unë bëhem veçanërisht i dijshëm se sa të pabindur jemi për ta vënë Jezusin që të sundojë jetën tonë. Ju kurrë nuk do të jeni në gjendje të bëheni i krishterë ose të jetoni si i krishterë në qoftë se nuk keni kurajën për t'ia dorëzuar jetën tuaj Jezu Krishtit dhe të braktisni një herë e përgjithmonë të gjitha ato

gjëra në jetën tuaj që duhet të zhduken.

5. Flisni me Perëndinë

A dini si të luteni? Ndoshta jeni në gjendje të recitoni ndonjë lloj formule, por a dini me të vërtetë se si të luteni? Disa mendime të njerëzve për lutjen janë kaq të çuditshme sa mund të m'i ngrinin qimet e kokës përpjetë... po të më kishte mbetur ndonjë!

Një ditë isha për vizitë në një familje. Nëna tha, "Edhe ne jemi të krishterë të mirë. Klara, eja këtu." Kur vogëlushja katërvjeçare i erdhi pranë, ajo vazhdoi, "Tregoji pastorit se sa bukur tashmë di të lutesh." Fëmija filloi të recitojë një lutje. Unë e ndërpreva menjëherë. "Pusho zemër. Nuk duhet të më tregosh mua se si mund të lutesh. Të lutem mos!"

Lutja e vërtetë është diçka krejt ndryshe. Lutja është t'i flasësh Perëndisë të cilit i afrohemi nëpërmjet Jezu Krishtit. Lutja është zbrazja e zemrave tona tek ai. Jeni lutur ndonjëherë kështu?

Një peshkop anglez me emrin Robinson shkroi një libër polemizues të quajtur *I ndershëm ndaj Perëndisë.* Në të ai shkruan, ndër të tjera, se njeriu modern nuk di më se si të lutet. Unë jam dakord me të në këtë pikë. Faji nuk është i lutjes por i njeriut modern. Teoria e Robinsonit është që besimi i krishterë duhet rishikuar plotësisht sepse sot njerëzit nuk dinë më se si të luten. Mua më duket më e drejtë që njerëzit duhet të mësohen prapë se si të luten.

Pse të mos bësh një provë për t'u lutur? Edhe në qoftë se thoni vetëm: "Zot, më ler të të gjej!" Apo: "Zot, të lutem më shpëto dhe mua!" Apo: "Zot, më ndihmo të gjej besimin e vërtetë!" Apo: "Zot, m'i fal mëkatet!" Hidhuni me kokë! Lutjet tuaja në fillim mund të mos jenë aq të bukura sa ato që recitojnë pastorët dhe priftërinjtë me librin e lutjes në dorë dhe me syzet e ulura në majë të hundës! Por nuk është e

nevojshme të bësh lutje të bukura. Ajo që ka rëndësi është se ju mësoni t'i flisni Perëndisë me zemër të hapur e të ndershme. Thjesht filloni të luteni dhe pjesa tjetër do të pasojë në mënyrë natyrale.

Besimi është një marrëdhënie e gjallë midis Perëndisë dhe njeriut. Dialogu është i domosdoshëm në atë marrëdhënie. Unë flas me Perëndinë; ai flet me mua.

6. Lexoni Biblën

Si u flet njerëzve Perëndia? Ai u flet nëpërmjet Biblës. Kështu që është absolutisht thelbësore që ju të filloni ta lexoni atë. Ju mund të mendoni se zor se e lexon më njeri Biblën. Kjo, për fat të keq, është më se e vërtetë.

Shpesh, gjatë vizitave që bëj, njerëzit më thonë, "Oh, pastor, ne kemi një Bibël të vjetër e cila daton që nga viti 1722. Është një trashëgimi familjare e lënë dorë më dorë nga stërgjyshja." Pastaj më tregojnë një send të madh për në muze të cilën është e qartë që nuk e lexon askush. Unë kam shumë respekt për Biblat e vjetra, por ju shkoni dhe blini për vete një Dhiatë të Re të vogël dhe të këndshme! Disa prej tyre janë më të vogla se dora ime. Botime të caktuara janë shumë tërheqëse. Merrni për vete një nga ato Dhiata të Reja moderne. Dhe pastaj lini mënjanë nga një çast çdo ditë për ta lexuar. Thjesht dëgjoni se çfarë ju thotë Jezusi nëpërmjet faqeve të saja.

Padyshim do të hasni disa pjesë që nuk do t'i kuptoni. Vetëm vazhdoni të lexoni. Ja se si ua shpjegoj unë gjërat të rinjve të mi: Një fermer brazilian më tha se kur u vendos në Brazil iu dha ca tokë. Sapo shkoi te ky vend ai zbuloi se ajo ishte vetëm një copë xhungël. Kështu ai filloi të pastrojë vendin nga pemët, të nxjerrë nga dheu gurët, dhe të shkulë

cungjet. Erdhi dita kur ai ishte gati për të zënë një pendë qe në parmendë dhe për të filluar të lëronte. Ai s'kishte bërë as tre hapa kur plori ngeci në një gur. Kështu që ç'bëri ai? Vrapoi në shtëpi për të marrë ca dinamit e për t'i hedhur në erë gurin, parmendën dhe qetë? Sigurisht që jo! Ai zbërtheu plorin nga parmenda, i kaloi anash pengesës, dhe vazhdoi të lëronte. Kur mbaroi rezultati nuk ishte në nivelin e duhur. Megjithatë ai e mbolli tokën dhe disa muaj më vonë mblodhi një prodhim të vogël. Vitin tjetër ishte pak më mirë. Ai pati mundësi të nxirrte më shumë gurë dhe të shkulte më shumë cungje, gjë që e bënte shumë më të lehtë parmendën për të kaluar. Vitin e tretë situata ishte përmirësuar shumë.

Ja se si duhet ta lexoni Biblën. Kryesorja është *të filloni* ta lexoni. Në qoftë se ka diçka që nuk e kuptoni, anashkalojeni vështirësinë dhe vazhdoni të lexoni.

Në kapitullin e parë të Dhiatës së Re, pas një liste të gjatë emrash të cilët ndoshta do t'ju duken pa interes dhe të mërzitshëm, do të vini papritur te ky varg: ***Ti do t'i vësh emrin Jezus, sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre***. Ju ndoshta do të reagoni ndaj këtij vargu duke thënë: "Këtë mund ta kuptoj! Ky është tamam për mua!" Lëreni Perëndinë t'ju flasë nëpërmjet Biblës në këtë mënyrë. Gjeni kohën për ta lexuar atë përditë. Dhe ofrojini këtë lutje Perëndisë: "Zot m'i hap sytë! Më jep zgjuarsi për ta kuptuar Fjalën tënde."

Edhe një gjë tjetër: Mos lejoni askënd ta denigrojë Biblën. Ai është një libër unik. Asnjë libër tjetër nuk është kaq i lidhur me jetën tuaj, apo kaq magjepsës.

Si ushtar i ri në Luftën e Parë Botërore, u dërgova një ditë në një mision special zbulimi. Ishte mbrëmje, muzg. Rrija ulur në buzë të një lugine të thellë. Dhe pastaj, papritur, pikërisht para se të binte nata, pashë një kamion kuzhinë të armikut që po çante rrugën duke u troshitur nëpër një lirishtë

të vogël në pyll. Ndoshta ishte nisur pak si shpejt. Ne kurrë nuk do ta kishim marrë me mend se ata mund të kalonin atje! Por ai kamion kuzhinë, që nuk kishte pritur sa të binte nata, na kishte zbuluar ne një nga rrugët që të çonin në pozicionet e armikut. Në qoftë se një kamion kuzhinë mund ta gjente rrugën nëpër pyll, përforcimet dhe municionet e trupave armike gjithashtu mund ta gjenin rrugën për në kampin e tyre. Këtu ishte një rrugë strategjike dhe ne nuk kishim ndër mend ta kursenim. Përkundrazi. Tërë natën e bombarduam.

Bibla është linja kryesore që përdor Perëndia për t'u dërguar ushqim dhe municion të krishterëve. Dhe Djalli është mjaft i mprehtë për ta bërë atë objekt të sulmeve të tij. Prandaj Bibla është nën sulm të vazhdueshëm. Djaloshi më budalla thotë, "Bah, duhet të jesh krejt i çmendur për të lexuar një libër të tillë!" Profesori i shkolluar mirë i universitetit përpiqet të provojë se Bibla është thjesht një libër si gjithë librat e tjerë. Mbi këtë pikë të vetme të gjithë bien dakord: zjarr të furishëm Biblës. Por në qoftë se ti do që të bëhesh fëmijë i Perëndisë, nuk duhet të lejosh që kjo të të ndalojë. Mos lejo askënd të denigrojë Biblën. Bibla vetë deklaron të jetë shkruar nga njerëz që ishin mbushur dhe ndriçuar nga Fryma e Shenjtë. Dhe kur të keni filluar për ta lexuar vetë atë, nuk do të kalojë shumë kohë para se të dalloni se një frymë tjetër, një frymë hyjnore, dihat nëpër faqet e saj.

Dikush më bëri këtë ankesë: "Bibla është një libër i mbyllur për mua. Do të doja të shpëtohesha, por, nuk marr asgjë nga leximi i Biblës." Iu përgjigja, "Kërkoji Perëndisë të të japë Frymën e tij. Lutu, për muaj të tërë po të jetë nevoja: 'Zot më jep dhuratën e Frymës sate që unë të mund ta kuptoj Fjalën tënde dhe të arrij të kem një besim të gjallë.' Më beso, Perëndia do t'i përgjigjet lutjes sate."

7. Dëgjoni predikimin e Fjalës së Perëndisë

Shkoni dhe dëgjoni Fjalën e Perëndisë atje ku ajo predikohet qartë. Duhet t'ju paralajmëroj se në shumë podiume predikimi, sot shpallet një mesazh i zbutur i ungjillit. Nuk do të shkoja në ato kisha po të isha si ju. Përsa më përket mua, nuk dua limonadë, por verën e pastër të Ungjillit. Nuk do të kalojë shumë kohë para se të njihni nëse predikohet Ungjilli i pastër apo jo. Për fat të mirë, ka predikues pothuajse kudo, të cilët ju mësojnë me besnikëri të vërtetën. Shkoni ku ndodhen ata dhe qëndroni nën zërin e Ungjillit. Bashkohuni me njerëz të tjerë që janë të vendosur për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë.

Një burrë më tha kohët e fundit, "Ti e di, unë jam individualist." S'mund të rrija pa iu përgjigjur, "Ti kurrë nuk do të jesh në gjendje ta mbash besimin gjallë në qoftë se nuk je në kontakt me të krishterët tjerë dhe në qoftë se nuk shkon në një kishë ku shpallet Fjala e Perëndisë."

Para se të përfundoj, do të desha t'ju tregoj një histori për një plakë që kam njohur. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në jetën time dhe u bë mjeti për të sjellë te Zoti tre inxhinierë me të cilët isha njohur. Më dukej se prej saj duhej të vërshonte një forcë e madhe shpirtërore, kështu në këtë rast të veçantë, shkova për t'i bërë një vizitë. Ajo ishte e veja e një minatori. U gëzua kur më pa dhe më tregoi se si ishte kthyer në besim.

Në atë kohë, ajo jetonte në një nga ish-rrethinat e Esenit. (Qysh atëherë është përfshirë brenda qytetit.) Emri i rrethinës ishte Shtopenberg. Ajo kishte lexuar në gazetën lokale se dy pastorë të rinj do të shuguroheshin në kishën e Shën Palit. Kështu ajo u tha shoqeve të saj, "Le të shkojmë të shohim. Gjëra të tilla janë gjithmonë ngjarje me rëndësi në Esen."

Ishte rrugë e gjatë deri në kishën e Shën Palit megjithëse ato i ranë shkurt përmes arave. Kur arritën, ndërtesa e stërmadhe ishte tashmë plot gati për të plasur. Kështu që atyre iu desh që të qëndronin në fund të sallës. Njëri nga pastorët që u shugurua atë ditë, Julius Daman, më vonë pati një ndikim të madh në qytet.

Kjo është historia që ma tregoi plaka: "Kur Julius Damani hipi në podium për të parën herë, lexoi nga kapitulli i tretë i Ungjillit të Gjonit: ***Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme***. Pastaj ai u përkul përpara dhe tha, 'Nga të gjitha fjalët në Bibël, nuk ka as edhe një fjalë që t'i trembem aq shumë sa fjalës "i humbur". Mund të jeni të humbur përjetësisht, deri në atë pikë sa edhe Perëndia tërhiqet prej jush. Ky është ferri!'" Gruaja vazhdoi: "Ja ku isha unë, një vajzë e vogël, që po rrija në fund të asaj kishe të madhe. Nuk dëgjova asnjë fjalë tjetër nga predikimi. Mu duk sikur të isha goditur nga rrufeja. Vazhdoja të përsëritja me vete, 'Edhe ti je e humbur. Ti nuk je në paqe me Perëndinë. Mëkatet e tua nuk të janë falur. Ti nuk je fëmijë i Perëndisë. Ti je e humbur!' Në një farë mënyre ia arrita të kthehesha në shtëpi, por kjo ndodhi si në ëndërr. Tri ditë më vonë im at më pyeti se mos isha sëmurë."

Ajo u përpoq më kot t'ua shpjegonte prindërve se ç'kishte ndodhur. Gjithçka që mund të thoshin ata ishte se atë e kishte lënë mendja, se po kalonte një krizë nervore. Askush nuk dukej ta kuptonte ankthin e thellë që po përjetonte ajo nga mendimi i të qenit e humbur përjetësisht.

"Për katër javë," vazhdoi plaka, "unë vetëm vija vërdallë, krejt e shastisur. Pastaj lexova në gazetë se pastor Damani do të predikonte përsëri. Kështu edhe një herë e bëra më këmbë gjithë rrugën nga Shtopenbergu në Esen. U luta gjatë gjithë

rrugës. E njëjta lutje - ishte një varg nga një himn - më vërtitej nëpër mend."

Në këtë gjendje arriti ajo në kishë. Ndërtesa ishte mbushur plot. Nuk kishte asnjë vend të lirë, kështu që asaj iu desh të rrinte në këmbë si më parë. Ajo u lut përsëri. Pastaj e hapi librin e himnit në numrin e treguar në listë dhe zbuloi, për habinë e saj të madhe, se ai ishte himni të cilin e kishte thënë me vete gjatë rrugës. "Në qoftë se të gjithë do ta këndonin këtë himn në frymë lutjeje," mendoi ajo, "ka shumë mundësi që të ndodhë diçka."

Pastor Damani u ngrit dhe lexoi një pjesë tjetër nga Ungjilli i Gjonit: ***Jezusi tha:... Unë jam dera; nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet.***

"Ishte hera e dytë që kisha qenë në këtë kishë," më tha ajo. Dhe përsëri nuk dëgjova asgjë përveç atij vargu të vetëm. ***Unë jam dera; nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet***. Brenda një çasti çdo gjë ishte bërë e qartë për mua. Krishti i Ngritur ishte dera për në jetë. Dhe unë eca nëpër atë derë! Nuk dëgjova asgjë më tepër nga predikimi; por ajo që dëgjova ishte mjaft. Kisha kapur jetën."

Ndonjëherë ua tregoj këtë histori njerëzve që thonë, "Oh, unë nuk shkoj kurrë në kishë. Nuk e duroj dot atmosferën e kishave. Më mirë shkoj për shëtitje në pyll ku mund të dëgjosh zogjtë që këndojnë dhe flladin që fëshfërin nëpër pemë." "Mirë," përgjigjem unë, "ajo grua nuk do të kishte arritur kurrë të besonte në qoftë se nuk do të kishte shkuar diku ku predikohej fjala e Perëndisë!"

Kështu, ç'duhet të bëni?

1. Jepini fund mosbesimit tuaj.
2. Mendimi i mirë për veten tuaj duhet të ikë!
3. Bëni hapin vendimtar.
4. Ndërpritini të gjitha veprimet e këqija që i bëni me

qëllim.
5. Flisni me Perëndinë.
6. Lexoni Biblën.
7. Dëgjoni predikimin e Fjalës së Perëndisë.

Secila nga këto pika është e rëndësishme. Por unë dua t'i përmbledh me një të vërtetë që është edhe më e rëndësishme.

Gjëja e rëndësishme nuk është se çfarë bëjmë *ne*. Më tepër është ajo që *Perëndia* ka bërë për ne në Jezu Krishtin. Ky është lajmi i mirë që unë jam i lumtur t'jua shpall juve: Jezusi ka bërë *çdo gjë* për secilin nga ne. Ai erdhi te ne, ai vdiq për ne, ai u ngrit përsëri për ne, ai është ulur në krahun e djathtë të Perëndisë për ne.

Jezusi është Bariu i Mirë i cili ka bërë *çdo gjë* për delet e tij. Autori i psalmit të njëzetetretë mban dëshmi për këtë. Ai thotë: ***Zoti është Bariu im, asgjë nuk do të më mungojë.*** Dhe ai vazhdon të përmendë të gjitha gjërat që Bariu i Mirë ka bërë për të....

Dëshira ime më e madhe është që edhe ju të arrini të thoni: "Zoti është Bariu *im*."

SI MUND T'I LEJOJË PERËNDIA GJËRA TË TILLA?

"64 persona vdesin në një aksident ajror."

"Një tërmet tjetër: 1200 të vdekur dhe 6000 të plagosur."

"7 të vrarë në një aksident në minierë."

"Një njeri i çmendur sulmon fëmijët me flakëhedhëse: 10 fëmijë të vrarë; të tjerët të plagosur rëndë."

Kurdoherë që njoftohen lajme të tilla në shtyp ose në televizion, dëgjojmë këto pyetje që bëhen kudo përreth nesh, "Po Perëndia? Ku është ai? Si e lejon ai gjithë këtë pa bërë asgjë? A nuk është ai i gjithfuqishëm? Është a s'është fare atje?"

Në mbarë botën po bëhen mizori. Gjyqe pa fund kanë zbuluar tmerret e kampeve të vdekjes në Treblinka dhe Aushvic. Dhe, më tronditësja nga të gjitha, fëmijët torturohen, vriten dhe keqtrajtohen kudo.

1. Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla?

Epo, kjo është tamam pyetje!

Atyre që e bëjnë këtë pyetje pa u menduar, thjesht në një përpjekje për të shfajësuar ndërgjegjen e tyre për indiferencën që kanë ndaj Perëndisë, nuk kemi asgjë për t'u thënë. Do t'u përgjigjemi vetëm atyre për të cilët kjo pyetje përbën vërtet një problem.

2. Perëndia në bankën e të akuzuarve?

Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla? Në qoftë se kemi ndër mend të bëjmë një akuzë kundër Perëndisë, ne jemi budallenj. Vetëm imagjinoni skenën e mëposhtme: Ajo ndodh në një sallë gjyqi. Ja tek jam unë, njeriu që është kaq i ofenduar dhe i trishtuar për gjithë vuajtjet në botë. Dhe jam

ulur në vendin e gjykatësit. I ulur në bankën e të akuzuarve ndodhet... Perëndia!

Dhe pastaj nga lartësia e vendit të gjykatësit, unë filloj të ndjek penalisht Perëndinë. "I akuzuar, ngrihu në këmbë! Si ka mundësi që i ke lejuar të ndodhin këto gjëra?"

Nuk ka kurrë mundësi që të ndodhë kjo! Nuk ka kurrë mundësi që Perëndia të shkojë në bankën e të akuzuarve dhe të gjykohet prej nesh. Kjo do ta bënte atë një figurë qesharake, të dobët dhe mjeran. Ai nuk do të ishte aspak Perëndi.

Thelbi është ky: në qoftë se Perëndia është Perëndi, atëherë ai është i shenjtë. Ai është Perëndia i gjallë. Ai është gjykatësi dhe ne jemi të akuzuarit.

Mbaj mend që njëherë po shkoja në një takim të trazuar në periudhën e turbullt midis dy luftërave. Kur oratori më dalloi në turmën që dëgjonte, thirri, "Hë, hë, ja ku qenka predikuesi! Pa eja këtu lart!" Kur shkova atje ai tha, "Ti mendon se ka një Perëndi, apo jo? Mirë, nëse ai ekziston, supozoj se do ta shoh atë pasi të vdes...". Tunda kokën në shenjë miratimi.

Ai vazhdoi: "Jam i kënaqur për këtë, sepse kur ta takoj do t'i them këtë, 'Ti e dije se fëmijët po vdisnin nga uria kurse të tjerët po dendeshin - dhe nuk bëre asgjë për këtë! Ti lejove që të bëhen luftëra - dhe njerëz të pafajshëm vuajtën kurse ata që ishin përgjegjës për këto vrasje u pasuruan! Ti nuk the asgjë për gjithë këtë fatkeqësi - asgjë kundër gjithë kësaj padrejtësie, shtypjeje dhe shfrytëzimi!' Po, do t'ia hedh të gjitha këto në fytyrë Perëndisë tënd. Dhe a e di se ç'do të bëj pastaj? Do t'i them, 'Dil jashtë! Zbrit nga froni dhe mbathja!"

Ia arriti të më zemëronte dhe e ndërpreva. "Bukuri! Edhe unë! Do të ulërij me ty, 'Zbrit nga froni dhe mbathja!'"

Një heshtje vdekjeje ra në takim. Oratori po më shikonte, i shushatur. Ai dukej sikur mendonte se kishte bërë ndonjë

gabim dhe se ndoshta në fund të fundit nuk isha unë pastori.

Kur pashë shprehjen e fytyrave të njerëzve, më erdhi për të qeshur. Edhe atmosfera nuk ishte më e njëjtë. Ishte çasti për të folur dhe nuk duhej ta humbisja.

"Dëgjo, një Perëndi që do t'ia lejonte vetes të fyhej prej teje në mënyrë të tillë do të ishte plotësisht qesharak. Po të them se një Perëndi i tillë nuk ekziston përveçse në imagjinatën tënde. Një Perëndi që do të mund të thirrej për të dhënë llogari, një Perëndi i cili do të qëndronte para teje si i akuzuari para gjykatësit - oh jo! Një Perëndi i tillë mund të ekzistojë vetëm në një mendje të sëmurë. Dhe mund të them vetëm këtë, 'Le ta heqim qafe një Perëndi të tillë. Le t'i japim fund një herë e përgjithmonë!'"

"Por ti je pastor apo jo?" belbëzoi ai me habi. "Sigurisht! Dhe prandaj do të doja të thoshja këtë." E ngrita zërin që të më dëgjonin të gjithë. "Do të doja të dëshmoj para të gjithëve se ka një Perëndi tjetër, Perëndia i vërtetë. Ju nuk do të jeni të zotë ta thërrisni *atë* për t'ju dhënë llogari. Përkundrazi, është ai që do t'ju thërrasë *ju* të dilni para gjyqit të tij të drejtësisë. Kur të vijë ajo kohë, ju do ta mbani gojën mbyllur. Nuk ka Perëndi të cilit mund t'i thoni 'Mbathja'. Por ka vërtet një Perëndi të shenjtë, të gjallë, të vërtetë. Dhe ky Perëndi, një ditë, mund t'ju thotë fare mirë, 'M'u hiq sysh! Dil jashtë!'"

Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla? Në qoftë se e bëjmë këtë pyetje në përpjekje për ta thirrur Perëndinë e gjallë për të dhënë llogari, arsyetimi ynë është plotësisht i gabuar. Sigurisht nuk do të marrim asnjë përgjigje. Vetëm do të tregojmë se sa budallenj jemi.

3. Perëndia dado fëmijësh?

"Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla?" pyesin shumë veta, të frikësuar dhe të revoltuar nga mendimet për të gjitha gjërat e tmerrshme që ndodhin në botë. Është një pyetje që u bëhet gjithmonë të krishterëve. "Na jep një përgjigje. Perëndinë tënde po akuzojmë. Ç'ke për të thënë në mbrojtje të tij?" A mund të ndihmojnë të krishterët për të justifikuar apo mbrojtur Perëndinë? Përsëri është një pikëpamje absurde në lidhje me Perëndinë e cila imagjinon se krijesat e tij mund ta mbrojnë.

Është njësoj si ta mendosh Perëndinë një dado fëmijësh, një kujdestare e cila është punësuar për të mbajtur rregull në çerdhe. Në qoftë se ndodh që një nga fëmijët të bjerë nga dritarja, të gjithë tmerrohen. "Ku ishte dadoja? Si mund ta ketë lejuar ajo që të ndodhte një gjë e tillë?" Kjo është shumë afër mënyrës se si mendojnë disa njerëz për Perëndinë. Është detyra e tij që të kujdeset për botën që gjërat të ecin pa probleme. Askush nuk pyet shumë për të deri sa diçka nuk shkon. Atëherë të gjithë menjëherë tronditen dhe pyesin veten se ku mund të ketë shkuar dadoja qiellore. Dhe pyetja natyrisht u drejtohet miqve të Perëndisë: "Si mund t'i lejojë Perëndia juaj gjëra të tilla?"

Të krishterët do të ishin fare budallenj që të përpiqeshin të vihesnin në mbrojtje të Perëndisë!

Nuk duhet ta ngatërrojmë Perëndinë me një dado fëmijësh! Ku është shkruar se është detyra e tij për t'u kujdesur që të sundojë rregulli në këtë botë poshtërsie dhe budallallëku?

Perëndia nuk i është borxhli askujt. *Ai është Zoti!*

4. A mund ta mohojmë në mënyrë kategorike ekzistencën e Perëndisë?

Ndodhin katastrofa. Dhe Perëndia hesht!

Për shumë veta konkluzioni duket i qartë: nuk ka Perëndi. Nuk mund të ketë asnjë Perëndi që të kontrollojë botën. Nuk mund të ketë asnjë Perëndi që të shikojë dhe dëgjojë çdo gjë. Dhe kështu Perëndia shtyhet krejt jashtë jetës sonë. "Do t'ua lemë në dorë teologëve për ta zgjidhur atë problem." Megjithatë, çfarë ndodh nëse, në fund të fundit, në të vërtetë ka një Perëndi? Po në qoftë se kemi qenë shumë të nxituar në mohimin e ekzistencës së tij?

Le ta deklaroj me shprehjen më të fuqishme të mundshme: Perëndia është vërtet i gjallë! Ai vërtet ekziston!

Në qoftë se pyesni se si mund të jem kaq i sigurt, unë vetëm mund të përgjigjem, "Perëndia e ka bërë veten të njohur. Ai erdhi te njerëzit në personin e Birit të tij, Jezu Krishtit. Përderisa Jezusi erdhi në botë, askush nuk mund ta mohojë ekzistencën e Perëndisë. Ta mohosh atë do të thotë që të pranosh injorancën ose keqdashjen tënde."

5. Pikëpamja krishtere për botën

Në qoftë se duam të kuptojmë se çfarë po ndodh në botë, duhet të dimë pikëpamjen krishtere për botën. Ndryshe kurrë nuk do ta zgjidhim problemin tonë. Bibla na tregon se Perëndia, Krijuesi, e bëri botën në harmoni dhe mirësi të plotë. Njeriu ishte kryevepra e veprës së tij krijuese. Perëndia e vuri atë në një vend nderi: ai donte ta bënte atë partnerin e tij. Kështu njeriu duhet të ishte krejtësisht i lirë.

Por katastrofa është regjistuar në faqen e parë të historisë njerëzore: atë që të krishterët e përshkruajnë si "Rënia".

Njeriu abuzoi me lirinë e tij. Ai u kthye kundër Perëndisë. Ai deshi të bëhej perëndia i vetvetes. Dhe këtë e kërkon akoma edhe sot.

Që nga kapitujt e parë të saj, Bibla deklaron se njeriu e ka ndarë veten nga Perëndia. Dhe me Rënien, ai e tërhoqi gjithë krijimin me vete. Është njëlloj sikur të ishte hapur porta e një dige. Vuajtje, vdekje, lot, fatkeqësi dhe padrejtësi të gjitha vërshuan në botë.

Bibla pohon qartë se bota në të cilën jetojmë nuk është ashtu si e deshi Perëndia. Ne jetojmë në një botë të rënë ku sundon mëkati dhe ku djalli, ***vrasës*** dhe ***ati i rrenës***, ka një fuqi të tillë sa që quhet "perëndi i kësaj bote".

Pikëpamja e Biblës mbi botën është tepër realiste dhe i përputhet me saktësi asaj që shohim rreth nesh. Ajo vazhdon me mësimin se Perëndia nuk imponon rregull në këtë botë të rebeluar. Bota duhet të ndjekë kursin e saj pikërisht deri në fund. Gjithçka që është e tmerrshme, e frikshme dhe e keqe duhet të realizohet plotësisht. Kur të vijë ajo kohë, Perëndia do t'i japë fund të gjithë asaj dhe do të krijojë ***një qiell të ri dhe një dhe të ri***.

Kjo nuk do të thotë që Perëndia thjesht e ka braktisur botën. Jo! Ai dërgoi Jezusin në të, për të vdekur në kryq për mëkatarët dhe për t'u ngritur nga të vdekurit. Kudo që njerëzit besojnë në Jezusin dhe e pranojnë atë, krijimi i ri i Perëndisë tashmë ka filluar. Të gjithë ata që i përkasin Zotit Jezus mbajnë këtë dëshmi: "Perëndia ***na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur***." Nëpërmjet dishepujve të Jezusit, Perëndia kërkon t'i sjellë ngushëllim, paqe, dashuri dhe ndihmë kësaj bote të rënë.

Të krishterët jo gjithmonë pyesin se përse Perëndia e lejon vuajtjen. Ata e dinë se nuk mund të jetë ndryshe në një botë të rënë. Dhe, duke e ditur këtë, ata marrin përsipër të ndihmojnë të tjerët. Por mbi të gjitha, ata presin ***qiej të rinj***

dhe një tokë të re, në të cilët banon drejtësia.

Po për sa i përket pyetjes: Si *mund* t'i lejojë Perëndia tmerre të tilla? Edhe në qoftë se ne jemi dakord që gjëra të tilla janë të pashmangshme në një botë të rënë, problemi akoma i torturon ata që janë prekur personalisht nga tragjedia. Mendoj për një çift të ri që kishin një djalë të vogël që e donin shumë. Një ditë atyre u sollën trupin e vdekur të tij: ishte vrarë nga një shofer i dehur. Kur ndodh kësi lloj gjëje, na digjet në buzë pyetja, "Si *mund* ta ketë lejuar Perëndia të ndodhë një gjë e tillë?"

6. A jemi në gjendje t'i kuptojmë rrugët e Perëndisë?

Më duket se një Perëndi të cilin mund ta kuptoja me zgjuarsinë time nuk do të ishte aspak Perëndi. Ai do të ishte vetëm një njeri si unë. Një fëmijë nuk e kupton se ç'tip njeriu është i ati. A është e besueshme që ne gjithmonë të jemi në gjendje t'i kuptojmë rrugët e Perëndisë?

Është një histori e vjetër që e dëgjoja kur isha fëmijë. Ajo e qartëson çështjen.

Na ishte një herë një eremit[1] plak që gjithmonë qahej për rrugët e Perëndisë. Por një ditë ai pa një ëndërr.

Një lajmëtar nga Perëndia iu shfaq dhe i tha eremitit t'i shkonte pas. Shkuan në një shtëpi ku iu dha një pritje e ngrohtë. I zoti i shtëpisë u tha, "Sot është një ditë e shënuar për mua. Armiku im i dha fund luftës me mua dhe si shenjë miqësie më ka dërguar këtë kupë të artë." Kur u larguan ditën tjetër, eremiti vuri re se lajmëtari e kishte marrë kupën me vete. Ai po bëhej gati të fliste me zemërim kur lajmëtari i tha, "Mbaje gojën! Këto janë rrugët e Perëndisë." Shpejt ata

[1] Eremit (ose oshënar): Njeri (kryesisht burrë në kohët e hershme të krishterimit) që jeton vetëm.

arritën në një shtëpi tjetër. I zoti, një koprrac plak, i mallkoi vizitorët e paftuar dhe u tha të shkonin në djall. "Hajde të ikim që këtej!" tha lajmëtari dhe ndërkaq, ia dhuroi kupën e artë koprracit. Përsëri eremiti u bë gati të protestonte dhe përsëri lajmëtari e ndaloi. "Mbaje gojën! Këto janë rrugët e Perëndisë." Aty nga mbrëmja ata arritën në shtëpinë e një burri që ishte shumë i dëshpëruar, sepse, pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e tij ai gjithmonë kishte hasur fatkeqësi. "Perëndia do të të ndihmojë," tha lajmëtari dhe, kur po niseshin për rrugë, i vuri zjarrin shtëpisë. "Mos!" thirri eremiti. "Mbaje gojën! Këto janë rrugët e Perëndisë."

Ditën e tretë shkuan në shtëpinë e një burri të trishtuar dhe të ngrysur. Ai nuk sillej mirë me asnjë përveç djalit të tij të vogël të cilin e donte shumë. Kur u larguan mëngjesin tjetër, burri u tha, "Nuk mund t'ju shoqëroj, por djali im i vogël do të vijë me ju deri tek ura. Ma kini shumë kujdes." "Perëndia do ta mbrojë," u përgjigj lajmëtari i Perëndisë. Kur arritën tek ura, ai papritur e shtyu fëmijën në lumë! "More demon hipokrit," ulëriu eremiti, "sigurisht që këto nuk ishin rrugët e Perëndisë...".

Pikërisht në atë çast, lajmëtari u shndërrua në një engjëll që shkëlqente nga lavdia qiellore. "Më dëgjo me kujdes! Ajo kupë ishte e helmuar. Kështu unë ia shpëtova jetën burrit dashamirës, kurse koprraci plak gjeti vdekjen duke pirë prej saj. I varfëri gjeti një thesar të vënë mënjanë kur po rindërtonte shtëpinë dhe u çlirua nga çdo nevojë për ditët që i mbetën. Ndërsa, përsa i përket burrit, djalin e të cilit e hodha në lumë, ishte një mëkatar i keq dhe po të rrinte me të, fëmija do të bëhej kriminel. Humbja e të birit e çoi të atin në pendim. Dhe fëmija është mirë atje ku është! Kështu, ti pate mundësi të shihje diçka nga urtësia dhe drejtësia e Perëndisë. Që tani e tutje, duhet të përkulesh para misterit dhe

providencës[2] së tij!"

Siç thashë, kjo histori ishte e mirënjohur kur isha i ri. Njerëzit që kanë lexuar histori të tilla në fëmijëri nuk janë kaq të nxituar për t'i rekomanduar Perëndisë se çfarë të bëjë dhe çfarë të mos bëjë. Ata e dinë se ne nuk mund t'i kuptojmë rrugët e Perëndisë.

Ne ndoshta nuk do të takojmë kurrë një engjëll në rrugë për të na shpjeguar gjërat siç takoi eremiti. Ne vetëm mund të vazhdojmë të ecim me tahmin në errësirë dhe të pranojmë faktin se nuk mund t'i kuptojmë rrugët e Perëndisë.

Perëndia ka thënë nëpërmjet gojës së profetit Isaia: ***Mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja, dhe as rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia.... Ashtu si qiejtë janë më të lartë se toka, kështu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja.***

Vetë profeti i madh ka deklaruar solemnisht: ***Zgjuarsia e tij është e panjohshme.***

Një poet i krishterë ka shkruar gjithashtu:

Perëndia lëviz në mënyrë misterioze
Për të kryer mrekullitë;
Ai i ngul gjurmët e hapave në det,
Dhe nget përmbi stuhitë.

Thellë në minierat e pamata
Të një arti që kurrë s'gabon
Ai ruan projektet e Tij të ndritura,
Dhe vulletin e Tij sovran ushtron.

Mos e gjyko Zotin me ndjenja të dobëta,
Por besoji Atij për hirin që të vesh;
Prapa një providence të vrenjtur
Ai fsheh një fytyrë që buzëqesh.

[2] Providencë: Përkujdesja e Perëndisë për botën gjatë historisë.

Mosbesimi i verbër sigurisht gabon,
Dhe veprën e Tij kontrollon më kot;
Perëndia veten e Tij vetë e interpreton,
Dhe do ta bëjë të qartë në bot'.

7. Të krishterët mësojnë të presin

E vërteta e çështjes është se shumicës së pyetjeve tona të vështira nuk mund t'u jepet përgjigje këtu në tokë. Duhet ta pranojmë se "mendimet e tij nuk janë mendimet tona". Por ne të krishterët jemi të sigurt se nuk do të ecim gjithmonë në errësirë. Jo, sepse në përjetësi të gjitha këtyre pyetjeve shqetësuese do t'ju jepet përgjigjja. Ky përshkrim ndihmon për ta shpjeguar këtë: Në qoftë se shikoni anën e prapme të një qilimi persian, e gjitha që mund të shihni duket si një ngatërrim i rastësishëm fijesh. Por kur qilimi kthehet nga ana tjetër, shfaqet një dizajn i shkëlqyer. Atëherë ju zbuloni se ekziston një rregull i përsosur në atë që duket si pështjellim.

Në këtë botë të vjetër ne mund të shohim vetëm anën e prapme të qilimit të jetës. Çdo gjë duket kaq e ngatërruar e pa kuptim. Por në qiell, do të jemi në gjendje të admirojmë anën e mbarë dhe atëherë do të çuditemi se sa me urtësi dhe sa metodikisht e ka modeluar Perëndia jetën tonë.

Në gjendjen tonë të tanishme, ne jemi si dikush që nget një veturë natën. Ai do të ishte në gjendje të shijonte pamjen e fshatit ndërsa kalonte aty, veçse errësira ia fsheh atë nga pamja. Ai nuk mund të shquajë asgjë nga peisazhi që do të dëshironte të shihte. Megjithatë, ai ka dritë të mjaftueshme për të ngarë, në sajë të fenerëve të parmë.

Ka shumë gjëra që ne të krishterët do të donim t'i dinim dhe t'i kuptonim. Ne do të donim t'i kuptonim udhët e Perëndisë, të ishim në gjendje të shpjegonim pse Perëndia e bën këtë apo atë gjë. Këtu në tokë ne jemi në errësirë. Shumë

gjëra na janë fshehur. Por Perëndia na ka dhënë dritë të mjaftueshme për ta gjetur udhën e duhur. Fjala e Tij - Ligji në Dhiatën e Vjetër dhe Ungjilli i Jezusit në Dhiatën e Re - na tregon mjaft nga rruga për të na çuar në synimin e përjetshëm.

Kur të kemi arritur në qiell, do të lindë dielli për ne. Atëherë do të jemi në gjendje të shohim qartë çfarë kishte në të djathtë e në të majtë të udhës sonë. Do të zbulojmë se ç'na ishte fshehur në tokë. Dhe do ta kuptojmë përse "Perëndia e lejoi gjithë këtë".

8. A s'mund të marrim asnjë përgjigje tani?

Ne kemi bërë një pyetje vigane: Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla?

Para se gjithash, na është dashur ta tregojmë qartë se ne nuk kemi asnjë të drejtë t'i flasim Perëndisë të shenjtë siç do të bënim me një njeri. Një person mund të thirret për të dhënë llogari, por Perëndia jo. Një person mund të veprojë padrejtësisht. Por Perëndia nuk kryen asnjë padrejtësi. Një person mund të analizohet dhe të kuptohet. Perëndia është mbi këtë.

Këto gjëra duhen thënë sa më qartë dhe më thjesht që është e mundur. Por pasi e kemi sqaruar arsyen, ne do ta bëjmë këtë pyetje përsëri, madje edhe më seriozisht se më parë: Pse i lejon Perëndia gjëra të tilla?

Dhe ka një përgjigje në Bibël. Problemi është se njeriu nuk do ta dëgjojë atë sepse arsyeja e tij që e bën këtë pyetje në radhë të parë është për ta akuzuar Perëndinë për padrejtësi. Megjithatë, përgjigjja e Biblës, i ndryshon rolet dhe na vë *ne* në bankën e të akuzuarve.

9. Çdo fatkeqësi është një paralajmërim dhe një thirrje

Lluka, shkruesi i ungjillit, tregon një episod që prek tamam thelbin e çështjes. Një grup njerëzish, të tronditur dhe të zemëruar nga një akt represioni politik që sapo kishte ndodhur, arritën ta gjejnë Jezusin për ta informuar për këtë. Në Jeruzalem po kremtohej një nga festivalet tradicionale. Në tempull ofroheshin flijime. Si zakonisht në raste të tilla, kur mijëra judenj mblidheshin në kryeqytet, garnizoni romak ishte në gatishmëri. Në këtë rast të veçantë kishte ndodhur një zënkë serioze. Nuk është e qartë se çfarë e shkaktoi atë. Por me sa duket disa njerëz që kishin ardhur nga krahina krenarisht e pavarur e Galilesë kishin tërhequr vëmendjen e disa ushtarëve romakë. Kishte patur një përleshje. Dhe një numër i madh galileasish ishin masakruar mizorisht.

"Si mund ta lejojë Perëndia një gjë të tillë?" Pyetja ishte tmerrësisht reale për njerëzit ndërsa ia raportuan incidentin Jezusit. Vetëm disa ditë para kësaj, një fatkeqësi tjetër i kishte tronditur banorët e Jeruzalemit. Një kullë e lartë me mure të trasha ishte shembur papritur duke varrosur tetëmbëdhjetë veta nën rrënoja.

Pyetja qëndronte aty në shumë zemra. "Po Perëndia?" Disa teologë që deklaronin se dinin gjithçka, sigurisht e dhanë përgjigjen: "Ata që vdiqën ishin mëkatarë të këqij dhe kjo ishte udha që zgjodhi Perëndia për t'i ndëshkuar."

Por Jezusi e hodhi poshtë këtë shpjegim. Ai tregoi shumë qartë se ne nuk mund t'i sondojmë sekretet e Perëndisë. Pastaj ai tha diçka që bëri që të gjithëve t'iu kalonte një valë e ftohtë të dridhurash nëpër shtyllën kurrizore. Ajo që tha ai i vulosi gojët e disave dhe i revoltoi disa të tjerë: ***Nëse ju nuk pendoheni, do të vdisni të gjithë me të njëjtën mënyrë.***

Çdo fatkeqësi, thoshte ai, megjithëse e mbështjellë me

mister, është një thirrje nga Perëndia, dhe një paralajmërim për një botë që jeton në kundërshtim me të.

Këto sinjale alarmi janë domosdoshmërisht të nevojshme.

Unë jam Zoti, Perëndia yt... Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. Kjo është porosia e Perëndisë për jetën tonë. Por ç'kemi bërë ne për të? Paratë tona, veturat tona, puna jonë, shëndeti ynë, fëmijët tanë: të gjitha janë bërë idhujt tanë. Këto janë perënditë të cilave u shërbejmë.

Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar. Mendoni për gjithë ato javë, muaj dhe vite kur ne nuk kemi patur aspak kohë për Perëndinë!

Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde. A e kuptojmë si ABC-në për "nderimin" e prindërve tanë sot?

Nuk do të vrasësh. Ç'vlerë i bashkangjit brezi ynë jetës njerëzore? Dhe askush nuk mund të deklarojë se është i pafajshëm në këtë drejtim. Sepse Bibla thotë se ***kushdo që urren vëllanë e vet është vrasës.*** Nëse kjo është e vërtetë, atëherë sa vrasje janë kryer në fshehtësi në shtëpitë dhe në vendet tona të punës!

Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore. Sa e sa martesa janë prishur, zgjidhur apo shkatërruar! Ne tallemi me pastërtinë sikur të ishte jashtë mode. Në vend që t'i marrim seriozisht urdhërimet e Perëndisë, flasim për "vështirësitë seksuale", për "mosdashjen që të ndrydhim vetveten".

Nuk do të vjedhësh. Vjedhja fillon duke mos kthyer librat që ke marrë hua. Sikur të gjitha zotërimet tona të fituara në mënyrë të padrejtë do të bërtisnin, çfarë ulërime do të kishim në shtëpitë tona!

Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd. Ç'kemi bërë ne me këtë urdhërim? Jeta publike dhe private janë helmuar nga shpifjet. Një person e tërheq zvarrë tjetrin nëpër batak. Po zilia? A nuk është bërë ajo një nga

faktorët shtytës të jetës politike?

Çfarë tha Jezusi? ***Nëse ju nuk pendoheni, do të vdisni të gjithë me të njëjtën mënyrë.***

Perëndia i shqeu qiejtë dhe dha Birin e tij që ne të kemi falje të mëkateve, jetë dhe shpëtim nëpërmjet tij. Dhe çfarë po bën njeriu sot me këtë dhuratë të Perëndisë? Ai e hedh poshtë atë. Ai bën gjoja sikur nuk di se çfarë të bëjë me të për shkak të problemeve të cilave duhet t'u bëjë ballë.

Duhet të pushojmë së pyeturi se përse Perëndia i lejon këto fatkeqësi. Do të ishim të mençur të dëgjonim paralajmërimet e tij dhe të pendoheshim.

10. Një Perëndi i rreptë?

"Këtë e marr vesh," mund të thotë dikush. "Por në qoftë se të gjitha tragjeditë janë paralajmërime nga Perëndia, logjikisht rrjedh se është Perëndia që i dërgon ato dhe kështu që ai është përgjegjës për to."

Dhe unë jam dakord. Në Bibël ka një fjali që të fut tmerrin, e cila thotë këtë: ***Në rast se në një qytet ndodh një fatkeqësi, a nuk e ka shkaktuar vallë Zoti?***

Gjithmonë do ta mbaj mend atë natë të tmerrshme kur Eseni u bombardua për herë të parë. Unë kisha mbetur si i zënë në çark në shtëpi e cila kishte marrë zjarr. Gjithçka rreth meje ishte një botë në flakë! Nuk kishte asnjë mundësi për ta shuar zjarrin - të gjitha tubat e ujit kishin plasur. Pikërisht kur po i dorëzohesha dëshpërimit, m'u kujtua kjo fjalë e profetit Amos: ***Në rast se në një qytet ndodh një fatkeqësi, a nuk e ka shkaktuar vallë Zoti?***

Një paqe e madhe erdhi mbi mua. Unë nuk isha lënë në duart e njerëzve apo të rastësisë: Unë isha në duart e Atit, të Zotit tonë Jezu Krisht.

Atëherë e ndjeva se mendimi ynë për Perëndinë është

shumë shpesh i gabuar. Duhet që të çlirohemi nga mendimet për të që i kemi shpikur nga vetja jonë dhe të mbahemi fort në atë që vetë Perëndia na ka zbuluar!

Mendimet tona për Perëndinë janë të paqarta, foshnjarake, prej budallai dhe të cekëta. Perëndia nuk është ai "gjyshi plak e i dashur" që imagjinojmë ne. Dhe kur paragjykimi ynë për Perëndinë nuk i përputhet realitetit, reagimi ynë i parë është ta heqim qafe Perëndinë! Megjithatë, ndërsa është vërtet e mundur t'i heqim qafe mendimet tona false për Perëndinë, *nuk* është e mundur të heqim qafe vetë Perëndinë. (Megjithëse ai mund të na heqë qafe ne!)

Ku është shkruar në Bibël - dëshmia e Perëndisë për veten e tij - se ai është "Zoti i mirë"? A nuk thuhet më tepër se ai është një ***Perëndi... i tmerrshëm***, një ***Perëndi xheloz***, një ***Perëndi që fshihesh***? Bibla e krahason atë me një luan që ulërin: ***Zoti bërtet nga Sioni***. Dhe në Dhiatën e Re: ***Gjë e tmerrshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë të gjallë.*** Jezusi, që është më i informuar se të gjithë mësuesit tanë, tha të njëjtën gjë: ***Mos kini frikë nga ata që vrasin trupin, por nuk mund të vrasin shpirtin; kini frikë më tepër nga ai që mund t'ua humbë shpirtin dhe trupin në Gehena.***

Bibla thotë gjithashtu se frika e Zotit është fillimi i njohjes. Dhe kur lexojmë librin e fundit të Biblës, ku përshkruhen ngjarjet e ardhshme, gjithë dëshira për ta krahasuar Perëndinë me një "gjysh plak e të dashur" largohet plotësisht prej nesh. Sepse zbulojmë se Perëndia mund të jetë tmerrësisht i rreptë; dhe kjo ndodh sepse ai është i drejtë. Ai nuk i mbyllë sytë para mëkateve tona. Perëndia është drejtësia vetë. Ai i ruan me xhelozi urdhërimet e tij.

Mos na duket tepër e rëndë kjo gjë?

Epo, ja që kështu është! Perëndia nuk përputhet me

nocionin tonë për të. Për më tepër, na përket ne t'ia përshtatim veten realitetit të Perëndisë. Në Gjykimin e Fundit, njeriu që nuk ka frikë nga Perëndia do ta provojë në kurriz të tij se sa i tmerrshëm mund të jetë Perëndia.

Sigurisht, disa njerëz do të thonë se nuk besojnë në Gjykimin e Fundit. Atyre duhet t'u themi se kjo nuk ka ndonjë rëndësi! Kemi mjaft kohë për të pritur dhe për të parë se kush ka të drejtë: tallësi mosbesues apo Fjala e përjetshme e Perëndisë. Kjo Fjalë vërteton se do të ketë gjykim. Të gjitha fatkeqësitë e botës janë vetëm për ta paraprovuar atë.

Në Bibël gjejmë këtë fjali: ***Vetë sjellja jote e keqe dhe shmangiet e tua do të të dënojnë. Prano, pra, dhe shiko sa e keqe dhe e hidhur për ty është të braktisësh Zotin, Perëndinë tënd, dhe të mos kesh fare frikë nga unë, thotë Zoti, Zoti i ushtrive***. Kjo do të jetë përvoja e botës në tërësi dhe e çdo individi në veçanti.

Si mund t'i lejojë Perëndia gjëra të tilla? Pyetja bazohet mbi një nocion të gabuar për Perëndinë.

Prandaj ai dërgoi Birin e tij në botë. Prandaj Biri i Perëndisë vdiq në kryq për ne. Prandaj Perëndia e ngriti Jezusin nga të vdekurit. Prandaj ne sot mund të themi: ***Ai që ka Birin, ka jetën***. Na përket neve që ta pranojmë këtë shpëtim që na është ofruar dhe të bëhemi fëmijë të Perëndisë të Plotfuqishëm; fëmijë që s'është më nevoja të frikësohen prej tij, sepse mëkatet e tyre janë falur.

Perëndia kërkon shpëtimin tonë. Prandaj ai na paralajmëron me anë të Fjalës së tij dhe me anë të ngjarjeve të panumërta të jetës. ***Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia, dhe nuk ka asnjë tjetër.***

Bibla guxon të deklarojë se ***Perëndia është dashuri*** pikërisht për këtë arsye. Por është krejt ndryshe të flasësh për të si një "Zot i mirë" që nuk turbullon ujë.

Kjo e vërtetë e madhe më la përshtypje kur isha në një situatë veçanërisht të tmerrshme. Ishte mbrëmje dhe unë ndodhesha në një oborr të zymtë. Një ditë më parë, qyteti ynë i Esenit ishte bombarduar keq. Sapo kishin arritur të hapnin një strehim kundërajror që poshtë gërmadhave dhe t'i nxirrnin të vdekurit. Atje, të nderë rreth meje ndodheshin trupat e shtatëdhjetë njerëzve, shumë prej të cilëve i njihja. Kishte njerëz të moshuar, nëna të reja, dhe fëmijë - të gjithë ishin goditur nga lufta. Ah, vogëlushët e dashur! Të shtrirë aty, të asfiksuar, të mbytur, të vdekur.

Me imagjinatën time, munda t'i shikoj fëmijët duke luajtur në diell në një lëndinë të mbuluar me lule. "Ja se si duhet të rriten fëmijët!" thërriste zemra ime. "Ata nuk duhej të shtriheshin aty të vdekur!"

Pastaj thirrja e vjetër shpërtheu në zemrën time. "Perëndi, ku ndodheshe atëherë? Ku je tani? Si mund ta lejosh një gjë të tillë?"

Nuk pati asnjë përgjigje. Vetëm një tra gjysmë i coptuar kërkëlliti frikshëm në erën e mbrëmjes.

Papritur një skenë më vetëtiu në mendje. Pashë Jezusin në kryq. ***Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme***. Ai kryq m'u shfaq si një lloj drite, një fener i dashurisë së Perëndisë, i vendosur në këtë botë mjerimi.

Unë nuk i kuptoj udhët e Perëndisë. Madje më kap tmerri kur shoh se si Perëndia është në gjendje të "braktisë" botën. Por nga kryqi i Jezusit rrezaton një rreze drite. Atje, unë shoh deri në zemrën e Perëndisë. Atje, ai tregon dashurinë e tij për mua dhe dëshirën e tij të zjarrtë për të më tërhequr, me anë të dashurisë së tij, pranë vetes së tij.

11. Cili është qëllimi i gjithë kësaj?

Kur dëgjojmë për fatkeqësi në lajme, vazhdon të përsëritet pyetja: Pse i lejon Perëndia gjëra të tilla?

Por pyetja bëhet akoma më shqetësuese kur dhe ne vetë jemi përfshirë në fatkeqësi. Kur humbim një fëmijë. Apo kur një goditje drithëronjëse na shkatërron tërë jetën. Atëherë pyetja nuk është më thjesht teorike. Ajo djeg si zjarr brenda nesh: "Pse më ndodhi kjo? Si mund të ma bëjë Perëndia një gjë të tillë?"

Dhe deri sa të marrim një përgjigje, nuk mund të ndiejmë paqe. Një person që qe një ndihmë e madhe për mua për ta kuptuar këtë, ishte një minator me emrin Merle.

Ai kishte qenë një njeri trupmadh dhe i fuqishëm, që nuk kishte frikë as nga Perëndia as nga djalli. Por një ditë u shemb miniera dhe e zuri brenda. Këmbët iu paralizuan. Kështu u nisa t'i bëj një vizitë. E gjeta në shtëpi, në një karrocë invalidësh, të rrethuar prej disa miqve të tij. Kur më pa te dera, filloi të bëjë potere të madhe, "Hë, frekuentues i kishës, ku ishte Perëndia yt i mirë kur mua më binin gurët përsipër? Ou, shko në djall më gjithë gjepurat e tua." Ishte kaq i tmerrshëm sa që nuk munda të thosha asnjë fjalë dhe m'u desh të largohesha pa e hapur gojën.

Por disa minatorë - të krishterë të vërtetë - filluan të merakoseshin për të. Ata i treguan atij shtegun për te Jezusi, rrugën e shpëtimit. Një ndryshim i madh ndodhi tek ai. Mëkatet iu falën dhe ai bëri paqe me Perëndinë.

Pas kësaj, i shkova një ditë për një vizitë. E gjeta në rrugë para shtëpisë së tij të ulur në karrocën e tij. Në këtë kohë ishim bërë miq të mirë.

U ula pranë tij në një nga shkallët e verandës. Sepse

munda ta shihja nga shprehja e fytyrës së tij se kishte për të më thënë diçka të rëndësishme. Nuk e zgjati shumë. "E di," tha, "ndiej se nuk kam edhe shumë kohë për të jetuar. Por tani e di se ku do të shkoj kur t'i mbyll sytë. Kur të vij në praninë e Perëndisë, do të bie në gjunjë dhe do ta falenderoj që ma theu shtyllën kurrizore."

"Merle," i thashë, "çdo të thuash?"

Ai buzëqeshi dhe shpjegoi, "Në qoftë se nuk do të më kishte ndodhur aksidenti, unë do të kisha vazhduar sipas mënyrave të mia të këqija, larg Perëndisë, deri sa të përfundoja në ferr. Perëndisë iu desh të merrte masa ekstreme për të më drejtuar te Biri i tij, Shpëtimtari im. Po, ishte e vështirë! Por ishte për të mirën time, për shpëtimin tim të përjetshëm."

Bëri një pauzë. Pastaj tha ngadalë, "Më mirë të hysh në parajsë i gjymtuar se sa të hidhesh në ferr me të dyja këmbët."

E zura për dore. "Merle, ke kaluar një shkollë të vështirë. Por nuk të shkoi kot. Mësimin e mësove." Dhe menduam me trishtim për gjithë ata njerëz që janë goditur aq ashpër, por që nuk e dëgjojnë Perëndinë që u thërret përmes sprovave të tyre.

Kur na ndodh një fatkeqësi, nuk duhet të mendojmë, "Pse e lejon Perëndia një gjë të tillë?" por më mirë, "Cili është qëllimi i saj? Çfarë kërkon të më mësojë ai nëpërmjet kësaj? Atëherë mund ta kuptojmë se çfarë ka shkruar autori i himnit:

Kur nëpër ujëra të thella të bëj thirrje të shkosh
Lumenjtë e trishtimit s'do të vënë përposh;
Sepse do të jem me ty, shqetësimet të t'i bekoj,
Dhe brengën më të thellë të ta shenjtëroj.
Kur nëpër prova zjarri, rruga jote do të kalojë,
Hiri im, i gjithmjaftueshëm do të të furnizojë:
Flakët nuk do të të dëmtojnë; unë vetëm planizoj

Mbeturinat të t'i heq dhe arin të ta pastroj.

Një ditë një burrë erdhi për ta vizituar një të krishterë plak dhe me përvojë. Ai u ankua për vështirësitë e ndryshme që i duhej të duronte. Pastaj tha, "Pse ma bën Perëndia këtë? Si mund t'i lejojë ai gjëra të tilla?" I moshuari iu përgjigj, "Ke parë ndonjëherë ndonjë tufë delesh? Që thua ti, disa dele duan të jenë të pavarura, kështu që ato largohen nga bariu. Atëherë bariu u dërgon qenin nga pas. Qeni leh, delet tremben dhe kthehen me vrap për të gjetur mbrojtje në krah të bariut. Hë, e shikon, vuajtja luan pothuajse të njëjtin rol si qeni i stanit. Në fillim ajo na tremb. Por qëllimi i vetëm i saj është të na kthejë te Bariu i Mirë, Zoti Jezus. Kështu, në vend që të ankohesh shko pikërisht tani tek Shpëtimtari yt. Ai i çlodh të gjithë ata që janë të lodhur dhe të ngarkuar rëndë!"

12. Si mund t'i bëjmë ballë?

Në realitet, unë nuk e di se si mund të jetë në gjendje një jobesimtar t'u bëjë ballë vështirësive të jetës. Ai thjesht nuk mund t'i përballojë ato. Çdo gjë në jetën e tij duhet të shkojë si në vaj. Në qoftë se atij i ndodh ndonjë tragjedi, ai inatoset shumë dhe qorton edhe Perëndinë edhe njeriun.

Në vend që të pyesim, "Pse e lejon Perëndia një gjë të tillë?", në vend që ta akuzojmë Perëndinë, duhet të pranojmë se jemi të dobët, të shkatërruar, të paaftë ta gjejmë vetë udhën tonë.

Unë vërtet nuk e di se si mund të arrijë t'ia dalë një njeri pa Jezusin. Dhe ndërsa horizonti errësohet dhe bëhet gjithnjë e më kërcënues në këtë botë, dishepulli i Jezusit mëson t'i kthejë sytë nga qëllimi i përjetshëm, mbretëria qiellore në të cilën ai është thirrur.

Le t'ju tregoj një histori të vërtetë: Shumë vjet më parë, isha pastor në një rajon të rëndësishëm minatorësh. Një ditë

kur kisha dalë për vizitë, shkova në shtëpinë e disa njerëzve që po festonin një përvjetor. Shishet me pije alkoolike po kalonin dora-dorës dhe të çjerra dhe shamatë dëgjoheshin nga çdo qoshe. Por kur unë u paraqita në derë, pati një qetësim. Pastaj një burrë bërtiti, "Hej, Predikuesi! Ç'kërkon këtu ai? Predikues, ne s'çajmë kokë fare për gjepurat e tua. Ne me kënaqësi do të ta dorëzonim parajsën ty... ty dhe zogjve!"

"Jeni shumë të sjellshëm," iu përgjigja, "por ka diçka që s'mund ta kuptoj. Si mund të më dorëzoni diçka që nuk ju përket juve? Në një farë mënyre ndiej se ju nuk keni parajsë për të ma dhënë mua! Më duket se rruga juaj ju çon në ferr dhe jo në parajsë. Kështu ç'do të na lini mua dhe zogjve?

Burri u duk i zënë ngushtë. Pastaj vazhdoi, duke bërtitur, "Ohu! Predikuesit gjithmonë përfundojnë në ngushëllimin e njerëzve duke u premtuar atyre parajsën. Dhe vë bast se ti po bëheshe gati pikërisht për këtë!"

"E ke gabim!" u përgjigja. "Nuk kam as qëllimin më të vogël që t'u jap njerëzve shpresën e parajsës për të cilën nuk kanë të drejtë. Unë vetëm mund t'ju nxit të mos rrini në rrugën që të qon në ferr dhe t'ju ftoj që të vini te Jezusi, Shpëtimtari. Ai ofron parajsën për të gjithë ata që e pranojnë."

Mos gënjeni veten....

Shpresa për jetë të përjetshme është një privilegj që e ofron Jezusi, krejt prej hirit, vetëm për ata që "e pranojnë" atë.

Besimtarët nuk pyesin gjithmonë se si mund ta lejojë Perëndia këtë apo atë sprovë. Ata vuajnë si gjithë të tjerët. Ata përpiqen ta lehtësojnë këtë botë të vuajtur sa të mundin. Por ndërsa vazhdojnë udhën e tyre, në vuajtje dhe gëzim, ata këndojnë në zemrat e tyre fjalët e himnit:

Perëndia mban çelësin e gjithë së panjohurës,
Dhe unë jam i gëzuar;
Nëse dorë tjetër çelësin do ta mbante,
Apo ai mua t'ma besonte,
Mund t'isha i trishtuar.

Po sikur shqetësimet e së nesërmes t'ishin këtu
Pa pushimin e saj!
Do të doja që ditën ta shkyçte;
Dhe kur orët të hapeshin krejt, të thoshte
"Më i miri është vullneti im."

Vetë mugëtia e vështrimit tim
Më bën mua të sigurt;
Se, duke u endur në mënyrën time mjegullplotë
Ndiej dorën e tij; e dëgjoj të më thotë,
"Ndihma ime është e sigurt."

Nuk mund t'i lexoj planet e tij për të ardhmen;
Por këtë e di:
Kam buzëqeshjen e fytyrës së tij,
Dhe gjithë mbrojtjen e hirit të tij,
Ndërsa këtu poshtë rri.

Mjaft! kjo m'i përmbush gjithë kërkesat,
Dhe kështu çlodhem duke pushuar!
Se atë që un' s'mund ta shoh, ai e shikon,
Dhe me kujdesin e tij ai më shpëton,
Përgjithmonë i bekuar.

Niçeja ka thënë në një poemë: "Mjerë njeriu që nuk ka shtëpi!" I tillë është mjerimi i këtij brezi: njerëzit duhet t'i përballojnë provat e rënda të jetës pa asnjë vend çlodhjeje dhe pa asnjë siguri. "Mjerë njeriu që nuk ka shtëpi!" Kjo është tragjedia e veçantë e epokës sonë.

Le të nisemi me zell në kërkim të Zotit Jezus. Ishte ai që tha, ***Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa***.

A nuk do të dëshironit që të kishte një të rezervuar për ju?

E DREJTA JONË PËR DASHURINË

1. Një hidhërim i pamasë

Ç'epokë paradoksale që jetokemi! Kurrë më parë nuk kanë jetuar njerëzit kaq pranë njëri-tjetrit - të grumbulluar e të ngjeshur siç jemi ne - e megjithatë, kurrë më parë nuk kemi vuajtur kaq shumë nga vetmia.

Një djalosh gjashtëmbëdhjetë vjeçar më tha një ditë, "Nuk kam asnjë njeri në botë!" "Hajde tani! Mos u bëj budalla!" i thashë. "Po yt at?" "Kur kthehet plaku im nga puna në shtëpi, grindet pak, kollofit darkën, dhe del përsëri." "Mirë, po jote ëmë?" "O ajo! Ajo është e mbytur në punë gjer në grykë. Ajo s'ka aspak kohë për mua." "Po shokët e punës?" "Punojmë bashkë dhe kaq! Jo, s'kam asnjë për të bërë muhabet." Dhe këtë ma tha një i ri gjashtëmbëdhjetë vjeç!

Të rinjtë nuk janë të vetmit që mund ta përjetojnë këtë lloj vetmie. Shumë gra të martuara ndihen të vetmuara megjithëse jetojnë me burrat e tyre. Shumë shpesh burri nuk ka as idenë më të vogël se çfarë e shqetëson gruan e tij. Dhe ajo nuk ka asnjë ide se ç'e shqetëson burrin e saj. Dhe ne u thënkemi atyre çift! Në këtë mënyrë ne të gjithë përfundojmë të jetojmë në vetmi! Njerëzit janë gjithë veshë kur filozofët tanë flasin për vetminë e njeriut modern; për arsyen e thjeshtë se burrat dhe gratë kudo po kërkojnë duke lypur të shpëtohen nga vetmia. Tani kjo dëshirë për të shpëtuar nga izolimi ynë shpesh kombinohet me forcën tonë më të madhe që ndodhet brenda nesh: nxitjen seksuale. Kur është kështu puna, ne menjëherë e injorojmë çdo kufizim.

Djaloshi gjashtëmbëdhjetë vjeçar do të kërkojë një dashnore për ta shpëtuar nga vetmia. Burri i martuar, që jeton me gruan e tij, por që ende ndihet i vetmuar, do të dalë për fundjavë me sekretaren e tij, me shpresën se ajo do ta bëjë ta

harrojë vetminë. Studenti, duke u ndier tepër i vetmuar midis dhjetë apo njëzet mijë të rinjve të universitetit, do të angazhohet me një studente po aq të vetmuar sa edhe ai. Kështu dëshira jonë për të shpëtuar nga vetmia kombinohet me energjinë tonë seksuale. Kjo është arsyeja pse bota e sotme është kaq shumë e dijshme për seksin.

Përveç kësaj, biznesmenët dinakë - krijuesit e filmave dhe romancierët - arrijnë përfitime të jashtëzakonshme nga fakti se njeriu e përdor seksin për ta zgjidhur problemin e vetmisë. Është përhapur fjala: jo më filma pa të paktën një skenë dashurie, jo më libra pa të paktën një rast tradhtie bashkëshortore. Dhe kur shikojmë njerëzit e tjerë që flirtojnë, ndiqen dhe bëjnë dashuri me njëri-tjetrin, kemi përshtypjen se jeta qenka e mrekullueshme!

Një vajzë e re më tha kohët e fundit, "Pastor, ne kemi vlera të ndryshme nga gjyshërit tanë. Ne kemi një moral të ri, një kod të ri etik." Kur dëgjoj këtë gjë, pothuajse tundohem të heq kapelën (në qoftë se mbaj të tillë) dhe të them, "Më ndjeni Zonjushë!" Por po të kishe qenë pastor në një qytet të madh për aq kohë sa dhe unë, nuk do të besoje më atë lloj bisede. Dhe unë e di nga përvoja se gjithë ajo gjuhë plot mburrje përdoret vetëm për t'u dukur. Prapa saj shtrihet një hidhërim i pamasë: i të rinjve që kanë marrëdhënie dashurie të dyshimta dhe që nuk mund t'u bëjnë ballë problemeve të tyre; i çifteve të martuara që përpiqen të fshehin atë që bëjnë ose që ndahen. Po, ka hidhërim të pamasë.

Dhe të gjithë dimë diçka për të. Sepse unë nuk po flas për njerëz të tjerë, po për vete dhe për ju!

Shumë vjet më parë, mbajta një fjalim mbi të njëjtën temë në një qytet të vogël afër Lipes. Ky takim ishte i hapur vetëm për të rinjtë. Kur hyra në sallë, thashë me vete, "Në ç'rrëmujë qenke futur kështu! Eh, këtu qenka si në ferr!" Djem e vajza... dhe kaq shumë tym cigaresh! Disa djem kishin sjellë

me vete ca uiski. Disa vajza ishin ulur në gjunjët e djemve. "Dhe më duhet të flas këtu?" Mendova. "Epo, plakush, do të kesh nevojë për shumë kurajë." Pastaj fillova të flisja: "Ne mund të përjetojmë një hidhërim që ta copton zemrën në jetën tonë seksuale." U duk sikur pikërisht në atë çast dikush kishte ndezur dritën. Akoma e kam parasysh një nga djemtë që përnjëherësh e rrëzoi vajzën që kishte mbi gju. Ai ishte prekur. Papritur pati një heshtje varri në sallë. Nuk mund të mos mendoja, "Në pamje të parë, të gjithë duken të lumtur. Por kjo provon se unë kam plotësisht të drejtë: ne vërtet mund të përjetojmë hidhërim që të copton zemrën në jetën tonë seksuale."

2. Nga vjen gjithë ky hidhërim?

Ky hidhërim vjen nga fakti se ne nuk e njohim më ndryshimin midis së drejtës dhe së gabuarës. Ne pretendojmë të kemi ide të reja për moralin. Por mos harroni këtë: *mëkati nuk është mit.* Sa herë që unë mëkatoj dhe bëj diçka të keqe, një peshë bie mbi ndërgjegjen time. Ky është një realitet! Për fat të keq, ne nuk e dimë më me saktësi se ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar. Le t'ju bëj disa pyetje të thëna fare hapur: Është e drejtë apo e gabuar që të jepesh pas marrëdhënieve seksuale para martese? Nëse martesa juaj nuk është e lumtur, është tradhtia bashkëshortore një nevojë apo një e keqe? Dhe a është homoseksualiteti midis burrave, apo me djem të rinj, apo midis djemve, mëkatar apo i ligjshëm? Është lezbizmi mëkat apo jo? Është e drejtë apo e gabuar të masturbosh? Apo për të kërkuar divorcin?

Për ta përmbledhur, çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar? Ky është shkaku i hidhërimit tonë. Me mijëra libra përpiqen të na bëjnë të besojmë se seksi nuk ka të bëjë fare

me atë se ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar. Kështu kjo çështje thjesht nuk shtrohet. Është gjë e keqe të jesh një mik i keq - bukur. Por seksi është jashtë shqyrtimit për të mirë a për të keq, na thuhet. Merrni filmat modernë, për shembull: në një marrje nga afër, shohim një puthje; pastaj perdja ulet dhe prapa perdes mund të shohim figura të paqarta në krahët e njëri-tjetrit. Kjo lloj skene është thjesht pjesë e filmit. Nuk ka çështje të së mirës apo së keqes. Në rregull?

Çfarë është e mirë? Çfarë është e keqe?

E mbaj mend shumë mirë se si, si i ri që isha, papritur pashë dritën. Munda ta dalloj ndryshimin midis së mirës dhe së keqes. Pastaj filloi të më shqetësojë kjo pyetje, "Çfarë është e lejueshme dhe çfarë nuk është?"

Por para se t'i japim një përgjigje të argumentuar kësaj pyetjeje, së pari duhet të pyesim, "Kush vendos, përfundimisht, çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar?"

Një ditë, një çift i ri më erdhi për vizitë. Ajo ishte një vajzë e shthurur, e llangosur me makijazh. Ai, me gishtat të ngjyrosur me nikotinë, dukej qartë që ishte djalë i paqëndrueshëm. U thashë, "Të paktën e di se ku jam me ju. Është tepër e qartë." Vajza ma ktheu aty për aty, "Por nuk ka asgjë të keqe këtu pastor! Nuk ka asgjë të keqe!" Iu përgjigja, "Një moment! Kush e ka të drejtën të na thotë nëse ka apo nuk ka ndogjë të keqe me këtë?" Po, kush do të na thotë çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe? Kisha? Jo! Unë nuk do t'u përulesha diktateve të saj. Kur isha i ri, nuk do ta kisha njohur kurrë autoritetin e kishës dhe të pastorëve të saj në jetën time. Dhe tani jam vetë një prej tyre! Kush e ka të drejtën të thotë se ç'është e mirë dhe ç'është e keqe? Teze Zhani? Ndërgjegjja ime? "Unë ndjek udhëzimet e atij zërit të ulët brenda meje!" thonë disa. Kështu, kush e ka të drejtën të vendosë ç'është e mirë dhe ç'është e keqe?

Tani kemi ardhur në një pikë shumë kritike. Në qoftë se

ka vërtet një Perëndi të gjallë, që është Sundimtari i kësaj bote, atëherë i takon atij të vendosë se çfarë është mirë e çfarë është keq. Nëse *nuk* ka Perëndi, mund të bëni atë që ju duket e drejtë juve. Dhe në qoftë kështu, nuk shoh pse duhet të silleni hijshëm as për hir të teze Zhanit. Kushdo, kur ndeshet me këtë problem, duhet të pyesë veten, "Ka apo nuk ka Perëndi?" Njoh njerëz që jetojnë në një çrregullim të tmerrshëm moral, por që thonë, "Unë besoj te Perëndia." Gjepura!

Në qoftë se ka Perëndi, atëherë ai gjithashtu ka mendimin e tij në lidhje me seksin. Ju duhet të vendosni. Ju mund ta nxirrni Perëndinë jashtë jetës suaj. Por atëherë ju do të vdisni sipas zgjedhjes suaj. Mos u përpiqni ta imagjinoni veten tuaj duke thënë, "Dua të jetoj pa Perëndinë", deri në moshën 45 vjeç, dhe pastaj papritur të vendosni të bëheni besimtarë të devotshëm kur po iu ngjitet pleqëria. S'do të keni rezultat! ***Kërkoni Zotin ndërsa mund të gjendet***, thotë Bibla, dhe jo "...kur ta shikoni ju të përshtatshme." Kështu unë përsërit: në qoftë se *nuk* ka Perëndi, bëni si të doni. Por në qoftë se ai vërtet ekziston, atëherë është ai që e ka të drejtën t'ju tregojë se ç'është e mirë dhe ç'është e keqe. A s'është logjike kjo?

Dhe unë ju them se Perëndia ekziston vërtet, se ai është vërtet i gjallë! Në qoftë se më pyesni se si mund ta them këtë me kaq siguri, përgjigjja ime është, "Sepse ai e zbuloi veten e tij në Jezu Krishtin." Dua që ju të kuptoni këtë. Meqenëse Jezusi ka ardhur në botën tonë, gjithë indiferenca dhe skepticizmi për Perëndinë është vetëm për shkak të padijes ose të keqdashjes.

Perëndia ekziston vërtet! Dhe me qenë se ekziston, është ai që vendos se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Ju mund të vendosni ta lini Perëndinë jashtë jetës suaj. Ju mund të thoni, "Ne kemi parime të tjera morale!" Por le t'ju siguroj

se një ditë do t'ju duhet të qëndroni para Perëndisë dhe të jepni llogari për jetën tuaj.

Në fakt, është një ngushëllim i madh të zbulosh se Perëndia është ai që vendos se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Dhe në Fjalën e tij - në Bibël - ai e thotë këtë fare qartë. Një burrë një herë më pyeti, "Por edhe për këto gjëra flet Bibla?" Ai ishte habitur. "Po, flet," u përgjigja. "Perëndia jep udhëzime shumë të sakta përsa i përket asaj se ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar në seks."

Më keni ndjekur? Tani duhet të pyesim, "Po çfarë ka për të thënë Perëndia për seksin?"

Do të përpiqem të përmbledh mësimin e Biblës mbi këtë çështje.

3. Çfarë thotë Perëndia

a) Perëndia e aprovon seksin

Në një nga poemat e tij, Tuçolski shkruan diçka të tillë: "Nga mesi deri te koka jam i krishterë; nga mesi deri te këmbët jam pagan." Sa absurde! Bibla thotë: ***Perëndia krijoi njeriun... Ai krijoi mashkullin e femrën***. Ai na krijoi ne me gjithë karakteristikat tona seksuale. Kështu që mund të flas hapur për të. Nuk është tabu. Perëndia më krijoi mua si burrë, dhe ju gjithashtu, gjithë lexuesit meshkuj. Kështu le të jemi burra - dhe jo thjesht kukulla! Dhe ju zonja, ai ju bëri gra. Bëhuni gra atëherë! Përpjekjet e dëshpëruara të disa grave për t'u bërë si burrat - apo të burrave të caktuar për t'u bërë si gra - janë pa dyshim simptoma të një sëmundjeje. E kuptoni? Ju mund të jeni burra të vërtetë dhe gra të vërteta! ***Perëndia krijoi njeriun... Ai krijoi mashkullin e femrën***. Ai nuk krijoi një seks të tretë! Perëndia e aprovon seksualitetin tonë, kështu që ne nuk është nevoja ta ndrydhim atë. Ne mund ta gjurmojmë që nga Krijimi tensionin që rezulton nga qënia

ime burrë apo grua.

Por ne jetojmë në një krijim të rënë. Bota nuk është më siç ishte kur doli nga duart e Perëndisë. Jeta jonë seksuale, kaq e rëndësishme e megjithatë kaq delikate, është e kërcënuar në mënyrë të veçantë. Kështu, Perëndia ndërmori hapa për ta mbrojtur atë.

b) Perëndia e mbron jetën tonë seksuale me anë të martesës

Perëndia e aprovon seksin dhe e mbron atë me anë të martesës. Martesa nuk është thjesht një kontratë sociale, por një institucion i Perëndisë.

Një psikiatër amerikan i cili ka shkruar një libër të rëndësishëm mbi këtë temë konfirmon këtë gjë: "Asgjë nuk është shkruar ndonjëherë mbi këtë temë, e cila mund të barazohet në thellësi me atë që lexojmë në Bibël, ***Perëndia krijoi njeriun... Ai krijoi mashkullin e femrën***." Dhe ai vazhdon: "Unë nuk jam i krishterë. Por si psikiatër, them se martesa është tamam ajo për të cilën kemi nevojë." Me kusht, sigurisht, që të ketë besnikëri në martesë. Dhe jo shtatë, tetë, nëntë apo dhjetë martesa, si në rastin e shumë yjeve të Holivudit! Fakti që ky tip martese mbahet si ideal është një nga shenjat e çmendurisë së brezit tonë. Ajo zbulon konfuzionin tonë të thellë. Perëndia e vendosi martesën, por atë lloj martese që karakterizohet nga dashuria dhe besnikëria.

Kështu, si mendohet të jetë martesa? Zonja, për të qenë një grua e mirë, nuk mjafton të përgatisësh gjellë të shijshme për burrin tënd ose t'i qepësh kopsat. Burra, kur i keni dhënë gruas paratë për mbajtjen e shtëpisë, mos pandehni se e keni bërë detyrën tuaj. Sipas planit të Perëndisë, martesa mendohet t'ju çlirojë të dyve nga vetmia. A e kanë, ata prej jush që janë martuar këtë tip jete martesore? Nëse jo, ndoshta

duhet ta bisedoni këtë çështje së bashku dhe të pyesni njëri-tjetrin, "Ç'ka ndodhur me ne? Martesa jonë mendohej të na shpëtonte nga vetmia!" Në fillim, Perëndia tha, ***Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm. Unë do t'i bëj një ndihmë që i leverdis***. Përpiquni ta kuptoni këtë. Ai donte t'ju nxirrte ju nga izolimi.

Le t'ju tregoj një anekdotë të shkurtër e cila flet sa për vëllime të tëra librash. Kur isha fare i vogël, unë dhe motra ime një ditë u lejuam të shkonim në një dasmë familjare në Shtutgart. Ishte hera e parë që shkoja në një dasmë dhe çdo gjë ishte shumë shumë interesante. Shkuam në kishë në një karrocë, pastaj pati një banket në hotel. Pika e fundit e menysë ishte "bombe glacée". Unë dhe motra ishim ulur në fund të tavolinës dhe nuk na pritej që të shikonim se kur do të vinte "bombe glacée". Por asaj iu desh shumë kohë për të ardhur, sepse xhaxhallarët, njëri pas tjetrit, çoheshin për të mbajtur nga një fjalim. Ne u mërzitëm tmerrësisht. Por një nga fjalimet ka mbetur i skalitur në kujtesën time. Një nga xhaxhallarët, duke u përpjekur të tregohej me mend, bërtiti, "Zonja dhe zotërinj! Thuhet se në parajsë ka dy karrige; ato janë caktuar për çiftin që kurrë nuk është penduar qoftë dhe për një sekondë që u martuan." Pastaj ai vazhdoi, "Por deri më sot, karriget nuk kanë patur pretendentë." Pikërisht në atë çast, ai u ndërpre. Mbi kokat e të gjithë miqve, im at i bërtiti nënës sime, e cila ndodhej në anën tjetër të tavolinës, "Mami, ato karrige po na presin ne!" Unë isha vetëm një vogëlush dhe nuk e kuptova domethënien e thellë të atyre fjalëve. Por zemra m'u mbush me gëzim të madh, sepse e ndjeva ngrohtësinë e mrekullueshme të një shtëpie si jona. A është edhe shtëpia juaj e tillë?

Në pritjen e dasmës sime, një nga kolegët e mi, një njeri më i moshuar, bëri disa vërejtje shumë prekëse për këtë pjesë të Zanafillës, ***...Do t'i bëj një ndihmë që i leverdis***. Ja se

ç'tha ai: "Jo një tirane që të sundojë mbi të. Jo një skllave që të shtrihet në këmbët e tij. As një send që ai mund ta hedhë mënjanë. Por një ndihmëse që të harxhojë pa kursim dashurinë për të."

Ditën e përvjetorit të tyre të argjendtë të martesës, mua më bëri përshtyje të thellë kur pashë mënyrën se si e pa im at nënën time dhe kur dëgjova që i tha, "Më je bërë çdo ditë e më e çmuar gjatë këtyre 25 vjetëve!" Nuk mund të mos mendoja për gjithë ato çifte, që, në 25 vjet martesë, e kanë parë dashurinë e tyre të venitet pak nga pak. Është tmerruese! Shumë të martuar duhet t'i thoshin njëri-tjetrit, "Dëgjo, le t'ia fillojmë sërish." Më besoni, është e mundur!

Ka edhe një çështje tjetër që dua ta prek. Shumë të rinj më thonë, "Nuk po e shqyrtoj problemin e martesës për momentin. Ç'mendon ti për këtë? A mund të bëjmë çfarë të duam?" Unë them këtë:

c) Perëndia kërkon që rinia të jetë e pastër

E di që në brezin dhe kohën tonë kjo konsiderohet krejtësisht qesharake. Por, mendoni se Perëndia ndjek modën? Është Fjala e Perëndisë që e thotë këtë, jo unë. Le të nxjerr argumentet e mia. Në Bibël është historia e një të riu që quhet Isak. Një ditë i ati ngarkoi një shërbëtor që t'i gjente një grua. I riu doli në arat për t'u lutur, sepse ai ishte i bindur se ishte Perëndia ai që mund të zgjidhte një grua për të. Dhe megjithëse nuk e kishte njohur akoma atë, ai tashmë ishte besnik ndaj saj. Ju të rinj, që ende nuk po mendoni për t'u martuar, mund të jeni të sigurt se kur të vijë koha, Perëndia do t'ju japë gruan e re që ju duhet. Dhe ajo meriton besnikërinë tuaj tani. E njëjta gjë vlen edhe për vajzat. Ju të reja duhet t'i qëndroni besnike atij për të cilin akoma nuk dini asgjë. Bibla është e qartë në këtë pikë: Perëndia kërkon që

rinia të jetë e pastër.

Një psikiatër njëherë më tha, "Jam i sigurt se thellë në zemrën e saj një vajzë e re mund të dashurojë vetëm një herë. Ajo ia fal dashurinë vetëm një burri. Në qoftë se ajo ka patur një gjysmë duzine dashnorësh, ajo është - nëse do të më falni për shprehjen tepër të vrazhdë - "e mbaruar" për martesë. Ajo mund të martohet me burrin e shtatë, por ajo gjithmonë do të mendojë për dashurinë e saj të parë." Iu përgjigja, "Mirë! Kjo që thua ti është jashtëzakonisht interesante. Duke përdorur psikiatrinë vijmë në të njëjtin konkluzion me Fjalën e Perëndisë."

Duhet ta bëj aq të qartë sa të jetë e mundur: seksi paramartesor, lezbizmi, homoseksualizmi, tradhtia bashkëshortore, dhe divorci janë të gjitha mëkate për të cilat një ditë do t'ju duhet të jepni llogari para Perëndisë!

Mund ta mbyllja këtu. Mund të kujtoj se në ditët e rinisë sime më ka ndihmuar shumë të dija se cili ishte vullneti Perëndisë dhe gjithashtu të kuptoja se Perëndia është i vetmi që ka një fjalë për të thënë mbi këto çështje. Por do të ishte mizore për mua që ta mbyllja në këtë pikë dhe të mos trajtoja një pyetje tjetër që është me rëndësi tepër të madhe.

4. Si mund t'i shpëtojmë hidhërimit?

Në Bibël ka një histori që është e mrekullueshme dhe megjithatë shqetësuese në të njëjtën kohë. Një ditë Jezusi, Biri i Perëndisë të gjallë, ishte rrethuar nga një turmë njerëzish. Papritur pati një zhurmë të madhe. Njerëzit u hoqën mënjanë për t'u hapur rrugën një grupi priftërinjsh dhe spektatorësh që po afroheshin. Ata po tërhiqnin një grua të re e të bukur me vete. Unë nuk e kam të vështirë ta imagjinoj atë atje para meje me rrobat gjysmë të grisura. Ata e sollën atë para Jezusit dhe bërtitën, "Zoti Jezus! E kapëm këtë grua

duke shkelur kurorën. Ligji i Perëndisë thotë se ky mëkat dënohet me vdekje. Ti gjithmonë je shumë i mëshirshëm, Zoti Jezus, por sigurisht ti nuk do të shkosh kundër vullnetit të Perëndisë! Ne do dëshironim të të dëgjonim të thoshje se kjo grua duhet të vritet me gurë që këtë çast." Jezusi e vështroi gruan e re dhe pastaj u përgjigj, "Po, Perëndia vërtet e merr shumë seriozisht këtë çështje. Sipas Ligjit të Perëndisë, ajo duhet të dënohet me vdekje." Shumë fytyra ndritën. Disa njerëz morën gurë, sepse shkelësit e kurorës vriteshin me gurë. Por Jezusi vazhdoi, "Një moment! Lini atë midis jush që nuk është fajtor për asnjë mëkat - qoftë në mendim, fjalë apo vepër - lini atë ta hedhë gurin e parë!" Pastaj u përkul dhe nisi të shkruante në rërë. Sa do të doja ta dija se çfarë shkroi, por Bibla nuk e thotë. Pas një kohe të gjatë Jezusi drejtoi trupin. Të gjithë kishin ikur! Vetëm gruaja kishte mbetur. Në Bibël thuhet: ***Atëherë ata, e dëgjuan këtë dhe të bindur nga ndërgjegjja, u larguan një nga një.***

Mund t'ju bëj një pyetje? "A do ta kishit patur ju të drejtën për t'ia hedhur gurin e parë asaj gruaje? Jeni ju të paqortueshëm? A jeni ju përsosmërisht të pastër në mendim, në fjalë dhe në vepër? Mund ta kishit hedhur ju gurin e parë?" A përgjigjet ndonjëri? Askush? As edhe një person? Në këtë rast ne nuk jemi asgjë por një tërësi mëkatarësh. Po, jemi pikërisht kështu!

Në atë rast, njerëzit bënë një gabim serioz. ***Të bindur nga ndërgjegjja, u larguan një nga një.*** Ata duhet të kishin bërë pikërisht të kundërtën dhe t'i thoshin Jezusit, "Shiko, ne do të zëmë vend pranë kësaj gruaje. Ti nuk e dënove atë. Ji i mëshirshëm edhe për ne!" Unë nuk njoh asnjë tjetër përveç Jezusit që të jetë në gjendje të na shpëtojë nga hidhërimi si rezultat i marrdhënieve seksuale. Arsyeja që mund ta them

këtë është se unë vetë jam ndihmuar prej tij. Kur flas për Jezusin unë nuk nxjerr teori të këndshme. Ai ndërhyri në jetën time dhe vazhdon akoma, madje edhe në këtë moment. Një pastor është një njeri si njerëzit e tjerë. Ai ka nevojë për Shpëtimtarin po aq sa dhe ju. E kam provuar fuqinë e shpëtimit të tij në dy mënyra të ndryshme:

a) Jezusi na fal mëkatet

Asnjë pastor, asnjë prift, madje as engjëjt nuk mund ta bëjnë këtë. Mendimi i parë i papastër juaji dhe të gjitha rëniet që pasuan janë mëkate të pariparueshme. Ato do të shkojnë me ju në përjetësi drejt e në fronin e gjykimit të Perëndisë, po të mos e keni gjetur Jezusin që më parë, t'i keni rrëfyer atij të gjitha të metat tuaja, dhe të jeni falur prej tij. Jezusi është i vetmi që mund të dhurojë faljen.

Kështu afrojuni në mendim kryqit të Jezusit dhe thoni, "Vij të të parashtroj gjithë mëkatet e rinisë sime. T'i rrëfej ty të gjitha marrëdhëniet dashurore të diskutueshme. Nuk dua të të fsheh gjë ty." Pastaj ngrini sytë drejt kryqit dhe thoni fjalët e këtij himni:

Unë besoj, unë besoj
Se Jezusi vdiq për mua;
Dhe nga gjaku i tij,
Gjaku i tij i çmuar,
Prej mëkatit do jem çliruar.

Bibla thotë: Gjaku i Jezusit, Birit të Perëndisë, na pastron nga çdo mëkat." Ç'fjalë çliruese!

Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare më thirrën për shërbimin ushtarak. Mund t'ju them me siguri se në kazerma shokët e mi bënë ç'ishte e mundur për të ma fëlliqur mendjen. Por pastaj një ditë, m'u hapën sytë dhe duke menduar për gjithë këto ndyrësi, thirra, "Kush mund të më çlirojë nga ky

lëmsh që kam bërë me jetën time?" Pastaj e kuptova se Jezusi ishte në gjendje ta fshinte të kaluarën time dhe të m'i falte mëkatet. Iu ktheva atij. Dhe tani nuk do të ndahesha nga ai për asgjë në botë.

Një ditë, në një takim të madh në Dyseldorf thashë se, me faljen e mëkateve Jezusi fshin të kaluarën tonë. Në fund të mitingut, kur të gjithë po iknin, pashë një burrë të gjatë me pamje që të bënte përshtypje duke çarë rrugën përmes turmës për t'u takuar me mua në pjesën e përparme të sallës. Kur më arriti pyeti me gjallëri, "Është realisht e vërtetë, siç thatë ju, se mund të marrim faljen e mëkateve?" "Po, lavdi Zotit! Falja e tij më jep zemër mua çdo ditë!" u përgjigja. Ai vazhdoi, "Unë jam psikiatër. Shumë njerëz këshillohen me mua për sëmundjet e tyre mendore. Ata kanë komplekse të të gjitha llojeve. Por ata nuk e dinë se nga se vuajnë. Shumicën e kohës ajo mund ta ketë prejardhjen nga gabimet e vjetra të cilët ata nuk mundin - ose nuk duan - t'i kujtojnë më. Ndonjëherë më duhet të kaloj orë të tëra me ta, duke u përpjekur t'i nxjerr gjithë ato shqetësime nga thellësia e nënvetëdijes së tyre. Por aty fuqia ime merr fund. Unë mund të nxjerr në dritë mëkatin e kryer - gënjeshtrën, grindjen, imoralitetin - por shpesh kam menduar me dëshpërim, 'Sikur të mund ta fshija secilën!' Dhe prandaj, pastor Bush, po të pyes nëse ka vërtet ndonjë që mund të na i heqë qafe mëkatet. Është e vërtetë, po, apo jo?" Plot gëzim, konfirmova edhe një herë faktin. "Po, lavdi Zotit!" Dhe e kuptova se ne kemi një mesazh të jashtëzakonshëm, që s'ta merr mendja, në Dhiatën e Re. Jezusi na i fal mëkatet!

b) Jezusi këput zinxhirët tanë

I thashë një ditë një sekretareje të re e tërheqëse, "Zonjushë, ti po shkon drejt ferrit! Kjo marrëdhënie dashurie

me shefin është gjë e tmerrshme. Mos i bëj fatkeqë këtë burrë dhe familjen e tij!" Me një pamje të dhimbshme në fytyrë, ajo u përgjigj, "Nuk ka asnjë mundësi! Unë e dashuroj këtë njeri!" "Të besoj," iu përgjigja, "por ai ka grua dhe fëmijë! Ti po shkakton dëm të madh." Munda ta dalloj që ajo ishte torturuar nga mendimi i kësaj lidhjeje, por ajo nuk mund ta bënte veten ta këpuste atë. Kështu unë u gëzova që isha në gjendje t'i thosha, "Ne nuk mund t'i këputim dot vetë vargonjtë e mëkatit, vërtet. Por Bibla thotë, ***Nëse Biri do t'ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë***. Kërkoni Jezusin. Vetëm ai mund t'ju çlirojë."

Këto fjalë të himnit mund t'ju ndihmojnë ta shkarkoni shpirtin tuaj para tij:

Prej trishtimit tim, natës, skllavërisë,
Jezus unë vij, Jezus unë vij;
Në dritën tënde, në kënaqësinë e lirisë,
Jezus, unë vij te ti:
Prej sëmundjes sime në shëndetin tënd,
Prej nevojës sime në bollëkun tënd,
Prej mëkatit tim e drejt e te ty,
Jezus unë vij te ti.

Si pastor në një qytet të madh, kam qenë dëshmitar i këputjes së shumë zinxhirëve.

Me qëllim që të çlirohemi nga skllavëria e seksit dhe t'i shpëtojmë vuajtjes së shkaktuar prej tij, të gjithë ne, të rinj e të vjetër njëlloj, kemi nevojë për Shpëtimtarin. *Ju* keni nevojë për një Shpëtimtar! Jezusi ofron një çlirim të mrekullueshëm, të vërtetë. Provojeni vetë! Ndryshe do të bëni një jetesë të mjerueshme për atë që ju ka mbetur nga jeta.

5. Bota është e etur për dashuri

Duhet të shtoj diçka tjetër. Shumë gra beqare më kanë thënë, "Jam mbi 40 vjeçe dhe asnjë burrë nuk më ka kërkuar që të martohem me të. Ç'duhet të bëj?" Unë jam pacifist i bindur dhe u bëra i tillë kur pashë brengën e këtyre grave beqare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pesë milionë burra të rinj vetëm në Gjermani humbën jetën në fushën e betejës. Kjo do të thotë që pesë milionë gra të reja në vendin tonë nuk e kanë parë shpresën e tyre më të mbajtur gjallë, atë për të bërë një burrë të lumtur, të përmbushur. Që do të thotë se pesë milionë gra të reja në vendin tonë janë të dënuara të mbeten beqare. A mos më duhet ndonjë arsye më e fortë për të qenë kundër luftës? Vetëm përpiquni të imagjinoni gjendjen e vështirë të këtyre pesë milionë grave gjermane. Burrat që ato donin t'i bënin të lumtur janë varrosur në varrezat tona ushtarake.

Do të doja t'u thoshja këtyre grave, "Për dashurinë e Perëndisë, mos u përpiqni të vidhni atë gjë nga e cila jeni privuar. Mos e prishni paqen e çifteve të martuar. Ky është një rrezik, një tundim, që është gjithnjë e më i shpeshtë mes njerëzve tanë." "Kështu ç'duhet të bëjmë?" pyesin ata. Dhe unë iu them, "Në qoftë se kjo është situata në të cilën ndodheni, atëherë pranojeni atë. Nuk është e thënë që njerëzit e pamartuar të mos jenë të lumtur."

Bibla tregon për një beqare të quajtur Tabitha. Ajo jetonte në Jopë, në qytetin e sotëm të Jafës. Në kohën kur ajo vdiq, apostulli Pjetër, rastisi të ishte në atë krahinë, kështu dërguan ta merrnin. Ai u çudit kur hyri në dhomën e saj. Ai, ka shumë mundësi që të ketë menduar, "Ndoshta do ta gjej këtë plakë të mirë të shtrirë në krevatin e saj pa asnjë njeri përreth." Por dhoma ishte mbushur me njerëz. Një vejushë e pranishme

tha, "Tabitha më ka bërë këtë fustan." Dhe një i verbër i tha, "Unë isha shumë i vetmuar dhe atëherë Tabitha vinte të më lexonte çdo të dielë pasdite, nga ora tre deri më katër. Kjo ishte ora më e lumtur e javës." Edhe të rinjtë atje kishin diçka për të thënë, "Kur ktheheshim në shtëpi nga shkolla, çelësi ishte nën rrogozin e derës. Askush nuk kujdesej për ne deri ditën kur Tabitha erdhi dhe u kujdes për ne." Pjetri e kishte kuptuar. "Tabitha kishte një jetë shumë më të pasur se disa gra të martuara. Disa, që u duhej të jetonin me një burrë të bezdisshëm, kanë përfunduar të mërzitura dhe të hidhëruara."

Në greqisht, gjuha e Dhiatës së Re, ka dy fjalë për "dashuri". Fjala "eros" i referohet dashurisë për të cilën folëm në fillim - dashurisë fizike. Nga këtu vjen fjala "erotikë". Por ka dhe një term tjetër që është përkthyer "dashuri". Është fjala "agape" që përshkruan dashurinë e Perëndisë, atë dashuri që unë mund t'ua jap të tjerëve.

Grave të pamartuara unë u them, pranojeni këtë situatë - dhe mbusheni jetën tuaj me "agape".

Bota është e etur për këtë lloj dashurie!

Për ta përmbledhur: është e drejta e veçantë e Perëndisë për të vendosur se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar; Perëndia kërkon pastërti morale nga të rinjtë dhe besnikëri në martesë; dhe në qoftë se rruga jonë nuk të çon në martesë, atëherë është një çështje e pranimit të situatës.

6. Një dashuri për të cilën nuk kemi asnjë të drejtë

Në mbyllje, do të doja t'ju tregoja diçka për Jezusin vetëm një herë të fundit. Tema që po trajtoj është: "E drejta jonë për dashurinë". Ka një dashuri për të cilën ne nuk kemi asnjë të drejtë, por e cila megjithkëtë, na ofrohet falas. Është dashuria e Zotit Jezus. Ne jemi mëkatarë. Dhe kemi nevojë për një Shpëtimtar.

Mund t'ju lë një dëshmi personale? Ishte koha e Rajhut të Tretë. Edhe një herë isha burgosur për shkak të besimit tim. Kapelani i burgut sapo më kishte bërë një vizitë dhe më kishte thënë, "Ke shumë pak shanse për të dalë që këtej këtë herë." Pastaj ishte larguar. Kisha mbetur vetëm në qelinë time. Ajo ishte shumë e ngushtë. Sipër lart, një frengji e ngushtë lejonte pak dritë. Ishte ftohtë dhe unë po ngrija. E gjithë atmosfera ishte e ftohtë akull. Kisha mall për gruan time, fëmijët e mi, shërbesën time, dhe të rinjtë e mi - sepse në atë kohë isha drejtues të rinjsh. Isha ulur atje, pa as më të voglën shpresë se do të më lironin më. Para se të binte nata, më kishte kapur një dëshpërim i thellë. Nuk e di nëse e keni provuar ndonjëherë një gjë të tillë. Por pikërisht atë moment - mund të dëshmoj për këtë - Zoti Jezus erdhi në qelinë time. *Ai është i gjallë!* Ai mund të kalojë nëpër dyert e kyçura. Dhe ai bëri pikërisht këtë. Ai më vuri para syve vdekjen e tij në kryq, vdekjen që ai vuajti për shkak të mëkateve të mia. Dhe më pëshpëriti, ***Unë jam Bariu i Mirë. Bariu i Mirë jep jetën e vet për delet***. Pikërisht atëherë mbi mua kaloi një valë e tillë dashurie, që unë mezi munda ta mbaj. Ishte tepër shumë për mua.

E kuptova që nuk e meritoja atë dashuri të veçantë, dhe as kisha ndonjë të drejtë mbi të. Ajo më ishte dhënë falas.

Dhe ju gjithashtu, mund ta arrini atë dashuri të Jezusit. Pse ta lini atë valë dashurie t'ju anashka-lojë, kur ajo kërkon të vërshojë në shpirtin tuaj?

A MUNDET TË FLITET ME PERËNDINE?

Një trupë akrobatësh arriti një ditë në një fshat në Svabi dhe kërkoi të jepte shfaqje atë mbrëmje. Pajisjet i kishin ngritur tashmë dhe një litar i gjatë ishte tendosur lart mbi arenë, kur një grua me fëmijën e saj kaluan aty pranë. Me theksin e tij tipik svabian fëmija pyeti, "Vërtet mund të ecin njerëzit mbi litar, mami?" "Sigurisht," u përgjigj ajo, "por duhet të dinë se si. Unë vetë nuk mund ta bëja këtë sepse nuk di se si!"

Mund të flasim ne me Perëndinë? Anekdota jonë e vogël më bën që të them:

1. Mundemi në qoftë se dimë se si!

Shumë njerëzve, ashtu si nëna e fëmijës, u duhet të pranojnë, "Nuk e di se si!"

A mund të flasim me Perëndinë? Sigurisht që mundim! Perëndia është shumë afër nesh kështu që mund të flasim me të. Ju mund të flisni me zotin Filan, kështu pse të mos jeni në gjendje të flisni me Perëndinë e gjallë? Ai është po kaq afër....

Por a dini se *si* të flisni me Perëndinë?

Kur isha i vogël kam mësuar këtë këngë:

Fëmijë të vegjël, dikush ju do ju,
Atje tutje, larg, përtej qiellit blu...

Dhe unë mendoja, "E ç'dobi ka lutja? Unë kurrë nuk do të bërtisja aq fort sa të më dëgjonte Perëndia atje tutje, lart në qiell!"

Rusët flasin gjithmonë me tallje për këtë gjë. "Ne kemi

dërguar sputnikët në hapësirë," thonë ata. "Në qoftë se ekzistonte Perëndia, do ta kishim parë." Shumë gra e burra janë në mëdyshje. "Ku është Perëndia?" pyesin ata. "Është ai atje tutje, lart, përtej qiellit blu? Sa lart? Një qind, një mijë kilometra larg?"

Dua ta sqaroj këtë pikë sa më shumë që të jetë e mundur: asgjëkund në Bibël nuk është përdorur ndonjëherë termi "Përtej qiellit blu". Bibla thotë diçka krejt të ndryshme. Ajo deklaron: ***Perëndia... nuk është larg nga secili prej nesh.*** Në një pjesë tjetër lexojmë: ***Ti më rrethon nga pas dhe përpara.*** Ne nuk mund ta kuptojmë këtë po të mos marrim parasysh faktin se shqisat tona mund të perceptojnë vetëm një botë tri-dimensionale. Sidoqoftë, Perëndia, është në një dimension tjetër - e megjithatë, në të njëjtën kohë, ai është shumë afër nesh.

Sigurisht që mund të flasim me Perëndinë! Si me ecjen mbi një tel të tendosur, po kështu dhe me lutjen: mund ta bëni atë po ta dini se si! Shumica e burrave dhe e grave sot duhet të pranojnë, "Unë nuk di si të lutem." Po ju? Pse të mos jeni të ndershëm me veten tuaj kësaj radhe? E vërteta e çështjes është se ju nuk keni as idenë më të vogël se si të luteni. Sepse po ta dinit, do të luteshit.

Kjo është një nga karakteristikat më alarmante të shekullit të njëzetë. Epoka jonë e ka humbur aftësinë për t'u lutur dhe si rezultat ka humbur aftësinë për të besuar. Autori i njohur gjerman, Franc Verfel, ka shkruar një roman të quajtur *Parajsa e Përdhosur.* Një fjali në librin e tij do të mbetet e skalitur në kujtesën time sa të jem gjallë: "Shenja e veçantë e kohëve moderne është topitja 'metafizike' e njeriut." Me fjalën "metafizike" ai do të thotë realitetet e përjetshme të cilat i përkasin një dimensioni tjetër. Njeriu është bërë aq i

shushatur nga radioja, TV, bisedat e kota, propaganda, ideologjitë e të gjitha llojeve, politika, fqinjët, dhe tensionet në punë, sa që nuk është më i dijshëm për afërsinë e Perëndisë ose për mundësinë e komunikimit me të.

A është e mundur të flasësh me Perëndinë? Do të ishte me të vërtetë e mundur në qoftë se mendjet e njerëzve gjatë shekullit të kaluar nuk do të ishin droguar me kaq shumë racionalizëm.

Një djalë gjashtëmbëdhjetë vjeçar më tregoi për një nga incidentet më të tmerrshme në të cilën ishte dëshmitar kur ishte ushtar gjatë luftës. Pas një sulmi ajror, ai ishte i pari që doli nga strehimi. Dhe kështu ishte ai që e gjeti një nga shokët e tij të shtrirë në tokë me barkun të çarë. Djaloshi donte ta ndihmonte, por i plagosuri i tha, "Nuk ia vlen të përpiqesh të më ndihmosh. A mund të lutesh me mua?" Djali iu përgjigj, "Në Rininë Hitleriane më mësuan të mallkoj dhe jo të lutem!" Ai vrapoi për të gjetur kapitenin duke thirrur, "Kapiten, eja shpejt!" Oficeri u ul në gjunjë pranë burrit, zorrët e të cilit po dilnin jashtë nga plaga e hapur, dhe e pyeti, "Ç'mund të bëj për ty, miku im?" "Unë po vdes kapiten. Të lutem lutu me mua!" "Ç'fatkeqësi," thirri kapiteni, "nëse ka gjë që nuk di si ta bëj, është të luturit!" Kapiteni vrapoi për të gjetur togerin.

Së fundi të gjithë ushtarët ishin rreshtuar, sipas rangut, rreth njeriut që po vdiste. Ja ku ishin këta ushtarë të paepur, kaq të sigurt në veten e tyre, ekspertë për të treguar barceleta dhe për të thënë fjalë të ndyra. Megjithatë, asnjë prej tyre nuk dinte si të lutej. Asnjë prej tyre madje nuk mund të thoshte as Lutjen e Zotit.

Djaloshi i ri shtoi, "Ndërsa rrija atje, u betova se gjëja e

parë që do të bëja në qoftë se do të dilja gjallë nga kjo luftë e qelbur, do të ishte të shkoja diku ku të mësoja për t'u lutur. Nuk doja të vdisja në mënyrë të mjeruar si ai i shkreti!"

Në këtë pikë kemi arritur ne sot.

Gjendja shoqërore nuk përbën asnjë ndryshim - menaxheri mendon se është tepër inteligjent për t'u lutur, dhe punëtori dominohet nga mendimi i lirë. Ne nuk jemi më në gjendje të lutemi. Ajo që Franc Verfel e quan "topitje metafizike e njeriut" është një fatkeqësi e madhe. Nuk është për t'u habitur që ne dalim jashtë luftimi kur na qëllojnë fare lehtë.

Në disa raste, kur bombardohej Eseni, më ndodhi që të isha në të njëjtin strehim kundërajror si disa njerëz gojëmëdhenj që shfrynin egërsisht për "fitoren përfundimtare", "Fyhrerin tonë të mrekullueshëm", dhe "madhështinë e Rajhut të Tretë". Por kur fillonin të binin bombat, pikërisht këta njerëz ulërinin me tmerr. Ne të krishterët luteshim me ta dhe këndonim këngë për t'i ndihmuar ata t'i qëndronin tensionit, sepse ata vetë nuk mund të luteshin. Ata nuk dinin se si! Është gjë e tmerrshme të mos dish se si të lutesh.

Një ditë tjetër isha ulur me një njeri inteligjent dhe me kulturë i cili deklaroi me një buzëqeshje, "Pastor Bush, lutja nuk të ndihmon me të vërtetë!" "Mos thuaj gjepura të tilla!" i thashë me ashpërsi. I shushatur, ai u përgjigj, "Ç'të hipi kështu?" Iu përgjigja, "Ti më kujton dikë që i kanë prerë këmbën dhe thotë, 'Nuk ka kuptim të bësh ski!" Si ai edhe ti s'di se ç'flet!"

Unë jam i gatshëm të diskutoj avantazhet e sportit të skive me këdo, por jo me një që ka këmbën të prerë. E megjithatë, ne bëjmë pikërisht këtë gjë kur vjen puna te lutja. Ne s'dimë asgjë për të, por kjo nuk na pengon të themi, "Nuk ka asnjë

dobi të lutesh." Sa më në gjendje të vajtueshme të jemi, aq më të bukur mundohemi të dukemi!

Kur shoh gjendjen e mjerueshme në të cilën ka rënë kombi ynë i shkretë, jo vetëm mbushem me zemërim por edhe me hidhërim të thellë. Gjithashtu, më shqetëson fakti se kisha duket se e pranon si të vërtetë se ende të gjithë dinë si të luten. Ndoshta është njëlloj edhe në kishën tuaj: për Krishtlindje, shihni aty njerëz që normalisht kurrë nuk e shkelin pragun e derës së kishës. Kishat tona mbushen plot për Krishtlindje! Dhe kur pastori thotë, "Le të lutemi", - dhe kjo më shqetëson - atëherë të gjithë ulin kokat dhe bashkojnë duart. Mua më vjen të thërras, "Mjaft u shtirët! Më pak se një person në dhjetë veta këtu di të lutet me të vërtetë. Ju vetëm po luani rolin!" Kam të drejtë apo e kam gabim?

E njëjta gjë ndodh në martesat dhe funeralet. Pastori thotë, "Le të lutemi", dhe njerëzit rrinë atje, me kapelat cilindër në dorë, duke menduar se të shikosh kapelën është njëlloj si të lutesh. Por sapo mbaron shërbesa, ikin ata në klubin aty afër për të pirë diçka!

Kur shërbeja në forcat e armatosura më 1914, na ishte dhënë urdhër të shkonim në kishë. Por para se të shkonim adjutanti na jepte udhëzimet e mëposhtme: "Do të shkoni te stolat tuaj pa bërë zhurmë. Kur të shkoni atje, do të qëndroni më këmbë me kapelat në duar, dhe me ngadalë të numëroni deri në dymbëdhjetë. Pastaj mund të uleni." Njerëzit që na shikonin, duhet të kenë menduar se sa me zjarr luteshim ne! Në fakt ne vetëm numëronim ngadalë deri në dymbëdhjetë para se të uleshim! Kam përshtypjen në martesat dhe funeralet, se njerëzit as nuk numërojnë deri në dymbëdhjetë kur pastori thotë, "Le të lutemi"! Më dhemb zemra kur kujtoj

se njerëzit dikur luteshin dhe nuk shtireshin, kur dëgjonin fjalët: "Le të lutemi!"

Eksploratori me famë botërore i Afrikës Qendrore, David Livingston - një nga njerëzit më të mëdhenj në histori, i shquar për kurajën, intelektin dhe të mësuarin e tij - vdiq kështu: I shoqëruar vetëm nga hamejtë e tij vendas, Livingstoni kishte depërtuar thellë në zemër të Afrikës. Një mëngjes djemtë kishin mbaruar së paketuari materialet dhe kishin hequr çadrat. Vetëm çadra e Livingstonit kishte mbetur e ngritur. Miqtë e tij besnikë e dinin se çdo mëngjes Livingstoni lutej, se ai fliste me "Tuan" e tij qiellor - Perëndinë e tij. Megjithatë, atë mëngjes koha e tij e lutjes, zgjati më shumë se zakonisht. Më në fund kryehamalli mori guximin të shikonte vjedhurazi nëpër një të çarë të çadrës. Dhe çfarë pa ai? Zotërinë e tij - ende në gjunjë. Ata pritën deri në mesditë para se të guxonin të hynin në çadër. Livingstoni ishte akoma në gjunjë. Por zemra e tij kishte pushuar së rrahuri.

Ky njeri i madh dhe i zgjuar vdiq më gjunjë duke u lutur. Por borgjezi i rangut të fundit, në vend që të pranojë me përulësi se nuk di më se si të lutet, guxon të shpallë se s'ka kuptim të lutesh. Livingstoni dinte si të lutej. Dhe ai vdiq duke u lutur. Por ne vdesim në spital, të ndihmuar nga injeksionet nën lëkurë. Ne nuk do të mund ta përballonim vdekjen në qoftë se mjekët nuk do të na jepnin ilaçe. Livingstoni nuk pati nevojë për to. Ai ishte mësuar të fliste me Perëndinë. Dhe ndodhi që ai ishte duke folur me Perëndinë kur hyri në përjetësi.

Po për lutjen familjare? Në shtëpinë tonë - ne ishim tetë fëmijë - ja se si i bënim gjërat: Në mëngjes tërë familja mblidhej së bashku para ngrënies së mëngjesit. Pasi

këndonim një himn, lexonim një pjesë nga Bibla, pastaj im at do ta mbyllte me lutje. Edhe kur unë e kisha humbur gjithë interesin për Perëndinë, mendimi se atje në shtëpi, familja lutej për mua, nuk m'u largua asnjëherë. Dhe kur unë, si oficer i ri hodha poshtë gjithçka dhe mora të tatëpjetën, lutjet e prindërve të mi më mbajtën.

A keni adhurim familjar në shtëpinë tuaj? Etër, një ditë Perëndia do t'ju çojë për të dhënë llogari dhe do t'ju bëjë ju përgjegjës për humbjen e gruas dhe të fëmijëve në qoftë se nuk e keni qeverisur si duhet shtëpinë tuaj. Si e filloni ditën në shtëpinë tuaj? Me një himn, leximin e Biblës dhe lutje?

Një njeri i shquar nga Eseni më kërkoi një ditë t'i bëja një vizitë në shtëpi. Atje, i ulur pranë gruas së tij, ai tha, "Një gjë e çuditshme na ndodhi një ditë. Djali ynë gjashtëmbëdhjetë vjeçar erdhi në shtëpi një mbrëmje nga takimi juaj i të rinjve dhe na pyeti, 'Pse nuk lutemi asnjëherë në shtëpinë tonë?' 'Gjithë kjo,' i shpjegova, 'është thjesht formalitet. S'ka asgjë prapa kësaj.' Ai vazhdoi të më pyeste: 'Ç'mendon ti babi për Frymën e Shenjtë?' 'E pra, hiç asgjë!' 'Ky,' theksoi djali ynë, 'është shqetësimi në familjen tonë. Ne na duhet një baba që të dijë të kërkojë Frymën e Shenjtë.'"

Kjo ishte historia që më tregoi ai njeri. Pastaj e pyeta, "A dëshiron që t'i jap tët biri një qortim të mirë që është sjellë në mënyrë të pahijshme me ty?" "Jo," u përgjigj. "Në qoftë se im bir ka të drejtë, atëherë unë jam në gjendje shumë të keqe." Unë vetëm iu përgjigja, "Po, je në një situatë serioze. Yt bir ka të drejtë." "Nga kjo kisha frikë," pranoi ai. "Ç'duhet të bëj?"

Ky burrë papritur kishte kuptuar se nuk kishte arritur të përmbushte detyrën më themelore të një babai. Nuk mjafton

vetëm t'i veshësh dhe t'i ushqesh fëmijët e tu. Etër, përgjegjësia juaj shkon më tej! A dini si të luteni?

Ka një legjendë që është e mirënjohur për detarët. Historia thotë se një anije fantazmë viziton shpesh të shtatë detet. Megjithëse ajo nuk ka as ekipazh as kapiten, asnjë stuhi, deri tani, nuk ka qenë në gjendje ta fundosë. Mendoni sikur një anije tjetër e shikon atë që shfaqet papritur në horizont. Ç'do të bëjë kapiteni? Do të përpiqet të lidhet me të me radio, sigurisht. Por ai kurrë nuk do të marrë përgjigje.

Ne jemi si ajo anije fantazmë. Perëndia përpiqet të hyjë në lidhje me ne. Ai përdor të gjitha llojet e rasteve dhe të përvojave për të arritur te ne - veçanërisht Fjalën e tij, Biblën. Por ne nuk e dimë se si të marrim kontakt me të. Anije fantazmë! Ja se ç'jemi ne!

Një ditë kur po flisja për këtë temë, një fëmijë e pyeti të ëmën, "Mami, pse po na qorton ashtu ai burri?" Shpresoj se e kuptoni që qëllimi im nuk është të qortoj ndonjë. Është vetëm se zemra ime digjet nga dhembja për kombin tonë të shkretë kur shoh se ç'ka mbetur prej tij - intelektualët dhe punëtorët, burrat dhe gratë, të rinjtë dhe pleqtë. Ne jemi njerëz që nuk e dimë më se si ta thërrasim Perëndinë. Megjithatë Perëndia është kaq afër - vetëm një frymë larg!

Shumë burra e gra e quajnë veten të krishterë dhe pretendojnë të kenë lidhje me kishën, por nuk dinë asgjë për lutjen. Kam takuar shpesh njerëz në vizitat e mia pastorale që kanë thënë, "Ne jemi të krishterë të mirë pastor Bush. Nëna ime e njihte shumë mirë pastor Smithin. Ti e ke njohur? Jo? Nëna ime e njihte shumë mirë." Përgjigjja ime do të ishte: "Në qoftë se nuk e njihni personalisht Jezusin, do të shkoni drejt e në ferr bashkë me pastor Smithin. Çështja e rëndësishme është nëse dini apo jo si të thërrisni emrin e

Zotit, nëse dini apo jo se si të luteni."

Unë ju lus t'i bëni vetes këtë pyetje: "A di unë se si të lutem? A lutem unë?"

Ndoshta ju jeni gati për të thënë, "Mjaft tani, pastor Bush. Na trego se si të mësojmë të lutemi." Tani po vij te kjo pikë.

2. Si mund të mësojmë të lutemi?

a) Qarja e një fëmije të porsalindur

Si mësojmë ne të flasim? A i mbani mend bëlbëzimet e para fëminore? Jo? As unë! Por në qoftë se doni të mësoni të luteni, më parë duhet të shqiptoni qarjen e një fëmije të porsalindur. Le t'jua shpjegoj.

Në një rast Zoti Jezus tregoi historinë e mëposhtme: Dy njerëz shkuan në kishë në të njëjtën kohë. Njëri prej tyre ishte një njeri i shquar e me influencë. Ai shkoi drejt e në ballë të kishës dhe filloi të lutej kështu: "Zot, të falënderoj që jam njeri i mirë...". Perëndia nuk dëgjoi më! Megjithëse njeriu vazhdoi të fliste sa t'i kënaqej zemra, fjalimi i tij ra në veshë të shurdhër. *Perëndia nuk po e dëgjonte.*

Tjetri nuk ishte njeri shumë i nderuar. Pak a shumë një mashtrues - një shitës në tregun e zi, një kontrabandist, apo diçka i përafërt me këto gjëra - ai ishte në skaj të shoqërisë. (Bibla e quan atë "tagrambledhës"; me fjalë të tjera ai që mbledh taksat.) Duke qenë i impresionuar nga solemniteti i vendit kur hyri, të gjorin e zuri frika. Duke qëndruar afër hyrjes, ai mendonte, "Ky nuk është vend për mua. Atmosfera e gjallë në lokal më përshtatet më mirë. Në klub ndihem si në shtëpinë time, por këtu jo!" Ai sa po bëhej gati t'ua mbathte këmbëve kur papritur u kujtua se pse kishte ardhur në këtë

vend. E kishte marrë malli shumë për Perëndinë. (A nuk jemi të gjithë në të njëjtën gjendje? Me mall për t'u kthyer në shtëpi, me mall për t'u kthyer tek Ati?) Jo, ai nuk mund të kthehej! Dhe as nuk mund të bënte përpara. Ndërsa kujtimet e mënyrës së jetesës që kishte bërë po e mbysnin, ai vetëm mund të shtrëngonte duart dhe të murmuriste këtë lutje të shkurtër: ***O Perëndi, ji i mëshirshëm ndaj mua mëkatarit.*** Bibla thotë se pikërisht atë çast ushtritë e qiellit filluan të këndojnë nga gëzimi. Një njeri kishte gjetur jetën!

"Unë kam mëkatuar." Ky është të qarët e fëmijës së porsalindur.

Kam qenë i pranishëm në lindjen e djalit tim të madh. Ishte një lindje shumë e vështirë dhe nuk mund të mos mendoja për fjalët e Jezusit: ***Gruaja, kur lind, ka dhembje, sepse i erdhi ora***. Ndonjëherë dukej se gruaja që doja dhe kokën e së cilës po mbaja ishte krejtësisht e këputur. Pastaj, papritur, dëgjova një qarje të dobët. Fëmija ishte aty! Një jetë e re! Vajtimi i tij nuk ishte aspak një melodi e harmonishme. Por kur e dëgjova, nuk durova dot dhe qava. Më kuptoni apo jo? Isha rrëmbyer nga ajo e qarë - e qara e parë e një jete të re.

Të qarët e parë e një personi që është lindur sërish - me fjalë të tjera, e burrit apo e gruas që më në fund ka ardhur në dritën e së vërtetës - është kjo: "Unë kam mëkatuar. O Perëndi! ki mëshirë për mua mëkatarin." Të gjitha litanitë[1] tuaja do të jenë të pavlefshme në qoftë se nuk e filloni me të qarën e një fëmije të porsalindur. Unë akoma nuk kam parë një fëmijë që të ketë filluar me një fjalim të gjatë.
Për të filluar është gjithmonë të qarët e një fëmije të porsalindur. Është pikërisht njëlloj për personin që hyn në

[1] Litani: lutje e shkruar në një libër lutjesh.

Mbretërinë e Perëndisë.

E keni shqiptuar të qarën e një fëmije të porsalindur? Jo? Atëherë shkoni në ndonjë vend të qetë dhe mendoni seriozisht për këto gjëra. Nuk kam dalë për t'i bërë reklamë kishës. Kam dalë për të ndaluar disa prej jush që po shkojnë në ferr. Ju nuk do të ndaloheni po të mos keni shqiptuar të qarën e një fëmije të porsalindur: "Unë kam mëkatuar. O Perëndi! ki mëshirë për mua mëkatarin."

Kur djali plangprishës në Bibël u kthye në shtëpi, gjëja e parë që i tha të atit kur e pa ishte,
O at, mëkatova kundër qiellit dhe para teje. Sapo edhe ju t'i keni shqiptuar këto fjalë dhe Jezusi, Biri i Perëndisë, do të vijë te ju dhe do t'ju thotë, "Miku im, unë vdiqa për mëkatet e tua. E pagova unë borxhin tënd."

b) Vetëm një fëmijë i Perëndisë mund të lutet

Një ditë takova një mik që ka tre fëmijë të këndshëm, një djalë dhe dy vajza të vogla. Ndërsa po ecnin drejt meje, pashë se si fëmijët e bombarduan atin e tyre me pyetje dhe vërejtje, deri në atë pikë sa që i shkreti e pati të vështirë të përgjigjej. Kur shkova tek ata, thashë, "Tungjatjeta zoti Filan! Tungjatjeta vogëlushë!" Sapo ma dëgjuan zërin, si me magji fëmijët pushuan së llomotituri. Unë isha i panjohur dhe kjo kishte qenë e mjaftueshme për t'i bërë ata të heshtnin. Fëmija zakonisht ndihet i lirë për të folur vetëm në praninë e të atit dhe së ëmës. Ai bëhet me turp sapo shfaqet një i panjohur.

E njëjta gjë ndodh edhe me ne. Ne mund të lutemi me të vërtetë vetëm në qoftë se jemi fëmijë të Perëndisë. Si pasojë, në qoftë se ne nuk dimë të lutemi, mund të pranojmë se nuk jemi fëmijë të Perëndisë.

Oh, e di, ne jemi të krishterë të devotshëm! Ne e kemi shpallur besimin tonë, ne shkojmë në kishë Ditën e Krishtlindjeve, ne përshëndesim priftin apo pastorin në mënyrë të sjellshme. Një ungjilltar dikur i ka përshkruar njerëzit e tillë kështu: "Ata janë lepuj të pagëzuar!" Kur dikush e pyeti se ç'donte të thoshte, ai u përgjigj, "Në qoftë se kapni një lepur të egër dhe e pagëzoni, ai do të kthehet me vrap në fusha sapo ta lëshoni. Disa njerëz bëjnë pikërisht të njëjtën gjë. Ata s'janë pagëzuar mirë kur kthehen me vrap në botë."

Kur gjërat janë kështu njerëzit nuk mund të luten. Vetëm një fëmijë i Perëndisë di vërtet si të lutet. Kështu vetëm një fëmijë i Perëndisë mund të jetë vërtet i lumtur.

Prandaj ju duhet të bëheni fëmijë i Perëndisë. Ju nuk u lindët fëmijë i Perëndisë. Ju mund të keni një lustër të krishterë, por nuk jeni një fëmijë i Perëndisë. Ne bëhemi fëmijë vetëm me anë të lindjes. Dhe bëhemi fëmijë të Perëndisë vetëm me anë të një lindjeje të re. Ju duhet të bëheni fëmijë i Perëndisë - pastaj do të mësoni si të luteni. Një fëmijë i Perëndisë nuk mund të jetojë pa u lutur. Lutja për të është si frymëmarrja. Të rinjtë e mi ndonjëherë i thonë me shaka njëri-tjetrit, "Tani mos harro të marrësh frymë!" Por *ju* e lini pas dore lënjen e shpirtit tuaj të marrë frymë; ju harroni të luteni. Është thelbësore për ju që të bëheni fëmijë i Perëndisë.

Si bëhemi fëmijë të Perëndisë? Me një fjalë - vetëm nëpërmjet Jezu Krishtit. Ishte ai që tha: ***Unë jam dera; nëse ndokush hyn nëpërmjet meje do të shpëtohet***. Prej mjegullës së dendur të kësaj bote, Jezusi vjen te ju. Jezusi, njeriu që mban shenjat e gozhdëve në trupin e tij. Deri tani ai nuk ju ka interesuar në mënyrë të veçantë. Ajo që keni

dëgjuar për të duket kaq e paarsyeshme, kaq pa kuptim. E megjithatë, ai vjen t'ju takojë *ju.* Ndoshta do t'ju shkrepë në mendje papritur se kush është Jezusi. Atëherë do të jeni në gjendje t'i thoni atij, "Ti je një njeri i ardhur nga një dimension tjetër; ti je Biri i Perëndisë të gjallë; ti s'je tjetër veçse Shpëtimtari im."

Hapi i parë që duhet të bëj për t'u bërë fëmijë i Perëndisë është që të njoh Jezusin si Shpëtimtarin tim.

Hapi i dytë është të përvetësoj një qëndrim mirëbesimi ndaj Jezusit: mirëbesim se ai mund të ma vërë jetën përsëri në rregull, të më çlirojë nga ankthi, nga ndjenja e fajit, nga mëkatet e rinisë sime.

Një shenjtor i Dhiatës së Vjetër thirri, "Ti kujdesesh për shpirtin tim." Krejt papritur, ne kemi kaq mirëbesim te Jezusi sa që madje mund t'i këputim lidhjet tona me të shkuarën dhe t'ia besojmë tërë jetën tonë kujdesit të tij. Këtë e quajmë "konvertim". Këtë e kam përjetuar unë kur, në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare e braktisa jetën time mëkatare dhe e vura veten në duart e Jezusit. Askush nuk mund ta bënte atë hap për mua. Dhe as unë nuk mund ta bëj atë për ju. Ajo është një çështje personale ndërmjet jush dhe Perëndisë. Pse nuk merrni një vendim të prerë për ta ndjekur atë që tani?

Pikërisht në çastin që bëni këtë hap, ju bëheni fëmijë i Perëndisë. Megjithëse disa besojnë se mund të shpëtohemi me mënyra të tjera, unë e përsëris se ka vetëm një derë me anën e së cilës ju mund të hyni në Mbretërinë e Perëndisë. Është Jezu Krishti që vdiq dhe u ngrit përsëri për ju. Bëni një hap në drejtim të tij dhe ai do t'ju presë me krahë hapur. Mos hezitoni më!

Sapo të bëheni fëmijë i Perëndisë ju do të dini si të luteni.

Mjerimi juaj do të marrë fund, sepse do të jeni në gjendje ta zbrazni zemrën tuaj para Perëndisë. Ju do të jeni në gjendje t'i flisni atij si një fëmijë të atit.

Unë kam qenë pastor për shumë vite të gjata dhe më është dashur të merrem me shumë njerëz. Tani jam i bindur se çdo individ fsheh thellë në zemrën e vet ndonjë sekret që e tërheq me vete kudo. Por kur bëhem fëmijë i Perëndisë, unë mund t'ia hap zemrën Jezusit dhe ta ndaj sekretin tim me të: atë mëkat që unë nuk mund ta heq, marrëdhënien time të paligjshme të dashurisë, kujtimin e një gabimi që më fanitet gjithmonë. Unë mund të ndaj me Jezusin gjëra që nuk do të guxoja kurrë t'i ndaja me ndonjë njeri tjetër.

Në mbyllje të një kampi rinor, disa të rinj na treguan për përvojat që kishin patur. Njëri prej tyre, një djalë tetëmbëdhjetë vjeçar, tha këtë gjë: "Megjithëse e konsideroja veten të krishterë, isha në prag të heqjes dorë nga çdo gjë. Një mbrëmje, para se të shkoja në studim biblik, u luta: 'Zoti Jezus, në qoftë se nuk më flet personalisht sonte, do të lë që çdo gjë të shkojë kot. Nuk mund të ndeshem me problemet e mia, veçanërisht me ato që has në këtë qytet të madh, në qoftë se ti nuk m'i hap sytë.'" Ai e vazhdoi tregimin e tij: "Kur arrita në shtëpi atë natë, çdo gjë ishte e qartë për mua. Zoti i ishte përgjigjur lutjes sime dhe më kishte folur personalisht." Ky tregim i të riut më preku thellë. Në dyshimin dhe dëshpërimin e tij, ai i kishte thirrur Jezusit - dhe kishte marrë përgjigje!

Sa shumë më tepër të prirur jemi ne për t'u dëgjuar kur lutemi si fëmijë të Perëndisë.

Nëna ime jetonte në Hulben, afër Urahut, në krahinën e Jurës Svabiane. Një ditë gjatë luftës, ajo më shkruante: "U zgjova në tre të mëngjesit dhe papritur fillova të mendoj për

bijtë e mi në front, për nipërit dhe mbesat e mia, për ju në zonën e bombardimeve, dhe për Elisabetën në Kanada, nga e cila nuk kam marrë lajm. Zemra m'u mbush me frikë. Ndjeva sikur dikush po më mbyste me dorashka prej hekuri. Duke mos mundur të duroja më gjatë, fillova të lutesha: 'Zoti Jezus, më thuaj diçka. Nuk mund ta mbaj dot peshën e frikërave.' Pastaj ndeza dritën, zgjata dorën për të marrë Biblën, (i lumtur është ai njeri që e mban gjithmonë Biblën mbi tavolinën pranë shtratit të vet), dhe e hapa. Sytë më ranë mbi këtë pjesë: ***Gjithë merakun tuaj hidheni mbi të, sepse ai merakoset për ju.***" Letra e nënës sime përfundonte me këto fjalë: "Atëherë e vura gjithçka në duart e Shpëtimtarit, fika dritën dhe rashë në gjumë."

A nuk është kjo e mrekullueshme? Kur të jeni fëmijë i Perëndisë mund ta keni këtë lloj përvoje.

Mbaj mënd nënën time që më thoshte një ditë, "Natën e kaluar isha aq e rraskapitur sa që as nuk mund të lutesha dot. Thashë vetëm, 'Natën e mirë, i dashur Shpëtimtar!" Ndërsa e dëgjoja, mendova, "Kjo është mënyra për fëmijët e Perëndisë që të flasin me Shpëtimtarin e tyre - thjesht natyrshëm." Perëndia vërtet bën rojë mbi fëmijët e tij. Ditë e natë Shpëtimtari im më rri në krah sepse unë jam fëmija i tij. Unë mund të mbështetem tek ai sido që të jenë rrethanat.

A është e qartë për ju e gjitha kjo?

Është tragjedi të mos dish se si të lutesh. Kështu unë shpresoj se ju do të shqiptoni thirrjen e një fëmije të porsalindur: "Zot, kam mëkatuar; ki mëshirë për mua, mëkatarin." Dhe besoj se nuk do të keni prehje në mendjen tuaj deri sa të bëheni fëmijë i Perëndisë, deri sa t'i përkisni Jezu Krishtit.

Atëherë, dhe vetëm atëherë, unë do të pushoja së merakosuri për ju.

JA QË NUK MUND TË BESOJ!

1. Askush nuk mundet të jetojë – pa besim

Tani pikërisht në fillim, duhet t'ju them këtë gjë: askush nuk mund t'ia dalë mbanë në jetë pa besim te Perëndia. Dhe nuk di se çfarë të këshilloj; thjesht sepse asgjë nuk mund të bëhet për të ndihmuar personin që nuk beson te Perëndia.

Le t'jua shpjegoj përse...

Për disa njerëz Perëndia duket të jetë thjesht një koncept teologjik ose filozofik, ose ndonjë forcë e natyrës. Në të vërtetë Perëndia është person. Ai është shumë i gjallë dhe mbush gjithë universin me praninë e tij. Dhe në qoftë se unë nuk kam bërë paqe me Perëndinë, në qoftë se nuk e kam rregulluar jetën time me të, në qoftë se nuk jam fëmija i tij, atëherë unë jetoj jashtë qëllimit kryesor të jetës. Kjo është vërtet tepër serioze.

Pika krizë arriti në jetën time kur isha oficer i ri në Luftën e Parë Botërore. Papritur më ra në mend: Perëndia është këtu! U ndjeva si dikush që e kishte ngarë veturën e tij drejt e mu në një mur tullash. Deri atëherë, unë kisha pretenduar, si shumë njerëz të tjerë, se besoja te Perëndia. Por nuk e kisha kuptuar faktin se Perëndia ishte real. Pastaj, në hapësirën e një sekonde, u gjenda ballë për ballë me realitetin e Perëndisë.

Një nga psalmet në Bibël përshkruan realitetin e Perëndisë me terma shumë të qartë. Çfarëdo që të bëjmë, ne nuk mund t'i shpëtojmë Perëndisë. ***Në rast se ngjitem në qiell, ti je atje***. Astronauti amerikan Xhon Glen deklaronte se ajo që i kishte bërë më shumë përshtypje në anijen e tij kozmike ishte mendimi: Perëndia është edhe këtu! ***Në rast se ngjitem në qiell***, - ose në qoftë se shpejtoj nëpër kozmos - ***ti je atje***! Ose në qoftë se fshihem një milje nën tokë në galerinë më të

thellë të një miniere - do ta gjej Perëndinë edhe atje. Psalmisti madje shkon aq larg sa të thotë: ***Në rast se shtrij shtratin tim në Sheol, ti je edhe aty.***

Kohët e fundit udhëtova me aeroplan për në Kaliforni. Ime shoqe më kishte futur fshehurazi një shënim të shkurtër në valixhe në të cilin kishte shkruar një varg nga ky psalm. E lexova atë kur hoqa plaçkat nga valixhja në San Francisko: ***Në rast se marr krahët e agimit dhe shkoj të banoj në skajin e detit, edhe aty dora jote do të më udhëheqë.***

Po, Perëndia është një realiet i madh.

Dhe për shkak se Perëndia është një realitet i madh, unë nuk mund ta injoroj atë dhe të shpëtoj pa u lagur. Nëse vazhdoj të jetoj sikur Perëndia të mos ekzistonte, nëse vazhdoj të jetoj duke i përbuzur ligjet e tij - duke mos e konsideruar Ditën e Zotit të shenjtë, duke shkelur kurorën, duke gënjyer, duke mos patur aspak respekt për prindërit, dhe aspak për emrin e Perëndisë - atëherë unë po e shkatërojë qëllimin e jetës. Nën këto rrethana, është e pamundur për mua t'i bëj ballë jetës.

Shikoni rreth jush! Njerëzit thjesht nuk mund të gjejnë një rrugëdalje nga vështirësitë, madje as ata që fitojnë para të mëdha. Të gjithë janë të shqetësuar. Asgjë nuk shkon mirë në jetën e tyre private dhe çdo gjë shkon keq në jetën e tyre familjare.

Si mund të vazhdojmë të jetojmë kur nuk kemi aspak besim në Perëndinë? Ne nuk mund t'i bëjmë ballë jetës dhe jemi të pashpresë përballë vdekjes.

As edhe një prej nesh nuk do të jetojë pas njëqind vjetësh. Të gjithë do të kemi kaluar në anën tjetër. S'ka asnjë dyshim për këtë! "Por me t'u futur në varr, gjithçka merr fund," mund të mendoni ju. "Ne do të vdesim dhe kaq." Nëse kjo është ajo që besoni ju, atëherë ndaluni një minutë dhe mendoni. Ku duhet të mbështeteni për faktet tuaja mbi vdekjen: në

mendimet tuaja apo në Fjalën e Perëndisë? Si mund ta përballoni vdekjen në qoftë se ju kap papritur ky mendim: "Unë nuk mund të marr me vete asgjë nga ato që kam vënë mënjanë"? Ndoshta keni ndërtuar një shtëpi të vogël; ose, si puna ime, keni një koleksion të madh librash. Por ju nuk mund të merrni me vete asgjë nga ato për të cilat kujdeseni. Dhe as nuk mund të merrni me vete asnjë nga të dashurit. Ka vetëm një gjë që ne e marrim me vete në përjetësi: është faji ynë para Perëndisë.

Përpiquni ta imagjinoni veten të shtrirë në shtratin e vdekjes, me këtë mendim që vazhdimisht ju sillet nëpër mend: "Do të më duhet të lë çdo gjë pas. Çdo gjë!... përveç shkeljeve dhe mëkateve që kam kryer që nga rinia. Gabimet e mia do të më ndjekin mu në praninë e Perëndisë të drejtë e të shenjtë!" Si mund të shfajësoheni në gjyqin e Perëndisë në qoftë se nuk besoni në atë që mund të shfajësojë një mëkatar? Mos harroni kurrë këtë: Një ditë do t'ju duhet të dilni para Perëndisë!

Zoti Jezus, edhe pse ishte i mëshirshëm, sidoqoftë tha në një rast: ***Të mos keni frikë nga ata që vrasin trupin***. (E megjithatë unë kam frikë nga njerëz të tillë.) "Ata janë pa rëndësi," la të kuptohej Jezusi. "Mos kini frikë prej tyre. ***Kini frikë më tepër nga ai që mund t'jua humbë shpirtin dhe trupin në Gehena***. Dhe sikur t'i shkonin të dridhura deri në palcë nga ky mendim, Jezusi përsëriti, ***Po, po ju them, nga ai të keni frikë***.

Një dijetar i mirënjohur me emrin Ole Hallesbi jetonte në Norvegji para disa vjetësh. Pata privilegjin ta njihja. Ishte një njeri i jashtëzakonshëm. Për një javë rresht, në një rast, ai bënte një bisedë çdo mbrëmje në radion kombëtare. E kam të lehtë ta shëmbëllej të ulur para mikrofonit duke thënë, "Ju mund të bini në gjumë qetësisht në shtratin tuaj sonte, por të

zgjoheni në ferr nesër në mëngjes. Është detyra ime t'ju paralajmëroj." Këto fjalë ngritën një stuhi protestash. Një gazetar, në gazetën më të madhe të përditshme të Oslos shkroi një kryeartikull me pak a shumë këtë theks: "Nuk jemi më në Kohët e Mesjetës! Është krejtësisht e palejueshme që një shpikje moderne siç është radioja duhet të përdoret për të përhapur gjepura të këtij lloji." Kur një gazetë e rëndësishme boton një artikull të tillë, të gjitha gazetat më të vogla i vijnë pas avazit. Shpejt gjithë shtypi po përsëriste: "Nuk jemi më në Kohët e Mesjetës. Si mundet që një dijetar i ditëve tona të flasë për ferrin!" Polemika qe e ashpër.

Së fundi, radio Oslos iu desh t'i kërkonte profesor Hallesbit të bënte të qartë pozicionin e tij. Ai u kthye prapë te mikrofoni, dhe ja se çfarë tha: "Më duhet t'i bëj të qarta deklaratat e mia. Epo, në rregull! Ja ku i keni: "Ju mund të bini në gjumë qetësisht në shtratin tuaj sonte, por të zgjoheni në ferr nesër në mëngjes. Është detyra ime t'ju paralajmëroj."

Kjo ishte e padurueshme!

Pastaj të gjithë peshkopët e Norvegjisë u pyetën. "A ekziston ferri apo jo?" Madje revista gjermane e lajmeve *Der Spiegel* e vazhdoi debatin dhe botoi një artikull të gjatë të titulluar: "Grindja në lidhje me ferrin në Norvegji".

Më pak se një vit pas kësaj stuhie, isha në Oslo për një sërë konferencash studentore dhe gjithashtu për disa mitingje publike në mbrëmje. Sapo arrita, m'u desh të mbaj një konferencë shtypi. Reporterë të gazetave të ndryshme ishin mbledhur në hotelin tim. Çuditërisht, në të djathtën time ishte gazetari që kishte qenë origjina e kësaj polemike, dhe në të majtën time ishte profesor Hallesbi që përfaqësonte shtypin protestant. Ata filluan të më pyesnin. Gazetari në të djathtë ishte i pari që u hodh në sulm: "Pastor Bush," tha ai, "Unë jam krejtësisht në mospajtim me profesor Hallesbi. Ti je njeri modern. Sipas mendimit tuaj, a ekziston ferri? Po apo jo?"

"Eh, sigurisht që ferri ekziston! Është e arsyeshme." "Hajde, hajde!" u përgjigj ai. "Si mund të jesh kaq i sigurt për këtë?" Unë fillova përsëri, "Do të ta shpjegoj me shumë kënaqësi. Unë besoj se ferri ekziston sepse kështu ka thënë Jezusi. Dhe unë e besoj plotësisht atë që ka thënë Jezusi. Ai dinte shumë më tepër mbi këtë temë se sa gjithë e ashtuquajtura inteligjenca jonë."

Fjala e Perëndisë shpall: ***Perëndia... dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen dhe t'ia arrijnë njohjes së së vërtetës***. Perëndia na ka treguar në Fjalën e tij se si mund të jetojmë dhe të vdesim në paqe. Dhe prandaj ne insistojmë në domosdoshmë-rinë e të besuarit. Si mund të vazhdoj të jetoj unë dhe t'i përballoj problemet e mia në qoftë se nuk mund të besoj?

Nuk ka absolutisht asnjë rrugëdalje!

Le ta shpjegoj këtë në mënyrë tjetër. Le të pretendojmë se ti ke një peshk të vogël të kuq. Një ditë ty të lind një ide e ndritur: "E shkreta krijesë e vogël," i thua ti. "Sa e tmerrshme duhet të jetë të të duhet të qëndrosh gjithë kohën në atë ujë të ftohtë. Prit një minutë; të shoh se ç'mund të bëj për ty." Kështu ti e nxjerr peshkun e kuq nga uji, e than atë me peshqir dhe e vë në një kafaz të bukur të praruar. I jep atij ushqimin më të mirë për një peshk të kuq dhe i thua, "Peshk i vogël, ti ke një kafaz të bukur të praruar, ushqim të shijshëm dhe ajër të freskët të mrekullueshëm. Jeta për ty tani është madhështore!" Ç'mendoni se do të bëjë peshku i kuq? Të përdredhë pendët e tij dhe të thotë, "Faleminderit. Oh, faleminderit"? Jo! Kurrë ndonjëherë! Ai do të përpiqet me dëshpërim të mbajë frymën. Dhe në qoftë se mund të fliste, do të thoshte, "Unë nuk e dua kafazin tënd të praruar apo ushqimin tënd shumë të shijshëm. Unë dua të kthehem në ambientin tim të natyrshëm - ujin."

Pra, e shikoni, ambienti ynë i veçantë është Perëndia i gjallë që krijoi qiejtë dhe tokën dhe që na krijoi edhe ne. "Gjithë jeta vjen nga Perëndia", fillon një këngë patriotike zvicerane. Perëndia është ambienti ynë. Por sa kohë nuk kam bërë paqe me Perëndinë, më e mira që mund të bëj është të siguroj një kafaz të praruar për shpirtin tim. Ju e kuptoni se ç'dua të them: njeriu sot i ofron shpirtit të tij çdo gjë që e tërheq atë - kënaqësitë e të gjitha llojeve, udhëtimet jashtë shtetit, ushqimi dhe vera e mirë. Por shpirti ynë lufton brenda nesh dhe psherëtin, "Unë me të vërtetë nuk i dua gjithë këto gjëra. Dua të jem në ambientin tim. Dua të jem në paqe me Perëndinë!" Mos u bëni kaq mizorë me veten tuaj. Zemra juaj do të jetë gjithmonë e shqetësuar deri sa të gjejë prehje në Perëndinë e gjallë. Si një peshk që kërkon të jetë në ambientin e tij, shpirti ynë kërkon që të gjendet në Perëndinë. Vetëm atëherë ai do të jetë në ambientin e tij.

Si mund ta kalojmë jetën nëse nuk besojmë te Perëndia? Unë vetëm mund të përgjigjem se nuk ka rrugëdalje: as në këtë jetë, as në vdekje, as në përjetësi! Ju mund të kundërshtoni se shumica e njerëzve duket se e bëjnë këtë fare mirë. Kjo, sipas opinionit tim, mbetet për t'u parë! Merrni, për shembull, një njeri si poeti gjerman Gëte.
Ai ishte i pashëm, i pasur, inteligjent. Kishte çdo gjë që gjithkush mund të dëshironte. Por nga fundi i jetës së tij, ai iu rrëfye një miku se në qoftë se do të mblidhte orët e lumturisë së vërtetë që kishte patur gjatë jetës së tij, nuk do të bëheshin as tri ditë. Gëtja nuk kishte paqe.

Sa e vërtetë është që pa besim nuk mund ta kalojmë jetën.

2. Është jetësore të kesh besim të vërtetë

Ajo që ka vërtet rëndësi është që të keni besim të vërtetë: besim që shpëton.

Është fakt i thjeshtë që çdo qenie njerëzore beson në diçka. Isha në shtëpi një ditë në kohën kur isha student kur një grua erdhi për vizitë te nëna ime. Meqë nëna kishte dalë, i thashë zonjës, "Nëna ime nuk ka ardhur akoma, zonjë, kështu që kam frikë se do t'ju duhet të më duroni mua." "Jeni shumë i mirë!" u përgjigj ajo me politesë. Pasi e kisha ftuar të ulej në dhomën e pritjes, më pyeti, "Dhe me se merresh në jetë?" I thashë se studioja teologji. "Çfarë!" thirri me habi. "Teologji? Kush beson gjë prej gjëje sot? Është e pamundur. Ne kemi besimin e Gëtes." (Kjo ka ndodhur në Frankfurt, qyteti ku kishte jetuar Gëtja.) "Krishterimi është jashtë mode, i mbaruar!" deklaroi me krenari plaka. Po hynim në ujëra të thella, dhe meqë nuk doja të bëja debat, ndryshova temë. "Mund t'ju pyes si e keni shëndetin zonjë?" Ajo u përgjigj shpejt, duke i rënë lehtë tavolinës në të njëjtën kohë, "Mjaft mirë... prek drurin! Por shiko djalosh, ti nuk duhet të bësh pyetje të tilla!" "Më falni," iu përgjigja, "por pse thatë, 'prek drurin'?" "Për t'i prerë rrugën fatit të keq." "Vërtet!" thirra i habitur. "Ju keni hedhur poshtë besimin në Perëndinë e gjallë, por keni besim në veprimin e prekjes së drurit. Kjo është e çuditshme. Shpresoj se keni përfituar nga ky shkëmbim!"

Atë ditë e kuptova që të gjithë kanë një farë besimi. Por mbetet të shihet nëse është besim i vërtetë, besim që shpëton. Njerëzit në ditët tona thonë se gjëja kryesore është të besosh. Disa thonë, "Unë besoj në Zotin e mirë!" Të tjerë, "Unë besoj te natyra!" Dhe të tjerë akoma, "unë besoj te fati!" ose "unë besoj te providenca!"

Jo, miqtë e mi, nuk është kjo! Kryesorja është të kesh besim të vërtetë, atë lloj besimi që sjell paqe: paqe me Perëndinë, paqe të zemrës. Unë kam nevojë për një besim që do të më shpëtojë nga ferri, një besim ndikimin e të cilit

mund ta ndiej qysh tani sepse ai më ka dhënë një jetë të re. Në qoftë se do të kisha ndonjë lloj tjetër besimi, do ta konsideroja atë pa vlerë.

Ishte një kohë kur shumë nga ne gjermanët besonim te Gjermania, te Fyhreri, në fitoren përfundimtare. Dhe ç'doli nga e gjithë kjo? A nuk e shihni se besimi mund të jetë i rremë?

Por besimi i vërtetë - ai që shpëton - është, me një fjalë, besimi në Jezusin, i cili nuk është tjetër veçse Biri i Perëndisë të gjallë. Besimi në Jezu Krishtin. Jo besim në themeluesin e ndonjë feje - ka një numër syresh - por besim në Jezu Krishtin, Birin e Perëndisë të gjallë.

Një histori shumë e bukur tregohet në Bibël, e cila ilustron në mënyrë të përsosur se ç'është në të vërtetë ky besim shpëtues në Jezusin. Me imagjinatën tuaj më ndiqni mua dy mijë vjet prapa në Jeruzalem - jashtë portave të qytetit dhe mbi një kodër të quajtur Kalvar (që do të thotë "Vendi i Kafkës"). Mos u kushtoni aspak vëmendje turmës histerike që ulërin apo ushtarëve romakë rojë që po luajnë se kush do të fitojë rrobat e të burgosurit. Por ngrijini sytë. Në kryqin e mesit Biri i Perëndisë është gozhduar, me fytyrën gjithë njolla gjaku nga kurora me gjemba që lëronte në kokën e tij. Është Perëndia ai që rri varur atje! Në kryqin në të djathtë të tij kanë kryqëzuar një vrasës. Një vrasës tjetër është në kryq në të majtë të tij. Nata po bie me shpejtësi. Vdekja po afrohet. Papritur një nga vrasësit bërtet, "Hej, ti në mes, dëgjo! Ti the që je Bir i Perëndisë. Nëse kjo është e vërtetë, dhe nëse nuk je gënjeshtar, atëherë zbrit nga kryqi yt dhe më hiq dhe mua nga imi!"

Është mjaft e lehtë për ta kuptuar. Kur njerëzit janë në portat e vdekjes, thonë gjëra që nuk do t'i thoshin kurrë normalisht.

Pastaj flet vrasësi tjetër. Duke iu kthyer shokut të tij i

thotë, "Akoma nuk ke frikë nga Perëndia?"

Dhe këtu duhet të *fillojë* besimi: Ne duhet të kuptojmë se Perëndia është i shenjtë dhe se zemërimi i tij është i tmerrshëm.

Kur binin bombat mbi qytetet tona gjatë luftës së fundit, njerëzit u tronditën dhe u shastisën. Ndoshta kishat duhej të fajësoheshin për këtë, sepse ato dështuan të paralajmëronin njerëzit se zemërimi i Perëndisë mund të jetë i tmerrshëm dhe se ai i lë individët dhe kombet të bëjnë punën e tyre pa ndërhyrjen e tij.

Akoma nuk keni frikë nga Perëndia? Kjo pyetje duhet të bëhet duke bërtitur nga majat e çative të qyteteve tona. Akoma nuk keni frikë nga Perëndia? Ajo duhet të bëhet duke bërtitur anë e mbanë. Akoma nuk keni frikë nga Perëndia? Për çfarë po mendoni? Mos jeni të verbër?

Ja se ku duhet të filloni: të njihni se Perëndia është i shenjtë dhe zemërimi i tij është i tmerrshëm.

Por krimineli i dytë, vrasësi, vazhdon të flasë, "Ne jemi dënuar me të drejtë; po marrim ndëshkimin e merituar."

Ky është *hapi i dytë* që të çon në besim dhe shpëtim: ai e pranon fajin.

Kam takuar shumë njerëz që më kanë thënë, "Unë thjesht nuk mund të besoj!" Unë u kam thënë atyre, "A e keni kuptuar se jeni fajtor para Perëndisë?" Dhe ata janë përgjigjur, "S'kam pse të ndihem aspak fajtor!" Më është dashur t'u them atyre, "Ju nuk do ta shihni kurrë dritën nëse vazhdoni të talleni me veten tuaj."

Takova dikë kohët e fundit që u justifikua në të njëjtën mënyrë. "S'kam pse të ndihem aspak fajtor!" tha ai. "Urime," iu përgjigja. "Unë nuk mund ta them këtë. Gjithmonë ka diçka që nuk shkon në jetën *time*!" Tjetri më tha, "Oh natyrisht, në qoftë se hyn në detaje." "Por Perëndia në detaje

shikon," qe përgjigjja ime. "Pusho së talluri me veten."

Kurrë nuk do të arrini të keni besim të vërtetë - këtë besim që shpëton - përderisa nuk e keni thirrur mëkatin me emrin e tij: zakonet tuaja seksuale të çrregullta -*marrëdhëniet seksuale jashtë martese*; shkeljet e besnikërisë martesore - *shkelja e kurorës*; mashtrimet - jo mendjemprehtësia, por *gënjeshtrat*; egoizmi juaj - jo një dashuri e ligjshme për vetveten por një formë *idhujtarie*, sepse e keni bërë veten perëndinë tuaj.

Le të përsëris prapë se hapi i dytë drejt besimit dhe shpëtimit është ta thërrisni mëkatin me emrin e tij të vërtetë dhe të pranoni para Perëndisë se e meritoni dënimin e tij.

Është alarmante të shohësh se si kaq shumë njerëz të ditëve tona përpiqen ta bindin veten e tyre se asgjë nuk shkon keq me ta. Por një ditë Perëndia do t'na e heqë maskën nga fytyrat tona.

Së fundi, hajduti kthehet nga Jezusi dhe i thotë, "Por ti, ti nuk ke bërë asgjë të keqe. Pse të kanë kryqëzuar?" Sa hap e mbyll sytë ai e kupton. "Ai është varur atje për mua. Për të hequr mëkatin tim." Dhe ai bërtet, "Jezus, kujtohu për mua kur të vish në mbretërinë tënde."

Ai ka bërë *hapin e tretë*: ai ka besuar se Jezusi mund ta shpëtojë atë për gjithë përjetësinë. Ai ka besuar se Jezusi po merr ndëshkimin për mëkatet e tij. Dhe përgjigjja e Jezusit është e menjëhershme: ***Në të vërtetë po të them: sot do të jesh me mua në parajsë.***

Ky është besim shpëtues: Unë bëhem i dijshëm për shenjtërinë e Perëndisë. E kuptoj që jam i humbur. Por unë besoj se Jezusi, i cili vdiq në kryq për mua, është shpresa ime e vetme e shpëtimit. Pa këtë besim nuk ka rrugëdalje. Por me këtë besim ju mund të jeni të sigurt për daljen nga pështjellimi në të cilin ndodheni. Kjo është gjithçka që mund t'ju them.

Shpesh kam qenë akuzuar për thjeshtësim të tepërt të çështjeve. Unë vetëm mund të përgjigjem se më vjen keq, por fakti i thjeshtë është se ja që nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të shtyrë jetën, për të përballuar vdekjen dhe për të qëndruar para stolit të gjykimit të Perëndisë.

Nuk kam rrugë tjetër, si mëkatar, veçse të vij te Jezusi, të pendohem dhe të rrëfej mëkatet e mia, pastaj të përsëris me besim:

Po unë besoj, po unë besoj
Se Jezusi vdiq për mua.
Dhe prej gjakut të tij, të çmuarit gjak
Jam përgjithmonë i çliruar.

Kurrë mos i harroni fjalët: *Jezu Krishti vdiq për mua.* Kur të zgjoheni nesër në mëngjes, ato duhet të tingëllojnë në zemrën tuaj: Jezu Krishti vdiq për mua! Kur të kaloni nëpër mërzitjen e përditshme në punë, ju duhet t'u kushtoni edhe atyre një pjesë të mendimeve: Jezu Krishti vdiq për mua!

Do të vijë dita, nëse Perëndia ka mëshirë për ju, kur do të jeni në gjendje ta përlëvdoni atë dhe të thoni, "*Për mua...* Po, unë besoj!" Në momentin që e keni kuptuar këtë të vërtetë, ju do të bëheni një fëmijë i Perëndisë; sepse Jezusi tha, ***Unë jam dera; kushdo që hyn nëpërmjet meje do të shpëtohet.***

Por unë duhet të vazhdoj me pikën time të tretë.

3. Njerëzit që nuk mund të besojnë te Perëndia

Shumë njerëz më thonë, "Pastor Bush, ajo që thua e gjitha është mirë, por përsa më përket mua, unë thjesht nuk mund të besoj te Perëndia."

Le ta shqyrtojmë këtë tip reagimi më nga afër.

Ka përgjithësisht katër kategori njerëzish që thonë këtë

lloj gjëje.

Së pari, ka njerëz që thonë se *nuk janë fetarë.* Argumenti i tyre është, "unë nuk mund të besoj thjesht sepse nuk jam fetar. Ti je pastor Bush, por unë jo." Kësaj vërejtjeje unë mund t'i përgjigjem vetëm, "Kjo mund të të çudisë, por as unë nuk jam fetar!" Që të tregohem i vërtetë, unë u kushtoj pak rëndësi kambanave të kishës, temjanit dhe gjërave të tjera të tilla. Në këto vite që kam kaluar në Esen, ka qenë gëzimi im të predikoj në një kishëz ku ka vetëm një bandë muzikore të mirë me vegla tunxhi. Asnjë organo, asnjë kambanë - dhe nuk e kam ndier aspak mungesën e tyre. Nuk jam kundër këtyre gjërave, por nuk kam nevojë për to. Kam frikë se nuk jam shumë fetar!

Kur Jezusi, Biri i Perëndisë, ishte këtu në tokë, kishte disa njerëz shumë fetarë aty rrotull. Ishin skribët, priftërinjtë dhe farisenjtë - që të gjithë ishin njerëz shumë fetarë. Saducenjtë, megjithëse më liberalë në pikëpamje, gjithashtu mund të llogariteshin ndër ta. Dhe këta ishin njerëzit - këta njerëz fetarë - që kryqëzuan Birin e Perëndisë. Sipas tyre nuk ishte Jezusi ai njeri i duhur për ta!

Pastaj, kishte njerëz të tjerë rrotull që nuk ishin aspak fetarë: prostitutat, batakçinjtë - Bibla i quan ata tagrambledhës - dhe punëtorët që përpiqeshin aq shumë për të fituar bukën e gojës. Ata ishin të gjithë njerëz pa besim apo ligj! E megjithatë ishin ata që u kthyen te Jezusi! Pse? Sepse thellë në zemrat e tyre ata pranuan, "Jemi fajtorë para Perëndisë. Sa gjëra nuk janë si duhet në jetën tonë. Por këtu është një njeri që do të na shpëtojë dhe do të na bëjë fëmijë të Perëndisë." Dhe ata besuan në Jezusin.

Jo, Zoti Jezus nuk erdhi për t'i bërë njerëzit fetarë edhe më fetarë. Por ai erdhi për t'i shpëtuar mëkatarët nga vdekja dhe ferri dhe për t'i bërë ata fëmijë të Perëndisë.

Atyre që thonë, "Nuk mund të besoj te Perëndia sepse nuk

jam fetar," unë u përgjigjem pa hezitim, "Ju jeni ata të cilët jeni më të prirur për t'u bërë fëmijë të Perëndisë." Mëkatarë jemi të gjithë - dhe ne të gjithë e dimë këtë gjithashtu!

Le të përsëris këtë: Jezusi nuk erdhi për t'i bërë njerëzit fetarë edhe më fetarë, por për t'i bërë mëkatarët e shkretë e të humbur, fëmijë të Perëndisë të gjallë.

Kategoria e dytë e njerëzve gjithashtu thotë, "Unë *nuk mund* të besoj te Perëndia." Por në qoftë se do të ishin të ndershëm me veten e tyre, ata do të thoshin, "Unë *nuk dua* të besoj." Nëse këta njerëz do të besonin te Perëndia, tërë jeta e tyre do të duhej të ndryshonte. Dhe kjo është një gjë që ata nuk e dëshirojnë. Ata e dinë më se mirë se shumë gjëra nuk janë si duhet në jetën e tyre. Për t'u bërë fëmijë të Perëndisë ata duhet të dalin në dritë. Dhe kjo është një gjë tjetër që ata nuk e dëshirojnë. Eh, miqtë e tyre ndoshta do të tallen me ta! Dhe çfarë do të thoshin gjithë të afërmit e tyre nëse ata papritur do të bëheshin të krishterë? Jo, më mirë jo!

Kështu në qoftë se takoni njerëz që ju thonë se nuk mund të besojnë te Perëndia, shikojini ata më me kujdes. Ndoshta ata në të vërtetë duhet të thoshin, "Nuk dua të besoj."

Ka një histori prekëse në Bibël. Jezusi, Biri i Perëndisë, ishte ulur diku në Malin e Ullinjve. Qyteti i Jeruzalemit shtrihej poshtë tij. Përballë tij, vetëm një distancë të shkurtër larg, ishte tempulli madhështor. Edhe paganët thoshin se tempulli i Jeruzalemit duhej të numërohej si një nga mrekullitë e botës. Kjo ishte pamja para Jezusit. Papritur dishepujt vunë re me habi se nëpër faqet e Jezusit po rridhnin lot. Të tmerruar ata panë nga ai në mënyrë pyetëse dhe pastaj e dëgjuan atë të ngashërejë, ***O Jeruzalem, Jeruzalem, që i vret profetët dhe vret me gurë ata që të janë dërguar! Sa herë kam dashur t'i mbledh bijtë e tu ashtu si i mbledh klloçka zogjtë e vet nën krahë, POR JU NUK DESHËT!***

Kjo është një nga pjesët më prekëse të Biblës.

Por ju nuk deshët.

Edhe banorët e Jeruzalemit kishin thënë, "Nuk mund të besojmë." Në realitet ata nuk dëshironin të besonin.

Ai që nuk dëshiron të besojë te Perëndia nuk është aspak i detyruar për ta bërë këtë.

Le të them këtë me që e solli fjala. Në kishat tona ekzistojnë akoma të gjitha llojet e kufizimeve. Por në Mbretërinë e Perëndisë çdo gjë bëhet sipas vullnetit të lirë. Ai person që dëshiron të jetojë pa Perëndinë ka një të drejtë të plotë për të bërë kështu. Perëndia na ofron veten e tij por ne mund ta refuzojmë po të dëshirojmë.

Dëshironi të jetoni pa Perëndinë? E keni këtë të drejtë. Dëshironi të jetoni pa bërë paqe me Perëndinë? E keni këtë të drejtë. Dëshironi të jetoni pa iu lutur kurrë Perëndisë? E keni këtë të drejtë. Dëshironi të jetoni pa Biblën? E keni këtë të drejtë. Dëshironi t'i thyeni urdhërimet e Perëndisë? E keni këtë të drejtë. Dëshironi të përdhosni Ditën e Zotit, dëshironi të bëni shkelje kurore, të mashtroni dhe të vidhni? E keni këtë të drejtë.

Burri apo gruaja që nuk e dëshiron Shpëtimtarin e dërguar nga Perëndia për të shpëtuar mëkatarët është i lirë të mos e pranojë atë. Burri apo gruaja që dëshiron të hidhet në ferr ka të drejtë të bëjë kështu. Perëndia nuk detyron askënd.

Vetëm kurrë mos harroni se ju duhet t'i pranoni pasojat e zgjedhjes suaj. Perëndia ju ofron falje dhe paqe nëpërmjet Jezusit. Ju keni të drejtën të përgjigjeni se as keni nevojë dhe as i dëshironi ato. Dhe mund të vazhdoni të jetoni me këtë qëndrim. Por mos mendoni se në pesë minutat e fundit të jetës suaj, pikërisht para se të vdisni, ju mund ta kapni shpëtimin që Perëndia ju ka ofruar gjatë gjithë jetës suaj. Është privilegji juaj ta refuzoni ofertën e paqes që ju bën Perëndia nëpërmjet Jezusit. Në qoftë se kjo është ajo që

zgjidhni, ju kurrë nuk do të jeni në paqe me Perëndinë gjatë gjithë përjetësisë!

Ferri është vendi ku ne e heqim qafe Perëndinë përgjithnjë. Me të shkuar atje, nuk ka asgjë që të të tërheqë për tek ai. Ju mund të dëshironi të luteni, por nuk do të jeni më në gjendje. Ju mund të digjeni nga dëshira për të thirrur emrin e Jezusit, por ju as do ta kujtoni se ç'është.

Ju nuk keni asnjë detyrim, të jeni të sigurt, për ta pranuar mesazhin që po ju sjell. Ju mund të zgjidhni të mos e ndiqni Jezu Krishtin. Por kurrë mos harroni se është ferri ai që po zgjidhni në vend të tij. Jeni absolutisht të lirë për ta bërë këtë zgjedhje.

Por ju nuk deshët, u tha Jezusi banorëve të Jeruzalemit. Ai nuk i detyroi ata, por zgjedhja që ata bënë ishte e tmerrshme.

Kategoria e tretë e njerëzve që thonë, "nuk mund të besoj te Perëndia," nxjerr një shpjegim tepër të çuditshëm. Ata nuk janë kurrë gra, gjithmonë burra. Ja çfarë thonë ata: "Pastor Bush, *kam parë kaq shumë gjëra gjatë jetës sime* sa që nuk mund të besoj më." Unë zakonisht pyes, "Mirë, më thuaj, tamam atë që ka ndodhur gjatë jetës suaj? As jeta ime nuk ka qenë monotone!" "Njerëzit më kanë bërë shumë të këqija. Dhe unë thjesht nuk mund të besoj më." Ky lloj të menduari i fanitet botës së burrave.

Unë kam zakonin tepër të prapë për t'i tallur njerëzit që më thonë këtë. "A e besoni atë që lexoni në orarin e trenit? A e besoni atë që iu thotë polici kur e pyesni për t'ju treguar diçka?" i pyes ata zakonisht. "Epo, sigurisht!" Dhe kështu vazhdoj: "Mjaft the atëherë që ti s'beson më në asgjë. Ti duhet të thoshje, 'Nuk besoj më në asgjë - përveç atyre që shkruhen në orarin e trenave, përveç atyre që thotë polici...'". Dhe mund të vazhdoja pa ndërprerje! Por jam i sigurt se e

keni kuptuar thelbin.

Zakonisht, me këtë lloj njeriu, unë e mbyll duke thënë, "Që ta dish, unë vetë bëja një jetë të zymtë mëkati, papastërtie, errësire dhe gabimesh. Atëherë ndërhyri Jezusi. Unë njoha që ai ishte Biri i Perëndisë, Lajmëtari i Perëndisë, dhe ia fala jetën time atij. Ai kishte bërë kaq shumë për mua. Ju mund të keni përshtypjen se në të vërtetë nuk mund të besoni më tek askush dhe në asgjë. Por ndoshta të paktën ju mund të besonit fjalën e atij që dha jetën e tij për ju? Sigurisht ju mund të besoni atë që thotë *ai*! Ju besoni kaq shumë gjëra. E prapë i thoni 'Jo' të vetmit person që e vlen mirëbesimin tuaj të plotë. Ju i thoni 'Jo' të vetmit person që nuk ka zhgënjyer askënd! Dhe guxoni të thoni se keni parë kaq shumë gjëra gjatë jetës suaj. Sipas mendimit tim, nuk keni parë aq sa duhet!"

Kategoria e katërt e njerëzve që pretendojnë të mos jenë në gjendje të besojnë te Perëndia janë *ata që kanë qenë shokuar nga kisha* apo që janë shkurajuar nga mësimet e saj.

Një studente e re u ul një ditë para meje dhe tha, "unë studioj shkencat e natyrës." "Shumë mirë," iu përgjigja, "por ç'të shqetëson ty zonjushë?" "Pastor Bush," u përgjigj, "unë erdha në një nga takimet e tua. E ndiej që ti ke diçka që do të doja ta kisha edhe unë. Por unë nuk mund të besoj. Unë nuk mund t'i pranoj pa shpjegim dhe verbërisht doktrinat dhe traditat e kishës! Do të ishte një lloj sikur të gëlltitje një vandak me bar të thatë!" S'e mbajta dot të qeshurit, por nxitova t'i përgjigjem. "S'është nevoja që të gëlltitësh një vandak me bar! Ke dëgjuar ndonjëherë për Jezusin?" "Po," qe përgjigjja. "Ç'do të thoshe ti," e pyeta pastaj, "nëse unë do të sugjeroja se Jezusi është gënjeshtar?" "Do të thoshja se nuk e besoj." "Kështu ti beson se Jezusi tha të vërtetën?" "Po," tha, "Këtë e besoj!" Unë vazhdova, "A ka një njeri të vetëm në këtë botë të cilit do të guxoje t'i thoshe, 'Jam e sigurt se ti

nuk ke thënë kurrë asnjë gënjeshtër""? "Oh jo," tha ajo, "unë kurrë nuk do të mundja t'ia thoja këtë ndonjërit." Vazhdova, "Nga gjithë kjo që sapo the, është e qartë se ti tashmë beson. Ti ke besim. Kjo është një gjë shumë e mirë. I ke rënë në të, zonjushë, ti beson se Jezusi tha të vërtetën. Bibla thotë: ***Kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar***."

Si konkluzion thashë, "Ti s'ke pse të luftosh me doktrinat dhe traditat e kishës. Prej mjegullës së kësaj bote dikush ka ardhur të të takojë. Dhe ndërsa ai afrohet, ti do të jesh në gjendje të dallosh qartë gjurmët e gozhdëve në duart e tij dhe shenjat e kurorës me gjemba mbi vetull. Ato janë prova që ai mori mëkatet e tua mbi vete dhe se ai të deshi kur nuk të donte askush tjetër. E pafsh Jezusin gjithnjë e më qartë dhe qofsh në gjendje t'i thuash atij, 'Zoti im, Shpëtimtari im dhe Perëndia im!' Të besosh nuk do të thotë ta gëlltitësh doktrinën si bar i thatë, pikërisht sepse kështu ka thënë pastori.

"Jo, të besosh është *të njohësh* Jezu Krishtin."

Dikush tjetër mund të thotë, "Përsa më përket mua, nuk mund të besoj sepse kam parë një pastor që ka bërë këtë, atë gjë dhe atë tjetrën...". Dhe ikin! Ç'nuk kam dëgjuar për pastorët! Njëri kishte marrëdhënie të dyshimta me gratë. Një tjetër iku duke marrë me vete fondet e kishës. Kudo ka patur telashe me pastorët. "Kështu, si mund të presësh akoma që unë të jem në gjendje të besoj?" Dhe unë nuk mund të mos skuqem, sepse dhe vetë e di fare mirë. Natyrisht unë nuk kam ikur me gjithë fondet e kishës. Por në qoftë se njerëzit do ta dinin gjithçka ndodh brenda meje, do ta kuptonin që as unë nuk jam i përsosur.

Ç'mund të them? Thjesht se askund në Bibël nuk është

shkruar: "Beso në pastorin tuaj dhe do të shpëtohesh." Bibla, megjithatë thotë: ***Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh***. Një pastor është - oh e di që nuk është gjithmonë kështu, por në qoftë se ai e bën punën si duhet - një pastor është një shenjë rrugore që tregon drejtimin për te Krishti. Një shenjë rrugore mund të jetë pak e shtrembër, e kthyer ose e fshirë nga shiu. Në të vërtetë nuk ka shumë rëndësi përderisa njerëzit mund të shohin se ku tregon ajo. Sa për mua, nuk do ta dëgjoja një pastor që nuk i drejton njerëzit te Jezusi, Biri i kryqëzuar dhe i ngritur i Perëndisë. Por sigurisht unë nuk do të zemërohem me një shenjë rrugore, qoftë edhe e deformuar, e cila tregon rrugën e duhur. Jo, unë vetëm do të vazhdoj të eci nëpër atë rrugë.

Vërtet mendoni se do të guxoni t'i thoni Perëndisë të gjallë kur të hyni në praninë e tij në Gjykimin e Fundit, "Zot unë nuk e desha shpëtimin tënd, nuk e pranova faljen e mëkateve të mia dhe gjithçka erdhi për shkak të atij pastorit që nuk ishte gjë tjetër veçse një hiç"? A është kjo rruga që e shikoni ju veten duke qëndruar një ditë para Perëndisë?

Miqtë e mi, është gabim të thuash, "Unë nuk mund të besoj." Jezusi tha diçka që sipas mendimit tim është me rëndësi shumë të madhe: ***Në qoftë se dikush don të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo që unë flas nga vetja ime***. Çështja që është në rrezik është nëse unë jam apo nuk jam i gatshëm t'i bindem dhe ta vë në praktikë, deri në detajet më të vogla, atë që kam njohur si të vërtetë. Atëherë, dhe vetëm atëherë, unë do të jem në gjendje të bëj përpara në jetë.

4. Ç'duhet të bëni?

Këtu me pak fjalë është ajo që duhet të bëni në qoftë se nuk mund të besoni te Perëndia.

Së pari, *kërkojini Perëndisë t'ju hapë sytë.* Ai është pranë jush. I thoni atij, "Zot, më ndihmo të besoj. Më ndihmo të shoh dritën." Perëndia i përgjigjet kësaj lloj lutjeje.

Së dyti, *mbështetuni në praninë e Perëndisë.* Kthejini mendimet tuaja tek ai dhe thoni, "Zoti Jezus, dua të të jap ty jetën time." Këtë bëra unë kur, si i ri në një situatë mosbesimi, frika nga Perëndia ishte bërë shumë reale për mua. Kur dëgjova për Jezusin, ia dhashë jetën time atij.

Së treti, *lexoni Biblën.* Ja se si mund ta njihni më mirë Jezusin. Çdo ditë, kaloni rreth pesëmbëdhjetë minuta në heshtje me të. Lexoni një pjesë nga Bibla dhe dëgjoni se çfarë ju thotë Perëndia nëpërmjet saj. Lexoni, duke i mbajtur veshët krejt të hapur ndaj zërit të Perëndisë. Pastaj në çfarëdo mënyre që t'ju vijë më natyrshëm, ia sillni preokupimet tuaja Perëndisë. Tregojini atij për mosbesimin tuaj. "Zoti Jezus, kam kaq shumë gjëra për të të thënë. Nuk mund të gjej rrugëdalje. Të lutem më ndihmo!"

Së fundi, *hyni në lidhje me të krishterë të tjerë.* Kërkoni njerëz të tjerë që janë gjithashtu seriozë për Perëndinë. Mos qëndroni të vetmuar. Nuk ka asnjë udhëtar të vetmuar në rrugën për në parajsë. Kështu kërkoni bashkësi me të krishterë të tjerë që ecin nëpër të njëjtën rrugë.

SI MUNDEMI TA SHIJOJMË JETËN NËSE FAJET DHE DËSHTIMET TONA NA RËNDOJNË?

Siç thonë, "S'bëhet më shaka!" Ja si dua ta paraqes unë temën tonë, sepse tani do të trajtojmë disa probleme shumë serioze.

Si mund ta shijojmë jetën nëse fajet dhe dështimet tona na rëndojnë? Duhet ta them hapur se pyetja nuk është formuluar aq mirë: ...*nëse* fajet dhe dështimet tona na rëndojnë? E vërteta është se që të gjithë ne jemi rënduar prej tyre në fakt. Fajet dhe dështimet tona na ndjekin kudo që shkojmë. Prandaj unë jam kaq i kënaqur që mund t'ju tregoj për diçka absolutisht të mrekullueshme - një dhuratë - e cila mund ta pasurojë jetën tuaj dhe ta mbushë atë me lumturi. Është diçka që nuk mund të blihet në asnjë vend të botës. Edhe sikur të ishit milioner dhe të ishit të gatshëm të harxhonit tërë pasurinë tuaj, nuk do të ishit në gjendje ta blinit atë! As mund ta merrni atë nëpërmjet miqve tuaj me influencë - megjithëse shumë njerëz sot arrijnë të sigurojnë gjëra që nuk mund të blihen me para duke luajtur gurët. As nuk ka asnjë mënyrë tjetër për ta siguruar atë vetë.

Në qoftë se e dëshironi, duhet ta pranoni atë si dhuratë. Kjo gjë e mrekullueshme, e rëndësishme, e pakrahasueshme për të cilën po flas, e cila as mund të blihet me para, dhe as mund të fitohet me anë të lidhjeve, nuk është asgjë më pak se falja e mëkateve.

Ndoshta ju u zhgënjyet. Mbase varët buzët kur lexuat fjalët "falje e mëkateve", dhe pyetët veten:

1. A kam vërtet nevojë për të?

Jam i bindur se shumica e burrave dhe grave arsyetohen si më poshtë: "Falje e mëkateve? Nuk kam nevojë për të." Kohët e fundit, një i ri m'i shpjegoi kështu gjërat: "Ne jetojmë në një epokë ku nevojat tona krijohen me anë të reklamës. Stërgjyshërit tanë nuk dinin asgjë për çamçakëzin apo për cigaret. Por si rezultat i reklamave të pareshtura, në radio, televizion, dhe në afishet e ndryshme, ne jemi kushtëzuar gradualisht; kështu tani ne jemi të bindur, për shembull, se nuk mund të jetojmë pa cigare. Krijohet nevoja në fillim, dhe pastaj nisin shitjen furishëm." I riu vazhdoi: "Kisha vepron tamam në të njëjtën mënyrë. Ajo u thotë njerëzve: 'Ju keni nevojë për falje.' Pastaj ajo vazhdon të shesë falje. Në të vërtetë ne nuk kemi nevojë për të, por ju, njerëzit e kishës keni krijuar nevojën me qëllim që të shisni mallin tuaj."

Është kjo realisht e vërtetë? Le të supozojmë se ju ndaloni dikë që po shëtit në rrugë dhe i thoni, "Tungjatjeta! Si e ke emrin?" "Braun," përgjigjet ai. "Mirë! Pa më thuaj zoti Braun, a ke nevojë të të falen mëkatet?" Zoti Braun ka shumë mundësi që të përgjigjet, "Bah! Ç'i ke këto budallallëqe! Unë kam nevojë për një dorë të mirë e të plotë parash, e jo për faljen e mëkateve të mia."

A ka të drejtë i riu? A kemi krijuar një nevojë që më parë nuk ka ekzistuar dhe po përdorim Biblën për t'u përpjekur që ta plotësojmë atë nevojë?

Jo, jo, një mijë herë jo! Është gabimi më i madh ta mendosh këtë. Nevoja jonë më e thellë është të na falen mëkatet. Burri apo gruaja që mendon se ai apo ajo mund të bëjnë pa të, nuk e njeh Perëndinë e shenjtë dhe që të imponon respekt. Kaq shumë theksim i është vënë dashurisë së Perëndisë në ditët tona, saqë ne kemi harruar se Perëndia i Biblës është gjithashtu një Perëndi për t'ia patur frikën. Ajo

që më shkundi nga jeta ime mëkatare ishte ky mendim që më erdhi papritur: ka arsye të forta për t'ia patur frikën Perëndisë. Personi që thotë, "unë nuk kam nevojë të më falin", nuk e njeh Perëndinë e gjallë, që mund ta shkatërrojë edhe trupin edhe shpirtin në ferr. Oh po, ferri ekziston; ekzistón dënimi i përjetshëm. Kështu tha Jezusi dhe ai duhet ta dinte! Dhe megjithëse e gjithë bota mund të thërrasë, "Ne nuk e besojmë këtë", sidoqoftë e gjithë bota do të humbasë. Jezusi e di se ç'na pret përtej varrit. Dhe na paralajmëron në lidhje me dënimin e përjetshëm.

Para disa vjetësh, mbajta një takim në qytetin e bukur të Zyrihut, në Sallën e Kongreseve, para një numri shumë të madh dëgjuesish. Shumë njerëzve iu desh të mbështeteshin pas murit. Midis atyre që rrinin atje, vura re dy burra që po bisedonin me gaz. Dukej qartë nga sjellja e tyre se kishin ardhur të shtyrë vetëm nga kureshtja. Njëri prej tyre kishte një mjekër të vogël e të lezetshme si prej cjapi. (Kjo ma kishte tërhequr vëmendjen dhe i kisha thënë vetes, "Sa turp që ti nuk mund të rritësh një të tillë!") Që nga fillimi i predikimit, kisha vendosur të tërhiqja vëmendjen e dy burrave. Në fakt ata ishin shumë të vëmendshëm deri sa unë shqiptova fjalën "falje". Menjëherë një buzëqeshje tallëse u duk në buzët e burrit me mjekrën si të cjapit. E pashë duke i pëshpëritur diçka në vesh shokut. Salla ishte
e madhe, dhe meqë dy burrat ishin nga fundi, unë sigurisht nuk dëgjova se çfarë tha. Por munda ta kuptoj nga shprehja e fytyrës së tij se ajo ishte ndoshta diçka e tillë: "Falje e mëkateve - dër-dëret e zakonshme të një pastori!" Dhe ndoshta ai ka menduar gjithashtu: "Në fund të fundit unë nuk jam kriminel. S'kam nevojë për falje. Jepi, jepi!" (A nuk është tamam siç po mendoni dhe ju?) Sidoqoftë, kur pashë reagimin e atij burri ndjeva se po zemërohesha. E di që

Perëndia nuk pëlqen të na shohë të zemërohemi por ja që unë nuk mund të duroja më. Kështu thashë, "Tani dëgjoni, të gjithë. Do të kemi tridhjetë sekonda heshtje. Dhe dua që secili prej jush, gjatë këtyre pak çasteve, t'i përgjigjet 'po' ose 'jo' kësaj pyetjeje: 'A jeni të gatshëm ta refuzoni mundësinë e faljes së mëkateve për gjithë përjetësinë vetëm sepse mendoni se nuk keni nevojë për të?" Për gjysmë minute mbi gjithë atë turmë të madhe ra një heshtje e thellë. Papritur pashë mjekroshin e mbështetur fort pas murit, të zverdhej nga frika. Ai duhet të ketë menduar, "Pikërisht tani unë deklaroj se nuk jam rob i keq; por kur të vijë koha që të vdes dhe gjërat të bëhen vërtet serioze, do të isha shumë i lumtur po të më faleshin mëkatet. Jo, më mirë të mos rri pa falje për gjithë përjetësinë."

Po ju?

Nëse ndërgjegjja jonë nuk është plotësisht e mbytur, ne e dimë shumë mirë se nevoja jonë më e madhe është t'i kemi mëkatet të falura.

Pak vjet më parë, Bill Hejli dha një koncert në Esen. Ai është ndër muzikantët modernë që unë i quaj "rrotullues vithesh". Mijëra adoleshentë ishin mbledhur në "Grugahalle" për të dëgjuar atë dhe grupin e tij. Që nga kënga e parë, spektatorët u tërbuan. Ata, në kuptimin e vërtetë të fjalës, e bënë sallën copë-copë. Dëmet u vlerësuan në 60.000 marka. Më vonë një polic i ri më tha në mirëbesim, "Unë isha ulur mu në radhët e para dhe m'u desh të kapesha pas karriges që të mos bashkohesha me ta!"

Ndërsa po ecja nëpër qendrën e qytetit ditën pas shfaqjes, pikasa tre adoleshentë që dukeshin se kishin marrë pjesë në ngjarjet e natës së kaluar. Kështu shkova tek ata dhe u thashë, "Hej! Vë bast se ju djema ishit në shfaqjen e Bill Hejlit natën që shkoi." "Ashtu është, pastor." "Mirë," u përgjigja, "atëherë jemi në terren të njohur. Më thoni, ç'ju shtyu ta bënit sallën

copë-copë?" "E bëmë nga dëshpërimi pastor Bush," u përgjigj një prej tyre. "Nga dëshpërimi? Dëshpërim për çfarë?" "Nuk e dimë!"

Teologu dhe filozofi i madh danez, Soren Kierkegard, tregon se si kur ishte fëmijë ai shkonte në shëtitje me të atin. Ndonjëherë, i ati ndalonte dhe, duke parë mendu-eshëm nga i biri, thoshte, "Mor djalë, ti mban dëshpërim të fshehur brenda teje." Kur e lexova këtë, nuk mund të mos mendoja se si pastor qyteti për dyzet vjet, kam zbuluar se kjo është e vërtetë për çdo qenie njerëzore.

Po për ju? A jeni edhe ju tepër të munduar nga ndonjë dëshpërim i fshehur? Le t'jua them se nga vjen kjo. Le t'u hedhim një sy thellësive të shpirtit tuaj me anë të një ilustrimi të vogël.

Meqenëse famullia ime ndodhet në Luginën e Rurit, shpesh kam zbritur poshtë në miniera. Është një përvojë e jashtëzakonshme. Së pari të japin rroba dhe pajisje minatori dhe një helmetë për ta vënë në kokë; pastaj zbret në pus me shpejtësi rrufe në një ashensor, deri rreth nivelit të tetë. A mund të zbritet më poshtë? Ndoshta, por askush nuk e bën sepse nën të ka vetëm një gropë plot me baltë. Këtu mblidhet gjithë uji që ka kulluar nga pjesa tjetër e minierës. Vetëm një herë, që kur kam qenë në Esen, është këputur kablloja e ngritjes. Atë ditë ashensori ra drejt e mu në gropën me baltë. Ishte e tmerrshme.

Gropa dhe ujërat e saj tërë baltë, më sjellin ndër mend njeriun. Të gjithë e dinë se ka disa "nivele" në jetën tonë. Nga jashtë ne mund të dukemi shumë gazmorë, ndërsa nga brenda gjërat janë krejt të kundërta. Ne mund të kemi një buzëqeshje të këndshme në fytyrë e prapë të jemi me zemër të plagosur. Ndonjëherë duket sikur e konsiderojmë jetën si një shaka të madhe, por në realitet dëshpërimi i errët fshihet thellë poshtë

në skutat më të brendshme të zemrës sonë.

Mjekët, filozofët, dhe psikiatrit që të gjithë e njohin këtë fakt. Kjo është tema e shumë librave dhe romaneve. Është shqetësuese të shohësh mënyrën se si dëshpërimi ose shqetësimi dalin hapur nganjëherë. Një psikiatër më tha një ditë, "Nuk mund ta imagjinosh numrin e të rinjve që vijnë tek unë për mjekim." Megjithatë, shumica e njerëzve, as nuk përpiqen të gjejnë shkakun e dëshpërimit apo shqetësimit të tyre. Ata thjesht përpiqen ta heqin qafe atë duke u dehur ose duke marrë drogë. A nuk është më e arsyeshme ti përballosh faktet?

Shumica e njerëzve mendojnë se dëshpërimi me rrënjë të thella i zemrës njerëzore u zbulua vetëm në këtë shekull. Por, çuditërisht, shkrimtarët e Biblës dinin për të që para më shumë se dy mijë vjetësh. Bibla flet për një "shpirt të ligështuar". Ajo na tregon gjithashtu shkakun e rrënjosur të dëshpërimit tonë: që nga Rënia, ne jemi larguar nga Perëndia, nga ambienti ynë, dhe kemi frikë ditën kur do të na duhet të dalim para tij. Për ta thënë akoma më ashpër, problemi ynë më i madh në jetë është faji ynë para Perëndisë. Kur përballemi me një problem të këtyre përmasave, e kuptojmë paaftësinë tonë për të gjetur vetë një rrugëdalje. Kështu dëshpërim i errët në thellësi të qenies sonë.

A kemi nevojë të na falen mëkatet? Patjetër që po! Ne kemi nevojë për falje më shumë se për çdo gjë tjetër.

Mëkat - çfarë është ai? Mëkat është çdo gjë që na ndan nga Perëndia. Ne jemi lindur mëkatarë. Një fëmijë i lindur në Angli gjatë luftës, për shembull, nuk kishte asgjë kundër ne gjermanëve. Por sidoqoftë ai ishte në kampin armik. Në të njëjtën mënyrë, duke qenë të lindur në botë, në kampin armik me Perëndinë, ne jemi të ndarë nga Perëndia pikërisht nga natyra jonë. Ndërsa jeta vazhdon, muri i fajit tonë bëhet gjithnjë e më i lartë, dhe ne largohemi gjithnjë e më tepër nga

Perëndia. Çdo shkelje e njërit prej urdhërimeve të tij është si një tullë që ne i shtojmë këtij muri. Mëkati është një realitet i tmerrshëm.

Do të doja t'ju tregoja se si u bëra për herë të parë i dijshëm për realitetin e tmerrshëm të mëkatit dhe për pandryshueshmërinë e tij. Unë kisha një baba të shquar. Ne kishim një marrëdhënie të mrekullueshme. Një ditë i isha shtruar mirë punës në një nga papafingot e shtëpisë sonë duke studiuar për një provim, kur dëgjova një zë që po më thërriste nga poshtë: "Vilhelm!" U zgjata nga dritarja dhe pashë se po më thërriste im at. "Ç'ka ngjarë?" e pyeta. "Ka marrë zjarr shtëpia apo çfarë?" "Unë po shkoj në qytet," u përgjigj. "A ke dëshirë të vish me mua? Ka më shumë lezet të shkosh në shoqëri me dikë." "Por o babi," iu përgjigja, "sapo po kaloj një pikë të rëndësishme të provimit. Kohë më të papërshtatshme se sot nuk mund të ketë!" "S'ka gjë! Po shkoj vetëm."

Dy javë më vonë ai vdiq.

Është traditë në vendin tonë që bijtë e të vdekurit bëjnë rojë me radhë mbi kufomën. Nata ishte e qetë. Të gjithë flinin. Unë rrija ulur vetëm pranë arkivolit të hapur. Papritur m'u kujtua ftesa e atit tim dy javë më parë për të shkuar me të në qytet dhe se si unë e kisha refuzuar. Shikova nga ai dhe thirra me zë të lartë, "Oh babi! Më thuaj përsëri. Do të bëj njëqind kilometra me ty po të duash."

Nuk pati asnjë përgjigje. Goja e tij qëndroi e mbyllur. Kuptova se mungesa e dashamirësisë sime ishte një realitet i tmerrshëm që nuk do të ndryshonte kurrë, edhe sikur ta kisha gjithë përjetësinë para meje.

A keni menduar për numrin e herëve që keni dështuar në planet tuaja? Si mund të jetojmë me një barrë të tillë? Ne nuk mund t'i bëjmë ballë jetës nëse nuk na janë falur mëkatet.

Dhe si mund ta përballojmë vdekjen? Mos doni t'i merrni gabimet dhe dështimet tuaja me vete në përjetësi?

Shpesh përpiqem të imagjinoj çastet e mia të fundit. Është tepër normale në moshën time. Unë mund ta shoh veten duke mbajtur dorën e një të dashuri. Pastaj vjen momenti që unë ta lëshoj atë; dhe varka ime largohet duke shkarë nëpër heshtjen e madhe derisa vjen në praninë e Perëndisë.

Po, pa hije dyshimi, ju do të dilni para Perëndisë një ditë. Me gjithë gabimet tuaja, me gjithë dështimet tuaja, do të viheni përballë Perëndisë të gjallë dhe të shenjtë. Dhe do t'ju ngrijë gjaku kur të shikoni pirgun tepër të madh të gabi-meve dhe të dështimeve që ju kanë ndjekur pas.

A kemi nevojë të na falen mëkatet? Ne kemi nevojë për falje më shumë se për çdo gjë tjetër, madje më shumë se për bukën tonë të përditshme.

2. Ku mund ta gjej?

Sapo ju tregova se çfarë ndodhi midis atit tim dhe meje. Nuk do të ketë kurrë mundësi për mua që të kthehem te gabimi im. Është e pamundur për ne që ta zhbëjmë djallëzinë që kemi bërë, dhe efektet e saj mbeten në sytë e Perëndisë. Fatura për t'u paguar është dërguar.

Një njeri i quajtur Juda e tradhtoi të zotin për tridhjetë monedha argjendi. Por pothuajse menjëherë pas kësaj, atë e brejti ndërgjegjja. Kështu ai u kthye te grupi i njerëzve që u kishte shitur të zotin dhe tha, "Unë kam bërë një gabim të madh! Na, merrini përsëri paratë. Unë dua t'i vë përsëri gjërat në vend." Duke mbledhur supet ata iu përgjigjën, "Ç'na duhen neve? Kjo është puna jote." Ju mund të flisni me kë të doni; ata do t'ju përgjigjen në mënyrë të pandryshueshme, "Kjo është puna jote."

A është e mundur, pavarësisht nga kjo, t'i kemi gabimet

dhe dështimet tona të pastruara, t'i vëmë gjërat në rregull me Perëndinë? Ku mund të marrim faljen e mëkateve? Cila është mënyra e duhur për ta gjetur atë?

Këtyre pyetjeve shkruesit e Biblës i japin një përgjigje unanime, të ngrohtë dhe të gëzueshme. Që nga libri i Zanafillës deri në librin e Zbulesës, në Dhiatën e Vjetër ashtu si në të Renë, e njëjta temë vazhdon të dalë në mënyrë të përsëritur: mëkatet tona mund të falen!

Por ku? Më ndiqni mua përmes portave të Jeruzalemit dhe deri në kodrën e quajtur Kalvar. Mos i kushtoni rëndësi turmës që është mbledhur aty dhe as dy kriminelëve të varur në kryqet në të majtë dhe në të djathtë. Le t'ia kushtojmë gjithë vëmendjen tonë njeriut të gozhduar në kryqin e mesit. Kush është ai? Duket qartë që ai nuk është si ne. Një ditë ai qëndroi para një turme dhe i sfidoi ata për ta fajësuar atë për mëkat. As edhe një person nuk e pranoi sfidën. Ata nuk mund të gjenin asnjë gabim tek ai. Më vonë ai u hodh në gjyq dhe u pyet nga autoritetet romake dhe nga udhëheqësit fetarë judenj. Ata nuk mund të gjenin asnjë arsye për ta dënuar atë. Jo, ai nuk ishte si ne. Ai nuk ka nevojë për falje sepse nuk ka mëkatuar kurrë. E megjithatë është ai që është i varur atje në kryq!

Përse?

Perëndia është i drejtë. Ai nuk mund ta lërë mëkatin pa e ndëshkuar. Kështu ai e hodhi mëkatin tonë mbi Jezusin, Birin e tij, dhe Biri i tij u ndëshkua në vendin tonë. ***Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar.*** Ky është thelbi i mesazhit të Biblës. Gjykimi i Perëndisë ra mbi Jezusin që ne të mund të gjenim paqe. Ja se ku mund të marrim falje të mëkateve.

Ku mund ta heq qafe barrën e gabimeve dhe dështimeve të mia? Ku mund të bëj paqe me Perëndinë? Në këmbë të kryqit të Jezusit. ***Gjaku i Jezu... Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat***. Përfitofshim të gjithë nga kjo!

Një amerikan me emrin Uilliam L. Hall botoi një libër tepër interesant. Ai ishte emëruar kapelan për Adolf Aihmanin, njeriun përgjegjës për masakrën ndaj milionë judenjve. Halli e vizitoi Aihmanin trembëdhjetë herë gjatë kohës së burgimit, dhe bëri biseda të gjata me të, dëgjoi fjalët e tij të fundit, e shoqëroi atë deri te trekëmbëshi dhe ishte i pranishëm kur hiri i trupit të tij u shpërnda mbi detin Mesdhe.

Reverend[1] Holli e botoi përmbajtjen e bisedave të tij me Aihmanin në një vepër të titulluar, *Beteja për një Shpirt.* Ai shkroi në fillim të librit të tij: "Synimi im ishte ta shpëtoja këtë mëkatar të neveritshëm nga vajtja në ferr." Dhe ne mësojmë me indinjatë se ky njeri që vrau me milionë njerëz që nga tavolina e tij dhe që e zhyti botën në një vuajtje të patreguar guxoi të thotë pikërisht deri në momentin që dha frymën e fundit, "Nuk kam nevojë për dikë që të vdesë për mua. Nuk kam nevojë për faljen e mëkateve, dhe as nuk e dua këtë."

Mos doni të ndiqni shembullin e Adolf Aihmanit dhe të vdisni siç vdiq ai? Jo? Epo, nëse nuk doni, më mirë kthehuni te Jezusi me gjithë zemër. Jezusi, Biri i Perëndisë, është i vetmi njeri në botë që mund t'i falë mëkatet sepse ai vdiq për t'i shlyer ato.

Gjatë bisedave me Aihmanin, reverend Halli pothuajse kishte frikë t'i ofronte falje të mëkateve nëpërmjet gjakut të Jezusit një njeriu si ai. A ishte e mundur që një kriminel kaq i madh të mund të falej? Po! Pa tjetër! ***Gjaku i Jezu... Birit të tij, na pastron nga ÇDO mëkat***." Por për të marrë falje mua

[1] Reverend: titull nderi për një prift a pastor.

më duhet t'i rrëfej mëkatet e mia dhe t'i them Perëndisë, me sytë të fiksuar në kryq:

Unë besoj, unë besoj
Se Jezusi vdiq për mua;
Dhe nga gjaku i tij,
Gjaku i tij i çmuar,
Nga mëkati do jem çliruar.

Bibla përdor ilustrime të ndryshme për të na ndihmuar të kuptojmë lidhjen midis vdekjes dhe ringjalljes së Jezu Krishtit dhe faljes së mëkateve tona (sepse, siç ndoshta e dini, Jezusi nuk qëndroi në varr por u ngrit ditën e tretë dhe sot jeton).

Një shembull që përdor Bibla është ajo e një *dorëzënësi.* Dorëzënës është një person që bëhet përgjegjës për borxhet e një personi tjetër. Ai premton të paguajë borxhin për atë person nëse ai nuk është në gjendje ta paguajë vetë. Dikush duhet të paguajë. Gjithmonë kështu është në jetë. Ja që, sa herë që mëkatoj, unë futem në borxh me Perëndinë. Bibla thotë: ***Paga e mëkatit është vdekja.*** Kjo do të thotë që Perëndia kërkon vdekjen tonë si pagesë për mëkatin tonë. Por ja ku ndërhyri Jezusi dhe vdiq për mëkatet tona për të na shpëtuar nga vdekja e përjetshme. Jezusi bëhet garant për ne para Perëndisë. Tani ju takon juve të zgjidhni: ose të paguani borxhin tuaj dhe të shkoni në ferr, ose të ktheheni te Jezusi dhe t'i thoni, "Zoti Jezus, dua të besoj se ti e pagove borxhin tim. Faleminderit."

Kjo na çon në ilustrimin e dytë të përdorur në Bibël: *shpërblesë për lirim.* Supozojmë se një njeri bie në duart e një tregtari skllevërish. Ai nuk mund ta shpengojë veten. Atëherë një njeri plot dhembshuri kalon aty dhe shkon te pronari i tij duke i thënë, "Sa do për këtë skllav? Do ta blej

atë për t'i dhënë lirinë." Kur i kthehet përsëri liria skllavit? Pikërisht në çastin kur paguhet qindarka e fundit! Në Kalvar, Zoti Jezus pagoi çmimin e shpengimit tonë deri në qindarkën e fundit. Besojeni këtë, dhe shpalleni si tuajën lirinë që ai ka blerë për ju. Jezusi shpengon, Jezusi çliron skllevërit nga mëkati!

Kjo nuk është e gjitha.

Një imazh tjetër që shfaqet shpesh në Bibël është ai i *pajtimit.* Edhe pagani më i pandriçuar e di që ai ka nevojë për pajtim. Prandaj në pothuajse të gjitha fetë ka priftërinj që kërkojnë të bëjnë paqe me perënditë me anë të flijimeve pajtuese. Por Perëndia i Plotfuqishëm pranon vetëm një flijim: flijimin nga ***Qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës***. Qindra priftërinj kanë ofruar flijime të panumërta. Por Jezusi është kryeprifti i madh që na pajton ne me Perëndinë. Ai është, për më tepër, flijimi shlyes për mëkatet tona. Kështu, vetëm ai, mund të rivendosë paqe midis nesh dhe Perëndisë.

Një figurë tjetër biblike e përdorur është ajo e *pastrimit.* Një i krisherë u shkroi vëllezërve të tij: ***Perëndia... na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e tij***. Ndoshta e dini historinë e djalit plangprishës i cili më në fund përfundoi në mes të derrave. Të shumtë janë ata - për fat të keq! - që kanë ndjekur gjurmët e tij. Por erdhi dita kur djali plangprishës e mblodhi veten. Ai i ktheu hapat në drejtim të shtëpisë, pastaj u hodh në krahët e të atit, tamam ashtu siç ishte. Ai nuk filloi duke bërë një dush të mirë ose duke blerë një palë rroba të reja dhe një palë këpucë. Jo, ai shkoi në shtëpi ashtu siç ishte. Dhe ishte i ati që u kujdes për ta pastruar dhe për ta veshur si duhet.

Shumë njerëz besojnë se duhet të përmirësohen më parë para se të bëhen të krishterë. Ky është një gabim i tmerrshëm. Ne mund të vijmë te Jezusi pikërisht ashtu siç jemi, të ndyrë

dhe të neveritshëm. Ai është i gatshëm të na pranojë me të gjitha gjërat që e kanë ndotur jetën tonë. Ai vetë do të na lajë dhe do të na bëjë të pastër. Ai i bën të gjitha gjërat të reja. ***Gjaku i Jezu... Birit të tij na pastron nga çdo mëkat.*** Kjo ishte dëshmia e apostullit Gjon dhe ajo mund të bëhet edhe juaja.

Nuk mund t'u referohem gjithë atyre imazheve që dalin në Bibël. Megjithatë, shpresoj se do t'i përvisheni punës për ta lexuar Biblën vetë. Dhe ndërsa e bëni këtë, do të zbuloni më plotësisht, mesazhin e saj të mrekullueshëm të faljes.

Si mund ta gëzojmë jetën nëse fajet dhe dështimet tona na rëndojnë? Nuk mundemi! Por çdo gjë ndryshon kur ne gjejmë Jezusin, kur nëpërmjet tij arrijmë të përjetojmë gëzimin e të paturit të mëkateve tona të falura. Kanë ikur frikërat tona, dëshpërimi ynë i thellë!

Dorzimi i jetës sonë Jezusit nuk është një çështje e trishtuar dhe solemne. Krejt e kundërta. Është të kalosh nga errësira e ankthit në dritën e diellit të hirit.

3. Si mund ta përvetësoj faljen?

Ju mund të mendoni në këtë fazë: "Duhet të jetë e mrekullueshme të dish se mëkatet e dikujt janë falur. Por si mund ta arrij unë këtë falje? Asnjë gazetë nuk ka shkruar asnjë rresht për këtë. Romanet moderne nuk e trajtojnë këtë temë dhe nuk di asnjë film të vetëm që të më tregojë ndonjë gjë."

Si mund ta marr faljen? Kjo është çështje me rëndësi!

Mua më duket se gjëja më e mirë për të bërë ju është që të gjeni një vend të qetë dhe t'i thërrisni Zotit për ndihmë - pikërisht tani. Ai është ngritur dhe ai jeton. Njerëzit që "besojnë" përshkruhen në Bibël si "ata që i thërrasin Zotit".

Pse të mos i thërrisni vetë atij?

Ka një linjë direkte që ju lidh me Jezusin. Ndoshta nuk e keni përdorur atë kurrë më parë. Sa turp! Pse të mos e merrni tani? Nuk keni nevojë as të rrotulloni numrin! Vetëm thoni: "Zoti Jezus", dhe do ta keni direkt në linjë! Lidhja me të do të jetë e menjëhershme. Ja se për se është lutja.

Por çfarë do t'i thoni atij? Çdo gjë që ju shqetëson. Mund të thoni, për shembull: "Zoti Jezus, kam një marrëdhënie dashurie dhe ja që nuk mund ta prish. Por e di që është gabim. Zot, më ndihmo." Ose: "Zoti Jezus, gjërat nuk janë të ndershme në biznesin tim. Për vite me radhë i kam vërtitur statistikat e taksave. Nëse do të përpiqem t'i rregulloj gjërat mund të falimentoj. Zot, më ndihmo." Ose ndoshta këtë: "Zoti Jezus, nuk jam besnik ndaj gruas sime. Nuk mund të dal nga pështjellimi ku ndodhem. Zot, më ndihmo." E dini, në këtë linjë private ju mund të ndani me Zotin Jezus gjërat që nuk do të guxonit kurrë t'ia tregonit dikujt tjetër. Ai ju dëgjon. Zbrazjani zemrën atij. Rrëfeni të gjitha gabimet tuaja. Kjo do t'ju lirojë.

Pastaj i thoni atij: "Zoti Jezus, pastor Bushi deklaron se për shkak të gjakut tënd çdo gjë do të dalë mirë. Është e vërtetë kjo?" Pyeteni. Mund të flisni me të për orë të tëra po të doni. Ai do t'ju dëgjojë.

"Mirë," mund të thoni ju, "por kur t'i kem treguar çdo gjë atij, ai ndoshta as nuk do të më përgjigjet." Po, do të përgjigjet! Dëgjoni me kujdes. Do t'ju tregoj se në ç'linjë mund ta dëgjoni atë të flasë. Merrni një Dhiatë të Re. Lëreni mënjanë Dhiatën e Vjetër për momentin, sepse është shumë vështirë për të filluar me të. Hapeni Dhiatën e Re tek Ungjilli i Gjonit dhe filloni të lexoni. Më pas provoni Ungjillin e Lukës. Lexojini ata siç do të lexonit një artikull gazete. Dhe nuk do të zgjasë shumë para se ta vini re se Jezusi flet gjatë tërë tekstit. Ja se çfarë e bën Biblën të ndryshme nga të gjithë

librat e tjerë. Ajo është linja që përdor Zoti për të folur me ne.

Dikush më tha një herë, "Kur dua ta dëgjoj Perëndinë që flet, unë bëj një shëtitje në pyll." "Kjo është qesharake," u përgjigja. "Kur jam në pyll, unë dëgjoj gjethet që fëshfërijnë, zogjtë që këndojnë, dhe ujërat që gurgullojnë. Dhe është vetë gëzimi. Por pylli nuk mund të më thotë kurrë nëse më janë falur apo jo mëkatet. Dhe as nuk mund të më tregojë se si mund të më bëhet zemra e re dhe se si mund ta gjej hirin e Perëndisë. Perëndia na e ka zbuluar gjithë këtë vetëm në Bibël."

Provoni të lini mënjanë pesëmbëdhjetë minuta çdo ditë për të mediturar dhe për t'u lutur. Thërrisni Jezusin dhe tregojini atij absolutisht çdo gjë: "Zot ti e sheh se sa shumë kam për të bërë sot që kurrë nuk do t'ia dal mbanë vetë." Mund të ndani çdo gjë me Jezusin. Pastaj, merrni Dhiatën e Re dhe lexoni një gjysmë kapitulli, duke u lutur gjithnjë: "Zoti Jezus, folmë tani." Dhe papritur do të vini te një fjalë nga Perëndia që është tamam për ju. Do të thoni me veten tuaj, "Ai po ma thotë mua atë!" Nënvizojeni pjesën, dhe po të doni, shkruani datën anash.

Kur isha i ri, një ditë isha për vizitë në një familje. Mbi piano ndodhej një Bibël. Duke shfle-tuar nëpër të, vura re se shumë pjesë ishin nënvi-zuar ose me jeshile ose me të kuqe. Datat ishin shënuar anash. Meqë ajo familje ishte e madhe unë pyeta se e kujt ishte ajo Bibël. "Është Bibla e Emit tonë," qe përgjigjja. E pashë Emin më nga afër - dhe u martova me të! Ajo ishte pikërisht ajo lloj vajze që doja unë: një vajzë e cila e kuptonte që Jezusi na flet në këtë linjë dhe në asnjë tjetër.

Shërbeva për pak kohë si telegrafist gjatë Luftës së Parë Botërore. Në atë kohë komunikimet me radio nuk njiheshin. Instrumentet tona ishin të vogla dhe ne na duhej t'u lidhnim

tela. Një ditë m'u desh të shkoja në një vend vrojtimi që ndodhej mbi një kodër. Atje nuk ishte ndërtuar asnjë strehim. Kështu m'u desh të shtrihesha mbi bar. Ndërsa po përpiqesha të lidhesha me trupat tona, papritur pashë një ushtar të plagosur lehtë që u duk në majë të kodrës. I ulërita. "Hej, ti atje! Ulu poshtë! Na kanë diktuar. Nuk do të zgjasë shumë para se të na bombardojnë." Ai u hodh për tokë, u zvarrit deri tek unë dhe tha, "Do të më japin leje me këtë plumb që kam marrë. Do të kem mundësi të kthehem në shtëpi. Dëgjo, pajisja jote është shumë e vjetër." "Po," i thashë me zë të ulët, "është model i vjetër." "Kapëset janë liruar." "Po kapëset janë liruar." "Dhe shiko, këtu mungon një pjesë." Më hipi inati dhe i thashë, "Pa qepe gojën! Nuk kam kohë të dëgjoj komentet e tua. Më duhet të përqëndrohem për të hyrë në lidhje me shtabin."

E njëjta gjë ndodh edhe me Biblën. Unë vetë dua të dëgjoj zërin e Jezusit. Por kur të tjerët vijnë dhe më thonë, "Bibla është thjesht një libër i shkruar nga njerëzit", dhe vërejtje të tjera të tilla prej budallai, unë vetëm mund të përgjigjem, "Qepe! Unë dëgjoj zërin e Jezusit në Bibël."

A e shihni se ku po dal? Mos i lini t'ju futin në rrugë të gabuar. Jezusi na flet vetëm në një linjë - Biblën.

Ju gjithashtu duhet të hyni në lidhje edhe me njerëz të tjerë që studiojnë Biblën. Kur unë u përmend njerëzve gjëra të tilla, ata gjithmonë përgjigjen, "E gjitha kjo është tepër jashtë mode. Vetëm pleqtë shkojnë në kishë sot." Kam punuar me të rinjtë për mbi tridhjetë vjet, dhe kam takuar grumbuj të panumërt të rinjsh që mund të dëshmojnë se falja e mëkateve është një realitet, se ne mund t'i flasim Jezusit dhe ai na përgjigjet.

Kërkoni miqësinë e atyre burrave dhe grave që i kanë përjetuar këto gjëra. Po, është vërtet e mundur të gjesh njerëz që duan të udhëtojnë në rrugën që të çon në qiell.

Jezusi po qëndron sot para jush dhe po ju thotë: "Ejani tek unë, të gjithë ju që jeni të lodhur dhe të ngarkuar, të rënduar nga fajet dhe dështimet tuaja, dhe do t'ju jap prehje për shpirtrat tuaj. Po, unë mund t'i fal mëkatet tuaja."

"SI MUND TA GËAZOJË JETËN – KUR NJERZIT E TJERË MË NERVIKOSIN!"

Ne të gjithë vëmë re se njerëzit e tjerë na ngrejnë nervat apo jo? Është pjesë e pandarë e jetës së përditshme. Rrallë kalon ndonjë ditë pa dikë që të na mërzitë dhe të na acarojë. Por është njëlloj edhe për të tjerët - edhe *ne* u ngrejmë nervat *atyre*! Të gjithë mërzitin gjithë të tjerët. Epo, pothuajse të gjithë! Gruaja ime, për shembull, nuk më acaron kurrë. Por ka disa njerëz që ma sjellin vërtet në majë të hundës. A nuk vini re dhe ju të njëjtën gjë? Sigurisht që po!

Kjo mënyrë e të shikuarit të të tjerëve është shkaku rrënjësor i fërkimeve të vazhdueshme në familjet tona, në fqinjësitë tona, në bizneset dhe punët tona - dhe madje edhe në kishat tona. E gjithë bota vuan nga sindromi "ti-m'i-ngre-nervat".

Shumë njerëz mendojnë, "Do ta shijoja jetën sikur Filani të mos ishte këtu!" Filani për ta është një halë në sy. Ai është objekti i tyre i veçantë i neverisë.

Kështu duket se është tamam koha që të merreshim me pyetjen: Si mund t'i ndalojmë njerëzit që të mos na ngrejnë nervat?

Kjo në fakt është pjesë e një problemi më të madh. Është pak a shumë si në rastin kur kollitet dikush. Ai mund të vuajë nga një infeksion serioz i mushkërive. Në qoftë kështu, karamelet për kollë nuk do t'i vlejnë. Ajo që ka nevojë i sëmuri është një kontroll rrënjësor dhe kurimi i duhur. E shihni se ku po dal? Fakti që ne i ngrejmë nervat njëri-tjetrit është vetëm një simptomë e një sëmundjeje më serioze nga e cila po vuan bota. Kështu arsyet shkojnë më thellë se, le të themi, karakteri i papëlqyeshëm i fqiut tonë!

Shkaku i vërtetë është një sëmundje që prek gjithë botën.

1. Bota ku jetojmë

Unë i jam mirënjohës Biblës për pikëpamjen time për botën. Sipas mendjes sime, trajtimi që i bën Bibla është e vetmja e vlefshme. Shumica e filozofive dalin jashtë mode brenda njëzet vjetësh.

Bibla thotë se në fillim, kur Perëndia e krijoi botën, ajo ishte e përsosur. Adami nuk ia ngrinte nervat Evës dhe as Eva Adamit. Mes tyre kishte harmoni të përsosur - harmoni të përsosur edhe midis njerëzimit dhe Perëndisë. Ishin të gjithë një: Perëndi dhe njerëzim; burrë e grua. Nuk ekzistonte as e meta më e vogël në marrëdhëniet e tyre.

Por, sipas tregimit biblik, ndodhi një katastrofë pikërisht në fillim të historisë së njerëzimit: Rënia. Njeriu u vu në provë. Nuk mendohej që ai të hante frutën e një peme të caktuar. Perëndia ia kishte ndaluar ta bënte këtë. Por ajo qenkësh tepër tunduese! Kështu, me vullnetin e tij të lirë ai zgjodhi të mos bindej. Adami hëngri frutën e ndaluar; dhe si rezultat i rënies së tij, u hap një e çarë e madhe.

Nga njëra anë, marrëdhënia e tij me Perëndinë u prish. Perëndia e përzuri njeriun nga Kopshti i Edenit dhe vuri dy engjëj që ta ruanin hyrjen. Që nga ai moment, daton ndarja jonë nga Perëndia. Qysh atëherë ne e acarojmë Perëndinë dhe ai na acaron ne. Për ta demonstruar këtë, ju duhet vetëm t'u flisni njerëzve për Perëndinë. Ata menjëherë nxehen dhe fillojnë të bërtasin me të madhe, "Ou mjaft me këto! Ne as nuk e dimë nëse ekziston Perëndia!" Midis nesh dhe Perëndisë ka një hendek të madh.

Nga ana tjetër, u prishën gjithashtu marrëdhëniet njerëzore. Vetëm të shikoni fëmijët e Adamit dhe Evës për të parë se edhe qysh atëherë njerëzit kishin filluar t'i ngrinin nervat njëri-tjetrit. Ishin dy vëllezër. Marrëdhëniet midis vëllezërve, siç e dimë të gjithë, shpesh janë të tendosura.

Këta dy vëllezër, Kaini dhe Abeli, ishim shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Një ditë, Kaini, që ishte bujk, po punonte në arë me shat. Ai pa të vëllanë, Abelin, duke kaluar aty afër. Nuk kam asnjë problem për ta imagjinuar reagimin e tij: "Shpresoj të mos sorollatet këtej. S'e shoh dot me sy!" Por Abeli erdhi tek ai dhe i tha disa fjalë. Papritur Kaini rrëmbeu shatin dhe filloi të qëllojë në fytyrën që e urrente, duke e goditur pa ndërprerje deri sa më në fund Abeli mbeti i shtrirë, para këmbëve të tij, i vdekur.

Ne jemi njerëz të qytetëruar; ne nuk e vrasim njëri-tjetrin me shat! Por në qoftë se lexoni gazetat, e dini se gjëra të tilla akoma ndodhin herë pas here. Kur mendoj përsëri për gjyqet e kriminelëve nazistë të luftës, nuk mund të mos them me vete, "Ata kishin tamam të njëjtin mentalitet me atë të Kainit; ishin plot urrejtje për të tjerët." Ishte në emër të kësaj urrejtjeje që ata masakruan qindra e mijëra burra, gra e fëmijë.

Ne qeniet njerëzore dukemi se mendojmë se nëse askush nuk e pa, asgjë nuk ndodhi! Sa prej nesh na faniten kujtimet e veprave të kobshme që nuk i pa askush!

Kaini u arratis. Ai ishte i shqetësuar. Papritur ai dëgjoi një zë që thirri: "Kain!" Kush mund të ishte? "Kain!" përsëriti zëri. Një valë e ftohtë frike i kaloi nëpër trup. I vetëtiu në mendje se ishte Perëndia që i kishte thirrur emrin. Perëndia paskësh qenë aty gjithë kohën! Perëndia paskësh qenë dëshmitar i të gjithë asaj që ndodhi dhe nuk paskësh thënë asnjë fjalë! "Kain!" u dëgjua përsëri zëri. "Ku është vëllai yt Abeli?" Për t'u mbrojtur Kaini u përgjigj, "Mos jam unë dadoja e vëllait tim! Askush nuk më ka thënë ndonjëherë që të kujdesem për të." Por Perëndia u përgjigj, "Kain, gjaku i vëllait tënd Abelit më thërret nga toka."

Kjo histori është një shembull i përsosur i çarjes që u hap

me Rënien. Marrëdhëniet njerëzore nuk kanë qenë njëlloj qysh atëherë: diçka u prish. Ne e mërzitim njëri-tjetrin. Por çarja gjithashtu preku marrëdhëniet e njeriut me Perëndinë. Perëndia e mërziti Kainin - dhe ai i mërzit edhe disa nga ju. Problemi është, ne nuk mund t'i heqim qafe të tjerët. Dhe as Perëndinë!

Kjo është bota ku jetojmë.

2. Fjalët nuk mund të ndihmojnë

Nuk ka dobi të flasësh për "Zotin e mirë". Midis nesh dhe Perëndisë ndodhet një mur, një hendek. Gjatë luftës, kur shtëpia ime dhe gjysma e qytetit të Esenit ishin në flakë, një grua u sul tek unë, duke ulëritur, "Si mund ta lejojë Perëndia yt gjithë këtë!" "Ndoshta sepse ai është armiku yt," iu përgjigja.

Qysh nga Rënia, marrëdhënia midis Perëndisë dhe njeriut është prishur. Duke u endur larg Perëndisë, as marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë nuk janë më njësoj. Kjo është arsyeja e thellë se përse njerëzit e tjerë na ngrejnë nervat. Në analizë të fundit, nëse fqiu yt të shqetëson, kjo ndodh për shkak të Rënies, sepse ne jemi njerëz të rënë, të ndarë nga Perëndia. Dhe këshilla më e mirë në botë nuk do të ndryshojë as edhe një gjë.

Një ditë rastesisht ndodhesha në kufirin zviceran. Varur në murin brenda sallonit të doganës ndodhej një afishe tërheqëse me këto fjalë: "Të jesh së bashku është më mirë". Mendova me vete, "Pa dyshim që është; por s'ka dobi kur dikush më ngre nervat." Lexova në një afishe tjetër: "Silluni mirë me të tjerët". Amerikanët kanë ngjitur etiketa në çdo qoshe rruge të qyteteve tona me parrullën, "Vazhdoni të buzëqeshni". Por asgjë nuk ndryshon, pavarësisht nga e gjithë kjo.

Mbaj mend një familje që e vizitoja shpesh kur isha

student në Fakultetin e Teologjisë. Në këtë familjë nuk kishte fare unitet. Të gjithë jetonin në të njëjtin fshat, por mes tyre kishte patur shumë grindje dhe mëri. Me optimizmin tim si student që studioja për t'u bërë pastor, e kisha mbledhur gjithë familjen së bashku një mbrëmje me qëllimin e lavdërueshëm për t'i pajtuar me njëri-tjetrin. M'u ça koka së foluri.... Nga ora njëmbëdhjetë e kisha vënë çdo gjë në rregull, dhe ata të gjithë i shtrënguan dorën njëri-tjetrit. I gëzuar jashtë mase, 'i rraha krahët vetes': "Do të bëhesh një pastor i mirë. Po e nis me një start të fuqishëm!" Kështu shkova në shtëpi i lumtur dhe fjeta qetësisht. Mëngjesin tjetër rastesisht takoj një nga gratë e reja të familjes. I thashë, "Ishte e mrekullueshme të shikoje mënyrën se si u zgjidhën gjërat natën e kaluar, apo jo?" "E mrekullueshme?" pyeti ajo. "Nuk e ditke se çfarë ndodhi më pas?" "Jo.... Çfarë?" pyeta duke u zbehur në fytyrë.

Gjatë rrugës për në shtëpi, me sa dukej, kishte nisur përsëri grindja. Dhe gjërat qenkëshin më keq se kurrë më parë! Ju mendoni se kjo është për të qeshur? Epo, për mua nuk ishte për të qeshur. Atë ditë u bëra thellësisht i dijshëm për realitetin brutal të Rënies; marrëdhënia jonë me Perëndinë dhe me njerëzit e tjerë është prishur.

Njerëzit shumë shpesh më shkruajnë, duke thënë: "I dashur Reverend Bush: Në këtë apo atë vend, kam të afërm që nuk shkojnë mirë me njëri-tjetrin. A mund të shkoni për një vizitë tek ata?" Unë gjithmonë refuzoj sepse e di se sa e padobishme është të këshillosh të tjerët. Vetëm mendoni për një çast për të gjithë njerëzit që ju acarojnë. Mund t'ju thosha se çfarë duhet të bënit por është absolutisht pa kuptim. Është tragjike.

Le ta ilustroj këtë.

Supozojmë se po bëj një vizitë në një familje. Dhe pastaj

hyn brenda djali i tyre shtatëmbëdhjetë vjeçar. Ai është krejtësisht i çlirët, ka veshur xhinse të grisura dhe i ka flokët sipas modës së fundit. I ati - një punonjës civil i ndërgjegjshëm dhe i edukuar - papritur tërbohet dhe shpërthen, "Shikoje, vetëm shikoje!" Pamja e të birit të tij që s'vlen për asgjë e bën gjakun e të atit të ziejë.

Ose merrni rastin e një nëne, krishterë të mirë, me tendencën për t'u bërë strikte në devotshmëri. E bija guxon të lyejë buzët me të kuq, dhe e ëma thërret, "Oh, si m'i ngre nervat ajo vajzë!" Ndërkohë, e bija po mendon, "Po kur m'i ngre nëna nervat mua ndonjëherë!"

A nuk është kudo kështu?

Një ditë një burrë në procesin e shkurorëzimit, të cilit po i shpjegoja se divorci është mëkat ma ktheu me inat, "Pastor Bush, mjaft tani! Mënyra se si e ha supën gruaja ime mjafton për të më bërë që ta humb durimin."

Mos ju duket qesharake kjo? Mua jo. Kjo mua më tmerron. Ju mendoni se këto janë gjëra të vogla, të parëndësishme? Epo, nuk janë. Ato janë simptoma të botës së sëmurë, të rënë, rebeluese në të cilën ne jetojmë si burra dhe gra pa Perëndinë.

Zemërimi mund të marrë disa forma shumë serioze kohë më kohë. Njoh një vajzë të re në Esen që është krejtësisht e paralizuar me sklerozë të shumëfishtë. Ajo jeton në një shtëpi të vogël. Një derë më tutje jeton një i ri, egoist dhe mizor. Ai shikon televizion çdo mbrëmje dhe ia ngre shumë zërin. Çdo mbrëmje deri natën vonë vajza e sëmurë mund të dëgjojë çdo gjë nëpërmjet murit të hollë që ndan dy shtëpitë. Një ditë ajo iu lut atij t'ia ulëte pak zërin televizorit. Por ai bëri pikërisht të kundërtën: ia ngriti zërin në kulm. Dhe kështu, vit për vit, natë për natë, orë për orë, vajzës së shkretë i duhej ta durojë këtë situatë.

Ja se sa mizorë mund të bëhemi ne njerëzit.

Kur isha pastor i ri m'u desh të përgatisja 150 të rinj për pranim me të drejta të plota në kishë. Vendosa t'u bëj vizitë secilit në shtëpitë e tyre. Ata jetonin në shtëpi me qira të ulëta. Në shtëpinë e parë që vizitova, i gjeta duke u grindur. Në të dytën, po grindeshin. Në të tretën, nuk ishte aspak e ndryshme. Ca kohë më vonë i pyeta fëmijët në katekizëm[1] nëse ata që nuk kishin asnjë zënkë në shtëpi mund të ngriheshin në këmbë. Vetëm tre a katër u ngritën. "Mos do të thotë kjo se në të gjitha familjet e tjera ka grindje?" pyeta. "Po." Duke u kthyer nga fëmijët që ishin ngritur, i pyeta, "Si ndodh që nuk ka asnjë grindje në shtëpitë tuaja?" "Kjo ndodh sepse ne jetojmë vetëm," ishte përgjigjja e tyre.

Kjo është situata.

Dhe nga ne pritet që të jemi kurajozë, të gëzueshëm dhe punëtorë kur gjithë kohën jetojmë në një gjendje të përhershme tensioni nervor. Kur na bie diçka në këmbë, ajo na dhemb. Por kur njerëzit e tjerë na i ngrejnë nervat në mënyrë të vazhdueshme, është e padurueshme.

3. Perëndia ndërhyn!

Nëse kjo do të ishte gjithçka që do të duhej të thosha, atëherë do të kishte qenë më mirë të mos thosha asgjë. Por unë kam lajme të çuditshme, të pabesueshme për ju: në mes të gjithë këtij tensioni nervor, këtij acarimi reciprok, Perëndia me mëshirën e tij të madhe ndërhyn. Gjendja e trishtuar e botës nuk e lë Perëndinë indiferent. Jo! Edhe ai përfshihet.

Dhe ai e bën këtë në mënyrë të mrekullueshme. Ky është mesazhi i Biblës - një mesazh që të lë pa frymë. Perëndia e rrëzoi murin që na ndante prej tij, dhe erdhi te ne në personin

[1] Katekizëm: lloj mësimi me pyetje dhe përgjigje.

e Birit të tij, Jezusit. Burra e gra sot nuk e pranojnë mesazhin e Biblës sepse ata e ndiejnë atë si diçka që nuk ka lidhje me ta. Ky qëndrim vetëm tregon verbërinë e brezit tonë. Duke mos pranuar Jezusin ata refuzojnë shpresën e tyre të fundit.

Ç'fat i madh për njerëz si ne, në marrëdhënie të këqija edhe me Perëndinë edhe me njeriun, që Perëndia e shkatërroi murin që na ndante prej tij.

Ç'fat i madh për ne që Jezusi erdhi të sjellë një ndryshim rrënjësor në situatën tonë!

Por si mund ta bëjë ai atë?

a) Paqe me Perëndinë

Gjithë përsosmëritë janë kombinuar në personin e Jezusit. Nuk ka pasur kurrë ndonjë përçarje midis atij dhe Perëndisë. Ai është Biri i Perëndisë.

Një ditë dikush më tha, "Jezusi ishte vetëm një njeri si ne; ai ishte themeluesi i një feje, asgjë më tepër." Unë u përgjigja, "Ndoshta nuk po flasim për të njëjtin person. Unë po flas për atë që tha, ***Ju jeni nga këtu poshtë, kurse unë jam nga atje lart.***" Personi për të cilin po mendoj unë është Biri i Perëndisë të gjallë, I pashoqi, qenia e jashtëzakonshme që erdhi në botën tonë të shkretë, të humbur e të mallkuar.

Nuk ka patur kurrë ndonjë përçarje midis Perëndisë dhe Jezusit. Dhe askush nuk i ngriti nervat atij; madje as Juda. E megjithatë Juda e tradhtoi. Jezusi nga ana e tij e deshi Judën bash deri në fund. Unë dua që ju ta shihni Jezusin nga ky këndvështrim: si njeriun e vetëm, nervat e të cilit kurrë nuk u acaruan nga njerëzit e tjerë.

Merrni për shembull, tregimin e darkës së fundit, në prag të kryqëzimit të Jezusit. Në Lindje, siç e dini, në kohët biblike, njerëzit nuk uleshin në karrige; ata shtriheshin në jastëkë të mëdhenj rreth tavolinës. Se si dreqin ia arrinin të hanin ata në atë pozicion është jashtë konceptimit tim! Një

gjë për të cilën jam i sigurt, është se, është e pamundur të përdorësh thikë dhe pirun duke qenë i shtrirë. Por kjo ishte mënyra se si hanin ata.

Ishte gjithashtu zakon për këdo që para se të ulej të hiqte sandalet dhe të lante këmbët. Tani, atë ditë të veçantë, dishepujt kishin bërë një rrugë të gjatë me Jezusin. Krejt të kapitur, ata hoqën sandalet dhe u hodhën në jastëkët. Dhe unë mund ta imagjinoj mirë Pjetrin duke i hedhur një vështrim kuptimplotë Gjonit sikur t'i thoshte: "Epo, një prej nesh duhet të shkojë të marrë ca ujë dhe një sfungjer për të larë këmbët. Kësaj radhe mund ta bësh ti këtë. Në fund të fundit, ti je më i riu. Gjithmonë përpiqesh t'ia hedhësh lehtë, Gjon, dhe kjo gjë po fillon të më ngrejë nervat!" Por Gjoni vetëm mbledh supet dhe mendon me vete, "Ky Pjetri po më mërzit vërtet. Ai gjithmonë më zgjedh mua vetëm sepse jam më i riu. Pse s'mund të shkojë Jakobi për të sjellë ujë?" Ndërkohë Jakobi, në qoshen e tij, po mendon, "E pse unë? Unë jam një nga dishepujt më të preferuar të Mësuesit. Le të kujdeset Mateu për këtë gjë këtë radhë!" Dhe kështu, për shkak se secili po përpiqej t'i shmangej punës, ata po i ngrinin nervat njëri-tjetrit.

Pikërisht atëherë Jezusi u ngrit. Dishepujt u zbehën. "Nuk ka për ta bërë ai atë punë, apo jo?" Po, ai paska për ta bërë! Jezusi u kthye me një përparëse shërbëtori të lidhur rreth mesit, duke mbajtur një legen plot me ujë dhe një sfungjer, dhe filloi t'i lajë këmbët e dishepujve. Këmbët e Judës, të Pjetrit, të Gjonit, të Jakobit, të Mateut... (për pak desh shtova... dhe të miat!).

Sa e vërtetë është që gjithë përsosmëritë janë kombinuar në personin e Jezusit, Birit të Perëndisë. Në Të ishte Perëndia. Dhe ai i donte njerëzit e tjerë.

Por tani dua t'jua tregoj Jezusin në vendin ku kam më

shumë dëshirë ta shoh atë: në kryq. Le t'ju udhëheq jashtë portave të Jeruzalemit dhe sipër një kodre. Mbi atë kodër po bën zhurmë një turmë; ushtarë romakë, të armatosur me shtiza, bëjnë rojë; dhe janë ngritur tri kryqe. Njeriu për të cilin kam folur është gozhduar në kryqin e mesit, me një kurorë gjembash mbi vetull. Mos ia ndani sytë atij, sepse për ju po vuan ai. Ai po vdes që ju të mund të shpëtoheni nga mjerimi juaj dhe të pajtoheni me Perëndinë.

A do të dëshironit që pengesa që ndodhet midis jush dhe Perëndisë të hiqej? Atëherë ejani te kryqi i Jezusit. Ky Jezus, që vdiq dhe u ngrit përsëri për ju, u dërgua nga Perëndia si ambasadori i tij i paqes. Mos i lejoni dyshimet tuaja, sado të shumta që të jenë ato, t'ju pengojnë. Vendoseni besimin tuaj te Jezusi. Lëshojeni barrën e mëkateve tuaja para tij. Dhe i thoni: "Që tani e tutje, dua të të përkas ty."

Në qoftë se e bëni këtë hap, unë mund t'ju siguroj se Perëndia do t'ju falë dhuratën e paqes së tij.

Në letrën e tij për romakët, apostulli Pal deklaron: ***Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë***. Po, vërtet, Jezusi është ambasadori i paqes i Perëndisë. Pranojeni atë. Sa e tmerrshme të mendosh për gjithë ata burra e gra që kanë dëgjuar për Jezusin por e kanë refuzuar ofertën e tij të paqes. Mos e ndiqni shembullin e tyre. Ju përgjërohem: për dashurinë e shpirtit tuaj, i thoni "po" ofertës së paqes që ju ka bërë Perëndia nëpërmjet Jezusit.

Sot po flisja me disa gazetarë. Ata kishin arritur në atë pikë ku po pyesnin veten nëse kishte akoma ndonjë gjë në ditët tona që ia vlente t'i besoje. "Sinqerisht", ua thashë sy më sy, "meqenëse kam kaluar dy luftëra botërore dhe kam jetuar nën regjimin nazist, më duhet të pranoj se në të vërtetë nuk e di se ku mund të mbështetem më. Mendimtarët dhe politikanët tanë nuk i marrin seriozisht fjalimet e tyre të

zbukuruara - kështu pse duhet ta bëj unë? Jo, nuk e di se çfarë të besoj mbi këtë tokë... me përjashtim të ofertës së paqes që Perëndia më ofron nëpërmjet Jezu Krishtit."

Ne mund ta marrim seriozisht ofertën e Perëndisë. Është e vetmja gjë që është ende e sigurt. Ia vlen t'i kushtojmë kësaj çështjeje pak vëmendje.

Në qoftë se jeni një nga ata njerëzit e zhgënjyer që thonë, "Nuk mund t'i besosh më askujt", atëherë ungjilli është pikërisht ai që ju duhet. Sepse Perëndia, në Jezu Krishtin ju mori ju shumë seriozisht. Dhe tani ju takon ju ta merrni seriozisht ofertën e tij të paqes.

Jezusi rivendos kontaktin midis jush dhe Perëndisë. Ndoshta ju mund të kundërshtoni, "Por unë shkoj rregullisht në kishë. Unë vë para në pjatën e lëmoshës çdo të dielë!" Ç'e mirë është kjo për ty, të pyes, nëse nuk ke paqe me Perëndinë? Le të përsëris këtë: Jezusi vdiq për ty. Ai mori gjithë veprimet e tua të këqija mbi veten e tij në mënyrë që ti të mund të jesh në gjendje t'i hidhesh në këmbët e tij duke i thënë, "Zot unë vij te ti krejt i dijshëm se jam një mëkatar i shkretë dhe i humbur. Por unë bësoj në ty. Të pranoj si Shpëtimtarin tim."

Ja se si mund ta zotëroni jetën dhe të gjeni paqe me Perëndinë.

b) Paqe me të tjerët

Kur Jezusi futet në një jetë ai sjell paqe me Perëndinë dhe paqe me të tjerët. Ne pushojmë së ngrituri nervat e njeri-tjetrit.

Disa nga ju lexuesit mund të jenë të krishterë të mrekullueshëm. Por sa kohë që njerëzit e tjerë vazhdojnë t'ju ngrejnë nervat, ka diçka që nuk shkon me ju. Është e qartë kjo? Ndoshta ju do të thoni, "Po ku e njeh ti fqiun tim - ai

është poshtërsia vetë!" Dhe unë do të përgjigjesha, "Për sa kohë që ti nuk e do atë ka diçka që nuk shkon në jetën tënde. Sepse kur Jezusi ka hyrë në jetën tonë ne duhet të pushojmë së qeni kaq të ndjeshëm dhe që të acarohemi kaq shpejt nga ata që ndodhen përreth nesh."

Jezusi na ofron paqe me Perëndinë dhe paqe me personin që na ngre nervat. Kështu, nëse ju nuk mund t'i duroni njerëzit e caktuar, ju keni nevojë për Jezusin. Përveç tij, askush tjetër nuk mund t'ju ndihmojë. Në fund të fundit do t'ju shkatërrohen nervat nga gjithë këto tensione. Keni nevojë për Jezusin që t'ju japë paqe me Perëndinë. Atëherë, dhe vetëm atëherë, gjërat do të jenë në rregull me njerëzit e tjerë.

Kam një mik shumë të mirë që jeton me qira në një apartament të bukur. Megjithatë, pronari, nuk është nga ata që të shkosh mirë aq kollaj dhe është koprrac i vërtetë. Një ditë ai i shkroi mikut tim një letër fyese: "Ti do të bësh këtë e do të bësh atë, e do të paguash kaq e aq." Miku im më tregoi se ç'ngjau: "Kur e lexova atë letër më hipi inati. U ula në tavolinën time të punës me synimin për t'iu përgjigjur aty për aty. Por sapo isha gati për të bërë kështu, pamja e Jezusit në kryq, duke vdekur për mua - dhe për pronarin tim - vetëtiu para meje. Nuk munda ta shkruaj letrën! Në vend të saj i shkova për vizitë dhe i thashë, 'Zoti Filan, a mendon se është e nevojshme që të përdoret një gjuhë e tillë fyese midis nesh? Mua më duket se që të dy jemi të hapur për diskutim. Kështu pse të mos ulemi dhe t'i bisedojmë gjërat qetësisht? Ti më pëlqen dhe me të vërtetë nuk mendoj se është e nevojshme që ti të më flasësh kështu." Pronari u çarmatos plotësisht - dhe nuk pati më probleme. Që të dy - pronari i pashpirt dhe dishepulli i Jezu Krishtit - më në fund u bënë miq të mirë.

Le t'ju tregoj dhe një histori tjetër prekëse. Njoh një burrë me emrin Erino Dapozo që ka qenë ungjilltar në Francë. Ai u kthye në shtëpi nga lufta, pas internimit në një kamp

përqëndrimi, me një krah të dëmtuar keq. Dapozo më ka treguar një herë për një incident në jetën e tij që nuk e kam harruar kurrë: "Komandanti i kampit të përqëndrimit ku isha internuar më thirri një ditë aty nga mesdita. Më çuan në një dhomë ku tryeza ishte shtruar për një njeri. Unë po vdisja urie. Komandanti i kampit erdhi duke u kapardisur. Pastaj u ul në tavolinën ku kishte drekën dhe hëngri atë që i ishte servuar si për një festë mbretërore. Mua m'u desh të qëndroja 'gatitu' gjithë kohën dhe të shikoja se si i përlante ai gjellët njërën pas tjetrës. Ai po lëpinte buzët... dhe unë po vdisja urie. Por më e keqja do të vinte më vonë. Kur iu servua kafeja, ai nxori një pako të vogël dhe e vendosi pranë filxhanit. Pastaj u kthye nga unë dhe tha, 'E shikon këtë pako? Është nga jot shoqe që ta dërgoi nga Parisi. Është plot me biskota.' (E dija që në Francë nuk kishin për të ngrënë, dhe se ime shoqe duhet të kishte hequr nga vetja për t'i pjekur ato biskota.) Pastaj ai person filloi t'i hante ato, njerën pas tjetrës! Unë iu luta, 'Të lutem, më jep një, vetëm një, për ta mbajtur si kujtim nga ime shoqe. Të premtoj, nuk do ta ha!' Por ai vetëm qeshi dhe i kollofiti të gjitha, deri tek e fundit."

Në një situatë tërbuese si kjo, zemërimi ynë mund të arrijë një kulm dhe të kthehet në urrejtje.

Dapozo vazhdoi me historinë e tij: "Papritur e kuptova se ç'domethënie ka Bibla kur thotë: ***Dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona***. Dhe unë ndjeva aty për aty dashuri të vërtetë për këtë njeri. Mendova, 'I shkreti ti askush nuk të do. Ti je i rrethuar nga urrejtja. Sa i privilegjuar jam unë si fëmijë i Perëndisë.'" Dapozo u mbush me dhembshuri për komandantin! Ai nuk e lejoi atë njeri që ta acaronte. Dhe komandanti duhet ta ketë kuptuar sepse u ngrit me nxitim dhe u largua nga dhoma.

Kur mbaroi lufta, Dapozo shkoi për t'i bërë atij një vizitë.

Ky u zbeh kur pa Dapozon në prag të derës. "Ke ardhur për hakmarrje?" pyeti. "Po," u përgjigj Dapozo, "kam ardhur për hakmarrje. Hajde të pimë një kafe së bashku. Kam një kek në veturë. Do të jetë meze e mirë për të dy." Ish-komandanti mbeti tmerrësisht i hutuar. Pastaj papritur e kuptoi: njeriu që i është dorëzuar Jezu Krishtit nuk është më nën dominimin e urrejtjes. Ai është çliruar nga zemërimi që valon sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrën e tij.

Si një pastor i vjetër që punon në një qytet të madh, herë pas here kam dëgjuar njerëz që ankohen: "Ndihem shumë i vetmuar. Askush nuk më do." Nuk mund ta duroj më atë gjë! Gjithmonë më vjen t'i pyes ata, "Po ju vetë? Sa njerëz doni?" Kur ne vetë jemi një copë akulli, nuk është shumë e arsyeshme të themi se në botë nuk paska dashuri!

Kur më lindi kjo gjë në mendje, menjëherë thashë me vete, "Më mirë po filloj të jem më i dashur me njerëzit e tjerë." Por shumë shpejt e kuptova se kjo ishte e pamundur. Zemra jonë qenka plot me "unë"! E di që ne ndihemi veçanërisht të tërhequr ndaj njerëzve të caktuar sepse ata janë të pëlqyer. Po të tjerët, ata që na ngrejnë nervat?

Mbaj mend një bisedë që pata me një punëtor komunist. Ai tha, "Ne demonstruam në mbështetje të hamejve të Shangait." "Shumë mirë," u përgjigja. "Por si vënë punët me fqiun në derën ngjitur?" Ai shpërtheu: "Kur ta shoh atë njeri, do t'ia thyej turinjtë!"

Jo, nuk është shumë e vështirë të duash dikë në anën tjetër të botës. Por gjërat komplikohen kur vjen puna për të dashur dikë që jeton në derën ngjitur.

Besoj se bota nuk do të ndryshojë kurrë përderisa secili prej nesh të mësojë personalisht të dojë fqinjtë e tij - duke përfshirë atë me të cilin është e vështirë të shkosh mirë, atë që është i dhunshëm, dhe atë që nuk na e do të mirën. *Kjo nuk mund të bëhet vetëm.* Ajo është dhuratë e Perëndisë.

Nga përvoja personale, unë e di që nuk është e lehtë. Kur Jezusi merr në dorëzim jetën tonë, ai jo vetëm që na jep dhuratën e paqes me Perëndinë, por kërkon të na ndihmojë që të gjejmë paqe edhe me të tjerët.

Por kjo të shkaktoka dhimbje! Sepse gjatë këtij procesi Jezusi na tregon se ne ua ngrejmë nervat njerëzve të tjerë edhe më shumë se ç'na i ngrejnë ata tonat, se është më e vështirë për ata që të na durojnë ne se sa për ne që t'i durojmë ata. Që kur kam njohur Jezusin, ai shpesh e ka vënë gishtin në të këqijat që u kam bërë unë njerëzve të tjerë. Dhe unë e çmoj gjithnjë e më tepër faktin që Jezusi duroi mëkatet e mia në kryq dhe më dhuron faljen e mëkateve.

Jezusi është në gjendje ta nisë revolucionin më të madh që ka njohur ndonjëherë bota. Nëse ka për të ndodhur kjo, secili prej nesh duhet ta pranojë atë. Kështu, ju lutem shumë, të mos kënaqeni vetëm me dëgjimin e fjalëve të mia. Vendoseni besimin tuaj në Jezusin.

Sa do të dëshiroja që ju të ishit në gjendje të thoshit, "Unë kam gjetur Jezusin dhe ai më ka gjetur mua."

GJËRAT DUHET TË NDRYSHOJNË - POR SI?

Kur isha i ri, shkrimet e Maks Eithit, një autor që është harruar që kur, ishin në modë. Ai ishte inxhinier me profesion, dhe romanet e tij zakonisht përqëndroheshin në fillimin e epokës industriale. Titulli i njërit prej tyre ishte *Tragjedi Profesionale.* Në tregim ne takohemi me një inxhinier të ri të cilit, një ditë, nëpërmjet një sërë rastësish të çuditshme, i ofrohet një kontratë shumë e rëndësishme. Projekti ka të bëjë me ndërtimin e një ure mbi një lumë pikërisht në vendin ku lumi zgjerohet e thellohet dhe bëhet pjesë e detit. Vështirësia e ndërmarrjes rritet nga fakti që ura do të duhej t'i rezistonte presionit të baticave dhe zbaticave. Në atë kohë nuk ekzistonte as teknologjia jonë moderne!

Inxhinieri i ri i hyn punës dhe ndërton një urë vigane. Kur ajo përfundon, bëhet një përurim zyrtar me muzikë, valëvitje flamujsh dhe me pasqyrim të plotë nga shtypi. Zyrtarët e pranishëm në ceremoni ftohen ta kalojnë urën me tren. Inxhinieri i ri është tema kryesore e bisedave në tërë vendin. Emri i tij shkruhet me shkronja të mëdha në të gjithë titujt e gazetave. Reputacioni i tij është i padiskutueshëm.

Shpejt pas kësaj, ai hap një zyrë të madhe arkitekture në Londër dhe martohet me një grua të pasur. Ai ka gjithçka që kërkon në jetë. Megjithatë, një sekret i çuditshëm, të cilin ia ka treguar vetëm së shoqes, ia zymton jetën. Një ditë në fillim të vjeshtës, ai zhduket papritur. Atë natë, ndërsa stuhia tërbohet dhe shiu derdhet me gjyma, të riun mund ta shohësh të mbështjellë me mushamanë e shiut, duke qëndruar në këmbë të urës së tij. Ai kishte frikë. Ai mund ta ndiente në mënyrë të drejtpërdrejtë furinë e stuhisë që rrihte kolonat e urës. Përsëri dhe përsëri ai i kontrollon me imtësi llogaritjet e tij për t'u risiguruar se kolonat e tij janë të lidhura sa duhet

dhe se e ka vlerësuar presionin e erës në mënyrë korrekte. Sapo stuhia pushon, ai kthehet në Londër. Edhe një herë ai është njeriu i dëgjuar, një figurë e rëndësishme në jetën shoqërore të qytetit. Askush nuk mund ta zbulojë frikën e fshehur që e bren përbrenda: "A e ndërtova atë urë si duhet? A është e fortë sa duhet?" Këto pyetje torturuese e mundojnë të riun ditë e natë dhe ia nxijnë çdo minutë të jetës së tij.

Maks Eithi vazhdon të përshkruajë me një gjuhë shumë mahnitëse, se si një natë stuhie të tmerrshme, inxhinieri, i pushtuar nga frika, përsëri shkon t'i hedhë një sy urës së tij. Ai shikon një tren që është gati për të kaluar mbi të. Ai shikon i përqëndruar dritat e kuqe në vagonin e fundit. Dhe pastaj, papritur ai nuk mund t'i shohë më ato. Treni, ai e kupton, sapo është zhdukur në ujërat e thella të detit të tërbuar. Ura është shembur në mes!

Kur e lexova këtë roman për herë të parë vite të shkuara, më shkoi nëpër mend ky mendim: "Në fakt, kjo është historia e çdo qenieje njerëzore." Secili dhe të gjithë ne po punojmë për ndërtimin e urës së jetës sonë. Dhe herë pas here, gjatë një nate pa gjumë, ose pas një përvoje tronditjeje, na zë frika: "A e kam ndërtuar urën e jetës sime si duhet? A është ajo aq e fortë sa t'u rezistojë stuhive të jetës?" Instiktivisht ne e dimë se diçka nuk shkon: ura e jetës sonë nuk është krejt e përsosur.

Kështu, çështja e parë që dua të trajtoj është kjo:

1. Diçka nuk shkon

Si pastor që kam punuar në një qytet të madh, shpesh kam pyetur njerëzit: "Më thuaj, a është çdo gjë përsosmërisht në rregull në jetën tënde?" Kurrë deri tani nuk kam takuar qoftë edhe një njeri të vetëm që të mos e ketë mbyllur duke pranuar, "Përsosmërisht në rregull? Jo! Gjërat duhet të ishin

ndryshe në shumë pjesë të jetës sime." Sigurisht, unë nuk mund t'ju them se ku e keni pikën e dobët në urën e jetës suaj. Por ju vetë jeni të vetëdijshëm se shumë gjëra duhej të ishin ndryshe.

Prandaj ne marrim goxha vendime herë pas here: "Do të ndryshoj. Duhet ta përmirësoj absolutisht këtë apo atë pjesë të jetës sime." Tregohuni të ndershëm - a besoni vërtet se një njeri mund të ndryshojë? Jo, në realitet njeriu është i paaftë për të ndryshuar. Bibla thotë këtë me realizëm brutal: ***A mundet një etiopias të ndryshojë lëkurën e tij apo një tigër të këmbejë lëkurën me vijëza? Në të njëjtën mënyrë ju, që jeni mësuar të bëni të keqen, a do të mund të bënit të mirën?***

Bota është plot mësime për moral dhe vendime të mëdha, por asnjë qenie njerëzore nuk mund të ndryshojë vetë. Kjo është një fjalë e vrazhdë.

Disa njerëz që takoj janë përsosmërisht të vetëdijshëm për dobësitë në urën e jetës së tyre. Ka raste kur më bëhet pyetja, "Por ç'mund të bëj unë? Është e pamundur që unë të ndryshoj." Kjo është e vërtetë: njeriu i papastër nuk mund t'i japë vetes një zemër të pastër; gënjeshtari nuk mund të bëhet i vërtetë; njeriu egoist nuk mund të bëhet papritur altruist (sepse edhe në qoftë se ai arrin të veshë dukjen e pak dashurie, ajo pakëz dashuri do të molepset nga egoizmi); dhe njeriu i pandershëm nuk mund të shndërrohet në një njeri të ndershëm. Ah sikur t'ju njihja aq mirë sa të isha në gjendje për t'ju treguar pikën e dobët në urën e jetës suaj! Por Perëndia e di dhe ai mund t'jua tregojë atë.

Kjo është një e vërtetë shumë shqetësuese që na e zbulon Bibla. Unë nuk po flas për mendimet e mia. Unë thjesht po u transmetoj të tjerëve atë që ka për të thënë Fjala e Perëndisë.

Bibla ka një mesazh të mrekullueshëm për ju pikërisht

tani, një mesazh që do t'ju lërë pa frymë. Ja tek është: Perëndia i gjallë dërgoi dikë në këtë botë i cili mund t'ju transformojë ju dhe ta ndryshojë tërë jetën tuaj. Ky person nuk është tjetër veçse Biri i tij, Zoti Jezu Krisht.

2. Çdo gjë mund të ndryshojë

Miqtë e mi, nuk e di nëse është gabimi i kishës që njerëzit mendojnë se Ungjilli është vetëm një tërësi përrallash me mbret. Për sa më përket mua, mesazhi i saj është i jashtëzakonshëm. Perëndia dërgoi Birin e tij në këtë botë për të më dhënë mua një shans. Dhe Jezusi bëri deklaratën mahnitëse: ***Ja, unë i bëj të gjitha gjërat të reja***. Vetëm ai mund ta ndryshojë një qenie njerëzore.

Kam njohur alkoolistë që janë shpëtuar nga dhënia pas pijes; plaka egoiste (egoiste deri në atë shkallë sa që të gjithë i mërzitnin për vdekje) që u ndryshuan nga njëra ditë në tjetrën dhe filluan të mendonin për të tjerët; dhe burra maniakë pas seksit, që u është dhënë pastërtia e një fëmije. Jezusi transformon. Ai shfaqet, dhe papritur të gjitha gjërat bëhen të reja.

Prandaj ne kemi nevojë për një Shpëtimtar, ne që e dimë se ura e jetës sonë nuk është si duhet të ishte. Ne kemi nevojë për Zotin Jezus - jo për anët e jashtme të krishterimit, por Krishtin vetë. Nuk është feja, dogma, anëtarësia në ndonjë sekt ajo që na duhet, por Shpëtimtari i gjallë. Dhe ai është pikërisht këtu. Ju mund t'i thërrisni atij pikërisht në këtë çast dhe t'i rrëfeni atij gjithë mjerimin në jetën tuaj. Ky është mesazhi i jashtëzakonshëm që kam për të ndarë me ju.

Këto kohët e fundit kalova një javë në qytetin e Mynihut. Ka një park shumë të madh në qendër të qytetit që quhet Kopshti Anglez. Meqë hoteli im ishte jo shumë larg nga ky park, shkoja aty për shëtitje çdo mëngjes. Afër portës së

hyrjes ndodhet një urë prej druri që bashkon brigjet e një lumi. Në të majtë të urës, uji rrjedh mbi një digë dhe kthehet në një ujëvarë. Në fund të ujëvarës, një ditë, pashë një copë dru që pluskonte në ujë. Unë nuk nxitoja, kështu që ndalova për të parë se si trungu vinte vërdallë në formë rrathësh. Ndonjëherë ai dukej sikur do të përfshihej nga rryma dhe do të vazhdonte në rrugën e tij. Por vorbulla e ujit gjithmonë e rrëmbente atë përsëri. Kur u ktheva ditën tjetër, copa e drurit ishte akoma atje. Çdo herë, pikërisht kur dukej sikur do të përfshihej nga rryma, tërhiqej pas nga shtjella e ujit. A mund ta imagjinoni skenën? Ishte një rrymë tepër e shpejtë - por copa e drurit vazhdonte të sillej rrotull e rrotull!

Shumica prej nesh jemi pikërisht ashtu. Jeta jonë rrotullohet pa fund në të njëjtët rrathë viciozë: të njëjtat mëkate, të njëjtat shqetësime, e njëjta joperëndishmëri, i njëjti dëshpërim në zemrat tona. Ditë për ditë, është e njëjta jetë monotone, e njëjta rutinë. Ne vijmë rrotull në rrathë. Por jo larg prej nesh është rryma. Ajo rrjedh nga Jezusi, Biri i Perëndisë.

Ky Jezus vdiq për ne në kryq. Më besoni, në qoftë se Perëndia lejoi që Biri i tij të vdesë me një vdekje kaq mizore, duhet të ketë patur ndonjë arsye të madhe për këtë, edhe pse ju mund të mos e kuptoni ende arsyen. Me sytë e mendjes, shikoni Jezusin në agoni, në kryq. *Duhet* të ketë një domethënie për vdekjen e tij! Vetëm për këtë arsye ju thjesht nuk mund të kaloni aty pranë, pa u përpjekur të paktën ta kuptoni se përse ndodh e gjithë kjo.

Për shkak se ai vdiq dhe u ngrit përsëri, një rrymë çliruese rrjedh nga Jezusi. Mjerisht, ne jemi tamam si ajo copë dru në Kopshtin Anglez. Ne vijmë vërdallë në rrathë pa fund. Atë kohë në park, mendova, "Gjithçka që i duhet copës së drurit me qëllim që të përfshihet nga rryma, është një shtytje e

lehtë." Duke u përpjekur me sa pata mundësi, nuk munda ta arrij atë pa rrezikuar të bija në ujë.

Megjithatë ne nuk jemi një copë dru! Për të dalë nga rrethi ynë i vjetër vicioz dhe për t'u futur në rrymën çliruese që rrjedh nga Biri i Perëndisë, ne duhet t'i japim vetes një të shtyrë. Dhe kur të kemi bërë kështu, ne zbulojmë se na paska ndihmuar Perëndia!

Por në këtë pikë, unë preferoj të theksoj faktin se ne të gjithë, secili prej nesh, duhet personalisht ta bëjë këtë hap drejt rrymës çliruese. Askush tjetër nuk mund ta bëjë atë për ne. Megjithatë, disa njerëz, janë thellësisht të vetëdijshëm që nga fillimi se Perëndia po punon në zemrën e tyre, dhe se është ai që do t'i aftësojë ata për ta bërë atë hap i cili do t'i nxjerrë nga rrethi i vjetër vicioz dhe do t'i përfshijë në rrymën çliruese që rrjedh në Jezusin.

3. Qenka ja kjo ja ajo!

Dy tregime nga Bibla do ta ilustrojnë atë që sapo u tha.

Apostulli Pal ishte burgosur në Cezare, qyteti ku qeveritari romak kishte rezidencën e tij. Qeveritari i ri i Judesë ishte një romak me emrin Fest. Një ditë, mbreti jude, Agripa dhe motra e tij Berenike erdhën në Cezare për të përshëndetur Festin. Ata i thanë atij, "Fest, një i burgosur tepër interesant i quajtur Pal, me sa duket është i burgosuri yt. Do të donim ta dëgjonim vetë këtë njeri." Kështu të nesërmen ishte përgatitur salla. Festi, Agripa dhe Berenike hynë tërë madhështi dhe etiketë, të ndjekur nga zyrtarë të lartë dhe nga paria e qytetit. Me urdhër të Festit, të akuzuarin e sollën brenda. Por brenda pak minutash, rolet u ndërruan. I akuzuari nuk ishte më Pali, por gjithë aristokracia e mbledhur rreth tij. Pali rrinte në këmbë para gjithë atyre dhe mbajti një fjalim me fuqi të madhe frymore. Ai u përpoq t'i bënte dëgjuesit e tij

ta kuptonin se kush është Jezusi. Në vend që të përqëndrohej në mëkatet e tyre, ai u përshkroi atyre Birin e Perëndisë - atë që tha: ***Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë.*** Pali u tha atyre diçka të tillë: "Ju, me etjen tuaj për të jetuar, me ndërgjegjen tuaj fajtore, me mallin tuaj për Perëndinë, frikën tuaj ndaj vdekjes, më dëgjoni! Jezusi jua shtrin juve dorën e tij dhe thotë, ***Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje.***" Me fjalë të tilla, Pali foli në përlëvdim të Jezusit të cilin e kishte takuar personalisht një ditë në rrugën për në Damask.

Kur Pali kishte mbaruar së foluri, qeveritari Fest i tha, "Pal, ti je orator i mirë. Por ajo që thua ti është çmenduri! Ti e lë veten të rrëmbehesh nga entuziazmi!" Festi nuk kishte kuptuar asgjë. Bibla thotë për njerëz të caktuar: ***Zemra e tyre është e pandjeshme si dhjami.*** Disa zemra janë si të mbuluara me lyrë, kështu që çdo gjë rrëshqet. Sidoqoftë, zemra e Festit ishte e tillë.

Agripa, nga ana tjetër, ishte krejt i hutuar. Ai tha diçka që mua gjithmonë më prek thellë: ***Për pak dhe po ma mbush mendjen të bëhem i krishterë!*** Me këto fjalë, mbreti u ngrit dhe u largua nga dhoma. Dhe gjërat mbetën si më parë! Si copa e drurit në Kopshtin Anglez, jeta e Agripës vazhdoi të ndjekë të njëjtët rrathë, në të njëjtën vorbull, në të njëjtën jetë monotone, në të njëjtin lloj ekzistence - deri në vdekjen e tij, deri në ferr.

Po ju? Edhe ju do t'i lini gjërat siç janë? Në qoftë kështu, atëherë Jezusi vdiq kot për ju. Dhe ringjallja e tij nuk do të ketë aspak dobi për ju. Për ju, nuk do të ketë asnjë falje, asnjë çlirim, asnjë paqe me Perëndinë. Për ju, ashtu si për Agripën, vetëm një hap ju ndan nga qenia i krishterë:
Për PAK dhe po ma mbush mendjen të bëhem i krishterë.

Ka burra e gra sot, që e quajnë veten të krishterë, e megjithatë nuk janë bërë kurrë fëmijë të Perëndisë. Ka burra dhe gra sot që e quajnë veten të krishterë, e megjithatë janë në rrugën drejt dënimit të përjetshëm. Ka burra dhe gra sot, që e quajnë veten të krishterë, e megjithatë nuk kanë aspak paqe. Është tragjike!

Tani do t'ju tregoj historinë e dytë të Biblës që është krejt e kundërta e së parës. Apostulli Pal erdhi një ditë në qytetin e Filipisë, një qytet evropian ku mund të gjeje çdo gjë: vende argëtimi, teatro, klube nate; me një fjalë të gjitha gjërat që mund të gjenden në çdo qytet të denjë për emrin e tij. Dhe me që në çdo qytet të vërtetë ka një burg, kishte një të tillë edhe në Filipi. Ky institucion ndodhej nën drejtimin e një ish-oficeri romak i cili mund të ishte caktuar në atë post për shkak të ndonjë plage të marrë në luftë. Një ditë rojtarit të burgut iu lanë në ngarkim dy të burgosur të pazakontë: apostulli Pal dhe shoku i tij Sila. Ata e kishin predikuar ungjillin me fuqi të rrallë në qytet. Predikimi i tyre kishte bërë që të shpërthente një trazirë dhe autoritetet lokale kishin urdhëruar që ata të rriheshin dhe të futeshin në burg. Kështu edhe Pali edhe Sila, u vunë nën kujdesin e rojtarit të burgut, me urdhërin se ata duhet të ruheshin mirë deri të nesërmen. Rojtari i burgut, një njeri i trashë, për të cilin urdhëri ishte urdhër, tundi kokën në shenjë miratimi: "T'i ruaj me kujdes? Mos u shqetësoni! Merrem unë me këtë punë!" Thellë, në pjesën më të brendshme të burgut, ndodhej një qeli që i rridhte uji çurkë nga muret. Pikërisht në këtë birucë, i solli ai dy të burgosurit, dhe ua shtrëngoi këmbët me dru.

Në qoftë se do të më pyesnit cila ishte feja e këtij njeriu, do t'ju thosha: e njëjta fe që ka shumica prej jush! Ai besonte në "Zotin e mirë", apo madje në disa "zotëra të mirë". Në atë periudhë, të gjithë në perandorinë romake kishin një lloj feje, por askush nuk shqetësohej shumë për të. Tamam si sot. A

mund të identifikoheni ju me këtë njeri?

Papritur ndodhi diçka e çuditshme, diçka që ne nuk do të jemi kurrë në gjendje ta shpjegojmë plotësisht. Sa për fillim, aty nga mesnata, Pali filloi të këndojë një këngë lavdërimi për nder të Jezusit. Ndoshta atij i kishte marrë gjithë kohën pranimi i trajtimit të padrejtë që kishte pësuar: goditjet, burgosjen, drurët. Ky lloj trajtimi është shumë i vështirë për t'u pranuar. Por një mendim i vetëtiu në mendje: "Zoti Jezus, Biri i Perëndisë, më ka shpenguar mua me anë të gjakut të tij. Unë jam fëmijë i Perëndisë. Unë kam paqe me të. Dhe madje edhe këtu në burg, ai më mban në dorën e tij." Kështu ai nisi një këngë lavdërimi; dhe Sila u bashkua me të, duke kënduar alto apo bas. Ishte shumë bukur! Të burgosurit e tjerë i dëgjuan, plot habi, sepse kurrë më parë nuk ishin dëgjuar tinguj të tillë në burg. Dhe kishte arsye për këtë!

Gjatë burgimeve të mia, kam arritur të njoh se si janë burgjet e shtetit policor. Gjithë ç'mund të dëgjohet është sharje, ulërima, dhe rënkim i të burgosurve, dhe të çjerrat e rojave. Kur fillova të këndoja një himn një ditë, ata erdhën menjëherë për të më ndaluar. Në ditët tona ata kanë arritur të kuptojnë se sa e rrezikshme është të lejosh dikë të këndojë lavdërimet e Perëndisë. Por në ato ditë nuk ishte kështu.

Pali dhe Sila vazhduan të këndonin. Sigurisht, rojtari i burgut u habit shumë. "Për Jupiter!" mendoi ai me vete, "ç'po këndojnë ata?" Ai zgjati veshët. "Eh, këto janë këngë fetare," thirri ai me habi, "dhe këtu në burg pale! Në atë vrimë atje poshtë, ka arsye të fortë që morali i dikujt të jetë shumë i ulët. Dhe këta njerëz po këndokan për nderim të Perëndisë të tyre!" Rojtari i burgut u kthye në shtrat. Por ai nuk kishte zënë ende vend mirë, kur ndjeu tronditjet e një tërmeti të fortë. Ishte Perëndia që e solli atë. Të gjitha dyert e burgut u hapën me të plasur. Zinxhirët e të burgosurve u këputën.

Rojtari u hodh nga shtrati, u vesh aq shpejt sa mundi, dhe zbuloi se dyert ishin hapur. "O Perëndi! Të burgosurit kanë shpëtuar," thirri ai. "Do të turpërohem. Kjo më pret!" Ai po bëhej gati të vriste veten kur dëgjoi zërin e Palit që vinte nga poshtë: "Mos i bëj ndonjë të keqe vetes. Ne të gjithë jemi këtu!"

Bibla nuk jep asnjë detaj se çfarë ndodhi në thellësi të shpirtit të atij burri. Por vetëtimthi ai kishte kuptuar kaq gjë: "Duhet të ketë një Perëndi të gjallë që ndërhyn për shërbëtorët e tij. Gjithë jetën time unë e kam fyer atë Perëndi me mënyrën time të të jetuarit dhe të vepruarit. Ai do të më kthejë mbrapsht, nuk do të më pranojë, sepse ai e njeh mëkatin tim. Ai di gjithçka për mashtrimet e ndyra që kam bërë unë. Po, ka një Perëndi të gjallë - dhe sa për mua, unë jam i humbur." Ai u sul poshtë në birucën e Palit dhe thirri, ***Zotërinj, ç'duhet të bëj unë që të shpëtohem?*** Ai sapo e kishte kuptuar se jeta e tij ishte si ajo copa e drurit në Kopshtin Anglez. Ajo s'bënte asgjë por rrotullohej në formë rrathësh. Gjërat gjithmonë mbeteshin në të njëjtën pikë. Por situata tani ishte kritike: "Ç'duhet të bëj unë që të arrij në rrymën çliruese?"

Në qoftë se rojtari filipas i burgut do të na kishte bërë ne një pyetje të tillë, ne ndoshta do t'i kishim bërë atij një predikim ose do t'i kishim bërë moral. Në qoftë se do të ishim në situatën në të cilën ndodhej Pali, është e mundur që do të kishim filluar t'i kërkonim atij të na lironte nga burgu. Por Pali u përgjigj menjëherë, me një fjali të vetme: ***Beso në Zotin Jezu Krishtin dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote***. Njohuria e rojtarit të burgut ishte shumë e kufizuar. Ai ishte turbull i dijshëm se ky Jezus na shpëton nga zemërimi i Perëndisë, nga gjykimi, nga ferri - dhe nga mënyra jonë e mëparshme e jetesës. Por vetëm në një moment ai mori goditjen shëruese e cila e shkëputi atë nga jeta e tij e

mëparshme dhe e përfshiu me vete në rrymën çliruese. Që atëherë e më vonë ai i takoi Jezusit.

Bibla vazhdon të tregojë se si ky njeri i nxori Palin dhe Silën nga biruca dhe u lau plagët, duke dëgjuar me vëmendje të gjitha ato që i mësonte Pali për Jezusin. Ai u pagëzua pikërisht atë natë, duke dëshmuar në këtë mënyrë se ai i përkiste Jezusit. Historia mbaron me këto fjalë: ***i çoi në shtëpinë e vet, ua shtroi tryezën dhe u gëzua me gjithë familjen e tij që kishte besuar në Perëndinë.*** Rojtari i burgut tani ishte përfshirë nga rryma jetëdhënëse. Ai kishte gjetur paqe me Perëndinë.

Një njeri tha se ai pothuajse u bind për t'u bërë i krishterë. Tjetri u gjend i shtyrë në rrymën çliruese që vjen nga Jezusi. Po me ju ç'do të bëhet?

4. Merreni seriozisht ofertën e Jezusit

Gjërat duhet të ndryshojnë - por si? Sa për fillim, ju duhet të arrini ta njihni Jezusin.

Kishte vetëm pak kohë që kishte mbaruar lufta. Një drejtor kolegji më telefonoi një ditë duke thënë, "Pastor Bush, kam pesëmbëdhjetë të rinj këtu. Ata kaluan nivelin 'A' në ushtri. Por ata duhet të bëjnë një semestër shtesë mësim që diploma e tyre të quhet e vlefshme. Ata janë ish-togerë të forcave ajrore, kapitenë këmbësorie dhe artilerie, dhe oficerë të tjerë me gradë më të ulët. S'është nevoja të thuhet, ata i tërbon mendimi se do t'u duhet të kthehen përsëri në shkollë. A do të bije dakord të jepje kursin për fenë?" Pranova dhe shkova në leksionin tim të parë me frikë dhe duke u dridhur.

I gjeta të gjithë të ulur atje, me uniformat e tyre të grisura, këta luftëtarë të rinj që u kishin dalë thinjat në fushën e betejës. "Tungjatjeta" thashë kur hyra, "Kam ardhur që t'ju

jap disa leksione mbi fenë." Hyrja ime u pre shkurt, sepse përnjëherësh njëri prej tyre, u ngrit në këmbë dhe e hapi debatin. "Pse e lejoi Perëndia këtë luftë të tmerrshme?" Një tjetër vazhdoi, "Ku është dashuria e Perëndisë? Ai qëndroi i heshtur kur miliona judenj vdisnin në dhomat e gazit." Pyetje të ngjashme vinin nga të gjitha anët. Më në fund, unë ngrita dorën dhe thashë, "Një moment ju lutem! Ju po veproni si një i verbër në timonin
e një anijeje në një mjegull të dendur! Është pakuptim të flasësh për Perëndinë në atë mënyrë! Perëndia është krejtësisht i panjohur dhe i fshehur për ne. Ai e ka zbuluar veten vetëm në një mënyrë - në Jezusin. Dhe para se të vazhdojmë, së pari duhet të mësojmë se kush është Jezusi. Zotërinj, ne do ta vazhdojmë përsëri këtë diskutim vetëm pasi të kemi parë, para së gjithash, në zbulesën e Perëndisë. Kjo do të jetë tema jonë në këto javët e ardhshme. Herën tjetër sillni Biblat me vete."

Ata i sollën dhe ne filluam të lexonim librin e Zanafillës: ***Në fillim Perëndia krijoi qiejtë dhe tokën***. Pastaj vazhduam me historinë e Rënies, pastaj me tregimin e gjykimit të Perëndisë mbi një njerëzim të rënë. Atyre u bëri të gjithëve përshtypje të madhe kjo thënie në Bibël: ***Vetë sjellja jote e keqe dhe shmangiet e tua do të të dënojnë. Prano, pra, dhe shiko sa e keqe dhe e hidhur për ty është të braktisësh Zotin, Perëndinë tënd, dhe të mos kesh fare frikë nga unë, thotë Zoti, Zoti i ushtrive***. Kombe dhe individë kanë zbuluar se sa e vërtetë mund të jetë kjo.

Pas kësaj ne lexuam së bashku historinë e Jezusit. Pa ndërprerje, dëgjuam tregimin e vdekjes dhe ringjalljes së tij. Ajo orë e veçantë do të mbetet përgjithmonë e skalitur në kujtesën time. Ndërsa një nga të rinjtë po lexonte pjesën me zë të lartë, një heshtje e madhe ra papritur në klasë. Ne mbajtëm frymën ndërsa dëgjonim gjërat e mëdha që kishte

bërë Perëndia nëpërmjet Jezu Krishtit. Dhe në zemrat e këtyre të rinjve ishte shkaktuar një ndryshim i tillë sa që kurrë më nuk u ngatërruan në atë lloj diskutimi shterp që kishte filluar në leksionin e parë. Këta djelmosha, të gjithë e quanin veten e tyre të krishterë, por ata nuk dinin asgjë për Perëndinë e gjallë që erdhi te ne në personin e Jezu Krishtit dhe që përmbushi gjithçka që ishte e nevojshme për shpëtimin tonë.

Po, ju duhet të arrini ta njihni Jezusin. E pastaj? Ju duhet ta merrni seriozisht ofertën e tij.

Jezusi tregoi një shëmbëlltyrë një ditë. Një mbret organizoi një gosti dasme për të birin. Ai dërgoi shërbëtorët për të njoftuar të ftuarit: "Ejani, gostia është gati!" Por që të gjithë ata, njëri pas tjetrit u justifikuan. I pari shpjegoi, "Më vjen keq por sapo jam në procesin e përfundimit të një marrëveshje të rëndësishme, dhe më duhet ta lidh atë menjëherë."

I ftuari i dytë pati një justifikim tjetër: "Faleminderit për ftesën, por sapo u martova. Jam i sigurt se e kupton se meqë jam pikërisht në mes të muajit të mjaltit, nuk mund të bëj asgjë tjetër."

Më në fund, nuk erdhi askush. Shpesh jam përpjekur të imagjinoj se si janë ndier këta njerëz më vonë. Ata duhet të kenë menduar me vete: "Në të vërtetë, duhet ta kisha pranuar ftesën për në gostinë e birit të mbretit; sidoqoftë rrethanat nuk ishin aspak të përshtatshme."

A nuk është kjo ajo që thoni edhe ju me vete? "Në të vërtetë, duhet të bëhem fëmijë i Perëndisë, por në një farë mënyre, nuk e bëj dot këtë gjë! Me të vërtetë nuk mund...". Unë ju lus, pranoni me anë të besimit ftesën e Birit të Perëndisë!

Sa shumë njerëz më thonë, "Edhe unë besoj." Unë di që

ne gjermanët besuam në shumë gjëra gjatë Rajhut të Tretë: në Fyhrerin, në fitoren përfundimtare, në armën mrekulli, e kështu me radhë. Por ajo për të cilin kemi më shumë nevojë nuk është një lloj i zakonshëm besimi, por paqe me Perëndinë. Kjo paqe mund të fitohet vetëm nëpërmjet Jezusit. Me anë të disa ilustrimeve, dëshiroj të shpjegoj se ç'do të thotë të besosh.

Në fillim të shërbesës sime, bëja vizita derë më derë në një zonë shumë të zgjedhur. Në pothuajse çdo shtëpi, njerëzit më përplasnin derën në fytyrë, duke më thënë, "Nuk duam të blejmë gjë!" Unë futja këmbën në derë, aty ku ishte e mundur, dhe përgjigjesha, "Unë nuk shes gjë. Jam pastor." "Nuk kemi nevojë për predikues këtu!" do të vinte përgjigjja e pandryshueshme.

Një ditë shkova në një apartament që të çonte drejt e në kuzhinë. Një i ri ecte lart e poshtë nëpër dhomë, me një pamje të xhindosur në fytyrë. "Tungjatjeta," i thashë. "Ngjatjeta!" "Jam një pastor protestant," vazhdova. "Çfarë ore? Predikues?" ulëriti ai, ndërsa ngriu në vend. "Epo kjo s'durohet! Pa dil përjashta sa s'është vonë! Unë nuk besoj më në asgjë. E kam humbur besimin te njerëzimi." Ai ndoshta sapo kishte marrë një goditje të rëndë. U përgjigja, "Djalosh, le t'i japim dorën njëri-tjetrit. Edhe unë e kam humbur besimin tek njerëzimi." I mahnitur, ai pyeti, "Çfarë the ore? Si pastor, ti duhet të përpiqeshe të ruaje besimin te njerëzimi." "Ashtu mendon ti?" ia ktheva. "Më vjen keq, por unë nuk shpresoj për më shumë nga njerëzimi. Kam kaluar luftën. Dhe kur mendoj për ndyrësitë, për gjithë pisllëkun dhe për shkretëtirën e egoizmit në të cilën është kthyer bota, jo, faleminderit, unë thjesht nuk mund të besoj më te njerëzimi." "Ke të drejtë," ra dakord ai, "por, si ka mundësi që je pastor atëherë?" Pyetje së cilës unë iu përgjigja, "Oh! kjo ndodh sepse unë mora një besim të ri, një besim që nuk mund ta

lëkundë asgjë në botë." "Ha!" thirri ai me habi, "Jam me të vërtetë kurioz të di se ç'lloj besimi është ai."

Kështu unë i shpalla atij Ungjillin: "Është një besim absolut në Jezu Krishtin, i cili erdhi në këtë botë si Shpëtimtar." Ai u shtang. "Jezu Krishti? Po ky është krishterim. Unë e mendoja krishterimin të mbaruar, jashtë mode!" thirri ai i habitur. "Aspak, krishterimi fillon atje ku marrin fund të gjitha besimet e tjera."

Sa dëshiroj që ju t'i hiqni qafe të gjitha besimet tuaja false në mënyrë që të mund të vinit në besimin shpëtues në Jezu Krishtin.

Menjëherë pas luftës, meqë kisha si synim të udhëtoja shumë, bleva një Opel P4 të vjetër. Ajo ishte një antikë e vërtetë! Kur dola për herë të parë me P4-ën time të vogël karakatinë, një mik bërtiti "Pa shikoni! Pastori po nget veturë! Do të na duhet të vëmë mbrojtëse rreth të gjitha pemëve!" Disi i lënduar, u përgjigja, "Dukesh se mendon se unë nuk mund të ngas makinë." "Sigurisht që mund të ngasësh. Ti ke marrë patentën e shoferit." "Hip, atëherë," e ftova unë, "dhe do të bëjmë një xhiro rreth bllokut." "Jo faleminderit!" erdhi shpejt e shpejt përgjigjja. "Nuk e kam bërë akoma testamentin!" Pikërisht atëherë më erdhi ime shoqe. "Emi, a dëshiron të vish për një xhiro?" e pyeta. Pa hezitimin më të vogël ajo hipi në veturë. Dhe - ju siguroj - ajo është gjallë akoma! Kur lëvizi nga toka e palëvizshme në veturën time ajo e vuri jetën e saj në duart e mia. Edhe ju duhet të bëni pikërisht këtë gjë në lidhje me Jezusin: vendoseni jetën tuaj me gjithë zemër dhe pa frikë në përkujdesjen e tij.

Jo shumë kohë më parë, lexova një histori prekëse për një ngjarje që ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore në Stalingrad. Në atë kohë qyteti ishte rrethuar plotësisht nga

trupat ruse. Avioni i fundit gjerman që mbante lidhjen me zonën jo-operative, sapo ishte ulur. Avionin e kishin ngarkuar me të plagosur. Por erdhën ushtarë të tjerë - të plagosur lehtë ose gjysmë të vdekur nga të ftohtit - dhe edhe ata donin të hipnin. Kështu ata u kapën tek aeroplani, duke u mbajtur në çdo gjë që mund të gjenin: dorezat e derës, në pjesën e poshtme të aeroplanit. Pastaj aeroplani u ngrit. Kur ai u ul më vonë, asnjë nga ata që ishin kapur tek avioni nuk ishin atje. Duke i patur duart të ngrira, ata thjesht ishin fshirë nga stuhia. Vetëm ata që ishin brenda avionit shpëtuan.

Kur e lexova këtë ndodhi, nuk mund të mos hiqja një paralele midis ungjillit të Jezusit, Birit të Perëndisë që vdiq dhe u ngrit përsëri për ne, dhe këtij avioni jetë-shpëtues. Për ne Jezusi është një mjet shpëtimi nga dënimi i përjetshëm. Në të ka shumë vend. Por - e trishtueshme ta thuash - kaq shumë burra dhe gra ndodhen në pjesën e jashtme. Ata nuk kanë hipur kurrë në avion. Ata kënaqen thjesht duke u varur në trupin e avionit. Ata shkojnë në kishë një herë në vit, për krishtlindje. Ata janë pagëzuar - por kjo nuk i pengon për të menduar dhe vepruar si pjesa tjetër e turmës. Dhe kur vdesin, pastori do të vërtetojë se ata ishin njerëz të mirë. Megjithatë, në të vërtetë ata kanë qenë gjithmonë në pjesën e jashtme të avionit. Dhe një ditë ata do të fshihen nga stuhia. Nuk ka asnjë fije dyshimi për këtë! Vetëm ata që janë brenda do të shpëtohen.

A jeni ju midis tyre?

Ferri do të ziejë nga njerëzit që kanë dëgjuar për Jezusin, por që kurrë nuk hipën në avion me të. Të "hipësh në avion me të" do të thotë "të besosh në Jezusin". Bëjeni atë!

Në katedralen Lybek, një kishë shumë e bukur dhe shumë e vjetër, ka një pjesë të bukur altari që përfaqëson kryqëzimin, pikturuar nga Hans Memling në shekullin e pesëmbëdhjetë. Në vitin 1942, kur kisha kishte marrë flakë

pas një sulmi ajror, një ushtar i panjohur, me disa shokë, vrapoi brenda shenjtërores duke rrezikuar jetën për ta shpëtuar këtë vepër arti.

Pak kohë pas lufte, unë mbajta një sërë takimesh në Lybek. Një ditë përgjegjësi i Muzeut të Arteve të Bukura erdhi për të më takuar dhe tha, "Unë e kam pjesën e famshme të altarit të Memlingut të ruajtur në bodrum. Në qoftë se je i interesuar, unë do të tregoja me kënaqësi." Sigurisht ishte një rast i mrekullueshëm. Kështu përgjegjësi më çoi, bashkë me një shok, poshtë në bodrum. Ishte një pikturë e madhërishme: ushtarë me shtiza të hipur në kuaj, mercenarë që luanin kumar, një turmë e llojllojtë, gra me lot në sy, farisenj me vështrimin e tyre tallës. Dhe atje, lart sipër turmës, tre kryqe.

Papritur më ra në sy një detaj shumë i çuditshëm: mu në mes të mizërisë, në këmbë të kryqit të Jezusit, kishte një hapësirë të zbrazët. Unë u thashë të tjerëve, "Sa e çuditshme që në mes të mizërisë, drejt e në këmbë të kryqit, të jetë diçka si hapësirë boshe. Pyes veten se ç'mund të ketë patur në mendje piktori?" Ata piktorët e mesjetës gjithmonë përpiqeshin të përçonin ndonjë mesazh nëpërmjet pikturave të tyre. Mikut tim i erdhi në mend një shpjegim. "Ja se ç'donte të thoshte ai, mendoj unë: në këtë vend, mu në këmbë të kryqit të Jezusit, ka një hapësirë të lirë. Ju mund ta vendosni veten tuaj atje po të dëshironi."

Shpesh mendoj për atë pikturë kur këndojmë këtë këngë:

Mbi atë kryq të Jezusit
Syri im shpesh shikon
Tamam formën që po vdes të Atij
Që vuajti atje për mua
Dhe prej zemrës së penduar, me lot,
Dy çudira unë rrëfej
Çudinë e dashurisë së Tij të lavdishme,

Dhe atë që unë nuk vlej.

Sa gëzohem që nën kryqin e Jezusit ka një vend të lirë - një vend për mua. Ka edhe një për ju.

A do të prisni akoma më gjatë para se të vendosni të qëndroni atje?

FALEMINDERIT – "JO PËR MUA!"

Çdo brez shpik parullat dhe shprehjet e veta. Njerëzit i përdorin dhe i përsërisin ato me pretekstin më të vogël, sikur ato të zbatoheshin në çdo rrethanë. Një thënie e tillë është shprehja negative "Jo për mua". Ajo do të thotë: "Nuk e dua atë me çfarëdo çmimi. As që mund të diskutohet!"

Ajo përdoret si justifikim për një grindje, për lëndimin e të tjerëve, dhe madje ndonjëherë për t'i bërë dëm vetvetes. Kështu kjo thënie e zakonshme mund të bëhet jashtëzakonisht e rrezikshme - madje deri në atë pikë sa ta vërë jetën e dikujt në rrezik. Por ajo mund të japë gjithashtu rezultate pozitive. E gjitha varet nga mënyra se si e përdorin njerëzit.

Tani do t'u hedhim një sy problemeve.

1. Ne nuk e përdorim atë kur duhet

Ka një histori në Bibël e cila, megjithëse është e vjetër me shekuj, është akoma e zbatueshme edhe sot dhe ilustron qartë këtë aspekt të çështjes.

Ndoshta keni dëgjuar për Abrahamin, njeriun e Perëndisë për të cilin është thënë kjo gjë në librin e parë të Biblës: ***ai i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë***. Abrahami ishte ai lloj njeriu që ishte thellësisht i vetëdijshëm për gabimet e tij. Por ai jetonte aq afër Perëndisë sa që në çastin që u bë i ndërgjegjshëm për një mëkat në jetën e tij, ai menjëherë e pranoi atë dhe e bëri të tijën me anë të besimit faljen që i ofroi Perëndia.

Tani, një ditë Abrahami u gjend në një situatë të vështirë në lidhje me të nipin, Lotin. Bibla na thotë se Abrahami ishte i pasur me bagëti dhe gjedhë. Loti që shoqëronte të ungjin, kishte gjithashtu tufa e kope të mëdha. Ajo që kishte për të

ndodhur ndodhi! ***Lindi kështu një mosmarrë-veshje midis barinjve të bagëtisë së Abramit dhe barinjve të bagëtisë së Lotit.*** Ishte gati të shpërthente një konflikt i hapur midis ungjit dhe nipit - e gjitha kjo sepse nuk kishte kullotë të mjaftueshme për të gjithë. Grindjet midis barinjve të Lotit dhe barinjve të Abrahamit po bëheshin gjithnjë e më serioze. Pas çdo incidenti të ri, ata do të vraponin te zotërinjtë e tyre respektivë dhe me zjarr do t'u raportonin fjalët dhe veprimet e kundërshtarëve të tyre. Dukej qartë që situata po degjeneronte.

Po të kishit qenë ju Abrahami, që ishte shumë më i vjetër në moshë se Loti, ç'do të kishit bërë? Po të kisha qenë unë Abrahami, ndoshta do t'i kisha thënë, "Ç'është kjo mënyrë të vepruari! Gjërat kanë shkuar shumë larg! Më mirë mblidh rraqet dhe largohu." Dhe Loti, është më se e mundshme, t'ia ketë kthyer vetëtimthi, "Kurrë ndonjëherë! Unë i mbroj të drejtat e mia. Ti je ai që duhet të largohet!"

Zënkat nuk do të pushonin kurrë me reagime të tilla.

Pastaj gjërat arritën një pikë kulminante dhe dukej se një çarje midis Abrahamit dhe Lotit ishte e paevitueshme. Por plaku i devotshëm jetonte pranë Perëndisë; dhe ndërsa e shikonte të nipin, mendonte me vete, "Konflikt? Përçarje? Jo,- për mua jo! As që mund të diskutohet!" Duke i vënë dorën në sup Lotit, i tha, ***Nuk duhet të ketë mosmarrëveshje midis teje dhe meje, as midis barinjve të mi dhe barinjve të tu, sepse jemi vëllezër.*** Abrahami vazhdoi t'i sugjerojë një zgjidhje të mosmarrëveshjes që mund të kthehej fare mirë në dëm të tij. Por ç'rëndësi kishte kjo? "Grindje? Jo, jo për mua!"

Ndoshta edhe ju e keni njohur këtë lloj situate kur dikush ju ka provokuar fuqimisht. A menduat, si Abrahami, "Grindje? Jo, jo për mua"?

A është kjo mënyra si reaguat? Unë e vë në dyshim. Ju

ndoshta preferuat ta pranonit sfidën për t'u ndeshur, dhe si pasojë madje edhe sot ju nuk shkoni mirë me Zonjën Filan Fistëku apo me fqinjët tuaj. Sa herë kjo thënie e shkurtër - "jo për mua" - do të ketë qenë gjëja e duhur për të thënë.
A nuk tha vetë Zoti Jezus, ***Lum ata që përpiqen për paqen***? Në qoftë se krishterimi ynë ka kaq pak ndikim, a nuk është kjo se kur situatat bëhen kritike ne nuk arrijmë të themi, "Grindje? As që mund të diskutohet!" A nuk ndodh kjo sepse në këtë tip situate ne dështojmë në mënyrë kaq të mjerueshme?

Le t'ju tregoj një histori tjetër nga Bibla që më pëlqen shumë. Është historia e një të riu të quajtur Jozef. Ai u shit nga të vëllezërit, kështu ai arriti si skllav në Egjipt, një vend shumë i madh dhe me qytetërim shumë të lartë në atë kohë. Një i pasur me emrin Potifar, pronari i shumë skllevërve dhe i disa banesave mahnitëse, e bleu atë.

Në vitet e para të adoleshencës, Jozefi kishte vendosur t'i shërbente Perëndisë të gjallë. Ai i kishte thënë Perëndisë, "Unë dua të të përkas ty." Dhe pastaj Jozefi i ri u gjend krejt i vetëm në Egjipt. Ai shikonte se si skllevërit e tjerë vidhnin dhe gënjenin. Por ai nuk pranoi të ndiqte shembullin e tyre. Natyrisht, ata talleshin me të.

Megjithatë, Potifari, shpejt zbuloi se mund t'i besonte Jozefit, kështu ai filloi t'i besojë atij detyra të rëndësishme.

E shihni, megjithëse njerëzit i kundërshtojnë të krishterët, atyre u pëlqen t'i thërrasin ata për punë të caktuara, sepse ata e dinë se të krishterët janë të ndershëm dhe të besueshëm.

Në kohën që Jozefi u bë burrë, zotëria i tij e kishte caktuar si mbikëqyrës të shtëpisë së tij dhe të çdo gjëje që kishte. Bibla shkon aq larg sa thotë, ***la gjithçka kishte në dorë Jozefit, dhe nuk shqetësohej më për asgjë, përveç ushqimit të vet***. Ndoshta Potifari do të kishte dashur t'ia

jepte Jozefit edhe atë punë! Ishte e vetmja gjë për të cilën i duhej të kujdesej vetë.

Jozefi u bë një i ri me trup të zhvilluar mirë dhe i pashëm. Ai vishej me shije dhe elegancë. Kështu nuk është për t'u habitur që gruas së re të zotërisë më në fund i ra në sy. Zonja Potifar ishte pagane. Ishte gjithashtu dhe përtace, sepse kishte një ushtri me skllevër në dispozicion të saj dhe ata kujdeseshin për çdo gjë. Ka një proverb që thotë: "Përtacia është mëma e të gjitha veseve."

Një ditë gruaja e re ia vuri sytë Jozefit dhe filloi të zbavitej me të. Por Jozefi nuk ia vinte veshin. Ishte në një rast tjetër të tillë që ndodhi skena e tmerrshme kur, krejt vetëm për vetëm në shtëpi me Jozefin dhe pre e pasionit të shfrenuar, ajo papritur qëndroi para tij dhe, duke e tërhequr për rroba, iu lut që të bënte dashuri me të. Bibla tregon me fjalë me një bukuri prekëse se si, pas një çasti mendimi, Jozefi iu përgjigj.

"As që mund të diskutohet! Në asnjë mënyrë! Shkelje kurore? Jo për mua!" Ja se si flasim....

Por njerëzit në Bibël kishin një mënyrë më të këndshme për t'i thënë gjërat. Jozefi i zgjodhi me kujdes fjalët: ***Nuk ka asnjë më të madh se unë në këtë shtëpi; ai nuk më ka ndaluar asgjë veç teje, sepse je gruaja e tij. Si mund ta bëj unë këtë të keqe të madhe dhe të kryej një mëkat kundër Perëndisë?***

Kjo ishte mënyra e Jozefit për të thënë, "Jo për mua!"

Të gjithë ne, në një kohë apo në një tjetër, jemi gjendur në këtë tip situate, kur ne jemi tunduar nga një mëkat i veçantë të cilin njerëzit sot nuk e konsiderojnë më si mëkat - mëkatin e shkeljes se besnikërisë bashkëshortore. A kemi reaguar duke thënë, "Perëndia më shikon. Të bëj shkelje të besnikërisë bashkëshortore? Punë që s'bëhet."

Si ndikon te ju qëndrimi i Jozefit?

Kam frikë se po të kishim qenë në situatën e tij, ne kurrë

nuk do të kishim ëndërruar të përgjigjeshim - thjesht nga respekti për urdhërimin e Perëndisë për të qenë të pastër në fjalë e vepër - "Jo për mua! As që mund të diskutohet!" Kjo thënie rrallë të vjen në mendje në ato çaste. Perëndia nuk e harron këtë. Do të vijë dita kur ai do të na i kujtojë të gjitha mëkatet tona. Është fatkeqësi që pikërisht kur kemi më shumë nevojë, fjalët "jo për mua" as nuk na hyjnë në kokë! Megjithatë, kjo është mënyra më e mirë, shumë më e mirë se gjithë të tjerat, për të reaguar në orën e tundimit, kur jemi gati të shkelim me këmbë një nga urdhërimet e Perëndisë. Një nga karakteristikat e shekullit të njëzetë është se njerëzit nuk i marrin më parasysh ligjet e Perëndisë.

Në shugurimin e peshkopit të tanishëm të Hanoverit, mua m'u desh t'u drejtohesha të gjithë pastorëve të qytetit. Vetë peshkopi e kishte sugjeruar temën e fjalimit tim: "Çfarë u mungon pastorëve dhe famullitarëve të qytetit tonë?" Ja se çfarë u thashë unë, në thelb: "Kam vetëm një gjë për t'ju thënë. Ajo që na mungon të gjithëve (pastorë e popull bashkë) është frika e vajtjes në ferr, frika që të shohim Perëndinë t'i marrë gjërat seriozisht, dhe frika për jo-fleksibilitetin e tij kur bëhet fjalë për urdhërimet e tij."

"Jo për mua!" është një përgjigje e shkëlqyer për t'u përdorur kur fryma e kësaj epoke na tundon për t'i shkelur me këmbë ligjet e Perëndisë.

Bibla përshkruan një skenë shumë kuptimplote: Jezusi, Biri i Perëndisë, ishte në majën e një mali shumë të lartë. Djalli - (oh, ju nuk besoni se ai ekziston? Sidoqoftë ai është shumë real, le ta them me që ra fjala) - qëndronte në krah të Jezusit, duke i treguar atij të gjitha mbretëritë e botës dhe lavdinë e tyre. Ai i tha Jezusit, "Unë do t'i jap të gjitha këto, nëse ti vetëm për një çast më bie në gjunjë, dhe më adhuron." Por Biri i Perëndisë u përgjigj. "Jo për mua! E gjithë bota

mund të të bjerë në gjunjë, por për mua as që mund të diskutohet absolutisht." Në realitet ai e jep përgjigjen shumë më mirë: ***Shporru, Satan, sepse është shkruar: 'Adhuro Zotin, Perëndinë tënd, dhe shërbeji vetëm atij'***!

A nuk do të ishte madhështore sikur thënia "jo për mua' të na vinte *gjithmonë* në mendje në kohën e duhur? Është për të ardhur keq që ne nuk e përdorim atë kur duhet.

2. Ne e përdorim atë kur s'duhet

Eh, miqtë e mi, shumica prej nesh e përdorim këtë shprehje jo në kohën e duhur.

Për shembull, para meje është një djalë i ri - një djalosh vërtet i këndshëm, siç mund të thoshte dikush. Unë i them atij, "Ti mund të bëje diçka të madhe me jetën tënde nëse ia dorëzon jetën tënde Perëndisë!" Dhe ai përgjigjet, "Jo për mua! As që mund të diskutohet!"

Ne e trajtojmë Perëndinë sikur... do të përdor një ilustrim për ta shpjeguar. Meqë mjeku im më rekomandoi një shëtitje ditore një orëshe, para ca ditësh mora një rrugë që kalon përgjatë anës së stacionit hekurudhor jugor të Esenit. Dhe atje, mu në mes të rrugës, papritur u ndodha para një komodinë të vjetër tip 'çestërfild'. Duke mos e dashur më, të zotët thjesht e kishin lënë atë në parkun publik të ndihmuar nga errësira e natës. Ata duhet të kenë menduar, "Është problem i qytetit ta heqë qafe atë!"

Ja se si e shoh unë historinë e 'çestërfildit' (krevatit) të vjetër. Ndonjë çift i ri ndoshta e kishte trashëguar atë nga një gjyshe që kishtë vdekur. Por duke patur një apartament modern dhe mobilje të reja, burri i kishte thënë së shoqes, "Ç'do të bëjmë me këtë 'çestërfild' (krevatin) të vjetër? Ai nuk shkon me mobiljet e tjera. Dhe kush e di, mund të ketë edhe pleshta! Gjëja më e mirë është ta heqim qafe." Kështu e

çuan në parkun publik dhe e lanë atje.

Pikërisht kjo është mënyra se si e trajtojnë sot burrat dhe gratë Perëndinë e gjallë. Ai thjesht nuk mund të përshtatet me stilin tonë të jetesës. Dhe ai nuk i përshtatet as shoqërisë sonë moderne pluraliste! Dhe as nuk konformohet ai me mentalitetin e epokës sonë. Kështu ç'do të bëjmë me të? Le ta lëmë 'çestërfildin' (krevatin) e vjetër në kishë. Sidoqoftë rri mbyllur gjithë javën!

Miqtë e mi, Perëndia i gjallë nuk është një 'çestërfild' (krevat) i vjetër! Qartë? Perëndia nuk është një objekt i vjetër që mund ta flakim tej si të duam vetëm se na duket jashtë mode. A keni ndonjë ide pikërisht se kush është Perëndia i gjallë? Ndoshta kisha është pjesërisht përgjegjëse për faktin se Perëndia është problem për shumë nga ne. Në të vërtetë, thjesht përmendja e emrit të tij do të ishte e mjaftueshme për të na futur të dridhurat. Por ne gjejmë strehë prapa një muri indiference - jo për mua!

Le të përpiqemi të rikthehemi duke gjurmuar nga efekti në shkakun. Pothuajse kudo dëgjojmë se tërë bota perëndimore është e sëmurë. Jo vetëm fizikisht e sëmurë - me shtimin e kancerit, leuçemisë, sëmundjeve të zemrës, dhe të gjitha llojet e tjera të sëmundjeve - por gjithashtu e sëmurë shpirtërisht. Ajo ka më të keqen e të gjitha sëmundjeve. Njeriu modern vuan nga mungesa shpirtërore. Ky është i vetmi shpjegim për rritjen alarmante të rasteve të depresionit. Siç e ka thënë një mjek mendjehollë zviceran: "Brezi ynë po vuan nga mungesa e Perëndisë." Në mesjetë, njerëzit akoma mbështeteshin te Perëndia - katedralet që ndërtuan ata e bëjnë të qartë këtë. Por me kalimin e kohës njeriu u përpoq ta hiqte qafe Perëndinë. Marksizmi nuk është asgjë tjetër veçse një përpjekje vigane për ta lënë Perëndinë mënjanë. Ata janë përpjekur ta zëvendësojnë atë me teknologji. Studiuesit, në

përpjekjet e tyre për të provuar se Perëndia nuk ekziston, i janë drejtuar penës. Dhe masat popullore kanë bërtitur, "Feja është opium për popullin." Edhe vogëlushi më naiv do të ketë pyetur veten se ku mund të fshihej Perëndia; dhe ndërsa akoma vazhdon të thithë gishtin e madh të dorës, ai ka thirrur me habi, "Unë nuk e kam parë - kështu që ai nuk mund të ekzistojë!"

Po, është bërë gjithçka për të na hequr qafe Perëndinë!

Dhe cili është rezultati? Të gjitha këto përpjekje kanë përfunduar në dështim. Ne nuk kemi qenë në gjendje të heqim qafe Perëndinë. Akoma po kërkoj një ateist të ndershëm me kurajën e mjaftueshme për të deklaruar me bindje se Perëndia nuk ekziston. Ky tip personi nuk gjendet askund sot. Madje edhe nëse do të zbulohej një, ai do të ishte aq bajat sa që nuk mund të merrej seriozisht.

Pak para vdekjes, një nga themeluesit e fizikës bërthamore moderne, Profesor Maks Plank, botoi një broshurë të titulluar *Feja dhe Shkenca.* Në të ai deklaron: "Për ne shkencëtarët, sot është e qartë se Perëndia është qëllimi themelor i gjithë dijes." Është e qartë se njeriu nuk ka qenë në gjendje ta eliminojë Perëndinë.

Mbajta një sërë konferencash, jo shumë kohë më parë, në një qytet të vogël në male. Kur dola nga kisha një mbrëmje, shikova një grup djemsh të rinj, të gjithë rreth njëzet vjeç, që po sorrollateshin jo larg meje. "Pse nuk hyni?" i pyeta. "H'm." "Kjo nuk është përgjigje! Më thuaj," thashë duke iu kthyer njërit prej tyre, "a beson se ekziston Perëndia?" "Nuk e di," ishte përgjigjja. "Por kjo është shumë e keqe. Ose ai ekziston - dhe duhet t'i përkushtohesh atij - ose nuk ekziston - dhe ti duhet të largohesh nga kisha. Thuaj, nuk e ke hequr akoma emrin nga regjistri i kishës?" "Jo!"

Duke parë nga një djalosh tjetër, vazhdova: "Po ti? A beson se Perëndia ekziston?" "Po!" "Më thuaj atëherë,"

e pyeta, "a i respekton urdhërimet e tij?" "Oh jo!"

Shkova nga njëri te tjetri, duke i pyetur; dhe as edhe një i vetëm nuk guxoi ta mohojë ekzistencën e Perëndisë. E megjithatë asnjë prej tyre as nuk dëshironte që seriozisht t'ia dorëzonte jetën e tij Perëndisë. Dhe kudo është njëlloj.

Shumë njerëz më thonë gjatë vizitave të mia pastorale, "Unë besoj se ka një Perëndi, por ua lë të tjerëve të shkojnë në kishë." Këta njerëz nuk e mohojnë Perëndinë, por sidoqoftë nuk duan të përzihen me të.

Dhe kështu problemi i Perëndisë mbetet pa përgjigje. Problemet që nuk gjejnë kurrë zgjidhje mund të krijojnë komplekse serioze, dhe shqetësime nervore ose mendore. Ata në fund të fundit mund ta çojnë një njeri në shkatërrim. Ne i bëjmë një dëm të madh vetes kur nuk shqetësohemi për të sqaruar problemin e Perëndisë.

Në kishat tona, ka një burrë në çdo dhjetë gra që vijnë në shërbesat tona. Ku janë burrat e tjerë? Unë mund t'ju siguroj se shumë kohë më parë se të shkoni në ferr, ju do të keqësoheni nga brenda; dhe kjo do të ndodhë sepse ju nuk keni as kurajën për ta vënë jetën në duart e Perëndisë, dhe as mjetet për ta hequr qafe atë.

Përballë kësaj situate të veçantë, ne të krishterët kemi për të shpallur një mesazh të jashtëzakonshëm: Ky Perëndi që ne e trajtojmë në mënyrë kaq të tmerrshme, prishi murin që na ndante prej tij dhe erdhi te ne në personin e Jezusit. Një Shpëtimtar hyjnor erdhi në tokë! Jo vetëm që ai jetoi midis nesh, por ai vdiq për ne në kryq. Është e mundur që Perëndia të bëjë më shumë se aq për ne? Pastaj ai u ngrit nga të vdekurit - duke e mundur vdekjen dhe duke hapur rrugën e jetës.

Po ju? Gjithçka që ju arrini të thoni është, "Epo, e gjitha kjo është mjaft interesante. Ia vlen ta dëgjosh, por nuk është

për mua!"

Një paqëndrueshmëri e tillë më mbush me neveri. Kjo, në kuptimin e drejtpërdrejtë, më bën të vjell.

Në vitet e para të veprimtarisë sime si pastor, ishte një punëtor në famullinë time që, sa herë që përpiqesha t'i flisja për Jezusin, më përzinte duke më tallur. Një herë e pyeta, "Si shpreson ta përballosh vdekjen?" Ai u përgjigj, "Ou ju pastorët, gjithmonë përpiqeni të na trembni duke folur për vdekjen. Mua më hiq nga lista!"

Ai vazhdoi në këtë mënyrë deri ditën kur u shtri në shtratin e vdekjes - nuk ishte as dyzet vjeç. E shoqja më telefonoi në mes të natës. U sula për t'i qëndruar pranë. "Erdhi çasti," i thashë, "kur Jezusi të thërret për herë të fundit." Ishte e tmerrshme. Ai donte të lutej por nuk mundej. Unë përsërita njërin varg biblik pas tjetrit - fjalë faljeje - por ai thjesht nuk mund t'i kuptonte ato. Ai kishte thënë, "Më hiq nga lista!" Tani ishte Perëndia që nuk ishte më i gatshëm. Burri vdiq në torturat e dëshpërimit të thellë dhe kurrë nuk gjeti paqe me Perëndinë.

Ka një varg solemn në Bibël që thotë kështu: "Si do të shpëtojmë ne në qoftë se lëmë pas dore një shpëtim kaq të madh?"

Ju lutem shumë, merreni seriozisht këtë mesazh të jashtëzakonshëm. ***Sepse Perëndia e deshi aq botën sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme***. Por Jezusi bën edhe më shumë se kaq. Ai flet një fjalë ngushëlluese për të gjithë ne: ***Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe e hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua***.

Ka nga të gjitha llojet e "të krishterëve". Ka nga ata që kënaqen kur i japin kishës së tyre lëmoshë - njerëz të mirë por tmerrësisht të mërzitshëm. Ka nga ata që shkojnë në

kishë vetëm për Krishtlindje - ndiej keqardhje për ta, për këta të krishterë të ditëve të shënuara. Pastaj janë ata që dërgojnë gratë në kishë, por që kurrë nuk shkelin vetë në të - kjo s'u kushton asgjë. Të tjerët thonë, "Unë jam pagëzuar" - epo të paktën kjo është diçka; por nëse nuk ka më shumë në të se kaq.... Dhe së fundi janë ata që, pasi kanë dëgjuar thirrjen e Shpëtimtarit të gjallë, janë përgjigjur, "Më hiq nga lista!"

Është vërtet e tmerrshme! "Zoti Jezus," thonë njerëzit, "po marr pak krishterim. Por të të lejoj ty që të marrësh në dorëzim jetën time? Kësaj i thonë me të vërtetë të shkosh shumë larg. Jo për mua!"

Ja se si mund ta përdorim thënien "jo për mua" kur s'duhet.

Në qoftë se doni ta njihni vërtetësinë e Jezusit personalisht, atëherë duhet t'ia vini veshin thirrjes së tij, të hapni derën dhe ta lejoni Atë në jetën tuaj.

3. Dikush që nuk e përdor

Është dikush që do të kishte shumë arsye për të thënë "jo për mua!" por që nuk thotë - lavdi Perëndisë! Është vetë Zoti Jezus.

Kam një histori tjetër për të treguar. Një autor danez me emrin Jakobson ka shkruar një roman prekës me titull, *Vdekja e Zezë në Bergamo.* Bergamo është një qytet i vogël në Itali, jo larg nga Ravena, i ndërtuar në një shpat mali. Në të mund të hyhet vetëm nëpërmjet një shtegu me gurë. Në historinë e Jakobsonit, në qytetin e vogël një ditë në mesjetë shpërtheu murtaja. Ishte e tmerrshme! Ditë e natë binin kambanat. Njerëzit i thërrisnin Perëndisë duke e lutur për ndihmë. Por nuk ndodhi asgjë. Murtaja i goditi akoma më keq.

Njerëzit e qytetit u mbushën me frikë dhe i thanë njëritjetrit, "Perëndia vdiq." Atëherë ata e flakën tej vetëpërmbajtjen. Kadet u rrokullisën jashtë qilarëve të verës, dhe të gjithë filluan të pinin lirshëm dhe rëndshëm. Nuk shkoi gjatë para se të dukeshin burra dhe gra të dehur të çiftosur për t'u dhënë me gjithë qejf pas seksit - pa u merakosur fare se kush mund të ishte partneri i tyre. Periudha e pirjes degjeneroi në një orgji të vërtetë - një orgji dëshpërimi. Për ditë me radhë asgjë tjetër nuk llogaritej por vetëm ndjekja e instinkteve të dikujt. Herë pas here, pikërisht në mes të vallëzimit, dikush rrëzohej i goditur nga sëmundja. Por askush nuk i kushtonte vëmendje. Orgjia vazhdonte.... "Le të hamë, të pimë dhe të gëzojmë, sepse nesër do të vdesim!"

Pastaj një ditë, krejt pa pritur, që të gjithë pushuan. Larg në distancë dëgjohej një këngë. Të gjithë vrapuan te porta e qytetit. Ata panë, për çudinë e tyre të madhe, një procesion të penduarish që po i ngjiteshin shtegut që të çonte në qytet. Ndërsa po i ngjiteshin kodrës, ata po thoshin një lutje: "Kyrie eleison - Zot ki mëshirë për ne!" Në krye të procesio-nit ishte një murg i ri që mbante një kryq të rëndë prej druri. Kortezhi arriti më në fund te portat e qytetit, por banorët e Bergamos vetëm rrinin atje në këmbë dhe qeshnin. "Tufë idiotësh!" thirrën ata. "Këtu, Perëndia ka vdekur. Pushojeni atë psalltjen tuaj idiote. Perëndia ka vdekur! Ejani, bashko-huni me ne. Të gjithë le të hamë, të pimë dhe të gëzojmë, sepse nesër do të vdesim!"

Murgu që kryesonte procesionin nuk u kushtoi aspak vëmendje dhe vazhdoi të ecte. Megjithëse askush nuk kishte qenë në kishë për ditë të tëra, dyert ishin të hapura kanat më kanat. Procesioni u drejtua për në kishë. Murgu e mbështeti kryqin e tij pas një kolone. Atëherë hordhia e egërsuar, e tërbuar e qytetarëve të dëshpëruar, të destinuar për të vdekur, vërshoi në kishë me britma dhe me të qeshura të forta. Një

kasap nxënës që mbante një përparëse të lyer me gjak, plotësisht i luajtur mendsh nga dëshpërimi, marshoi për tek altari. Duke rrëmbyer një kupë të artë, ai e ngriti atë lart dhe bërtiti, "Le të pimë dhe të dehemi sepse këtu Perëndia ka vdekur!"

Ndërkohë, murgu kishte shkuar te katedra. Ai ishte shumë i zbehtë, por me një lëvizje të dorës ai i bëri shenjë turmës të heshtte. U rivendos qetësia. Atëherë ai filloi të flasë: "Dua t'ju tregoj diçka. Kur e varën Birin e Perëndisë në kryq dhe ia shpuan duart me gozhdë, të gjithë atje filluan ta përqeshnin, ta sfidonin dhe ta tallnin. Madje edhe dy hajdutët e kryqëzuar në të majtë dhe në të djathtë të tij, u bashkuan në tallje me turmën. Atëherë Biri i Perëndisë mendoi, 'A mos vallë duhet të vdes për këta njerëz, që nuk janë prekur as nga vdekja që po më afrohet? A duhet ta jap jetën për njerëz kaq të neveritshëm dhe zemërgur?' Dhe duke bërtitur me zë të lartë, 'Jo për mua! Më hiq nga lista!', ai i shkuli gozhdët nga druri me anë të fuqisë së tij hyjnore, kërceu nga kryqi, dhe e rrëmbeu mantelin e tij prej ushtarëve me aq forcë sa që zaret shkuan duke u rrokullisur nëpër gjithë rrugën e kodrës së Kalvarit! Ai e hodhi mantelin mbi supet e tij dhe u kthye në qiell, duke përsëritur gjatë gjithë rrugës, 'Jo për mua! Më hiqni nga lista!' Kryqi mbeti bosh. Kështu tani nuk ka asnjë mundësi për shpengim, për shpëtim ose për jetë të përjetshme. Ne na presin vetëm vdekja dhe ferri."

Me këto fjalë, murgu përfundoi. Në kishë ra një heshtje varri.

Ndërkohë, ndihmës kasapi kishte zbritur nga altari dhe po qëndronte pikërisht poshtë katedrës. Kupa i shkau nga duart. "Nuk ka asnjë mundësi për shpengim, për shpëtim...". Duke bërë tre hapa para, ai drejtoi gishtin te murgu dhe bërtiti me një ton të mprehtë, "Hej, ti atje lart! Ktheje Shpëtimtarin

prapë në kryq, ktheje Shpëtimtarin prapë në kryq."

Miqtë e mi, murgu nuk i tregoi faktet ashtu siç ndodhën në të vërtetë.

Siç e shihni, një nga gjërat më të habitshme është se Biri i Perëndisë *nuk* tha, "Jo për mua!" Në një farë mënyre, Jezusi vazhdon ta lejojë veten e tij të kryqëzohet prej atyre që thonë, "Puna, kënaqësia dhe shëndeti janë më të rëndësishme për ne se sa shpëtimi."

Po, Zoti do të kishte çdo arsye për të deklaruar, "Jo për mua! Bëni çfarë t'ju dojë qejfi!" Megjithatë, edhe sot e kësaj dite ai nuk ka pushuar së qeni i interesuar për ju.

Po të kisha qenë unë Jezusi, do ta kisha lënë botën të vazhdonte rrugën drejt shkatërrimit të saj. Por Biri i Perëndisë nuk tha, "Jo për mua! Më hiqni nga lista!" Përkundrazi. Ai vazhdon të na kërkojë. Edhe sa kohë do t'i duhet atij t'ju kërkojë? Kur do të arrini ta kuptoni se ai kërkon që ju të bëheni të tijtë? Kur do t'ju hapen sytë? Kur do t'i thoni atij, "Zoti im, Shpëtimtari im"?

Shkurt, pika ime e fundit....

4. Ne nuk mund t'i bëjmë dot ballë vetë

Atyre që e refuzojnë atë duke thënë, "Jo për mua! As që mund të diskutohet!", Jezusi u përgjigjet, "Pa mua ju nuk mund të bëni asgjë." Kjo është absolutisht e vërtetë. Gjithçka që mund të bëni në jetë pa Shpëtimtarin është pa asnjë vlerë nën dritën e përjetësisë.

Një ditë pashë disa djelmosha që po ziheshin në rrugë. Një vocërrak që rastisi të kalonte aty pranë, mori gjithashtu pjesën e tij të goditjeve, ndoshta rastësisht. Sapo po mendoja nëse duhet të ndërhyja, u bëra dëshmitar i një skene prekëse. Në një farë mënyre, vocërraku ia arriti t'i shkëputej përleshjes. Nga sytë i rridhnin lot, hundët i kullonin, por ai

filloi të vraponte sa i hanin këmbët e tij të vogla. Kur u sigurua se ishte larguar sa duhet, ai ndaloi dhe ulëriti me sa kishte në kokë, "Do ta shikoni, do t'i them vëllait të madh!" Papritur përleshja u ndërpre. Ai paskësh një vëlla të madh! Një vëlla të madh të cilit mund t'i thoshte çdo gjë dhe që ishte gati ta ndihmonte. Dhe unë thashë me vete, "Miku im i vogël, është gjë e madhe që ke një vëlla të madh!"

Zemra ime u mbush plot me gëzim atë ditë - sepse edhe unë kam një vëlla të madh që më qëndron në krah. Jezusi! Është e mrekullueshme të shohësh se si ky vëlla i madh ndërhyn fuqishëm për llogari të të vetëve. Dhe ai na kujton: "Pa mua ju nuk mund të bëni asgjë."

Pse të mos i thoni atij që ka bërë aq shumë për ju, "Zoti Jezus, unë nuk dua të bëj asgjë pa ju që tani e tutje"?

A KA NDONJË SIGURI NË ÇËSHTJET RELIGJIOZE?

Jo! Është e qartë se në problemet religjioze ne nuk mund të kemi asnjë siguri. Feja është, me përkufizim, kërkimi i Perëndisë nga njeriu. Shqetësimi dhe pasiguria e vazhdueshme janë pjesë e pashmangshme e kësaj pune.

Nuk është kështu me Ungjillin, i cili është kërkimi i njeriut nga Perëndia. Ndoshta do të ishte më mirë ta bënim pyetjen në mënyrë tjetër: A na jep ungjilli ndonjë siguri?

1. Pasiguri e madhe mbreteron tek njerzit – në lidhje me Perëndinë

Njerëzit e sotëm janë qesharak! Sapo një djalosh i shëndetshëm e i fuqishëm ka pak dhembje, ai vrapon te mjeku dhe i thotë, "Doktor, këtu më dhemb vërtet. Çfarë kam?" Ai do ta dijë me saktësi se çfarë ka.

Ose merrni rastin e një familjeje që kërkon një shërbëtore. Një vajzë e re kërkon ta bëjë atë punë. "Mirë", thotë zonja e shtëpisë, "do të kesh një dhomë me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, një televizor dhe një magnetofon stereo. Do të kesh gjithashtu një ditë të plotë pushim çdo javë." "Shumë mirë," përgjigjet vajza, "por do të doja të dija sa para do të marr në fund të muajit." Zonja përgjigjet, "Do të biem dakord për këtë pikë vetëm pasi unë të të shoh si punon!" "Kurrë!" kundërpërgjigjet vajza. "Nën këto rrethana, më mirë nuk po e pranoj punën. Dua ta di që më parë se sa do të fitoj!" A nuk kishte të drejtë? Sigurisht që kishte.

Kur bëjmë kërkesë për punë, është e qartë se çështja më e rëndësishme është se sa do të jetë rroga dhe cila do të jetë pozita jonë. Duam të dimë se ku jemi. Atje ku është çështja për para ne nuk tolerojmë asnjë pasiguri. Dhe kështu ndodh me të gjitha pjesët e jetës sonë - përveç asaj më së

rëndësishmes nga të gjitha: marrëdhënies sonë me Perëndinë. Aty ne tolerojmë dyshimin më të pabesueshëm.

Shumë vjet më parë, mbajta një sërë takimesh në qytetin e Augsburgut. Ishte ngritur një tendë në Sheshin Plärrer ku bëhet panairi i përvitshëm. Komiteti që organizonte takimet pati një ide të shkëlqyer. Të shtunave mbrëma, vendet e argëtimit në qytet ishin zakonisht plot. Kështu ata vendosën të mbahej një takim natën e së shtunës - në mesnatë! Takimi nuk ishte shpallur publikisht. Ata nuk donin të shikonin shumë të krishterë që të dyndeshin aty nga kurioziteti.

Sapo ora ra njëmbëdhjetë e gjysmë, shokët e mi u hodhën në veturat e tyre për të mbledhur njerëzit jashtë në qytet derisa ata dilnin nga kafenetë dhe kabaretë që mbylleshin në mesnatë. U morën gjithashtu kamarierët dhe kamarieret që ktheheshin nga puna për në shtëpi. Njëra pas tjetrës, veturat lëshonin pasagjerët e tyre para derës së tendës. Dhe kur në mesnatë, unë u ngjita në platformë për të folur, para meje ndodhej një audiencë e jashtëzakonshme. Disa njerëz ishin pak si gjysmë të pirë. I ulur mu në radhën e parë ishte një burrë i shëndoshë me një puro gjysmë të përtypur që e shtrëngonte në gojë dhe me një borsalinë në kokë. "Epo," mendova, "le të shpresojmë që gjërat të shkojnë në rregull!" Pastaj fillova të flisja. Në çastin që përmenda emrin e Perëndisë për herë të parë, ai i shëndoshi me borsalinë ulëriti, "Nuk ekziston!" Të gjithë shpërthyen në të qeshura. Por unë u përkula mbi katedër dhe pyeta, "A je i sigurt për këtë?" Ai kruajti kokën dhe borsalina i ra mbi hundë; pastaj, duke e kaluar bishtin e puros në cepin tjetër të gojës, më në fund u përgjigj, "Epo, mendoj se askush nuk di ndonjë gjë të sigurt për Perëndinë." Unë vetëm qesha dhe thashë, "Më fal por unë kam një informacion të sigurt." "E çfarë di ti për këtë?" thirri ai. "Dhe cili është burimi nga e ke marrë?" U përgjigja se është Jezusi që na jep të gjitha faktet për Perëndinë. Një

heshtje prej varri ra në atë çast në sallë.

A keni siguri për Perëndinë? Dhe ju të krishterë, a mund të thoni, "E *di* që kam jetë në të; e *di* që me dashurinë e tij ai më ka shpëtuar"? Shumica prej jush ndoshta do të përgjigjen, "Kështu shpresoj!"

A nuk është për t'u habitur që aty ku është çështja për Perëndinë, si besimtarët, po ashtu edhe jobesimtarët i nënshtrohen jetesës në dyshim dhe pasiguri? Në qoftë se do të shkoja nga njëra anë e qytetit në tjetrën, duke u bërë këtë pyetje të gjithë atyre që do të takoja gjatë rrugës, "Më thuaj, a beson se Perëndia ekziston?" ata të gjithë do të përgjigjeshin, "Po; duhet të ketë Perëndi!" Por në qoftë se unë do të vazhdoja me këtë pyetje, "A i përket ti atij?", po të njëjtët njerëz do të thoshin, "Nuk e di."

Në një fushë kaq jetësore sa kjo, burra e gra janë gati të pranojnë situatën më të mjegullt!

Një nga të rinjtë tanë pati një përvojë interesante vetëm pak kohë më parë. Ai është student; dhe me qëllim që të siguronte ca para xhepi, zuri një punë gjatë verës si punëtor i pakualifikuar në një kompani ndërtimi. Një ditë shokët e tij të punës zbuluan se ai ishte aktivist në një grup të rinjsh protestantë. "Pash Zotin!" thirrën ata me habi. "Mos je me pastor Bushin?" "Po." Pas kësaj erdhi një goxha raund talljesh. Ata nisën ta përqeshnin. "Ti ndoshta shkon në kishë të dielën?" "Sigurisht që po!" "Çdo të dielë?" "Po, çdo të dielë." "Por, ti duhet të jesh i çmendur!" thirrën ata. "Sigurisht që jo! Madje shkoj në studim biblik gjatë javës." "Mos po tallesh?" ishte reagimi. "Epo kjo është tamam çmenduri!" Pastaj ata vollën gjithë vrerin e tyre mbi të: "Predikuesit synojnë vetëm t'i bëjnë bashkësitë e tyre budallenj!" "Krishterimi ka dështuar në mënyrë të mjerueshme pas dy mijë vjet përpjekjesh." "Bibla është

vetëm një deng me gjepura."

I riu u ndodh nën një sulm shumë të rëndë. Por ai e kishte lëkurën si të elefantit, dhe e la që çdo gjë t'i anashkalonte. Pastaj ai u tha atyre, "Në qoftë se ky është qëndrimi juaj ndaj krishterimit, e marr me mend se ju të gjithë jeni larguar nga kisha." Heshtje. Një nga më të moshuarit mori fjalën, "Ç'do të thuash me 'larguar nga kisha'? Dreqi e mori! Edhe unë besoj në Zotin e mirë. Më duket se ti mendon se je i vetmi i krishterë. Unë besoj në Zotin e mirë po aq sa dhe ti!" U futën dhe të tjerët në bisedë, "Ti ke një mënyrë për t'u bërë të dukesh më mirë se të tjerët. Edhe ne jemi të krishterë. Ne besojmë te Perëndia ashtu si edhe ti." Papritur rolet u ndërruan. Ata të gjithë filluan të ulërinin së bashku: "Edhe ne besojmë në Perëndinë. Jemi po aq të krishterë sa edhe ti." Kur u qetësuan, miku im i ri i pyeti, "Mirë atëherë, pse talleni me mua?" Ata u përgjigjën, "Ti na ngre nervat. Nuk ka asnjë mundësi për të folur me ty."

Ata punëtorët e ndërtimit ishin djem trupmëdhenj dhe pas një pune të rëndë mund të rrëkëllenin dy pinta birrë përnjëherësh. Ata as që çanin kokë për krishterimin; por kur ziheshin ngushtë, e vetmja gjë që mund të thoshin ishte, "Edhe ne jemi të krishterë!"

Çfarë t'i themi gjithë kësaj? A nuk është shqetësuese?

Atje ku është çështja për Perëndinë, ne nuk shqetësohemi të jetojmë në terr. Njerëzit jetojnë ndonjëherë si paganë, ndonjëherë si të krishterë. Mos e kam gabim? Kam frikë se shumica prej jush jetojnë në të njëjtën pasiguri, në të njëjtin konfuzion.

2. Bibla na jep siguri të mrekullueshme

Ju mund të protestoni: "Por, pastor Bush, besimi i krishterë nuk ka të bëjë fare me siguritë! A nuk qëndron

gjenia e krishterimit në faktin se ne nuk dimë asgjë por që besojmë në çdo gjë?"

Jo shumë kohë më parë, një burrë më dha një nga ato argumentet e gatshme që i kam dëgjuar aq shpesh nëpër vite: "E di që dy dhe dy bëjnë katër; por përsa i përket krishterimit, ne nuk mund të dimë asgjë, ne na duhet vetëm të besojmë." Sipas kësaj pikëpamjeje, duket se atje ku është çështja për të vërtetat biblike na kërkohet që ta vëmë logjikën në gjumë dhe të kemi një besim të verbër. Shumica e njerëzve e besojnë këtë.

Dikush tjetër mund të thotë, "Por ju të krishterët nuk bini dakord as midis jush. Ka katolikë, protestantë dhe sekte. Dhe midis protestantëve, ka anglikanë, luteranë, presbiterianë, dhe shumë e shumë të tjerë. Cili grup ka të drejtë?"

Më duket se edhe bota e krishterë është bindur se besimi i krishterë është, në thelb, diçka jashtëzakonisht e paqartë, jashtëzakonisht e pasigurt. Por ky është një gabim serioz.

Në fakt, vetëm nëpërmjet Dhiatës së Re mund të mësojmë pikërisht atë që është besimi i krishterë. Çdo frazë pa përjashtim përmban siguri. Kjo është tej çdo dyshimi! Nuk është normale që të krishterët të jetojnë në një pasiguri të tillë. Por nuk është faji i krishterimit - absolutisht jo! Dhiata e Re është plot me siguri të mrekullueshme, nga fillimi deri në fund.

Një prej tyre është fakti i *ekzistencës së Perëndisë.* Ai nuk paraqitet si Qenia Supreme, Providenca, Fati, apo Zoti i mirë, por si *Ati i Zotit tonë Jezu Krisht.* Ai Perëndi vërtet ekziston! Si mund ta dimë këtë? Sepse ai e zbuloi veten në personin e Birit të tij. Ne mund të jemi absolutisht të sigurt për këtë. Hapeni Biblën në çdo faqe. Bibla nuk flet për probleme fetare. Ajo dëshmon se Perëndia ekziston dhe se ai e zbuloi veten e tij nëpërmjet Jezu Krishtit. Ajo tregon gjithashtu se

njeriu që jeton pa Perëndinë nuk bën jetë të drejtë.

Një siguri tjetër është fakti se ky *Perëndi* (i cili është i aftë të shkatërrojë kombe dhe të zbatojë drejtësinë) *më do shumë.* Ne nuk jemi reduktuar në hamendje. Ne lexojmë në Romakët 8:38-39: ***Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta, as engjëjt, as pushtetet, as fuqia dhe as gjërat e tashme as gjërat e ardhshme, as lartësitë, as thellësitë, as ndonjë tjetër krijesë, nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezu Krishtin, Zotin tonë.*** Kjo është një diçka që ne nuk e supozojmë; është diçka që ne e *dimë.*

Si na bëhet e njohur dashuria e Perëndisë? Ajo shfaqet në Jezu Krishtin. Kështu besimtari mund të këndojë:

Kur paqja, si lumë, rrugën ma shoqëron,
Kur brengat, si tallaz deti, vërtiten me tërbim;
Çfarëdo fati që të kem, Ti, të them më mëson,
"Është mirë, është mirë me shpirtin tim."

Dhe Satani do më godasë, dhe sprovat do të vijnë,
Le të kontrollojë kjo siguri e bekuar,
Që Krishti e pa gjendjen time të pashpresë,
Dhe derdhi për shpirtin tim gjakun e tij të çmuar.

Mëkati im - oh hareja e këtij mendimi të lavdishëm!
Jo pjesërisht - por i tërë mëkati im,
Është gozhduar në kryqin e Tij; dhe unë nuk e mbaj më:
Lëvdo Zotin, Lëvdo Zotin, o shpirti im!

Për mua, qoftë Krishti, qoftë Krishti, që sot për të jetuar!
Në qoftë se lumi Jordan sipër meje do kalojë me rrëmbim,
Asnjë dhembje s'do të jetë e imja, sepse në vdekje si në jetë
Ti do t'i pështpëritësh paqen tënde shpirtit tim.
Por, Zot, për Ty, për ardhjen Tënde ne po presim;
Qielli, jo varri, është yni synim:
Oh, trumbetë e engjëllit! oh zë i Zotit!
Shpresë e bekuar! Prehje e bekuar e shpirtit tim!

A dini diçka nga kjo? A jeni të sigurt për këtë?

Besimtarët e ndryshëm të përmendur në Bibël gjithashtu kishin *siguri të plotë për shpëtimin e tyre* dhe ata e dinin që ishin fëmijët e Perëndisë. ***Ai na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur.*** Dishepujt e Jezusit përjetuan një ndryshim rrënjësor në jetën e tyre - dhe ata e dinin këtë! Gjoni shkroi: ***Ne e dimë se kemi kaluar nga vdekja në jetë.*** A mund ta thoni ju këtë? Diku tjetër gjejmë këtë: ***Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë.*** Këtu kemi një folje në kohën e tashme: ***JEMI.***

Bibla është plot me siguri.

Nga vjen atëherë, kjo thënie absurde: "E di që dy dhe dy bëjnë katër. Por përsa i përket krishterimit, ne nuk dimë asgjë, ne vetëm na duhet të besojmë"? Edhe unë e di që dy dhe dy bëjnë katër. Por unë jam akoma më i sigurt se Perëndia ekziston. E di që dy dhe dy bëjnë katër. Por jam akoma më i sigurt që Perëndia na do në Jezu Krishtin. Të gjithë ata që ia kanë dorëzuar jetën e tyre Perëndisë të gjallë mund të bëjnë një hap më tej: ne e dimë që dy dhe dy bëjnë katër. Por ne jemi akoma më të sigurt se jemi bij të Perëndisë.

Më thoni, në cilat kisha predikojnë sot siguri kaq absolute? Ku, ju pyes? A nuk demonstron kjo se ne kemi devijuar nga pozicioni biblik dhe është tamam koha që t'i kthehemi atij përsëri? Le të heqim qafe krishterimin tonë të holluar me ujë! Një pikë besimi të krishterë nuk bën dobi. Ai për të cilin kemi nevojë është një besim që është tërësisht biblik, një besim që ia pranon Perëndisë fjalën e dhënë. Kjo është ajo për të cilën kemi nevojë të jemi të gjithë të sigurt: që Perëndia ekziston, që ai na do dhe që ne jemi bijtë e tij. Çdo gjë tjetër është dytësore.

Ka dy aspekte ndaj sigurive të besimit të krishterë. Unë e di nga ana *objektive* se Perëndia ekziston dhe se zbulesa e tij në personin e Jezu Krishtit është e mirëfilltë - madje edhe pse e gjithë bota e hedh poshtë atë. Unë di gjithashtu se Jezusi vdiq për të pajtuar mëkatarin me Perëndinë dhe se ai u ngrit nga të vdekurit për ta shpëtuar atë - madje edhe nëse askush nuk do ta shfrytëzonte këtë. Nga ana tjetër, unë e di nga ana *subjektive* se Perëndia ekziston, se ai e zbuloi veten e vet në Jezu Krishtin, se ai vdiq dhe u ngrit nga të vdekurit. Unë e di këtë sepse personalisht e kam përvetësuar atë me anë të një akti të qëllimshëm besimi.

Në qoftë se dhjetë mijë dijetarë do t'i deklaronin një besimtari të ri se Jezusi nuk u ngrit nga të vdekurit, ai mund të thotë këtë, "Zotërinj, pavarësisht nga respekti që kam borxh për ju, unë e *di* që Shpenguesi im jeton." Sikur gjithë bota të ishte kundër tij, besimtari mund të deklaronte me vendosmëri, ***E di kujt i kam besuar***. Sikur të më mbysnit me argumente shkencore, do t'ju përgjigjesha, "Unë di më shumë për këtë se sa ju!" Dhe madje edhe sikur gjithë universi ta dyshonte atë, unë ende do të thosha, "Jam i sigurt për këtë."

Kur besimi ynë është i themeluar në Bibël, është po kaq i fortë!

3. A e keni ju këtë siguri?

Tani kam për t'ju bërë një pyetje. A keni ju personalisht një siguri të tillë? Apo akoma ju mungon në jetën tuaj? Unë nuk do të kem folur më kot në qoftë se ju arrini të pranoni, "Mendoja se isha i krishterë, por nuk mund të jem sepse çdo gjë është kaq e paqartë në mendjen time...".

Më kujtohet një kamp të rinjsh ku mora pjesë në Holandë. Rreth orës dy të mëngjesit u zgjova nga një trokitje në derë. E

hapa dhe pashë para meje gjithë grupin të veshur me pizhame. "Ç'ju solli këtu në këtë orë të natës?" pyeta. Një prej tyre u përgjigj, "Mendonim se ishim të krishterë. Sapo arritëm të kuptojmë se e kishim gabim.
" Ata ishin aq të shqetësuar për këtë sa që donin ta sqaronin çështjen aty për aty në mes të natës!

Ne kemi bërë një hap të madh në jetën tonë kur pranojmë që, megjithëse e quajmë veten tonë të krishterë, jemi larg nga të paturit e sigurisë që jep Bibla.

Çarls Hedon Spërxhën, predikuesi i famshëm londinez i cili ishte në fillesën e një rigjallërimi të fuqishëm në shekullin e kaluar, tha dikur: "Besimi është një shqisë e gjashtë."

Siç e dini ne kemi pesë shqisa që na lejojnë të perceptojmë botën e jashtme: të shijuarit, të nuhaturit, të dëgjuarit, të prekurit dhe të parët. Me anë të tyre ne jemi në gjendje të gjejmë rrugën tonë në këtë botë tridimensionale. Një njeri që pranon vetëm ato që mund të perceptojë me anë të shqisave arsyeton kështu: "Ku mund të jetë Perëndia? Unë nuk mund ta shoh. Nuk mund ta shoh as Jezusin. Kështu si mund të prisni që unë të besoj?"

Por kur Perëndia na ndriçon me anë të Frymës së tij, Ai bën që të zhvillohet një shqisë e gjashtë brenda nesh. Kjo do të thotë që ne jo vetëm jemi të aftë të shohim, prekim, dëgjojmë, nuhasim, dhe shijojmë por mund të perceptojmë gjithashtu botën frymore. Siç e thotë Bibla: ***Kjo është jeta e përjetshme: të të njohin Ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar***. Vetëm një shqisë e gjashtë mund ta kapë këtë të vërtetë.

Këto kohët e fundit, shkova për t'i bërë një vizitë një bosi industrialist në Esen. Zyra e tij ndodhej në një ndërtesë të madhe biznesi nga ku dukej gjysma e qytetit. Pasi kalova nëpër disa zyra dhe dhoma pritjeje, më në fund u gjenda i

ulur përballë tij. I shpjegova arsyen e vizitës sime, dhe për pak sekonda çështja u zgjidh. Kështu filluam të bisedonim.... Ai tha, "Sa emocionuese të kem një pastor në zyrën time një herë të vetme!" "Oh, jam i sigurt se duhet të jetë tepër emocionuese!" u përgjigja me tallje. "E dini," vazhdoi tjetri, "pas luftës, herë pas here merrja pjesë në disa konferenca mbi teologjinë. Ajo që më bëri përshtypje në ato takime..." "Vazhdo," e ndërpreva për ta inkurajuar, "unë nuk tronditem kollaj." "Ajo që më bëri më shumë përshtypje në ato takime," përsëriti ai, "ishte se krishterimit duket se i mungon qartësia. U trajtuan tema si *I krishteri dhe Ekonomia, I krishteri dhe Çarmatimi, I krishteri dhe Paraja, I krishteri dhe Kisha.* Por ato nuk shpjeguan asnjëherë se çfarë është një i krishterë! Dukej qartë që ata njerëz nuk e dinin as vetë!"

I ulur në atë zyrë madhështore, iu ktheva me ashpërsi, "Oh, kjo nuk është e vërtetë! Duhet ta kesh gabim." Atëherë ai më pyeti, i mahnitur, "A mund të më thuash *ti* se çfarë është një i krishterë?" "Sigurisht," iu përgjigja, "Do ta bëj shumë të qartë. Nuk mund të ketë asnjë ngatërresë të mundshme në këtë pikë." "Epo tani," tha ai me një ton pakëz tallës, "disa njerëz thonë se i krishterë është ai që nuk ka patur kurrë probleme me policinë. Të tjerët mendojnë se i krishterë është kushdo që është pagëzuar dhe varrosur sipas riteve fetare." "Zotëri," iu përgjigja, "le të të tregoj se çfarë është një i krishterë. Hapi veshët mirë! I krishterë është një person që mund të thotë nga thellësitë e qenies së tij, 'Unë besoj se Jezu Krishti - Perëndi i vërtetë i Perëndisë të vërtetë, i lindur prej Atit nga gjithë përjetësia, por gjithashtu njeri i vërtetë i njeriut të vërtetë, i lindur prej Virgjëreshës Mari - është Zoti im dhe ishte ai që më shpëtoi mua, mëkatarin e shkretë, të humbur dhe të dënuar.' Zotëri, ti je një mëkatar i shkretë, i humbur dhe i dënuar!" Ai tundi kokën në shenjë aprovimi. E kishte kuptuar aq gjë - dhe ishte i gatshëm ta

pranonte.

"Mirë," u përgjigja. "...Ishte ai që më shpëtoi mua, një mëkatar i shkretë, i humbur dhe i dënuar, që më bleu dhe më çliroi nga mëkati, nga vdekja dhe nga laku i Djallit. Zotëri, i blerë dhe i çliruar nga pushteti i Djallit!" Ai tundi edhe një herë kokën në shenjë miratimi. Ai dukej qartë që nuk ishte i paditur për këto çështje. Unë vazhdova. "...Ishte ai që më bleu dhe më çliroi nga mëkati. Bibla thotë: ***Duke ditur se jo me anë gjërash që prishen, si argjendi ose ari, jeni shpenguar nga mënyra e kotë e të jetuarit të trashëguar nga etërit, por nga gjaku i çmuar i Krishtit, si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë***. Më dëgjo me kujdes," i thashë, "Vetëm burri dhe gruaja që mund të thonë, 'Unë i përkas Jezusit; ai më ka çliruar nga mëkati, nga vdekja dhe nga ferri me anë të gjakut të tij. Për këtë jam i sigurt' - vetëm ai person është i krishterë!"

Pati një çast heshtjeje në zyrë. Pastaj personi më pyeti, "Por si mund të bëhet kjo? Si mund të bëhet kjo?" Unë u përgjigja, "Sekretarja jote më tha pikërisht para se të vija në zyrën tuaj se ju do të largoheni në pushime. Do t'ju dërgoj një Dhiatë të Re që sot pasdite. Merreni me vete dhe çdo ditë lexoni një kapitull nga ungjilli i Gjonit. Lexojeni atë në një qëndrim lutjeje. Ja se si do të bëhet!"

Për ta përmbledhur, pozita e të krishterit siç përshkruhet në Dhiatën e Re mban një siguri të dyfishtë: një, *objektive*, që të vërtetat e Biblës janë të besueshme; dhe tjetra, *subjektive*, që unë mund t'i përvetësoj ato me anë të besimin dhe të shpëtohem. A i keni ju këto siguri? Për sa më përket mua, nuk do të mund të vazhdoja të jetoja nëse nuk do të isha i sigurt se Perëndia më ka pranuar.

Pyeta një të ri një ditë, "A e do Zotin Jezus?" "Po," u përgjigj. "A e dini nëse ai ju ka pranuar dhe nëse ju jeni

fëmija i tij?" "Nuk jam plotësisht i sigurt," u përgjigj ai. "Akoma kam shumë dyshime." "Unë si Vilhelm," ia ktheva, "nuk mund të duroja të jetoja në një pasiguri të tillë. Kam nevojë për siguri që jam fëmijë i Perëndisë.

Personi që e quan veten i krishterë e megjithatë që as nuk e di nëse ekziston Perëndia - megjithëse ai e di deri në qindarkën e fundit se si e ka gjendjen e tij financiare - ai person nuk është aspak i krishterë. Sipas Dhiatës së Re vetëm burri apo gruaja që mund të deklarojë, "Unë e di që Jezusi është bërë Zoti i jetës sime", është i krishterë i vërtetë.

Le ta ilustroj këtë me anë të një anekdote që ju ndoshta e keni dëgjuar. Gjenerali fon Fihban tregon se një ditë gjatë manovrave, derisa po ecte me kalë nëpër pyll, iu kap uniforma në një degë dhe iu gris. Është në kundërshtim me rregulloren për një gjeneral që të sillet rrotull me një të çarë në uniformë. Kur arriti në shtabin e ushtrisë atë natë, dalloi disa ushtarë të ulur mbi një mur guri. Ai e tërhoqi kalin deri në një ndalesë dhe u thirri, "A ka ndonjë rrobaqepës midis jush?" Një prej ushtarëve u sul te gjenerali, nderoi, dhe tha, "Urdhëro, Zotëri!" Gjeneral fon Fihban i dha duke ulëritur këtë urdhër: "Do të vish menjëherë në dhomën time në hotelin 'Qengji i Artë' dhe të riparosh uniformën time." "Por unë nuk di të qep Zotëri," erdhi përgjigja. "Çfarë! Nuk di të qepësh? Po a nuk je rrobaqepës ti?" "Më fal, Zotëri," u përgjigj ushtari. "Mbiemri im është 'Rrobaqepësi' por unë nuk jam rrobaqepës!"

Kështu ndodh me shumicën e burrave dhe grave. Ata e quajnë veten e tyre të krishterë, por në realitet ata nuk janë aspak të krishterë. Ç'situatë e tmerrshme dhe jashtëzakonisht serioze, sepse kjo do të thotë se këta njerëz nuk janë të shpëtuar.

Kështu, unë duhet të shkoj një hap më tej dhe të bëj këtë pyetje:

4. Si mund të gjejmë siguri?

Në qoftë se doni të jeni të sigurt për këto gjëra, ju këshilloj, para së gjithash, të pyesni Perëndinë për siguri; pastaj filloni ta lexoni Biblën nga disa minuta çdo ditë.

Ju tërheq vëmendjen në një pikë të rëndësishme: Ne nuk e arrijmë sigurinë e shpëtimit me anë të logjikës sonë, por me anë të ndërgjegjes sonë.

Sa herë që unë nis një diskutim mbi besimin e krishterë këto ditë, dikush gjithmonë do të nxjerrë këtë gjë: "Ti e di, unë thjesht nuk mund të besoj! Ka shumë kontradikta në Bibël." "Kontradikta?" "Po, kontradikta!" deklarojnë ata. "Për shembull, Bibla thotë se Adami dhe Eva kishin dy bij: Kainin dhe Abelin. Por Kaini e vrau Abelin. Dhe kështu Kaini ishte i vetmi bir që mbeti. Bibla vazhdon të thotë se Kaini shkoi në një vend të largët dhe atje gjeti një grua! Tani, në qoftë se ishin të vetmit njerëz mbi tokë, si mund të gjente Kaini një grua diku gjetkë? Kjo thjesht nuk ka kuptim!"

Jeni ndeshur ndonjëherë me këtë vërejtje? Mua më duket se ky është një argument kyç i përdorur nga njerëzit këtu në Gjermani për të shpëtuar nga Perëndia. Zakonisht unë u përgjigjem kështu atyre: "Kjo që thoni ju është shumë interesante. Ja ku është Bibla. Më tregoni ku është shkruar që Kaini shkoi në një vend të largët dhe atje mori një grua." Zakonisht ata fillojnë të skuqen. Unë vazhdoj: "Në qoftë se ju e keni hedhur poshtë Biblën, mjetin me të cilin një numër i madh burrash dhe grash të arsyeshëm kanë ardhur në besim, në qoftë se e konsideron veten tënde më inteligjente se ata, ti ndoshta e ke studiuar Biblën tërësisht! Të lutem, më trego pjesën ku gjendet kjo!"

Gjithmonë del se ata nuk dinë asgjë për të. Kështu ua tregoj vetë atë pjesë në Librin e Zanafillës. Ai thotë: ***Kaini u***

largua nga prania e Zotit dhe banoi në vendin e quajtur Nod, në lindje të Edenit. Dhe Kaini njohu të shoqen, e cila u ngjiz dhe lindi Enokun. Kaini thjesht e paskësh sjellë të shoqen me vete! Kush ishte ajo? Në kontekst thuhet se Adami ***pati bij dhe bija*** të tjerë. Atëherë Kaini, ishte martuar me një nga motrat e tij. Nga ana tjetër, në Bibël thuhet qartë, se Perëndia donte që të gjithë njerëzit të rridhnin nga i njëjti gjak. Si pasojë, ishte e nevojshme që në fillim vëllezërit dhe motrat të martoheshin me njëri-tjetrin. Perëndia më vonë e ndaloi që të martoheshin njerëzit që kishin lidhje gjaku. A është e qartë kjo?

Pastaj unë nxjerr konkluzionin tim. "Vërejtjet e tua," them unë, "bien si një mullar prej letrash!"

A mendoni se ky njeri do t'i hapet Ungjillit tani? Në asnjë mënyrë! Ai tashmë ka një vërejtje tjetër në majë të gjuhës: "Po, pastor Bush, por më thuaj diçka...". Dhe ja ku fillon avazin përsëri! Dhe sikur t'u përgjigjesha dhjetëmijë pyetjeve të ngjashme, është e qartë se ai nuk do të luante nga vendi as edhe një centimetër.

Jo, besimi ynë nuk rrjedh nga logjika jonë por nga një ndërgjegje e shqetësuar.

Një nga paraardhësit e mi në Esen, Reverend Julius Daman ishte në fillesën e një zgjimi të madh shpirtëror në qytetin tonë. Një i ri erdhi për ta takuar një ditë për t'i bërë pyetje si ajo për gruan e Kainit. Me një të tundur të dorës, Julius Damani e shmangu pyetjen duke thënë, "Djalosh, Jezu Krishti nuk erdhi për të debatuar për gjëra pa rëndësi, por për të shpëtuar mëkatarët. Kur të bindesh se ti vetë je mëkatar, mund të vish përsëri."

Janë njerëzit me ndërgjegje fajtore, njerëzit që janë gati të pranojnë thellë se jeta e tyre është një pështjellim i madh dhe që ata nuk do të dalin dot vetë prej tij, që arrijnë të besojnë në Shpëtimtarin. Është logjikë.

Një ditë hyra në një dhomë spitali ku ndodheshin gjashtë burra në shtrat. Më pritën ngrohtë. "Të falënderojmë që vjen të na shohësh pastor Bush," më thanë. "Do të donim të të bënim një pyetje." Okej. Po ju dëgjoj." Që me shikimin e parë, e dija se do të më bënin një pyetje me të hedhur. Një prej tyre, nën vështrimet e vëmendshme të shokëve të tij të dhomës, pyeti, "Ti beson se Perëndia është i plotfuqishëm, apo jo?" "Po." Vazhdoi ai, "ja pyetja ime: A do të mund të krijonte Perëndia yt një shkëmb, që do të ishte aq i rëndë, sa që të mos mundte ta ngrinte as vetë?"

E kuptoni kurthin? Nëse do të isha përgjigjur "po" ose "jo", konkluzioni do të ishte njësoj - Perëndia nuk është i gjithëfuqishëm.

E bluajta çështjen në mendje për një çast, dhe pyesja veten nëse duhet t'ia shpjegoja atij këtë, por e gjitha kjo m'u duk një budallallëk aq i madh sa që ia ktheva duke i bërë një pyetje: "Djalosh, para se të përgjigjem, do të doja të dija nëse ju keni kaluar net pa gjumë mbi këtë pyetje." "Net pa gjumë?" pyeti ai me një pamje çudie të plotë në fytyrë.
"Oh jo!" "Epo, është kështu," vazhdova, "koha ime është e kufizuar, kështu që mund t'u përgjigjem vetëm atyre pyetjeve që i lënë njerëzit pa gjumë. Më thuaj djalosh, ç'të pengon ty që të flesh?" Përgjigjja ishte e menjëhershme: "Kam një problem me të dashurën. Ajo është shtatzënë, dhe ne nuk mund të martohemi akoma." "Mirë," thashë, "nëse kjo është ajo që t'i shkakton netët e tua pa gjumë, le të flasim për këtë." "Në rregull, po të duash," ra dakord ai tepër i habitur. "Por ç'ka të bëjë e gjithë kjo me fenë?" pyeti ai. Unë u përgjigja, "Pyetja jote për shkëmbin s'ka të bëjë asgjë me krishterimin. Por nuk është kështu për çështjen me të dashurën tënde. Në këtë rast, ti ke bërë gabim. Ti theve një nga urdhërimet e Perëndisë duke patur marrëdhënie seksuale

me të. Kështu ti tani po vret mendjen duke u përpjekur të gjesh një rrugëzgjidhje - një mëkat akoma më të madh. E sheh, ti ke ngecur në baltë. E vetmja mundësi për të dalë është të kthehesh te Perëndia, dhe të pendohesh, duke iu rrëfyer atij, 'Zot, unë kam mëkatuar.' Atëherë, dhe vetëm atëherë Zoti do të jetë në gjendje të bëjë diçka për ty." I riu dëgjonte me vëmendje. Dhe papritur ai e pa dritën: "Jezusi merakoset për peshën që rëndon mbi ndërgjegjen time. Ai mund të më ndihmojë dhe të ma ndreqë jetën time të padobishme."

I riu, së pari u përpoq t'i drejtohej arsyes. Por ai thjesht po fliste gjepura. Vetëm kur u bë i vetëdijshëm për fajin e tij i pa gjërat qartë.

A e kuptuat tani se për të fituar sigurinë e shpëtimit nuk ka kuptim të harxhosh kohë me pyetje të ngatërruara si ato të cilave iu referuam? Jo. E vetmja mënyrë për të gjetur siguri është të dëgjoni ndërgjegjen tuaj dhe të thërrisni, "Unë kam mëkatuar." Në atë çast, Shpëtimtari i kryqëzuar do ta bëjë të njohur veten e tij dhe ju do ta *dini* se mëkatet tuaja janë falur. Rruga e shpëtimit kalon nëpër ndërgjegjen dhe jo nëpër logjikën tonë.

Nëse doni ta merrni këtë siguri, atëherë duhet të jeni të gatshëm të rrezikoni. Le ta shpjegoj. Shumica e kishave kanë dritare me xhama shumëngjyrësh. Kur i shikoni ata nga jashtë, madje edhe në mes të ditës, ata duken të errët, dhe ju zor se i dalloni ngjyrat. Por sapo hyni brenda në kishë, ngjyrat marrin jetë. Është pikërisht e njëjta gjë me besimin e krishterë. I parë nga jashtë, ai duket i errët, i turbullt. Por ju duhet të hyni brenda - d.m.th. ju duhet të rrezikoni të bëni hapin drejt Jezusit. Duhet t'ia dorëzoni jetën tuaj Shpëtimtarit dhe t'i besoni atij. *Pastaj* çdo gjë bëhet e qartë dhe e ndritshme. Është një hap nga vdekja
në jetë. Dhe për një sekondë gjithë bukuria e besimit të

krishterë shpaloset para syve tuaj.

Një ditë Jezusi po predikonte. Mijëra njerëz po e dëgjonin. Ndërsa fliste, Jezusi tha qartë se përderisa të kishte një ndryshim rrënjësor në jetën e tyre - të shkaktuar nga vetë Perëndia - ata nuk mund të hynin në Mbretërinë e Perëndisë. Për pasojë disa burra u ngritën, duke thënë, "Ejani të shkojmë. Ai i bën qimet trarë. Ne nuk mund ta pranojmë atë që thotë ai." Dhe kështu ata ikën. Disa gra, që i panë ata të ngriheshin dhe të iknin, vendosën të bënin të njëjtën gjë. Pastaj një grup të rinjsh ndoqi gjurmët e tyre. Më në fund e gjithë turma filloi të shpërndahet. Duhet të ketë qenë e tmerrshme.

Imagjinoni që unë jam duke bërë një predikim dhe që papritur njerëzit të fillojnë të largohen nga salla njëri pas tjetrit. Epo, pikërisht kjo i ndodhi Jezusit! Krejt papritur ai mbeti vetëm. Mijëra burra dhe gra u larguan kur ai po fliste. Ata nuk donin ta dëgjonin më.

Mbetën vetëm dymbëdhjetë dishepujt.

Po të isha unë në vendin e Jezusit, ndoshta do t'u isha lutur të Dymbëdhjetëve: "Ju të paktën, ju lutem, rrini me mua. Ju miqtë e mi besnikë, mos më lini!" Por reagimi i Jezusit ishte krejt i ndryshëm. A e dini se çfarë u tha ai atyre? "Edhe ju mund të shkoni po të doni." Në Mbretërinë e Perëndisë nuk ka asnjë kufizim. Ajo është e vetmja mbretëri ku nuk ka forca policore. Liria e vërtetë e zgjedhjes është pjesë e saj. "Edhe ju mund të shkoni po të doni?" Ja se ç'u tha Jezusi dishepujve. Ata duhet të jenë torturuar. Kur gjashtë mijë njerëz ngrihen dhe ikin, është tunduese të bësh të njëjtën gjë. Ndoshta atyre u vinte të ndiqnin turmën - veçanërisht kur Jezusi u ofroi mundësinë: "Edhe ju mund të shkoni...?" Rruga ishte krejt e hapur. "Po të doni mund të humbisni. Ju mund të zgjidhni që të jetoni pa Perëndinë. Ju mund të shkoni me vrap drejt e në

ferr." Por Pjetri filloi të mendojë: "Ku do të mund të shkoja? Ku pra? A të futesha në ndonjë punë dhe të punoja si skllav? Apo të jetoja në fëlliqësinë e mëkatit? Dhe të gjendesha më në fund përballë vdekjes dhe ferrit? Kjo do të ishte punë budallai!" Pastaj ai hodhi sytë nga Jezusi. Dhe u bë absolutisht i sigurt për një gjë: vetëm një jetë e jetuar me Jezusin ishte një jetë që ia vlente të jetohej. Atëherë ai i tha Jezusit, ***Zot te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme. Ne kemi besuar dhe kemi njohur*** (që është baraz me: ne jemi të sigurt) ***se ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë.*** Ne do të qëndrojmë."

Miqtë e mi, ja se si gjejmë ne siguri absolute. Pasi kemi parë me kujdes rrugët e ndryshme të hapura para nesh, arrijmë në konkluzionin se Jezusi është njëra dhe e vetmja rrugëzgjidhje. Shpresoj që edhe ju, gjithashtu do të arrini të ndani këtë siguri të mrekullueshme të dishepujve: ***Ne kemi besuar dhe kemi njohur se ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë***.

Para se ta mbyll, do të dëshiroja t'u thoja një fjalë të veçantë atyre mes jush që tashmë e kanë hedhur hapin e parë të besimit - duke ia dorëzuar jetën Jezu Krishtit - por që thellë brenda tyre mendojnë: "Nuk jam i sigurt për shpëtimin tim. Si mund të sigurohem? Ka akoma kaq shumë mëkat në jetën time!" Do të doja t'ju thosha këtë juve, "Mos vallë me të vërtetë mendoni se është e nevojshme që të presim deri sa të mos mëkatojmë më para se të sigurohemi për shpëtimin tonë? Në këtë rast, do të na duhet të presim deri sa të shkojmë në parajsë!" Ne do të kemi nevojë për gjakun e Jezusit për faljen e mëkateve tona deri në ditën tonë të fundit, deri në frymën e fundit!

Ju, pa dyshim, sillni në mend historinë e djalit plangprishës që ra në krahët e të atit duke shqiptuar këto fjalë: ***Unë kam mëkatuar***. I ati e priti më krahë hapur dhe

bëri një festë të madhe për nder të tij. Tani, përpiquni të imagjinoni skenën e mëposhtme: mëngjesin tjetër djali pa dashje e rrëzon filxhanin e kafesë në dysheme. Në vendin e largët, në mes të derrave, ai e kishte harruar zakonin e të qenit në tavolinë. Kështu kur dëgjon filxhanin që bëhet copë e thërrime, ai fillon të mallkojë: "Ta marrë djalli! Më ra nga duart." Mos do ta flakë i ati përjashta për shkak të kësaj dhe t'i thotë, "Shporru! Kthehu te derrat e tu!"? Kurrë. Ai do të thotë vetëm të kundërtën: "S'ka gjë; mos u mërzit." Duke iu kthyer të birit, ai madje mund të shtojë, "Bir, përpiqu të mos lejosh që kjo të ndodhë përsëri. Ne do të bëjmë ç'është e mundur që të të ndihmojmë të mësosh përsëri që ta vësh filxhanin e kafesë si duhet mbi tavolinë, të pushosh së mallkuari, dhe pak nga pak të mësohesh me rregullat e shtëpisë." Por i ati nuk do ta kthejë atë kurrë te derrat.

Kur një njeri ia dorëzon jetën Jezusit, nuk zgjat shumë para se ai të bëjë zbulimin e trishtuar se natyra e tij e vjetër nuk është zhdukur dhe se ai akoma bie në mëkat herë pas here. Kur keni pësuar humbje pas shqetësimit tuaj, mos u dëshpëroni. Uluni në gjunjë dhe i thoni tri gjëra Perëndisë: *para së gjithash*, "Faleminderit Zot, sepse jam i yti përgjithmonë"; *së dyti*, "Më fal me anë të gjakut tënd"; dhe *së treti*, "Më çliro nga ndikimi i natyrës sime të vjetër."

Por, mbi të gjitha, bëjini të ditur atij se sa mirënjohës jeni për faktin se jeni ende fëmija i tij.

Për t'i përmbledhur gjërat, të qenët të sigurt për shpëtimin tim më lejon të them, "Jam kthyer në shtëpi; jam kthyer tek im at. Unë do të përpiqem për shenjtëri se një bir që është kthyer në shtëpi për të mirë, dhe jo si një bir që nxirret nga shtëpia sa herë që gabon dhe që përherë kthehet."

Ata që predikojnë se ne duhet ta përvetësojmë shpëtimin sërish çdo ditë, shpallin një mesazh të tmerrshëm. Nuk ka

nevojë që fëmijët e mi të qëndrojnë çdo mëngjes para tavolinës sime të punës dhe të më pyesin, "Babi, a mund të jemi sot përsëri fëmijët e tu?" Ata *janë* fëmijët e mi. Dhe burri apo gruaja, djali apo vajza, që është fëmijë i Perëndisë, është fëmijë i Perëndisë për gjithmonë. Ai (ose ajo) do të luftojnë kundër mëkatit duke qenë dhe duke mbetur fëmijë të Perëndisë.

Ardhtë secili prej jush në sigurinë e plotë se jeni fëmijë të Perëndisë!

A `ËSHTË KRISHTERIMI ÇËSHTJE PRIVATE?

Shumica e njerëzve kështu mendojnë. A kanë të drejtë ata? A ka krishterimi në veçanti diçka private në lidhje me të? Apo, ta bëjmë pyetjen më qartë, a interesohet besimi i të krishterit vetëm për veten e tij?

Para se të përgjigjem, po ju bëj një pyetje shumë të thjeshtë: Çfarë shikoni të gdhendur në monedha? Një figurë apo një mbishkrim? Të dyja sigurisht. Çdo monedhë ka dy anë. Kështu ka dhe besimi i krishterë. Nëse besimi i krishterë është i vërtetë dhe i gjallë, ai ka dy anë. Është ana rigorozisht private, personale; pastaj është ana e hapur, publike. Nëse mungon një nga këto aspekte, ka diçka të dyshimtë në lidhje me të.

Le të shqyrtojmë tani këto dy aspekte të besimit të vërtetë.

1. Krishterimi ka aspektin personal

Për ta ilustruar këtë do të tregoj një histori. Dikush më tha një herë se unë jam vetëm një tregues historish. Iu përgjigja, "S'ka asgjë të keqe këtu. Unë gjithmonë kam frikë se mos shoh njerëz që t'i zërë gjumi në kishë. Kështu në qoftë se tregoj ndonjë histori të vogël herë pas here, ajo i mban ata zgjuar!" Sidoqoftë, gjithë jeta jonë është e përbërë nga përvojat - jo nga teoritë!

Një predikues me emrin Johan Hajnrih Folkening jetonte në një rajon të Ravensburgut në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Ky njeri i Perëndisë ndodhej prapa një lëvizjeje të fuqishme rigjallërimi. E gjithë zona rreth qytetit të Bileveltit ishte transformuar krejtësisht si rezultat i predikimit të tij. Një mbrëmje, Folkeningu u thirr pranë shtratit të një fermeri të pasur, që zotëronte një fermë të madhe dhe njihej si një njeri i

ndershëm dhe punëtor. Por ai kishte një antipati të madhe për takimet ungjillizuese. Fakti ishte se ky burrë nuk ishte i gatshëm të pranonte se ishte mëkatar dhe nuk mund të kuptonte pse kishte nevojë për një Shpëtimtar. Motoja e tij e jetës ishte: "Bëj atë që është e drejtë dhe turpëroje Djallin." Siç thashë, një mbrëmje Folkeningu u thirr pranë shtratit të tij. Fermeri plak po vdiste dhe donte të merrte kungim për herë të fundit. Kështu Folkeningu shkoi në fermë. Ai ishte një burrë i gjatë dhe sytë e tij blu xixëllues tërhiqnin vëmendjen e njerëzve. Kur erdhi te shtrati i njeriut që po vdiste, ai e shikoi atë për një kohë të gjatë pa thënë asnjë fjalë. Më në fund ai foli, "Hajnrih, jam i shqetësuar, shumë i shqetësuar për ty. Rruga në të cilën ke ecur deri tani nuk të çon në parajsë; ajo të çon drejt e në ferr." Pastaj Folkeningu u kthye dhe doli jashtë! Fermeri, i skuqur nga inati, ulëriti pas tij, "Dhe e quan veten predikues pale! Dhe guxoke të predikosh për dashurinë e Perëndisë!"

Ra nata. Por fermeri i shkretë, që ishte i sëmurë rëndë, nuk mund të bënte asnjë sy gjumë. Atë po e mundonte ndërgjegjja: "Ti nuk po shkon në parajsë por në ferr.... Po sikur, në fund të fundit, kjo të ishte e vërtetë?" Mëkatet e shumta që kishte bërë i vërshuan në kujtesë. Ai nuk e kishte nderuar Perëndinë ashtu siç duhej të kishte bërë. Herë pas here kishte arritur t'i mashtronte të tjerët në mënyra shumë tinëzare.

Ndërsa netët rrëshqisnin njëra pas tjetrës, gjithë qenien e tij e kapi një frikë për vdekje. Ai nuk mund të gjente aspak prehje. Ai arriti të kuptonte se kishte kryer një numër të madh mëkatesh gjatë gjithë jetës së tij dhe se nuk kishte absolutisht asnjë arsye për të pretenduar se ishte fëmijë i Perëndisë. Ai arriti në atë pikë ku kishte shumë dëshirë për të bërë një kthesë në jetën e tij. Kështu tri ditë më vonë e thirri të shoqen dhe i tha, "Shko dhe gjej Folkeningun." Ishte vonë

natën, por Folkeningu erdhi menjëherë. Fermeri plak i tha atij me një ton të shqetësuar, "Pastor, mendoj se për mua është pikërisht koha për ta ndryshuar jetën." "Po," u përgjigj Folkeningu, "kur plakemi, bëhemi më të mençur. Por një pendim i nxituar nuk është domosdoshmërisht një pendim i vërtetë! Ju keni nevojë për diçka më të thellë se kjo." Edhe një herë predikuesi vuri thembrat nga majat dhe doli nga shtëpia. Edhe një herë fermeri u tërbua nga inati. A nuk do të ishit zemëruar edhe ju? A nuk do të ishte më mirë për Folkeningun që të sillej më mirë me fermerin? Mbi të gjitha, ai njeri ishte në prag të vdekjes! Por Folkeningu jetonte shumë afër Perëndisë, kështu që ai dinte se ç'bënte.

Tri ditë më vonë, fermeri plak ishte në agoni dhe dëshpërim të thellë. Ai e dinte se i kishte ditët të numëruara. Pyeti veten, "Cili vend në jetën time ka qenë për dashuri, gëzim, paqe, durim, dashamirësi, mirësi, besnikëri, butësi, dhe vetëkontroll?" Gjatë gjithë jetës së tij ai e kishte përbuzur Shpëtimtarin që kishte vdekur për të. Sa herë që Perëndia me dashurinë e tij i kishte folur, ai nuk e kishte pranuar. Dhe ja ku ishte tani në buzë të ferrit - i dëshpëruar. Iu lut së shoqes, "Shko dhe merr pastorin!" "Jo," ia ktheu ajo. "Nuk do të shkoj më. Sidoqoftë nuk do të ketë dobi." "Të lutem," u lut ai, "të lutem, shko dhe merre. Unë po shkoj në ferr." Kështu ajo shkoi.

Kur arriti Folkeningu, ai gjeti një njeri që e kishte kapur kuptimin e kësaj pjese në Bibël: ***Mos u gënjeni: Perëndia nuk vihet dot në lojë, sepse ç'të mbjellë njeriu, atë edhe do të korrë.*** Ai e afroi karrigen pranë shtratit dhe tha, "Ti po shkon drejt e në ferr apo jo?" "Po," qe përgjigjja, "po shkoj në ferr." Toni i Folkeningut u bë lutës. "Hajnrih," tha ai, "le të shkojmë së bashku në Kalvar. Atje vdiq Jezusi për ty." Pastaj ai vazhdoi të shpjegonte me dhembje se si Jezusi merret me

shpëtimin e një mëkatari. Para së gjithash, ne vetë duhet të bëhemi të vetëdijshëm për gjendjen tonë mëkatare; pastaj duhet të pushojmë së përsërituri moton tonë të preferuar në jetë; dhe duhet të kapemi pas fakteve të thjeshta. Atëherë dhe vetëm atëherë, mund të na dhurojë Jezusi shpëtimin e tij.

Më në fund fermeri e kuptoi: "Jezusi vdiq për *mua* në kryq. Ai shleu mëkatet e *mia.* Ai mund të më shfajësojë plotësisht duke më ofruar të vetmen drejtësi që është e pranueshme në sytë e Perëndisë." Për herë të parë në jetën e tij ai u lut me të vërtetë: "O Perëndi, ji i mëshirshëm me mua, mëkatarin. Zoti Jezus, më shpëto nga ferri."

Folkeningu u largua pa u ndier nga dhoma. Ai mund të kthehej në shtëpi me mendje të qetësuar, sepse njeriu që po vdiste kishte thirrur emrin e Zotit. Tri herë në Bibël gjejmë këtë varg: ***Kushdo që thërret emrin e Zotit do të shpëtohet***. Ditën tjetër kur Folkeningu u kthye për ta parë atë, gjeti një njeri në paqe me Perëndinë. "Si je Hajnrih?" pyeti ai. "Jezusi më ka pranuar - me anë të hirit," qe përgjigjja.

Kishte ndodhur një mrekulli.

Tani do t'ju tregoj një histori tjetër.

Një jude i ditur e gjeti një ditë Jezusin dhe i tha, "Mësues, - do të doja të flisja pak me ty për çështjet fetare." Por Jezusi u përgjigj, "S'ka asgjë për të diskutuar. ***Nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë***." "Ç'thua kështu?" thirri me habi vizitori. "Unë nuk mund të kthehem në barkun e nënës sime dhe të lind për herë të dytë!" Por Jezusi i qëndroi arsyetimit të tij dhe deklaroi, ***Kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë***.

Këtu kemi aspektin rigorozisht personal të besimit të krishterë: burri apo gruaja që dëshiron të rrokë jetën e përjetshme duhet të hyjë nëpër derën e ngushtë, duke "lindur

sërish" nëpërmjet veprës së mrekullueshme të Frymës së Shenjtë.

Nuk po diskutojmë këtu për stërhollimet teologjike. Jo. Fati juaj i përjetshëm është në rrezik. Ju mund të mos e keni rastin e të paturit të një Folkeningu pranë shtratit tuaj kur të jeni në prag të vdekjes. Kështu do të tregoheshit të mençur të dëgjonit ato që kam për të thënë.

Të "lind sërish" do të thotë që unë më në fund të arrij të njoh se Perëndia ka të drejtë; që unë pranoj se kam humbur dhe se zemra ime është e keqe. Të "lind sërish" kërkon që unë të pohoj nevojën time për Jezusin, Shpëtimtarin e vetëm të botës. Të "lind sërish" kërkon që unë të bëj rrëfimin tim të çiltër dhe të ndershëm të mëkateve të mi: "Zot, unë kam mëkatuar kundër qiellit dhe kundër teje." Të "lind sërish" gjithashtu përfshin bërjen prej meje të një akti besimi: "Gjaku i Jezusit më pastron nga çdo mëkat. Ai pagoi borxhin tim dhe më ofron të vetmen drejtësi të pranueshme në sytë e Perëndisë." Të "lind sërish" bën thirrje për një dorëzim total të jetës sime në duart e Jezusit. Së fundi të "lind sërish" do të thotë që Fryma e Shenjtë të ma bëjë të qartë se unë jam fëmijë i Perëndisë: ose, për të përdorur terma biblikë, që Perëndia ka vënë vulën e tij mbi mua. Pa përvojën e kësaj "lindjeje të re", nuk do të hyni në mbretërinë e Perëndisë. Burri apo gruaja që është bërë fëmijë i Perëndisë mund të jetë absolutisht i sigurt për këtë. Kur jam duke u mbytur dhe dikush më nxjerr nga uji, unë e di me siguri se jam shpëtuar kur ndiej tokë poshtë këmbëve të mia dhe kur frymëmarrja më kthehet në normale.

Le ta përsëris: ky është aspekti rigorozisht personal i besimit të krishterë. "Lindja e re" është një përvojë të cilën duhet ta kalojë secili prej nesh në mënyrë personale nëse duam jetën e përjetshme. Duke iu kthyer mënyrës se si u bëra

fëmijë i Perëndisë, jam i detyruar të pranoj se ajo ishte një mrekulli e vërtetë. Unë jetoja larg Perëndisë, duke bërë të gjitha llojet e mëkateve. Por pastaj Jezusi erdhi në jetën time, dhe tani unë i përkas atij. Do të doja të kisha dhjetë jetë për të jetuar me qëllim që të rrëmbeja burra dhe gra nga dënimi i përjetshëm duke i sjellë ata te Jezu Krishti. Mos gjeni prehje deri sa të keni "lindur sërish" dhe të mund të thoni:

I tij përgjithmonë, vetëm i tij;
Nga Zoti a do t'më ndajë kush?
Ah, me ç'prehje lumturie
Krishti zemrën që do e mbush!
Toka dhe qielli mund të zhduken,
Së parëlindurës dritë t'i humbë ndriçimi;
Por, ndërsa unë dhe Perëndia mbetem,
Unë jam i tij dhe ai është i imi.

Lindja sërish nuk është fundi i përvojës së krishterë. Ajo është vetëm fillimi. Gjatë gjithë jetës së të krishterit, besimi i tij do të ketë një karakter personal për të.

Pikërisht që nga fillimi i jetës sime të krishterë, e dija që ishte e domosdoshme të dëgjoja çdo ditë zërin e mikut tim të ri. Kështu fillova të *lexoja Biblën.* Shumë njerëz sot duken se mendojnë se vetëm pastorët e lexojnë Biblën. Jo larg shtëpisë sime në Esen ndodhet një park publik. Atje më pëlqen të shkoj për të lexuar Biblën në mëngjes duke ecur poshtë e lart kur e bëj këtë gjë. Njerëzit aty pranë ndonjëherë më vështrojnë. Një person më tha një ditë, "Të shoh që lexon librin e lutjeve mëngjeseve." Që ta dini, janë priftërinjtë katolikë romakë, që lexojnë librin e lutjeve. Ai njeri nuk mund të më imagjinonte mua të lexoja një libër që mund ta lexonte gjithashtu çdo njeri i zakonshëm. Në kundërshtim me opinionin e përgjithshëm, Bibla është një libër për të gjithë.

Në kampet që organizoj për grupin tim të të rinjve në

Esen, mblidhemi së bashku në kohën para ngrënies së mëngjesit për një kohë prej pesëmbëdhjetë minutash për meditim. Fillojmë duke kënduar një himn, pastaj shikojmë leximin ditor në librin *Drita e Përditshme*. Më pas unë sugjeroj një pjesë nga Shkrimet dhe kushdo largohet për ta lexuar atë më vete në qoshen e tij. Ata që e kanë bërë hapin e parë të besimit drejt Jezusit vazhdojnë ta praktikojnë këtë gjë në shtëpi, sepse ata nuk mund të bëjnë pa dëgjuar zërin e Bariut të Mirë dhe pa i folur atij. Në qoftë se ju keni vendosur ta ndiqni Jezusin, sigurohuni të kultivoni aspektin personal të besimit tuaj duke filluar të lexoni Dhiatën e Re. Kijeni kohën tuaj të qetë prej pesëmbëdhjetë minutash çdo ditë, në mëngjes a në mbrëmje.

Dhe kur ta keni mbaruar së lexuari Dhiatën e Re, mbyllini sytë dhe lutuni: "Zoti Jezus, tani duhet të flas me ty. Kam për të bërë gjithë këto gjëra. Më ndihmo t'ua dal mbanë. Më shpëto nga mëkatet e mia të preferuara. Më jep dashuri për të tjerët. Më mbush me Frymën tënde." Folini Jezusit. Ai është shumë afër dhe mund t'ju dëgjojë. *Lutja* është gjithashtu një nga elementet private të besimit të krishterë.

Para ca kohësh, i thashë një burri që sapo ishte rilindur (kthyer në besin), "Ti duhet të kalosh një çerek ore çdo ditë në praninë e Jezusit." Kësaj ai iu përgjigj, "Pastor Bush, unë nuk jam pastor si ti. Ti ke kohë për këtë. Unë nuk kam. Kam një orar ditor shumë të ngjeshur." "Më dëgjo me kujdes," i thashë. "Ti kurrë nuk arrin t'ia dalësh mbanë gjithë asaj pune që ke, apo jo?" "Jo," pranoi ai, "kurrë."
"E shikon," i shpjegova, "kjo ndodh sepse ti nuk lë mënjanë një kohë për meditim dhe lutje. Po të kishe zakon që të flisje çdo ditë me Jezusin - të lexoje disa vargje nga Bibla sistematikisht, të ndjekura nga një moment lutjeje - shpejt do të shihje se mund t'ia dalësh mbanë punës sate sikur ajo të

ishte lojë fëmijësh. Sa më shumë punë që të kesh, aq më shumë do të kesh nevojë për atë kohë të qetë prej pesëmbëdhjetë minutash. Madje mund të kesh nevojë që ta zgjatësh atë çerek ore në gjysmë ore me qëllim që të kesh kohë të mjaftueshme për t'i sjellë të gjitha nevojat (brengat) e tua para Zotit. Dhe do të shohësh se gjërat do të përmirësohen. Ta them këtë sepse e kam përjetuar vetë të vërtetën e saj. Ndonjëherë unë s'kam nxjerrë akoma këmbën nga shtrati kur bie telefoni. Pastaj shkoj marr gazetën te porta. Pastaj bie përsëri telefoni. Menjëherë pas kësaj, dikush vjen për vizitë. Gjatë gjithë ditës i kam nervat të ngritura në maksimum. Asgjë nuk shkon siç duhet. Pastaj papritur kujtohem: "Eh, ti nuk ke marrë asnjë minutë të lirë sot për të folur me Jezusin; dhe ai nuk ka patur mundësi për të folur me ty. S'është për t'u çuditur që gjërat shkojnë keq!"

Kjo kohë e kaluar në praninë e Jezusit është gjithashtu një nga aspektet private të jetës së krishterë.

Një tjetër është ajo që Bibla e quan "*kryqëzim i mishit*". Gjatë jetës kam biseduar me shumë burra dhe gra. Pothuajse të gjithë më kanë treguar për brengat dhe hidhërimet e tyre. Gratë janë ankuar për burrat e tyre; burrat janë ankuar për gratë e tyre. Prindërit kanë kritikuar fëmijët e tyre dhe fëmijët - kanë kritikuar prindërit. Por kurrë nuk i ra ndërmend ndonjërit që kur ia drejtonin një gisht dikujt tjetër duke thënë, "Është faji i atij (ose i asaj) që unë nuk jam i lumtur apo e lumtur", ata në fakt, drejtonin tre gishta nga vetja e tyre!

Nëse bëni zakon të meditoni dhe të luteni, nuk do të kalojë shumë kohë para se Jezusi t'ju tregojë se ju vetë jeni përgjegjës për brengat tuaja. Problemet tuaja martesore dhe familjare ndodhin për faktin se ju nuk jetoni në praninë e Perëndisë. Gjërat nuk shkojnë si duhet sepse ju nuk po ecni me Perëndinë. I krishteri duhet të mësojë, ditë për ditë, ta kryqëzojë natyrën e tij të vjetër.

Do të dëshiroja të ndaja me ju një përvojë personale që kam patur kohët e fundit. Bashkë me rreth pesëdhjetë njerëz të tjerë që punonin mes të rinjve në Esen, pata mundësi të mbikëqyrja një kohë tërheqjeje për të jetuar të veçuar prej disa ditësh. Ishte e mrekullueshme, kaq e mrekullueshme sa që nuk mund të përshkruhet. Ishim kaq të lumtur që ishim së bashku; dhe Perëndia na bekonte me bollëk. Pavarësisht nga kjo kishte disa acarime. Por ditën e fundit, para se të festonim Darkën e Zotit së bashku, mund të shiheshin njerëzit njëri pas tjetrit, duke shkuar lart e poshtë te njëri-tjetri dhe duke thënë, "Të lutem më fal për këtë apo për atë." Përsa më përket mua, m'u desh të shkoja te tre nga bashkë-punëtorët e mi dhe t'u thoja, "Do të më falni që ju fola aq ashpër atë ditë?" "Por ti kishe të drejtë, " u përgjigj një prej tyre. "Megjithatë më falni," iu luta unë. Nuk është e lehtë për një burrë të moshës sime ta përulë veten para një njëzetvjeçari, por nuk do të kisha patur paqe nëse nuk do të kisha bërë kështu.

Nëse krijoni zakonin e ardhjes rregullisht në praninë e Jezusit, do të mësoni ta kryqëzoni natyrën tuaj të vjetër çdo ditë. Dhe do të shihni se gjërat do të përmirësohen. Ky është një nga elementet e anës rigorozisht personale të besimit të krishterë. Në qoftë se nuk dini asgjë për këtë aspekt të jetës së krishterë, atëherë - ju lutem - pushoni së quajturi veten tuaj të krishterë!

Shpesh, kur jam duke shëtitur nëpër rrugë, arsyetoj kështu me vete: "Njerëzit që më parakalojnë me shpejtësi në rrugë, ndoshta të gjithë e quajnë veten të krishterë. Po ta ndaloja dikë rastësisht dhe ta pyesja, 'Më falni, jeni ju i krishterë?' ka shumë mundësi që ai të thoshte, 'Sigurisht që jam. Ti nuk më merr për mysliman apo jo?' Dhe nëse do të vazhdoja ta pyesja, 'Më thuaj, a ke patur raste kur nuk ke qenë në gjendje të flesh nga gëzimi që je i krishterë?', ai ndoshta do të

thoshte, 'Mos je gjë i çmendur apo çfarë?'"

A nuk kam të drejtë? Krishterimi i ditëve të sotme nuk gjen gëzim në mendimin e besimit që ai shpall. Ne ankohemi për kishën - dhe kaq! As shenjën më të vogël të gëzimit! Por që nga çasti që përjetojmë mrekullinë e lindjes sërish, e kuptojmë rëndësinë e kësaj fjale nga apostull Pali: ***Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni!***

Kohët e fundit u lexova një pjesë të shkëlqyer nga Bibla të rinjve të mi: ***Për ju që keni frikë nga emri im, do të lindë dielli i drejtësisë*** (aluzion profetik për Jezusin) ***me shërimin në krahët e tij***. A nuk është e mrekullueshme kjo? Teksti vazhdon: ***Dhe ju do të dilni dhe do të hidheni si viçat që dalin nga stalla***. Kjo pjesë e thotë shumë bukur e megjithatë unë rrallë takoj të krishterë të cilët, në gëzimin e tyre që i përkasin Zotit, të kërcejnë ***si viçat që dalin nga stalla***. Pse ndodh që nuk e ndiejmë këtë gëzim?

Përgjigjja është e thjeshtë: ne nuk jemi të krishterë të vërtetë.

Nuk mund të mos mendoj për nënën time. Gëzimi i saj i thellë në Zotin ishte i dukshëm për këdo. Kam njohur shumë të krishterë të tjerë të cilët, ashtu si ajo, u ndriste fytyra nga gëzimi. Shpresoj që me kalimin e viteve edhe unë të arrij ta ndiej gëzimin e Zotit gjithnjë e më tepër. Kjo do të thotë ta marrësh seriozisht Ungjillin dhe të mos kënaqesh me një lustër të hollë krishterimi.

Kaq për njerën anë të besimit të krishterë - aspektin e vet rigorozisht personal.

Por ka një anë tjetër - që duket nga të gjithë.

2. Krishterimi është veprim publik

Në radhë të parë, *një i krishterë ka miqësi me besimtarët e*

tjerë. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme. I krishteri i vërtetë, bashkohet me të krishterë të tjerë të cilët, si ai, synojnë për kryerjen e plotë të shpëtimit të tyre.

Ka një shërbesë adhurimi të dielave në mëngjes, për shembull. Pse nuk shkoni ju? "Por unë dëgjoj shërbesën e së dielës që transmetohet në radio televizion!" mund të thërrisni ju. Tani, unë nuk po flas për të sëmurët. Për ta është një gjë e shkëlqyer të jenë në gjendje që ta hapin radion në një shërbesë adhurimi. Por në qoftë se ti nuk ke qejf të marrësh pjesë vetë në një shërbesë të vërtetë adhurimi, në një mbledhje të vërtetë besimtarësh, atëherë krishterimi yt nuk shkon shumë larg. Shërbesa e adhurimit të së dielës është pjesë përbërëse e një jete të vërtetë të krishterë.

Rreth vitit 300 pas Krishtit - shumë kohë më parë - sundonte mbi perandorinë romake një njeri i jashtëzakonshëm me emrin Diokletian. Dikur skllav, Diokletiani i kishte ngjitur një nga një shkallët e shoqërisë deri sa më në fund u ul në fronin e perandorisë së madhe romake. Në atë kohë krishterimi kishte depërtuar nëpër të gjithë perandorinë. Perandori Diokletian e dinte, sigurisht, se paraardhësit e tij i kishin përndjekur të krishterët. Por ai mendoi me vete, "Unë nuk do të jem aq budalla. Nuk do t'i përndjek njerëzit më të mirë në perandori. Ata mund të besojnë çfarë të duan. Nën sundimin tim, kushdo mund të zgjedhë lirisht fenë e vet." Ishte krejt e pazakontë për një perandor që të kishte një qëndrim kaq tolerant. Sundimtarët e botës, në përgjithësi, duan të kenë kontroll mbi ndërgjegjet tona.

Tani, Diokletiani kishte marrë si shok të ngushtë një farë Galeri, një ish-bari. Më vonë ai u bë pasardhësi i Diokletianit në fron. Një ditë Galeri i tha atij diçka të tillë: "Diokletian, ke për ta parë se kur këta të krishterët të kenë shumicën, do të

ketë shumë trazira publike. Ata vazhdojnë të flasin për Jezusin - mbretin e tyre. Duhet të bëjmë diçka për t'i ndalur!" "Hajde, hajde," iu përgjigj Diokletiani, "ti po flet gjepura. Për 250 vjet, paraardhësit e mi i përndoqën të krishterët në mënyrë të vazhdueshme dhe kurrë nuk ia arritën t'i zhduknin. Sa për mua, më mirë po i lë rehat." Diokletiani ishte shumë i arsyeshëm. Por Galeri vazhdoi ta ngacmonte: "E di që ata të krishterët janë njerëz të çuditshëm. Ata deklarojnë se janë mbushur me Frymën e Shenjtë, dhe se të tjerët nuk janë; dhe deklarojnë se janë të vetmit për të cilët është i realizueshëm shpëtimi. Ata janë një popull krenar dhe ju do të tregoheni i mençur po t'i hiqni qafe."

Diokletiani vazhdonte të refuzonte. Galeri, nga ana tjetër, nuk mposhtej lehtë; kështu ai vazhdonte të kthehej vazhdimisht deri sa më në fund Diokletiani u dorëzua: "Okej, por gjithçka që do të bëjmë është t'i ndalojmë të krishterët të mblidhen së bashku."

U shpall një dekret me pasojën që qysh tani e tutje të gjithë të krishterët ndaloheshin të adhuronin së bashku përndryshe dënoheshin me vdekje. Ata kishin të drejtë t'i ndiqnin besimet e tyre në një bazë rigorozisht personale, por jo si një grup i mbledhur besimtarësh. Pleqtë e tyre u mblodhën së bashku për të shqyrtuar situatën: "Ç'duhet të bënim? A nuk do të ishte më e mençur sikur thjesht të bindeshim? Në fund të fundit, ne mund të bëjmë çfarë të duam prapa mureve të shtëpive tona. Askush nuk do të na prekë as me gisht në shtëpi." Konkluzioni i tyre ishte tepër i dobishëm: "Të takuarit së bashku për lutje, këngë, predikim, mësim, dhe në dhënien e të dhjetave është pjesë përbërëse e besimit tonë të krishterë. Do të vazhdojmë si më parë!" Dhe ata vazhduan të takoheshin në kishat e tyre.

Galeri u ngazëllye. "E sheh Diokletian," tha ai, "ata të krishterët janë armiq të shtetit. Ata nuk nënshtrohen." Dhe ai

ndërmori një nga përndjekjet më mizore që kishin njohur të krishterët deri në atë kohë. Shumë të krishterë u nënshtruan, duke menduar: "Ne mund të qëndrojmë në shtëpi dhe përsëri të jemi të krishterë! Nuk do të shkojmë më në takime." Por nuk ishte ky mendimi i kishës në përgjithësi. "Ata janë mohues të besimit," deklaroi ajo. "Burri apo gruaja që pushon së marri pjesë në mbledhjet
e krishtera konsiderohet si mohues i besimit."

Ne duhet t'u themi të njëjtën gjë të krishterëve të brezit tonë. Ka me të vërtetë një numër të madh mohuesish të besimit në krishterimin e sotëm. Të krishterët e asaj kohe kishin plotësisht të drejtë në kundërshtimin e dekretit perandorak, sepse Bibla thotë qartë: ***Pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin, sikurse kanë zakon disa***. Sot ne mund të themi, "...sikurse kanë zakon *pothuajse të gjithë*." Prandaj unë këmbëngul që ata që kërkojnë me etje të jenë të krishterë, duhet të bashkohen me një asamble besimtarësh.

Ka mënyra të ndryshme për besimtarët për t'u takuar së bashku: ka takime të rregullta në kishë, studime biblike në shtëpitë private, grupe qelizë për lutje, grupe të rinjsh. Ju përgjërohem, merrni kontakt me të krishterët e tjerë. Një francez më tha një ditë, "Disa njerëz kanë qejf të hanë cironka; të tjerët kanë qejf të shkojnë në kishë!" Më falni, por kjo nuk është aspak e vërtetë! Është shumë më serioze se kaq! Disa njerëz janë në rrugën për në ferr; të tjerët kërkojnë bashkësi me besimtarët e tjerë. Ky është fakt.

Në qoftë se ju jeni me të vërtetë seriozë përsa i përket të jetuarit si dishepull i Jezu Krishtit, atëherë duhet të bëni përpjekje për të gjetur një grup për t'u bashkuar ku të mund të mësoni më shumë për Jezusin. Kjo është shumë e rëndësishme. Duhet të shkoni vetëm atje ku flitet për Jezusin. Askush nuk mund të thotë, "Në zonën time nuk ka asgjë."

Njerëzit që duan Zotin Jezu Krisht mund të gjenden kudo. Ata mund të mos jenë të shumtë. Ata madje mund të jenë pak të çuditshëm. Por kjo s'ka rëndësi! Besimi juaj i krishterë është besim i vdekur nëse nuk keni bashkësi me besimtarët e tjerë.

Një shërbesë e krishterë lavdërimi përbëhet nga të paktën katër gjëra: këngë, mësim, lutje dhe ofertë. Ato duhet të jenë pjesë e çdo takimi. Kjo ka qenë praktika e të krishterëve të parë; dhe kështu duhet të shprehet jeta e re
e dhuruar nga Perëndia e çdo të krishteri.

Ka vetëm një tip besimi të krishterë. Është lloji që gjen shprehje në bashkësinë e besimtarëve të tjerë. Bibla shkon aq larg sa të thotë: ***Ne e dimë se kemi kaluar nga vdekja në jetë, sepse i duam vëllezërit***. Ky varg nënkupton se personi që nuk është tërhequr prej të krishterëve të tjerë është akoma i vdekur frymërisht.

Nuk do t'i harroj kurrë fillimet e jashtëzakonshme të shërbesës sime në Bilevelt ku isha ndihmës pastor në një nga rrethinat e qytetit. Ne ishim vetëm një grusht njerëz në shërbesat e mëngjesit të së dielës të cilat bëheshin në sallën e famullisë lokale. Një të shtunë mbrëma Perëndia më lejoi të bëj një diskutim të gjatë në Shtëpinë e Popullit - një sallë që zotërohej nga komunistët - me disa militantë dhe mendimtarë të lirë. Ai zgjati deri në orën një të mëngjesit, deri sa bufetjeri më në fund na flaku të gjithë jashtë derës.

Jashtë binte shi. Ia kisha arritur, për herë të parë, të mblidhja rreth meje një grup dëgjuesish prej afro njëqind burrash - të gjithë punëtorë fabrike në zonën time. Formuam një rreth nën një llambë rrugore. Burrat më bënin pyetje dhe unë u përgjigjesha. Folëm për Jezusin dhe për ardhjen e tij në këtë botë. Pas një farë kohe ata arritën në atë pikë ku u treguan aq të ndershëm sa të pranonin se ishin të trishtuar dhe se vetëm po gënjenin veten duke deklaruar se nuk kishin

mëkatuar, se thellë brenda tyre ata besonin me të vërtetë në përjetësi dhe në gjykimin e ardhshëm të Perëndisë. Rreth orës dy të mëngjesit, më në fund u thashë, "Tani, miqtë e mi, është koha që unë të shkoj në shtëpi. Paradite do të mbaj një shërbesë në kishë në orën 9:30. Jam i sigurt që të gjithë do të dëshironit të vinit... po të mos kishit kaq shumë frikë nga njëri-tjetri!"

Pikërisht përballë meje ndodhej një punëtor që po e quaj B. Në atë kohë ai duhet të ketë qenë rreth të tridhjetë e pesave; dhe ai ishte një vendas i vërtetë i Vestfalisë. "Kush unë?" pyeti ai. "Të kem frikë? Kurrë ndonjëherë!" "Mirë, mirë," iu përgjigja, "mos u nxeh! Por në qoftë se shkon në kishë të dielën, do të të bëjnë shumë vërejtje në punë të hënën në mëngjes, apo jo? Dhe kjo është ajo nga e cila keni frikë të gjithë!" Për herë të dytë ai tha, "Jo, unë nuk kam frikë!" Dhe për herë të dytë unë thashë, "Hajde, tani! Ti do të dëshiroje të vije, por...". "Në rregull. Do të jem atje nesër në mëngjes, me një libër himnesh nën sqetull!"

Dhe atë mëngjes të diele - vetëm disa orë më vonë - kush na ardhka duke shëtitur rrugës, me një libër himnesh të futur nën sqetull, dhe drejt e në sallën tonë, përveç këtij vestfaliani të mirë! Atë e njihnin mirë në atë krahinë. Të hënën në darkë ai erdhi për t'u takuar me mua dhe më tha, "Kishe të drejtë. Shokët e mi në fabrikë u tërbuan me të vërtetë me mua që shkova në kishë. Por unë kam parë më tej se blofi i propagandës sonë. Ne thërrasim, 'Rroftë liria', por në fakt ne jemi skllevër të njerëzve të tjerë. Kam hequr qafe çdo gjë, duke përfshirë librin e tyre të vjetër mbi mendimin e lirë. Tani më trego për Jezusin... dua të di më shumë për *të*."

Ai qe i kthyeri im i parë (në besin). Dhe gjithçka filloi sepse një mëngjes të diele, ai mori pjesë në shërbesën e adhurimit të grupit tonë të vogël dhe të përulur të

besimtarëve. Ai këmbënguli, dhe të tjerët ndoqën shembullin e tij. Ishte krijuar një e çarë. Me kalimin e kohës, Perëndia vazhdoi të punonte mes nesh. Por gjëja që më bëri më shumë përshtypje në atë kohë ishte fakti se pika e kthesës për këta punëtorë arriti kur ata filluan të merrnin pjesë në takimet tona - dhe erdhën nën ndikimin e bashkësisë dhe mësimit të krishterë.

Ju lutem shumë, për hir të shpirtit tuaj dhe të shpëtimit tuaj të përjetshëm: hyni në lidhje me besimtarë të tjerë. Nuk po bëj fushatë për ndonjë kishë apo predikues të veçantë. Dëshira ime parësore është shpëtimi i shpirtit tuaj.

Pastaj gjithashtu, çdo i krishterë është i thirrur që të *pohojë publikisht* atë që ka gjetur ai në Jezusin. Ky është aspekti i dytë i anës së hapur, të dukshme të besimit të krishterë.

A keni dëshmuar ndonjëherë për Jezu Krishtin, qoftë edhe vetëm me thënie të tilla: "Është e vërtetë që Jezusi është i gjallë"? Ose "Ti po fyen emrin që unë dua mbi të gjithë me blasfemitë e tua." Ose: "Me historitë e tua të ndyra, ti po zvarrit në baltë një nga mrekullitë më të mëdha të krijimit të Perëndisë." A keni dëshmuar ndonjëherë për të thjesht duke thënë: "Unë i përkas Jezusit"? Njerëzit thjesht nuk do t'u besonin veshëve nëse ne të gjithë do të fillonim të dëshmonim!

Për sa kohë që nuk kemi kurajën për t'u folur të tjerëve për Shpëtimtarin tonë, ne nuk jemi të krishterë të vërtetë. Jezusi tha: ***Kushdo që do të më rrëfejë përpara njerëzve, dhe unë do ta rrëfej përpara Atit tim që është në qiej. Por kushdo që do të më mohojë përpara njerëzve, edhe unë do ta mohoj përpara Atit tim që është në qiej.*** Do të jetë tragjike në Ditën e Gjykimit të shohësh të ashtuquajturit të krishterë të çohen dhe të thonë, "Zoti Jezus, ne kemi besuar në ty", dhe të shohësh Jezusin të kthehet nga Ati i tij dhe të

thërrasë, "Unë nuk i kam njohur kurrë ata"! "Por Zot, unë vërtet...". "Nuk ju njoh," do të jetë përgjigjja. "I afërmi juaj kurrë nuk e dinte se po shkonte drejt e në ferr. Ju kurrë nuk e paralajmëruat, megjithëse ju vetë e dinit rrugën që të çon në jetën e përjetshme. Çdo herë që ju duhet të kishit hapur gojën dhe të shprehnit një qëndrim në lidhje me mua, ju heshtët." "E di por besimi im ishte kaq i dobët." "Duhet ta kishe pohuar edhe atë besim të dobët. Një besim i dobët prapëseprapë e ka një Shpëtimtar të fuqishëm. Sidoqoftë, unë kurrë nuk të kërkova që të shpallësh besimin tënd, por të më shpallësh *mua.* Unë nuk të njoh."

Kushdo që do të më rrëfejë përpara njerëzve, edhe unë do ta rrëfej përpara Atit tim që është në qiej. Por kushdo që do të më mohojë përpara njerëzve, edhe unë do ta mohoj përpara Atit tim që është në qiej. Këtë thotë Jezusi. Dhe Jezusi nuk gënjen kurrë. Kur do ta gjejmë kurajën për të hapur gojën dhe për ta rrëfyer atë?

Duhet t'ju tregoj një histori tjetër. Para disa javësh po flisja në një nga qytetet e Luginës së Rurit. Takimet ishin organizuar nga miku im i ri, Gustavi. Gustavi është drejtuesi i punishtes së riparimit të njërës prej garazheve më të mëdha të qytetit. Ai është bërë një dëshmitar i gëzueshëm dhe i efektshëm i Jezu Krishtit sepse ai mësoi të shprehë një qëndrim në lidhje me Shpëtimtarin e tij në kohën e duhur. Një të hënë në mëngjes në punishte, çdo punëtor, njëri pas tjetrit, filloi të mburrej për "bëmat e së dielës". Njëri prej tyre tha, "U dehëm aq shumë sa na doli birra nga sytë!" Një tjetër përshkroi në detaj një aventurë me seksin e kundërt. "Po ti Gustav," e pyetën ata, "ku ishe?" Në atë kohë ai ishte akoma mekanik nxënës. "Në mëngjes," u përgjigj ai, "shkova në kishë. Pasdite shkova në takimin e të rinjve të pastor Bushit

në Vajgëll Haus." Atëherë pasoi një goxha raund ngacmimesh dhe talljesh. Dhe çiraku i ri qëndronte aty, kokë varur. Por papritur, kur të gjithë - çirakë, mekanikë, madje dhe kryepunëtori - po e sulmonin, një zemërim i madh gufoi brenda tij. "Pse ndodh," mendoi ai, "që mes njerëzve që e quajnë veten të krishterë është e mundur të mburresh për gjërat më të turpshme, por nuk është e mundur të shprehësh një qëndrim për Shpëtimtarin?"

Ai vendosi aty për aty që të orvatej ta fitonte të gjithë punishten për Jezu Krishtin. Duke filluar me shokët e tij çirakë, ai e merrte secilin mënjanë më vete dhe i thoshte, "Dëgjo, po të vazhdosh kështu, një ditë do të përfundosh në ferr. Pse nuk vjen me mua të dielën tjetër në takimin e të rinjve në Vajgëll Haus? Atje do të dëgjosh gjithçka për Zotin Jezus!"

Në kohën që Gustavi u largua nga punishtja pasi kishte kaluar me sukses provimet e kualifikimit, gjërat kishin ndryshuar krejtësisht. Për këtë isha vetë dëshmitar. Të gjithë çirakët bënin pjesë në grupin tim të të rinjve. Tre nga mekanikët shkonin në takimet në LKR (Lidhjen e Krishterë të të Rinjve). Në punishte, askush nuk guxonte më të thoshte ndonjë gjë të ndyrë. Kur ndonjë i sapoardhur fillonte të fliste fjalë të pahijshme, të tjerët i bënin shenjë të heshtte, ose ndryshe dikush do t'i pëshpëriste në vesh, "Mbylle! Do të të dëgjojë Gustavi."

Dhe kështu Gustavi fitoi respektin e të gjithëve. Sot ai ka një post me shumë përgjegjësi si kryemekanik në një garazh të rëndësishëm. Duket qartë që Perëndia e ka bekuar atë në të gjitha mënyrat.

Edhe një herë e përsëris pyetjen: Ku janë të krishterët sot me kurajën për të folur me zë të lartë dhe për të deklaruar publikisht se janë për Shpëtimtarin? Megjithatë, vetëm kur ne e rrëfejmë Krishtin atëherë rritemi frymërisht.

Është besimi i krishterë një çështje rigorozisht private? Jo, nuk është! Ne kemi një detyrim ndaj botës për të dëshmuar për besimin tonë në Jezu Krishtin. Kështu, jepini fund heshtjes suaj të neveritshme. Ndryshe Jezusi do t'ju mohojë në Ditën e Gjykimit.

Gjatë Rajhut të Tretë, një numër i madh nga të rinjtë e mi, që të gjithë adoleshentë, u regjistruan me forcë në "Arbeitsdienst", ose "Shërbimin e Punës" të Hitlerit. Pak para se të niseshin, i dhashë secilit nga një Bibël të vogël me këtë rekomandim: "Kur të shkoni në repartin tuaj, pikërisht në mbrëmjen e parë vendoseni Biblën mbi tavolinë, hapeni dhe lexojeni në sy të të gjithëve. Kjo do të jetë si një bombë. Por ditën tjetër kjo do të marrë fund. Nëse nuk e shprehni qëndrimin tuaj pikërisht në fillim, nuk do ta bëni kurrë atë."

Ata bënë atë që ua sugjerova. I vunë Biblat mbi tavolinë që ditën e parë. "Ç'po lexoni aty?" "Biblën." Po të kishte shpërthyer një granatë dore në dhomë, reagimi nuk do të kishte qenë më i keq!

E trishtueshme ta thuash, në shoqërinë tonë gjermane, mund të lexosh çdo lloj libri të pistë, por jo Biblën!

Një nga miqtë e mi të rinj, Pali, (ai nuk u kthye nga lufta) zbuloi mëngjesin tjetër kur po hapte dollapin se Bibla e tij ishte zhdukur. Ai kot kërkoi nëpër dhomë. Një nga djemtë ia dha të qeshurit; të tjerët u bashkuan me të. "Ju ma vodhët Biblën?" pyeti ai. "H'm...," qe përgjigjja. "Ku e hodhët Biblën time?" nguli këmbë ai. "E mori major rreshteri!" Pali e dinte atëherë se gjërat do të vinin duke u keqësuar.

Kur kishte mbaruar punët e tij atë natë, ai kërkoi një vend ku të ishte vetëm dhe u lut: "Zoti Jezus! Unë jam vetëm. Jam vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç. Të lutem mos më lër në baltë. Më ndihmo të shpreh një qëndrim për ty." Kur mbaroi së luturi, ai shkoi në zyrën e major rreshterit dhe trokiti në derë.

"Hyr!" Major rreshteri ishte ulur në tavolinën e tij. Dhe atje mbi tavolinë ishte Bibla e Palit! "Çfarë kërkon?" "Të lutem zotëri," iu lut Pali, "ma ktheni Biblën. Është imja." "H'm...," qe përgjigjja e vetme. Ai e mori biblën dhe filloi të shfletonte nëpër të. "Kështu, ti je ai të cilit i përket kjo Bibël?" tha ai. "A nuk e di se Bibla është libër i rrezikshëm?" "Po zotëri, e di që është. Është libër i rrezikshëm edhe e mbyllur në dollapin tim zotëri. Edhe atje krijon shqetësime!" Oficeri u drejtua në karrige dhe tha, "Ulu një minutë." Atëherë ai u zbraz, "Një herë e një kohë, kur isha i ri, planifikova të studioja teologji." Pali e pyeti, "Zotëri, ju e keni mohuar besimin tuaj?" Pastaj pasoi një bisedë e pafund gjatë së cilës major rreshteri, një burrë rreth të dyzetave, pranoi para shtatëmbëdhjetë vjeçarit, "Në fakt unë jam një njeri shumë i trishtuar. Por nuk mund të kthehem prapa - çmimi është tepër i lartë." "I shkreti ti," i tha Pali, "por Jezusi ia vlen të gjitha sakrificat!" Oficeri e la djaloshin të largohej me këto fjalë: "Je një djalë me fat, biri im." "Ashtu është, Zotëri," miratoi Pali kur doli nga zyra me Biblën futur nën sqetull. Që atëherë e më vonë askush nuk bëri as vërejtjen më të vogël për Biblën e tij.

Ku janë ata të krishterë sot që kanë kurajën të ngrihen për bindjet e tyre?

A është besimi i krishterë një çështje rigorozisht personale? Po, është. Lindja sërish dhe jeta e krishterë zënë vend në thellësitë e zemrës së besimtarit.

A është besimi i krishterë një çështje rigorozisht personale? Jo, nuk është. Të krishterët mblidhen në kishë për ta adhuruar Perëndinë së bashku. Së bashku ata marrin pjesë në studimet biblike shtëpiake, në takimet e të rinjve, dhe në grupet e bashkësisë. Ata hapin gojën dhe deklarojnë publikisht se ndjekin Zotin.

Bota duhet ta shohë se Perëndia ka ndezur një zjarr mbi tokë në personin e Jezu Krishtit!

KUR DO TË VIJË FUNDI?

Para ca kohësh bisedova me një biznesmen. Ai më rrahu shpatullat dhe tha, "Pastor, ajo që po bën ti për t'i inkurajuar të rinjtë që të bëjnë një jetë të denjë është e mirë." "Që të jem shumë i sinqertë," u përgjigja, "nuk pres shumë prej kësaj. Bibla thotë se zemra e njeriut është e keqe që në fëmijëri. Kështu nuk mendoj se moralizimi ka shumë dobi. Do të dëshiroja diçka të ndryshme." "Oh...! Saktësisht, ç'do të dëshironit?" "Do të dëshiroja t'i shihja këta të rinj të ktheheshin te Zoti Jezus dhe të bëheshin bij të Perëndisë tani dhe në përjetësi." "Pastor," tha ai, "ajo që thua është e mirë por duhet të zbresësh në tokë."

Tani a nuk është kjo fjalë mençurie? "Duhet të zbresësh në tokë!" Ia dhashë të qeshurit. "Miku im i dashur," e pyeta me shaka, "duhet të zbres në *cilën* tokë? A nuk e ke vënë re se toka ka qenë duke u tundur nën këmbët tona për një periudhë të gjatë kohe?"

Nuk është nevoja të jesh bos i madh në industri për të kuptuar se bota nuk është më një vend i sigurt. Dhe kjo është ajo që i frikëson njerëzit sot. Të gjithë kërkojnë siguri, por të gjithë e dinë se nuk mund të gjendet asgjëkundi. Disa njerëz hapin një llogari bankare në Zvicër; të tjerët kanë ndërtuar një strehim bërthamor në Bolivi. Në fund të fundit, siguria duhet të jetë diku! Por thellë në brendësi të gjithë dimë një gjë: nuk ka asnjë siguri. Nuk është për t'u habitur që njerëzit sot po pyesin me ankth, "Ku po shkon bota jonë?" Në mënyrë të pamohueshme, një nga karakteristikat e kohëve tona është fakti që shumë njerëz pyesin se kur do të vijë fundi i botës.

Disa vite më parë, doli në skenë një dramë nga autori zviceran Dyrrenmat, *Fizikanët.* Drama mbyllej me një skenë në të cilën një nga fizikanët bënte një parashikim shumë të zymtë: askush nuk mund ta pengojë njerëzimin që të përdorë

bombën atomike dhe të shfarosë vetveten. Autori konkludonte: "Dhe diku atje në hapësirë, toka radioaktive do të vazhdojë të rrotullohet pambarimisht dhe pavlefshmërisht."

Vizioni i një bote të shkretuar që rrotullohet pa fund në hapësirë, pa jetë a qëllim, dukej shumë re-al. Kur një shkrimtar modern flet me terma kaq të frikshme për fundin e botës, kjo kërkon vëmendjen tonë. Personalisht, unë nuk besoj se Dyrrenmati kishte të drejtë. Unë nuk besoj se një ditë nuk do të ketë më tepër se një tokë radioaktive që vjen rrotull në hapësirë. Nëse do të përpiqesha t'ia shpjegoja këtë gjë autorit, ai ndoshta do të më pyeste, "Pse nuk e pranon teorinë time? Kuptohet vetvetiu se kështu do të ndodhë." Por unë do t'i përgjigjesha, "Nuk është kjo pikëpamja e krishterë. Zoti Jezus la të kuptohej se raca njerëzore nuk do të zhdukej para fundit të botës. Pavarësisht nga mundësitë, gjërat nuk do të ndodhin si i imagjinoni ju."

Çështja është, kë mund të besoni dhe parashikimit të kujt mund t'i besoni?

Ka dy mënyra të gabuara të shqyrtimit të së ardhmes.

Është mënyra që kishte Jozef Gëbelsi, e cila thjesht konsiston në fantazimin për atë se si mund të jetë e ardhmja. Edhe tani më bëhet sikur e dëgjoj duke folur me fjalë të mëdha, "Si sot pas pesë vjetësh, qytetet gjermane do të ngrihen më të bukura se ç'kanë qenë ndonjëherë më parë!" Kjo mënyrë të menduari është baras me projektimin e fantazive të dikujt mbi perden që fsheh të ardhmen.

Dëshmitarët e Jehovait e përdorin këtë metodë me mjeshtëri. Disa njerëz më të vjetër në moshë mund të kujtojnë afishet që ishin ngjitur në çdo qoshe rruge në vitin 1925: "Miliona njerëz që jetojnë tani nuk do ta shohin kurrë vdekjen!!" Kjo parullë zuri fill me Studentët Ndërkombëtarë të Biblës. Për ironi, më shumë njerëz vdiqën pak vjet më

vonë se sa kurrë ndonjëherë më parë në historinë e botës. Studentët Ndërkombëtarë të Biblës, thjesht kishin ëndërruar një përfytyrim të trëndafiltë të së ardhmes. Më vonë ata e ndryshuan emrin dhe u bënë të njohur si Dëshmitarët e Jehovait. Dhe ata ndoshta akoma po shpikin imazhe të reja mendore edhe sot.

Së dyti, është mënyra e fallxhorëve. Më duhet të pranoj se nuk kuptoj asgjë në lidhje me të. Dhe as dua të mësoj asgjë për shortaritë, spiritizmin, radiestezinë, kartomancinë, horoskopet, e të tjera si këto. Le t'jua them përse. Perëndia e ka thënë mjaft qartë në Fjalën e tij, në Bibël: ***Nuk do të zbatoni asnjë lloj shortarie apo magjie.*** Ai gjithashtu ka thënë këtë: ***Mos iu drejtoni mediumeve dhe magjistarëve... për të mos u ndotur me anë të tyre.*** Një pjesë tjetër thotë: ***Të mos gjendet midis teje ndonjë që e kalon birin ose bijën e vet nëpër zjarr, as ndonjë që praktikon shortarinë, bën parashikime, interpreton shenjat dhe merret me magji, as ai që përdor yshtje, as mediume apo që konsultojnë frymat, as magjistarë, as ai që ndjell të vdekurit, sepse të gjithë ata që merren me këto punë neveriten nga Zoti.***

Meqë dëshira ime më e madhe në jetë është të jem i krishterë dhe të jem pjesë e popullit të Perëndisë, do të kujdesem që të mos përzihem me këto gjëra. Në qoftë se ju keni rënë në këtë kurth, ju lutem për hir të shpirtit tuaj dhe për shpëtimin tuaj: lini kohë për të kontrolluar zemrën tuaj; pastaj thirrini Jezusit, rrëfejani këtë mëkat atij dhe kërkojini falje.

Për veten time, jam i vendosur ta vë besimin tim në Bibël, në Fjalën e Perëndisë. Nuk mund të bëj ndryshe, sepse Bibla mban vulën e vërtetësisë. Ajo nuk është thjesht spekullim. Herë pas here shkruesit e saj shpallin: ***Kështu thotë Zoti!***

Mënyra më e sigurt për të zbuluar të ardhmen është t'i referohemi Biblës.

Në kulmin e luftës, gestapoja më urdhëroi ta ndërprisja shërbesën time shëtitëse. Isha i autorizuar të bëja takime vetëm në qytetin e Esenit. Qyteti ishte shkretuar nga bombat. Sidoqoftë, çdo mbrëmje unë bëja një studim biblik në një qilar. Duke pasur shumë kohë të lirë gjatë ditës, shfrytëzova rastin për të studiuar tërësisht librin e fundit të Biblës, Zbulesën e Gjonit. Ajo që më bëri më shumë përshtypje në studimin tim ishte lidhja me aktualitetin. Dhe atëherë vendosa të ndaja me të tjerët mësimet që nxora prej tij.

1. Jezusi do të kthehet

Bibla e thotë qartë këtë. Kthimi i Jezu Krishtit në lavdi është ngjarja kurorëzuese drejt së cilës drejtohen shpresat e të gjithë të krishterëve. Kur Jezusi u ngjit në qiell dyzet ditë pas ringjalljes, dishepujt i mbajtën sytë të fiksuar mbi të. Dhe ata e panë atë të zhdukej në një dimension tjetër. ***Një re... ua hoqi prej syve të tyre.*** Pastaj krejt papritur dy lajmëtarë të dërguar nga Perëndia iu paraqitën dishepujve dhe thanë, ***Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell.***

Po, Jezusi do të kthehet përsëri! Një ditë duke ardhur nga një dimension tjetër, nga dimensioni i Perëndisë, Zoti Jezus, në një re lavdie, do të vijë papritur në botën tonë tridimensionale. *Kjo është shpresa e krishterë.*

Duhet t'ju tregoj se si kjo e vërtetë e jashtëzakonshme u ngulit tek unë më shumë se njëzet e pesë vjet më parë. Në atë kohë isha pastor i ri dhe sapo kisha shkuar në një qytezë minatorësh në qytetin e Esenit. Isha vetëm njëzet e shtatë vjeç dhe u gjenda i vetëm mes 12.000 minatorësh, askush

prej të cilëve nuk ishte aspak i interesuar për mesazhin tim. Në zemër të qytezës, rrethuar nga blloqet e apartamenteve të minatorëve dhe nga kullat e puseve, ishte një shesh i madh dhe i shkretë. Në një nga qoshet e sheshit një shtëpi e vogël mbahej akoma në këmbë. Arrita të rregulloja një vend takimi modest në të dhe pastaj fillova të mbaja studime biblike të rregullta. Ishte e mrekullueshme të shihje njerëzit që vinin njëri pas tjetrit për herë të parë: disa minatorë (komunistë dhe mendimtarë të lirë) që ishin kureshtarë të dëgjonin atë që kishte për të thënë ky predikues i ri, disa gjyshe të dashura, një grusht fëmijë dhe dy a tre të rinj. Edhe pse duket e çuditshme, kjo kishë embrionik modeste e acaroi gjithë popullatën e zonës. Na shqetësonin në çdo takim. Një ditë thyen xhamat e dritareve. Kështu vumë grila. Por atëherë ata filluan t'i gjuanin grilat me gurë. Zhurma ishte shurdhuese. Pas kësaj filluan të luanin futboll me kuti prej teneqeje mu përballë derës në mënyrë që askush të mos dëgjonte asnjë fjalë që thuhej. Në një rast tjetër, ata parakaluan me fyej para sallës sonë të vogël dhe filluan të këndonin me zë të lartë. Brenda, grupi ynë i vogël filloi të këndojë një këngë adhurimi.

Ato ishin kohë heroike!

Pastaj një ditë gjendja u bë alarmante. Dukej sikur ishte lëshuar i gjithë ferri. Ndodhi diçka e çuditshme. Në derë u flak një objekt i rëndë, dhe ra në tokë me zhurmë të madhe. "Kanë hedhur bombë!" mendova. Munda të dëgjoj zhurmën e njerëzve që largoheshin me vrap. Zemrat tona pushuan së rrahuri. Pastaj jashtë u bë prapë heshtje. Unë hapa derën ngadalë dhe pashë, aty për tokë, në mes të një pellgu me ujë, një kryq shumë të madh prej metali me portretin e Jezusit në të. Ai ishte shqyer nga një ndërtesë e një shoqate katolike aty afër dhe ishte hedhur në derën tonë. Dukej sikur armiqtë tanë

donin të na thoshin, "Ja tek e keni Krishtin tuaj! Le të rrijë në baltë!"

Ishte një mbrëmje e zymtë nëntori. Binte shi. Dhe aty në këmbët tona ishte kryqi në pellg. Po qëndroja në skajin e atij sheshi të braktisur. Prapa meje grupi ynë i vogël ishte mbledhur tok, duke u dridhur dhe duke fërgëlluar nga frika; para të gjithëve ne, në pellg, ishte shëmbëlltyra e Shpëtimtarit të kryqëzuar. Nuk mund të mos mendoja, Perëndia mund ta kishte lënë botën në fatin e vet të tmerrshëm për një mijë arsye. E megjithatë ai nuk e bëri këtë. Ai madje dërgoi Birin e tij, i cili bëri një gjë të jashtëzakonshme: ai mori mbi vete mëkatet tona dhe lejoi që të gozhdohej në kryq. Dhe ç'ka bërë njeriu? Në vend që të bjerë dhe të adhurojë Shpëtimtarin, ai e ka marrë shëmbëlltyrën e tij dhe e ka hedhur në baltë. Është njësoj sikur ai të ketë pështyrë në dorën që Perëndia i ka shtrirë atij."

Shikoni, të paktën ata njerëz në Esen kishin pak urrejtje për Jezusin. Njerëzit sot as nuk vrasin mendjen për ta urryer! Ata thjesht e hedhin kryqin me Krishtin në pellg për shkak të indiferencës së tyre të plotë.

Atë ditë më pushtoi një zemërim që më digjej përbrenda. "Ç'do të bëjë tani Perëndia?" Mendoja. "Me siguri zjarr do të bjerë nga qielli!" Por zjarr nuk ra aspak. Vazhdoi të binte shi. Dhe shëmbëlltyra e Shpëtimtarit në kryq qëndronte e shtrirë në pellg.

Munda të dëgjoj të qeshura shpotitëse nga larg. Ata po talleshin me mua! "Gjërat nuk do të jenë gjithmonë kështu," mendova papritur. "Biri i Perëndisë, i cili vdiq për këtë botë, nuk ka për të qenë gjithmonë një objekt përbuzjeje. Jo, nuk ka për të qenë gjithmonë kështu. Për momentin, fuqia dhe madhështia e tij janë ende të fshehura. Por do të vijë dita - dhe kjo është absolutisht e sigurt - kur bota që e përbuzi ka për ta njohur atë si të vetmen rrugë shpëtimi dhe si Zot të

gjithësisë. Ai do të vijë përsëri në lavdinë e tij."

Atë mbrëmje në shi, në sheshin e shkretë me kryqin me Krishtin në baltë, me grupin tim të vogël të besimtarëve aty afër, isha në gjendje për herë të parë, ndërsa kthehesha në vendin modest të takimit, të gëzohesha në mendimin e rikthimit të Jezusit. Kur ndodhesha përsëri te katedra, hapa Ungjillin sipas Mateut, kapitullin 24, dhe lexova: ***Do ta shohin Birin e Njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit, me fuqi dhe lavdi të madhe***. Nuk kam pushuar së gëzuari për kthimin e tij qysh atëherë.

Kur shoh se në ç'masë po përbuzet Shpëtimtari im - ky Shpëtimtar që shpëton nga vdekja, fal mëkatet, sjell lumturi dhe që shpëton - jam i kënaqur të di se po vjen dita kur petku i përbuzjes do të bjerë nga supet e tij dhe ai do të shfaqet në gjithë lavdinë e tij.

Herën e parë që shkova në sallën kryesore të Vajgëll Hausit, një qendër të rinjsh të krishterë në Esen, vëmendjen time e tërhoqi një pikturë në mur. Në këtë sallë, ku qindra të rinj mblidheshin së bashku, ndodhej një pikturë unike. Ajo paraqiste kthimin e Jezu Krishtit: në fund të pikturës një qytet; mbi të, re; mbi këto re një kalë i bardhë, mbi të cilin kishte hipur Mbreti. Dora e tij ishte ngritur lart dhe në atë dorë mund të shiheshin ende shenjat e gishtave.

I thashë pastor Vajgëllit, paraardhësit tim, "Është kjo e vetmja pikturë që keni në mure? Nuk duket shumë e përshtatshme këtu në një qendër të rinjsh." "Miku im i dashur," u përgjigj ai, "këta të rinj kalojnë gjithë javën në shkollë, në punë, në fabrikë, ose poshtë në minierë. Kur ata dëshmojnë për besimin e tyre në Zotin Jezus, ata nuk ndeshin asgjë përveç sarkazmës dhe talljes. Dhe nëse ngrejnë zërin kundër së keqes, ata tallen dhe kritikohen. Nuk është për t'u habitur që shpesh ata dekurajohen. Kjo pikturë ka për qëllim

t'ua kujtojë atyre, kur mblidhen këtu, se Krishti është fitimtar dhe se me dekret të përjetshëm bota *do të* jetë e tij."

Kam përjetuar personalisht fuqinë e kësaj shprese të mrekullueshme. Nën sundimin e Hitlerit, u arrestova pasi mbajta një takim të madh në qytetin e Darmshtatit. Më futën duke më shtyrë në një veturë policie në krah të një zyrtari të Gestapos. Qindra njerëz u grumbulluan rreth nesh. Ushtari eses në timon mori urdhër të nisë makinën. Por motori nuk ndizej. Ndoshta vetura ishte në gjendje të mirë por thjesht nuk punonte. "Nisu!" ulëriti oficeri eses. Por motori akoma qëndronte i bllokuar. Pikërisht atëherë, nga mesi i turmës, një i ri që qëndronte në shkallët e kishës filloi të këndojë me zë të lartë:

Gëzohuni! Shpëtimtari mbretëron -
Perëndia i së vërtetës dhe i dashurisë së zjarrt';
Pasi njollat ne na i pastron,
Zë vendin e Tij atje lart:
Ngrijeni lart zemrën, zërin lart çojeni:
Gëzohuni, përsëri ju them, gëzohuni.

Gëzohuni në shpresën e lavdishme:
Jezusi, Gjykatësi do të vijë,
Dhe shërbëtorët e Tij do t'i marrë lart
Në shtëpinë e tyre të përjetshme:
Shpejt zërin e kryeengjëllit do të dëgjojmë:
Boria e Perëndisë do të tingëllojë: Gëzohuni!

I riu u zhduk menjëherë në turmë. Dhe atëherë makina u nis! Duke u kthyer nga zyrtari i Gestapos, i thashë, "Miku im i shkretë! Unë jam në anën e fitimtarit." Ai u hodh përpjetë nga fjalët e mia pastaj më pështpëriti, "Shumë kohë më parë unë isha anëtar i LKR." "Mirë!" i thashë, "dhe tani ti po arreston të krishterët! I shkreti ti, nuk do të doja që të isha

unë në këpucët e tua." Vazhduam të bisedonim derisa arritëm në burg, por në atë kohë të shkurtër shpresa e rikthimit të Krishtit ishte hapur para meje.

Dhe ndërsa ditët errësohen shpresa e ardhjes së Krishtit merr rëndësi akoma më të madhe.

Kthimi i Jezu Krishtit në lavdi do të jetë, në fakt, ardhja e tij e tretë në tokë. Ai erdhi herën e parë në mishërimin e tij. I lindur nga Maria, ai u shtri në grazhdin e Betlehemit. Është kjo ngjarje që festojmë ne në Krishtlindje; domethënë, nëse e dimë akoma se përse bëhet e gjithë kjo. Ndodhi në atë kohë që Biri i Perëndisë u bë njeri, që ne të mund të bëhemi fëmijë të Perëndisë, dhe që ai të mund të bëhet vëllai ynë.

Jezusi vjen për herë të dytë pikërisht tani, tamam këtë ditë - në personin e Frymës së tij. Ai thotë, ***Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe e hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua***.

Pse ungjillizojmë ne? Për të përgatitur rrugën për Zotin Jezus që të vijë te njerëzit sot. Bibla thotë: ***Të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besuan në emrin e tij***.

Kur Jezusi të vijë për herë të tretë, kjo do të jetë në gjithë lavdinë e tij. Bibla ka zbuluar diçka për rrethanat që do të çojnë deri në këtë ngjarje monumentale. Në kohën e rikthimit të tij, ne do t'i kemi provuar të gjitha sistemet e ndryshme të qeverisë: monarkinë konstitucionale dhe monarkinë absolute; demokracinë presidenciale dhe demokracinë popullore; diktaturën dhe kushedi se çfarë, dhe do të kemi parë se ato nuk japin asnjë rezultat. Dhe
do të kemi pranuar se asnjë nga këto sisteme nuk ia vlen shumë.

Kjo do të jetë koha e përshtatshme për kthimin e Jezusit.

2. Ngjarjet që i paraprijnë kthimit të Krishtit

Bibla thotë se zhvillimi i historisë botërore do të vazhdojë për një kohë mjaft të gjatë nëpër epokat. Pastaj në një mënyrë pothuajse të paperceptueshme, do të vijë një periudhë kohe kur zhvillimit të saj, si të thuash, do t'i vijë fundi. Për ta emërtuar këtë kohë, do të përdor një shprehje e cila nuk gjendet në Bibël. Do t'i referohem asaj si "periudha e fundit". Bibla tregon për një kohë kaosi të përhapur kudo kur njerëzit nuk do të jenë në gjendje të zgjidhin problemet e tyre. Të kapur nga paniku, ata do të kërkojnë ndihmë por nuk do të gjejnë. Zoti Jezus theksoi se katër faktorë do ta karakterizojnë këtë "periudhë të fundit".

Ai aludonte për *konfuzionin politik* të kësaj periudhe kur thoshte, ***Do të ngrihet, pra, popull kundër populli dhe mbretëri kundër mbretërie***. Asnjë epokë si kjo jona, kur diplomatët kanë mbajtur kaq shumë konferenca të kushtueshme, nuk është njohur ndonjëherë. Asnjë epokë si kjo jona, ku riarmatimi bëhet në dëm të popujve në një mënyrë të tillë kaq të çmendur, nuk është njohur ndonjëherë. Paratë e harxhuara për armët atomike mund të përdoreshin për të ndërtuar disa qytete të mëdha dhe kështu t'i jepnin fund mungesës së strehimit. Por në vend të kësaj, politikanët në mbarë botën thonë, "Duhet të riarmatosemi!" Edhe shteti më i vogël duhet ta ketë bombën atomike.
E megjithatë, kurrë më parë nuk ka patur kaq dëshirë të zjarrtë për paqe! Çdo vend kërkon paqe. Askush nuk kërkon luftë. Por çdo vend hyn si i çmendur në garën e armatimit. A nuk mund të ishte kjo kaosi politik "i fundit"?

Së dyti, Jezusi përmend *konfuzionin ekonomik* të kësaj periudhe: ***Do të ketë zi buke... dhe tërmete në vende të***

ndryshme. Toka prodhon ushqim të mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që të hanë sa të ngopen. Dhe nuk ka patur kurrë kaq shumë ekonomistë të kualifikuar sa në ditët tona. Kurrë nuk ka qenë ekonomia botërore kaq e sofistikuar. Megjithatë pavarësisht nga kjo, sipas raporteve të Kombeve të Bashkuara, më shumë se gjysma e njerëzimit kurrë nuk ha sa të ngopet. Në një shoqëri kaq shumë të civilizuar sa jona, a nuk do të ishim në gjendje të mbulonim urinë e të gjithë njerëzve? Por në një farë mënyre nuk mund t'ia arrijmë kësaj. Dhe çrregullimi ekonomik rritet.

Shenja e tretë e dalluar e "periudhës së fundit" për të cilën aludon Jezusi është *konfuzioni fetar*. Jezusi e përshkroi këtë me këta terma: ***Atëherë, në qoftë se dikush do t'ju thotë, 'Ja, Krishti është këtu', ose 'Është atje', mos i besoni. Sepse do të dalin krishtër të rremë dhe profetë të rremë, dhe do të bëjnë shenja të mëdha dhe mrekulli të tilla aq sa t'i mashtrojnë... edhe të zgjedhurit.***

Kohët e fundit u përballa me një të ri që më tha, "Nuk di se kujt t'i besoj. Janë katolikët romakë, ortodoksët, protestantët, dëshmitarët e Jehovait, mormonët, moonët, budistët, myslimanët, dhe gjithë të tjerët. Kë të besoj?" Qesha dhe iu përgjigja, "Djalosh, merr kurajë sepse gjërat po shkojnë keq e më keq. Kështu thotë Bibla!"

Kjo është vërtet një nga shenjat e "periudhës së fundit". Për shkak se njerëzit refuzojnë të orientohen nga Fjala e Perëndisë, ata çorientohen nga Djalli. Dhe Perëndia e lejon këtë. "Ja, Krishti është këtu...! Ja, është atje!"

Ka një konfuzion të tmerrshëm në çështjet fetare. Unë alarmohem kur vë re mënyrën se si vrapojnë njerëzit nga një spektakël fetar në një tjetër. Por le t'ju them që tani se asnjë predikues i madh nuk do t'ju shpëtojë ndonjëherë. Nëse nuk e takoni personalisht Shpëtimtarin do të humbisni përjetësisht.

Ka dhe një shenjë të fundit të "periudhës së fundit": *kthimi i Judenjve në Palestinë.* Ekzistenca e shtetit të Izraelit më duket se është një nga shenjat më të çuditshme të kohëve. Disa njerëz nuk shohin asnjë shenjë në të.

Por kohët e fundit kur po prisja në radhë në kufirin zviceran dhe pashë një veturë me një targë ku shkruhej "Shteti i Izraelit" para meje, nuk mund të mos mendoja, "Profecitë biblike po përmbushen dhe madje edhe targat e makinave po e shpallin këtë!"

Im at më ka thënë se në vitin 1899 Judenjve iu ofrua Madagaskari si tokë për t'u strehuar, por ata refuzuan. "Gjë që s'bëhet!" thanë ata. "Ne kemi marrë një premtim: premtimin e kthimit një ditë në tokën e të parëve tanë." Opinioni botëror në atë kohë ishte se ishte e pamundur që të arrinte të bëhej kjo gjë ndonjëherë. E megjithatë, shteti i Izraelit sot ekziston vërtet.

Ajo që e karakterizon "periudhën e fundit" është fakti që pavarësisht nga gjithë progresi i tij, njerëzimi është gjithmonë e më tepër i shushatur. Paaftësia e njeriut është e dukshme. Se sa do të zgjasë "periudha e fundit" nuk mund ta them. Bibla nuk e përmend numrin e viteve. Por ajo na paralajmëron të "rrimë syhapur". Apostull Pali u jep këtë këshillë të krishterëve: ***Le të mos flemë pra, si të tjerët, por të rrimë zgjuar dhe të jemi esëll.***

Kur kjo periudhë konfuzioni para kthimit të Krishtit të jetë në kulmin e saj, *do të fillojë koha e Antikrishtit.* Unë do ta quaj atë "ditët e fundit". Është e vërtetë se tani ne po përjetojmë konfuzionin e "periudhës së fundit". Dhe ky konfuzion edhe tani bën zhurmë për shfaqjen e "njeriut të fortë". Po, bota jonë e sotme po kërkon këtë njeri të fortë. Dhe kur pikëllimi të arrijë një pikë kulminante, ky njeri i fuqishëm do të shfaqet dhe do ta shpallë veten si çlirimtar të botës. Ai nuk do të jetë Krishti por Antikrishti.

Bibla na tregon se prej oqeanit të kombeve do të dalë një diktator që do të dominojë gjithë botën: ky është ai që ne e quajmë Antikrishti. Nën sundimin e tij, bota do të bashkohet për herë të fundit. Kjo epokë e historisë do të karakterizohet nga kokëfortësia e njeriut. Do të jetë përpjekja e fundit e njeriut për të shpëtuar botën me anë të një programi politik dhe ekonomik të bërë vetë. Është magjepsëse të lexosh përshkrimin që bën Bibla për këtë diktator të fundit. Ajo e përshkruan atë me një gjuhë metaforike. Për ta kuptuar atë duhet që të na ndriçojë Fryma e Shenjtë. Apostull Gjoni pa vizionin dhe shkroi: ***Pashë të ngjitej nga deti një bishë, që kishte dhjetë brirë dhe shtatë krerë, dhe mbi brirë dhjetë kurora dhe mbi krerë emra blasfemie.***

Si mund ta shpjegojmë këtë përshkrim përshtypjelënës?

Deti është simboli i kombeve të tokës. Ata që kanë qenë ndonjëherë në det e dinë se sa i egër mund të bëhet ai. Ai kurrë nuk është përsosmërisht i qetë. As kombet e tokës nuk janë kurrë të gjithë në paqe. Ka gjithmonë diku një pikë të nxehtë.

"Çlirimtari" i fundit i botës do të dalë nga deti i kombeve. Të gjithë udhëheqësit politikë të mëdhenj të dy shekujve të fundit e mbanin veten për çlirimtarë. Dhe ata të gjithë e kishin origjinën nga populli: Napoleoni, korsikani i vogël; Adolf Hitleri, tetari i vogël i Luftës së Parë Botërore; Stalini, këpucari. Të gjithë ata ishin pararendës të Antikrishtit. Secili prej tyre doli nga gjiri i popullit dhe populli i gëzuar, i brohoriti ata duke thënë, "Ata janë një prej nesh!"

Jezu Krishti, çlirimtari im, nuk vjen nga deti i kombeve, por nga bota e Perëndisë. Sepse ai është Biri i Perëndisë të gjallë.

Antikrishti quhet *bishë*. Ç'do të thotë kjo? Bibla thotë se

njeriu u bë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Sa më afër Perëndisë që të jem aq më njerëzor bëhem. Sa më shumë të largohem nga Perëndia, aq më kafshëror bëhem. Niçe, armiku i madh i krishterimit, deklaroi në një rast: "Njeriu më fisnik është bishë me flokë të verdha." Ai e kishte kuptuar në mënyrë të përsosur. Antikrishti do të jetë një njeri plotësisht i larguar nga Perëndia. Ai do t'i ketë kthyer shpinën Perëndisë. Kjo do ta bëjë atë bishë.

Ai do të jetë një bishë *me shtatë kokë.* Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ai nuk do të jetë aspak budalla. Njerëzit sigurisht do të jenë në gjendje të thonë për të, "Ai e ka kokën mirë mbi supe!"

Antikrishti do të ketë *një gojë si të luanit.* Kjo nënkupton se ai do ta mbysë botën me propagandën e tij. Brezi ynë tashmë e ka provuar një shije të parakohshme të hungrimës së luanit që ushton nëpër gjithë mikrofonat dhe altoparlantët tanë. Nuk është e vështirë të imagjinosh se kur Antikrishti të jetë këtu, propaganda e tij absurde do të ketë një efekt rrafshues në të gjitha aspektet e jetës sonë.

Kjo përpjekje e fundit nga njeriu për të shpëtuar botën pa kërkuar ndihmën e Shpëtimtarit të saj, Zotit Jezus, sidoqoftë do të hasë sukses. Shpëtimi do t'i ofrohet njeriut pa iu dashur atij të pendohet dhe të ndryshojë mënyrat e sjelljes. Dhe të gjitha problemet do të zgjidhen për të: në fushën politike me anë të krijimit të perandorisë botërore; në fushën ekonomike me anë të shpërndarjes së tollonave
të ushqimit; dhe në fushën fetare me anë të adhurimit të vetë Antikrishtit.

Është alarmante të vështrosh se sa shpejt po shkon bota jonë drejt "ditëve të fundit".

Dhe kur të vijë ajo kohë, e gjithë bota do t'i nënshtrohet Antikrishtit. Të krishterët do të jenë të vetmit që do të thonë, "Ne refuzojmë të të adhurojmë ty!" Kushdo, pavarësisht se

cila mund të jetë pozita e tij shoqërore, do t'i duhet të mbajë një damkë mbi ballin e tij apo të saj. Por të krishterët do të thonë, "Jo! Ne kemi një Shpëtimtar. Ai është Jezusi!" Për shkak të kësaj, ata do të përndiqen. Bibla thotë: ***Askush të mos mund të blinte ose të shiste, po të mos kishte damkën***. Përsa i përket këtij vargu, një komentator svabian i Biblës i quajtur Auberlen, para njëqind e pesëdhjetë vjetësh, shkroi vërejtjen e mëposhtme: "Ne nuk e kuptojmë shumë mirë se ç'do të thotë kjo, por shpalosja e vetë ngjarjeve do të na ndihmojë të shohim qartë." Ne që kemi jetuar nën regjime totalitare mund t'i kuptojmë këto gjëra deri diku. Ne e dimë se ç'do të thotë: Zoti X nuk merr asnjë çertifikatë regjistrimi, asnjë tollon ushqimor, asnjë leje për punë; ai mund të besojë çfarë të dojë, por ai nuk ka më asnjë atdhe ose asnjë të drejtë. Kjo po ndodh pikërisht tani në ditët tona.

Më erdhi keq kur për herë të parë lexova këtë varg. "Kaq shumë njerëz besojnë se Bibla është e dalë jashtë mode," Nuk mund të mos mendoja. "Nuk është Bibla që është jashtë mode por ideologjitë tona. Bibla të çon drejt së ardhmes."

Antikrishti do të tolerojë çdo gjë, përveç një dëshmie të mbajtur për Shpëtimtarin e vërtetë, Zotin Jezu Krisht. Prandaj do të përndiqen të krishterët.

Një ditë, kur po bisedoja me fëmijët e mi për këto gjëra, vajza e vogël filloi të qajë. "Shpirt," i thashë, "pse po qan?" Mes ngashërimeve, ajo u përgjigj, "Por kjo gjë mund të ndodhë në secilën nga ditët!" "Po," i thashë, "Është e mundur." "Dhe ç'do të ndodhë në qoftë se unë nuk mund t'i qëndroj besnike Jezusit?" "Kjo do të ishte e tmerrshme," i shpjegova, "por ajo që ka rëndësi është se ti e ndjek atë ditë për ditë tani për tani."

Periudha e "ditëve të fundit" mund të na kapte në befasi kurdoherë. Kur të ndodhë kjo, nuk do të kemi më mundësi të

gjejmë Jezusin. Sepse nuk do të ketë më shërbesa kishtare. Kambanat e kishave do të treten për të bërë statuja për lavdinë e Antikrishtit. Kishat do të kthehen në muze dhe do të përdoren për të ekspozuar fotografitë e viteve të dikurshme të Antikrishtit.

Në këtë fazë, njerëzit do të thërrasin për ngushëllim. Por duke e hedhur poshtë Jezusin, të vetmin Ngushëllues, ata nuk do të gjejnë asnjë ngushëllim tjetër. Në pikëllimin e tyre burra dhe gra do të jenë nën mëshirën e qenieve si ata vetë. Megjithatë, të krishterët, do ta quajnë veten me fat - madje edhe nëse do t'u duhet të përballojnë vdekjen - sepse në këto ditë të vështira *ata* do të kenë një Ngushëllues.

Unë jam shqetësuar gjithashtu nga kjo deklaratë që bëri Jezusi: ***Njerëzit do të mpaken nga frika dhe nga pritja se çfarë do ta pllakosë botën.*** Libri i Zbulesës duket se sugjeron që Antikrishti do ta mbushë botën me fanfara dhe flamuj. Pyesja veten se si mund të pajtohen këto dy thënie. Nga njëra anë lexojmë për frikë dhe pritje; dhe nga ana tjetër për suksese të mëdha. Por duke jetuar vitin 1933, unë kam mësuar se bota mund të mbushet me brohorima, fanfara dhe flamuj, e megjithatë mund të jetë e përfshirë nga tmerri dhe frika për të ardhmen.

Kur Antikrishti të jetë në kulmin e fuqisë së tij, kur ai të jetë i sigurt se Jezusi është eliminuar një herë e përgjithmonë - Perëndia do të ndërhyjë! Jezusi do të kthehet në gjithë lavdinë e tij. Pak është thënë për Antikrishtin, përveç se Jezusi do ta shkatërrojë atë me frymën e gojës së tij.

Ndërsa kohët bëhen gjithnjë e më të errëta, shenjat e frikshme të pikëllimit njerëzor dhe të sundimit të ardhshëm të Antikrishtit bëhen më të dukshme. Por njerëzit që lexojnë Biblën marrin kurajë, sepse ata presin rikthimin e Jezu Krishtit.

3. Ngjarjet që do të pasojnë kthimin e Krishtit

Përsëri këtu Bibla zbulon vetëm përmbledhjen.

Para së gjithash, na thuhet se Jezusi do të mbretërojë mbi tokë për një mijë vjet. Edhe një herë Bibla përdor figura letrare gjë e cila ndoshta thjesht tregon se Jezusi do të sundojë për një periudhë të gjatë kohe. E gjithë kjo mua më duket përsosmërisht e qartë: para së gjithash, gjendja e pashpresë e njeriut do të bëhet evidente; pastaj, njeriu kokëfortë do të bëjë përpjekjen e tij të fundit për të shpëtuar botën; por pas kësaj, Jezusi duhet të sundojë. Dhe ai di si të qeverisë!

Po të doni provë për këtë, vizitoni një shtëpi ku Jezusi është Mbret - sepse ato ekzisojnë, madje që sot - dhe ju do të jeni të ndërgjegjshëm për një atmosferë të ndryshme sapo të keni kapërcyer pragun e derës. Mendoj për një çift të ri që njoh. Burri erdhi një ditë për një vizitë tek unë dhe tha, "Jam gati për t'iu dorëzuar Perëndisë. E kam mohuar ekzistencën e tij deri tani. Madje kam folur publikisht kundër tij. Nuk mund të duroj dot më!" Ai vazhdoi ta shkarkonte veten nga të gjitha gjërat që i rëndonin. Ai pranoi se martesa e tij kishte shkuar keq. Ai tha, "Doja t'u tregoja të gjithëve se mund të kesh martesë të lumtur edhe pa Perëndinë." Dhe pastaj çdo gjë shkoi keq. Fëmija i tyre
i parë vdiq dhe duke qëndruar pranë trupit të tij të vdekur ai dhe e shoqja patën një grindje të ashpër. Më në fund atij iu desh të pranojë, "Perëndia është kundër nesh. Po dorëzohem." Shërbesa e funeralit, që e bëra unë, ishte pikëlluese. Në mes të dhomës ishte arkivoli i fëmijës. Në njërën anë, djaloshi dhe familja e tij. Në tjetrën, një grua e re e bukur, duke kafshuar buzët, e rrethuar nga familja e saj. Dy botë, dy anë. Dhe i ndante ata, fëmija i vdekur!

U desh më shumë se një vit për gruan që të arrinte të besonte në Zotin Jezus. Nuk do ta harroj kurrë shënimin e shkurtër që më dërgoi mëngjesin e Pashkës: "Ai është ngritur edhe në zemrën time!"

Pas kësaj ata u martuan - ata kishin jetuar së bashku - dhe ia filluan nga e para. Megjithëse që të dy ishin nga natyra shumë të pavarur, dhe krenarë për inteligjencën e tyre, arritën të përjetojnë harmoni të vërtetë si çift. Burri ma shpjegoi një ditë se si kishte ndodhur kjo. "Më parë," tha ai, "çdo gjë shkonte keq në shtëpinë tonë...". "Dhe si ndodh që çdo gjë shkon mirë tani?" e ndërpreva. Ai u përgjigj, me fytyrën që i shkëlqente, "Sepse tani Jezusi është kreu i shtëpisë sonë. Unë dhe ime shoqe nuk zihemi më për të provuar se kush është i parë. Por së bashku ne pyesim, 'Çfarë pret Jezusi prej nesh?' Dhe kjo jep rezultat!"

Ndërsa ai fliste, papritur më erdhi një mendim: Në qoftë se është kaq bukur, kaq e mrekullueshme, kur Jezusi sundon mbi një shtëpi, si do të jetë kur ai të jetë Mbreti i botës?

Bota do të kalojë nëpër një periudhë të dytë sprovimi pas mbretërimit të Jezusit. Do të testohen zemrat për të provuar nëse ato kanë ndryshuar vërtet apo jo. Satanit, në kuptimin e drejtpërdrejtë, do t'i hiqen prangat, dhe do të shihet se zemra e njeriut nuk ka ndryshuar aspak dhe se njerëzimi është akoma ai që ka qenë gjithmonë.

Bibla na jep për të kuptuar se do të ketë një revoltë të fundit kundër Perëndisë, dhe se pas kësaj do të vijë fundi i botës. Të gjitha sistemet diellore do të çintegrohen. Qiejtë dhe toka do të zhduken. Pastaj, siç shkroi Gjon apostulli, duke kujtuar vizionin e tij për "gjërat e fundit": ***Pashë një fron të madh të bardhë dhe atë që ulej mbi të.... Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u***

gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre.... Dhe, nëse ndokush nuk u gjet i shkruar në Librin e Jetës, u flak në liqenin e zjarrit.

Dikush më pyeti dikur, "Ku do të jetë froni në qoftë se çdo gjë zhduket?" Iu përgjigja, "Mos u shqetëso për këtë. Më tepër duhet të merakosesh për mënyrën se si do të paraqitesh para atij froni të madh të bardhë!" Ne mund të dënohemi! Do të preferoja që kjo e vërtetë e tmerrshme të mos gjendej në Bibël. Por Fjala e Perëndisë na vë përballë me këtë eventualitet tmerrues: të të qenit përjetësisht të dënuar.

Do t'ju tregoj një histori të shkurtër. U dha një darkë në një kështjellë në Skoci, dhe biseda iu kthye temës së krishterimit. Mysafirët ishin ulur të gjithë rreth vatrës në të cilën digjej një zjarr i madh. Një zotëri elegant i moshuar u kthye nga zonja e shtëpisë dhe tha, "Nga vërejtjet e tua, zonjë, unë arrij në përfundimin se ju jeni e krishterë. A e besoni seriozisht çdo gjë që shkruhet në Bibël?" "Po." "Dhe që secili prej nesh do të gjykohet?" "Po." "Dhe që personi emri i të cilit nuk gjendet i shkruar në Librin e Jetës do të shkojë në ferr?" "Po, e besoj këtë." Burri u ngrit, kaloi nëpër dhomë dhe mori një zog 'buxhi' nga një kafaz që varej në një qoshe. Pastaj ai erdhi te vatra dhe bëri gjoja sikur do ta hidhte zogun në zjarr. E tronditur, zonja u hodh për ta ndaluar. "Ç'bën kështu?" klithi ajo. "I shkreti zogth!" Burri filloi të qeshte. "E shikoni zonjë, juve ju vjen keq për këtë zog të shkretë, e megjithatë ai që ju e quani një Perëndi dashurie do të hedhë miliona qenie njerëzore në ferr. Ç'Perëndi i çuditshëm dashurie!"

Pati një moment heshtjeje, pastaj zonja e mori fjalën përsëri, "Kam frikë se e ke gabim. Perëndia nuk hedh asnjë në ferr. Ne hidhemi vetë në të. Perëndia dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen."

Bibla jep një pamje të frikshme të Gjykimit të Fundit. Na jepet një përshkrim i gjyqit të Perëndisë. ***Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre.*** Njerëzit e kundërshtojnë me forcë mesazhin e gjykimit. "Nuk është e vërtetë!" thonë ata.

Njëri nga miqtë e mi të rinj u pyet në punë, "A beson vërtet në Gjykimin e Fundit?" "Po." "Lëri këto," i thanë shokët e punës. "Sa njerëz jetojnë tani? Dhe sa kanë vdekur tashmë? Mirë, vetëm përpiqu t'i imagjinosh të gjithë duke u gjykuar në mënyrë individuale. Mund ta llogaritësh kohën që do të duhej?" I riu ua ktheu, "Kur të vijë ai çast, do të kemi kohë me shumicë. Se mos do të kemi gjë tjetër për të bërë!"

Po, Perëndia do të ketë shumë kohë për ne. Duke na gjykuar në mënyrë individuale, ai na tregon për herë të fundit se sa seriozisht e merr ai secilin prej nesh. Perëndia tashmë na e bëri këtë të qartë kur Biri i tij vdiq në vendin tonë. Ju mund të mos e merrni jetën tuaj seriozisht, ju mund të zgjidhni ta harxhoni atë në mëkat dhe pa menduar për të - por sidoqoftë Perëndia do t'ju marrë seriozisht në Ditën e Gjykimit.

Bibla e mbyll parashikimin e saj për të ardhmen me këtë thënie: ***Ne presim qiej të rinj dhe tokë të re, në të cilët banon drejtësia***. Dhe ajo e përshkruan këtë botë të re me fjalë që e tejkalojnë arsyetimin tonë. Përshkrimi thekson një realitet madhështor dhe unik: Perëndia e ka përmbushur qëllimin e tij. Ata, emrat e të cilëve janë shkruar në Librin e Jetës do ta banojnë këtë botë të re. Ata do të jenë të ngjashëm me të, të ngjashëm me Birin e Perëndisë. Në këtë botë nuk do të ketë as polici, as burgje, as gjykata, as frymëra të këqija, as luftëra, as dhimbje, as mëkat, as vdekje.

Lexoni për veten tuaj kapitujt e mrekullueshëm të 21 dhe 22 të Zbulesës.

Këto imazhe të jashtëzakonshme janë shumë larg arsyetimit tonë, me këtë jetë që jetojmë në një botë mëkati, vdekjeje dhe vuajtjeje. Përsa më përket mua, kur mendoj për atë që më ka rezervuar Perëndia, mezi pres të jem në atë botë të re.

4. Ose... ose...

Do të dëshiroja të nxirrja disa konkluzione. Sa më shumë studioj përshkrimin e "ditëve të fundit" në Bibël, aq më shumë më bën përshtypje fakti që në fund do të ketë vetëm dy kategori njerëzish: të shpëtuarit dhe të humburit.

Ju mund të thoni, "Po të shohësh nëpër botë, zor se mund të gjesh ndonjë që të shqetësohet për Jezusin." Kësaj unë mund t'i përgjigjem vetëm, "Atëherë do të ketë shumë njerëz që do të humbasin!"

Le të shtoj vetëm nja dy fjalë. Një fjalë për të humburit para së gjithash. Miku im Pal Hamburg tha një ditë, "Pashë një ëndërr. Ishte Dita e Gjykimit. Dëgjova Jezusin t'u thoshte të dënuarve, ***Largohuni nga unë, të mallkuar***. (Kjo është shkruar në Bibël.) I pashë ata të largoheshin me shpinat e tyre të përkulura, të frikësuar, të dëshpëruar. Pastaj dëgjova një person që t'i thoshte një tjetri, 'E vure re?' 'Po,' u përgjigj tjetri. 'E vura re. Dora që na largoi tutje kishte një vrimë. Ajo u shpua për ne në kryq. Por gjatë jetës sonë, ne kurrë nuk i kushtuam vëmendje asaj. Është vetëm e drejtë që tani jemi të humbur.'"

Më dëgjoni me kujdes. Zoti Jezus vdiq për ju. Besoni a s'besoni në ndonjë gjë pak rëndësi ka. Jezusi vdiq për ju. Ejani te Shpëtimtari! Ju mund të thoni, "Por... unë jam

mëkatar." Jezusi erdhi për të kërkuar mëkatarët - dhe ne jemi të gjithë mëkatarë. Në qoftë se dikush thotë se është i mirë, ai nuk është gjë tjetër veçse një gënjeshtar! Njeriu më larg prej Perëndisë është ai që mendon se nuk ka nevojë për një Shpëtimtar. Ai është kaq i humbur sa që as nuk mund ta kuptojë këtë gjë.

Dhe tani një fjalë të shpëtuarve. Në përshkrimin e Biblës për botën që do të vijë, thuhet se Jeruzalemi i ri është ndërtuar mbi dymbëdhjetë gurë të çmuar shumë të mëdhenj. Të skalitur mbi këta gurë të çmuar janë emrat e dymbëdhjetë apostujve, dëshmitarë të Ungjillit. Jam përpjekur t'i imagjinoj ata. Mbi një gur është emri i Pjetrit, mbi një tjetër emri i Gjonit, mbi një tjetër emri i Jakobit. Mbi një gur të katërt është emri i Mateut. A e dini se çfarë ishte Mateu? Ai ishte një dallaveraxhi, një specialist i tregut të zi, një batakçi. Një ditë kur ai ishte i zënë me tregtinë e tij të dyshimtë, Jezusi kaloi aty afër dhe i tha Mateut ta ndiqte. Dhe Levi - ky ishte emri i tij në atë kohë - la gjithçka aty për aty dhe ndoqi Jezusin. Më vonë ai që dëshmitar në vdekjen e Jezusit. Ai e pa atë të ngritur nga të vdekurit dhe e vështroi të kthehej në dimensionin e Perëndisë. Së fundi ai që dëshmitar i derdhjes së Frymës së Shenjtë.

Miqtë e tij i thanë disa kohë më pas, "Mate, ti pe aq shumë gjëra kur ishe me Jezusin. Duhet t'i shkruash ato." Dhe ai bëri pikërisht këtë gjë. Ja se si doli në dritë Ungjilli sipas Mateut. Ungjilli gjendet në Bibël dhe ka qenë mjeti për të ndihmuar miliona njerëz për të gjetur Jezusin.

Emri i tij i ri, Mate - emri i maskarait që shpëtoi Jezusi - do të jetë i shquar në botën e re.

E tillë është fuqia e hirit të Jezu Krishtit. Ai përdor madje edhe njerëzit më të pabesueshëm për të ndërtuar mbretërinë e tij. Po i njëjti hir kërkon të fillojë një punë në ju. Mos i rezistoni. Shpëtimi juaj është në rrezik - për këtë jetë dhe për përjetësinë!

Ç'FARE ËSHTË KUPTIMI I JETËS ME PERËNDINË?

Në fakt, mund ta thosha atë në mënyrë tjetër: A ia vlen të jesh i krishterë?

Sa për hyrje, do të doja t'i referohesha një fjalie që gjendet në fillim të Letrës së Efesianëve: ***I bekuar qoftë Perëndia, Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, që na bekoi me çdo bekim frymëror në vendet qiellore në Krishtin***. Ky varg i Biblës na kujton në mënyrë të admirueshme bekimet e shumta që ka në dispozicion i krishteri nëpërmjet Jezu Krishtit.

Por para se të hyjmë në thelb të temës sonë, dua të trajtoj dy pika paraprake.

1. Jeta me Perëndinë nuk është aspak iluzion

Dua ta them këtë në mënyrë kategorike: jeta e krishterë nuk është prodhim i imagjinatës, dhe as nuk është fryt i një iluzioni. Le t'jua provoj këtë.

Pastorët që punojnë në qytete të mëdha kanë të gjitha llojet e kontakteve interesante, siç tregon biseda e mëposhtme që bëra me një të ri jo shumë kohë më parë. "Miku im," i thashë prerazi, "ti mund të bëje diçka të madhe me jetën tënde po t'ia dorëzoje atë Perëndisë." "Pastor Bush," erdhi përgjigjja, "më mirë zbrit në tokë! Perëndia as që ekziston!" "Ky qenka lajm i freskët," thirra unë. "Më dëgjo me kujdes," vazhdoi ai. "Për shkak se njerëzit në të kaluarën ndiheshin të dobët dhe pa ndihmë kur ndesheshin me forcat e natyrës, ata arritën në përfundimin se ekzistonin fuqi më të mëdha të cilat mund t'i ndihmonin. Ata u dhanë këtyre forcave emra të ndryshëm si, Allah, Perëndi, Jehova, Buda, e kush e di se çfarë. Është provuar që kur se e gjithë kjo nuk është asgjë por vetëm produkt i imagjinatës dhe se qielli në

realitet është bosh." Këto ishin ato lloje vërejtjesh që bëri i riu. Kur ai mbaroi unë u përgjigja, "Problemi është, miku im, se ti nuk njeh Jezusin." "Jezusin?" tha ai. "Ai është vetëm një nga themeluesit e shumtë të një feje!" "Ja, këtu e ke gabim. Le të të tregoj se pikërisht kush është Jezusi. Është për shkak se unë e njoh Jezusin që e di se Perëndia ekziston. Pa Jezusin, ne do të ishim plotësisht në errësirë në lidhje me Perëndinë."

Kush është Jezusi atëherë dhe si na e zbulon ai Perëndinë?

Për t'ju ndihmuar ta kuptoni, do të përdor një ilustrim. Gjatë jetës sime kam kaluar nëpër shumë sprova të vështira. Në më shumë se një rast, jam futur në burg; jo për ndonjë krim që kam kryer, por thjesht për shkak të bindjeve të mia fetare. Nën sundimin e Hitlerit, pastorët si unë që punonin ndër të rinjtë nuk pëlqeheshin nga autoritetet. Kështu unë u futa në disa burgje shumë të këqija. Më i keqi ishte një ndërtesë e stërmadhe prej betoni. Muret ndarëse të tij ishin aq të holla sa që mund të dëgjoje të tjerët që kolliteshin në qelitë më poshtë, dhe kur një i burgosur binte nga shtrati në dyshemenë sipër, gati sa s'pëlcisje në lëkurë nga frika! Unë isha mbyllur në një hapësirë shumë të ngushtë.

Një ditë sollën një të burgosur të ri në qelinë ngjitur. Edhe ai ishte një i burgosur i Gestapos. Ai duhet të ketë qenë në dëshpërim të thellë, sepse natën unë mund të dëgjoja ngashërimet e tij të mbytura që vinin nëpër murin e hollë që na ndante, ndërsa ai kthehej e vërtitej vazhdimisht mbi shtratin e tij të fortë. Është e tmerrshme të dëgjosh një burrë që qan. Ne na ishte ndaluar të shtriheshim gjatë ditës, kështu mund ta dëgjoja fqiun ngjitur ndërsa ecte lart e poshtë nëpër qeli: dy hapa e gjysmë një drejtim, dy hapa e gjysmë në drejtimin tjetër. Ai ishte si një kafshë në kafaz. Ndonjëherë rënkonte thellë. Dhe ja ku isha unë, vetëm dy hapa larg, duke gëzuar praninë e Zotit, me zemrën në paqe! Mendova, "Ti duhet të shkosh ta shohësh atë, dhe t'i flasësh. Fundi i fundit,

ti je pastor!" Kështu i rashë ziles për të thirrur rojën. Kur ai erdhi, i thashë, "Burri në derën ngjitur është i dëshpëruar. Ai do të çmendet. Të lutem, më lër ta vizitoj dhe t'i flas. Unë jam pastor." "Mirë," u përgjigj roja. "Do të shkoj të kërkoj leje." Një orë më vonë, ai u kthye me përgjigjen: "Refuzohet. Një gjë e tillë nuk lejohet." Kurrë nuk e pashë njeriun në qelinë fqinje, edhe pse distanca midis nesh ishte jo më shumë se gjerësia e një dore.

Kurrë nuk e zbulova se ç'pamje kishte ai, dhe as se ç'moshë kishte. Por unë ndjeva thellësinë e dëshpërimit të tij. Ndonjëherë, duke qëndruar para murit të hollë ndarës që ma fshihte atë nga shikimi, mendoja, "Ah sikur ta thyej këtë mur copa-copa dhe të shkoj tek ai njeri!" Por edhe duke e goditur atë me të gjithë forcën, nuk do të kisha qenë në gjendje t'i bëja as edhe të çarën më të vogël.

Tani Perëndia, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, gjendet në një situatë të ngjashme me timen në atë burg. Ne njerëzit jemi burgosur në këtë botë të dukshme tridimensionale. Perëndia është shumë afër. Bibla thotë: ***Ti më rrethon nga pas dhe përpara***. Që do të thotë se distanca që e ndan Perëndinë nga ne nuk është më shumë se gjerësia e një dore. Sidoqoftë, midis nesh dhe atij ndodhet një mur, që ndan dy dimensione të ndryshme. Veshët e tij mund të dëgjojnë shumë qartë thirrjet e pikëllimit njerëzor. Ai dëgjon blasfemitë e atyre që janë zemëruar, ngashërimet e njerëzve të vetmuar, vajtimet e familjeve në zi, psherëtimat e viktimave të padrejtësisë. Gjithë ky hidhërim kalon nëpër zemrën e Perëndisë, ashtu si dëshpërimi i shokut tim të burgut në qelinë ngjitur që kaloi tek unë.

Por vetëm mendoni për këtë: Perëndia bëri atë që unë nuk isha në gjendje ta bëja! Ai e prishi murin që qëndronte midis nesh dhe atij dhe hyri në botën tonë në personin e Birit të tij.

Vetë Perëndia erdhi në tokë në Jezu Krishtin - tamam në pisllëkun dhe vuajtjen e kësaj bote të vjetër.

Që kur kam arritur ta njoh Jezusin, kam qenë i sigurt për ekzistencën e Perëndisë. Shpesh them se që nga ardhja e Jezusit, ateizmi është vetëm një formë e injorancës.

Le t'ju flas tani për Jezusin.

Po të më lihej mua në dorë, nuk do të flisja për gjë tjetër veçse për jetën e Jezusit në të gjitha takimet e mia. Edhe ashtu, koha do të ishte tepër e shkurtër për një temë kaq të gjerë dhe kaq të lavdishme.

Jezusi u lind në Betlehem. Ai u rrit dhe u bë burrë. Asgjë nga lavdia e tij hyjnore nuk mund të shihej në pamjen e tij të jashtme. E megjithatë njerëzit u tërhoqën pas tij. Instinktivisht ata e ndienin se dashuria dhe hiri i Perëndisë kishin ardhur afër tyre.

Në atë periudhë të veçantë, toka e Kanaanit, ku Jezusi jetonte në mes të popullit të tij, ishte e pushtuar nga trupat e huaja, trupat romake. Në qytetin e Kapernaumit, garnizoni romak ishte nën komandën e një centurioni. Ia vlen të vërejmë se megjithëse romakët besonin në një mori perëndish, ata nuk kishin asnjë Perëndi të veçantë të tyren. Tani, në Kapernaum, ndodhi që një nga shërbëtorët e centurionit, të cilin ai e kishte shumë për zemër, u sëmur. Zotëria i tij thirri disa mjekë për t'i bërë një kontroll mjekësor, por ata nuk mundën të bënin asgjë për të. Ai ishte në prag të vdekjes kur centurioni papritur u kujtua se kishte dëgjuar për një farë Jezusi. "Ndoshta ai mund të më bëjë punë," mendoi ai. "Do të përpiqem ta gjej." Kështu ky jobesimtar, ky njeri i rritur në paganizëm, shkoi dhe gjeti Jezusin dhe i tha, "Zoti Jezus, shërbëtori im është i sëmurë rëndë. Do ta shërosh atë?" "Sigurisht, do të vij me ty," u përgjigj Jezusi. "Por nuk ka nevojë që ti të ndërrosh rrugën tënde!" kundërshtoi centurioni. "Kur unë jap një urdhër,"

vazhdoi, "ai zbatohet menjëherë. Edhe ti, thuaj vetëm një fjalë dhe shërbëtori im do të shërohet!" Me fjalë të tjera, ky centurion pagan sapo kishte deklaruar, "Për ty është e mundur të bësh të pamundurën. Ti je Perëndia vetë." Atëherë Jezusi u kthye dhe iu drejtua turmës që i vinte nga pas, ***As në Izrael nuk kam gjetur një besim kaq të madh***. Kjo është sikur Jezusi të ketë thënë në gjuhën tonë të shekullit të njëzetë, "Kurrë nuk kam gjetur besim si të këtij ateisti, as edhe në kishë." Centurioni e kishte kuptuar se vetë Perëndia kishte ardhur te ne në Jezusin.

Është thelbësore që ju ta njihni jetën e Jezusit. Shkoni dhe blini një Dhiatë të Re për veten tuaj - ju lutem shumë! Lexoni Ungjillin sipas Gjonit, pastaj ungjijtë e tjerë. Ata janë tregime të mrekullueshme për jetën e Jezusit. Asnjë revistë në botë nuk përmban histori aq të bukura sa ato që gjenden në Dhiatën e Re.

Por Jezusi, Biri i Perëndisë, nuk erdhi në botë për qëllimin e vetëm të shërimit të shërbëtorit të centurionit dhe për të provuar me anë të këtij shërimi se Perëndia ekziston. Plani i tij shkoi shumë më tej: me ardhjen për të jetuar me njeriun, Jezusi erdhi për të na ofruar paqe me Perëndinë.

Ne jemi të ndarë nga Perëndia për faktin se jemi në një dimension të ndryshëm. Por kjo nuk është gjithçka. Muri i mëkatit tonë gjithashtu na ndan nga Perëndia. Keni thënë ndonjëherë ndonjë gënjeshtër? Po? Epo, kur gënjyet, vendosët një gur midis jush dhe Perëndisë. Keni jetuar ndonjëherë një ditë të tërë pa Perëndinë, pa u lutur? Po? Kjo vë dhe një gur tjetër. Mendimet e këqija, kurorëshkelja, vjedhja dhe gënjeshtra, për të mos përmendur numrin e madh të gjërave të vogla që janë po kaq, shkelje të ligjit hyjnor - dhe me çdo shkelje, shtohet një gur tjetër. Ne të gjithë, secili prej nesh, kemi kontribuar në ndërtimin e këtij muri që e

ndan njeriun nga Perëndia. Perëndia është një Perëndi i shenjtë. Dhe kështu, thjesht shqiptimi i emrit të Perëndisë do të ngrejë në mënyrë të paevitueshme problemin e mëkatit dhe të fajit tonë. Është një problem që duhet të trajtohet.

Perëndia e merr shumë seriozisht mëkatin tonë. Njoh njerëz që fshehtazi mendojnë, "Perëndia duhet të jetë vërtet i kënaqur që unë besoj ende tek ai." Zot i madh! Kjo nuk mjafton! Qoftë larg! Dhe Djalli vetë "beson në Perëndinë". Ai sigurisht nuk është ateist! Djalli është plotësisht i dijshëm për ekzistencën e Perëndisë. Megjithatë, me gjithë këtë ai nuk është në paqe me Perëndinë.

Ne mund të jemi në paqe me Perëndinë vetëm kur muri i mëkatit që na ndan prej tij të jetë shkatërruar. Prandaj erdhi Jezusi - për të prishur murin e fajit tonë. Për të përmbushur këtë, atij iu desh ta linte veten të gozhdohej në kryq. Ai e dinte se dikush duhej të duronte dënimin për mëkatin - ose njerëzimi ose ai vetë. Për ta bërë atë më personale unë do të thosha, "ose Vilhelm Bushi ose Jezusi". Dhe ja se si Jezusi, i pafajshmi, zuri vendin e fajtorit dhe mori ndëshkimin për mëkatin tim - dhe tuajin.

Edhe një herë do të dëshiroja ta përshkruaja Zotin Jezus në kryq. Për mua është skena më e çmueshme në botë. Shikojeni atë të varur në atë dru të mallkuar, atë për të cilin Bibla flet me këta terma: ***Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve***. Ai mbajti, si të thuash, mbi supet e tij, të gjithë gurët që përbënin murin e mëkatit tonë. Kështu ai bëri atë që asnjë person tjetër nuk mund ta bënte: ai i hoqi ato të gjitha. Lexoni vetë në Bibël, veçanërisht në kapitullin e pesëdhjetë e tretë të librit të Isaias. Atje në kryq, u plotësua profecia e Isaias për një Shpëtimtar që vuan: ***Ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar***.

Kam një mik të dashur në Zvicër. Kemi bërë disa

ekskursione të këndshme së bashku. Sigurisht çdo herë që hanim në restorant duhej të paguhej llogaria. Problemi ishte se kush do ta paguante. Kuleta e kujt ishte më e trashë? Përgjigjja ishte e qartë. Kështu unë i thosha mikut tim, "Mirë, këtë radhë do të të lë të paguash ti!" Por dikush duhej ta paguante llogarinë.

Është pikërisht njëlloj me borxhin që i kemi Perëndisë si rezultat i mëkateve dhe shkeljeve tona. Dikush duhej ta paguante atë. Ose besoni se Jezusi e pagoi borxhin për ju, ose do të jeni të detyruar ta paguani atë vetë një ditë. Prandaj, Jezusi ka një rëndësi kaq të madhe për mua. Unë kapem pas atij sepse ky është ai që pagoi borxhin tim.

Por Jezusi nuk mbeti në varr. Vdekja nuk kishte asnjë fuqi mbi të. A nuk është e mrekullueshme kjo?

Tri ditë pas kryqëzimit të Jezusit, mund të shikoje një burrë të humbur në mendime. Ai po pyeste veten: "Ç'duhet të mendojmë për Jezusin tani? Ai vdiq e vate! E pashë vetë se si ia futën trupin në varr dhe rrokullisën një gur të madh para hyrjes. Ishte apo nuk ishte ai Biri i Perëndisë?" Emri i këtij burri ishte Thoma. Ndërsa po bluante në mendje dyshimet, pa miqtë e tij që po vraponin drejt tij, duke shkumëzuar nga gëzimi. "Ai është gjallë," ulëritën ata. "Mjaft u duke kaq i trishtuar. Ai është gjallë!" "Kush është gjallë?" "Ehu, Jezusi... sigurisht." "Kjo nuk është e mundur," qe për-gjigjja e Thomait. "*Po ja që është!*"
E pamë varrin bosh me këta sy. Mund të betohemi për të. Dhe pastaj... takuam Jezusin!" "Ku është dëgjuar një gjë e tillë?" mendoi Thomai. "Dikush që të ngrihet nga të vdekurit? Po të ishte e vërtetë kjo, atëherë Jezusi do të ishte me të vërtetë Biri i Perëndisë. Do të ishte verdikti i Perëndisë në favor të Jezusit."

Por Thomai mbeti skeptik. Ai vazhdoi të mendojë, "Ma

kanë hedhur aq shumë gjatë jetës sime sa që tani besoj vetëm atë që shoh me sy." Duke u kthyer nga të tjerët Thomai deklaroi, ***Po nuk e pashë në duart e tij shenjën e gozhdave, dhe po nuk e vura gishtin tim te shenja e gozhdëve dhe dorën time në brinjën e tij, unë nuk do të besoj***. Dishepujt u përpoqën ta bindnin sa u vajti goja te veshi, por Thomai vazhdonte të përsëriste, "Nuk e besoj."

Pas tetë ditësh, Thomai ishte me miqtë e tij kur papritur u shfaq Jezusi dhe tha, ***Paqja me ju!*** Pastaj duke u kthyer nga Thomai i tha, ***Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; shtrije edhe dorën dhe vëre në brinjën time; dhe mos ji mosbesues, por besues!*** Dyshuesi i shkretë ra rëndshëm në gjunjë dhe thirri, ***Zoti im dhe Perëndia im!***

Ndoshta tani ju e keni kuptuar pse unë deklaroj se ecja me Perëndinë nuk është as iluzion dhe as produkt i imagjinatës. Perëndia nuk është një kon-cept i paqartë, siç e imagjinojnë ndonjëherë njerë-zit. "Duhet të ketë një Perëndi diku, por askush nuk e di me siguri se si është ai," thonë ata. Jo, kjo nuk është e drejtë. Mundësia e ecjes me Perëndinë është rezultat direkt i ardhjes së Birit të Perëndisë në këtë botë, dhe i vdekjes dhe i ringjalljes së tij për ne. Prandaj ne mund të kemi një njohuri të qartë dhe të besueshme për Perëndinë.

Tani po vij te pyetja e dytë:

2. Çfarë duhet të bëj unë që të eci me Perëndinë?

Sa herë kam dëgjuar këtë vërejtje: "Pastor Bush, ti ke diçka që ne nuk e kemi!" Unë jam përgjigjur, "Mos fol gjepura të tilla. Edhe ti mund ta kesh. Jezusi është edhe për ty." Atëherë njerëzit zakonisht bëjnë këtë pyetje: "Ç'duhet të bëj që të eci me Perëndinë?" Bibla jep një përgjigje shumë të qartë, me një fjali: ***Beso në Zotin Jezu Krisht***.

Por para se të përpiqem t'ju bind që të besoni, para së gjithash duhet t'ju shpjegoj kuptimin e fjalës "besoj"; sepse shumë njerëz kanë një mendim krejt të gabuar në lidhje me atë se çfarë është besimi. Në qoftë se keni një orë dore, mund ta shikoni atë dhe të thoni, "E di që ora është saktësisht shtatë e njëzetë." Por në qoftë se nuk keni orë, duhet të jeni të kënaqur me thënien, "Besoj se ora është shtatë e njëzetë." Është shumë i përhapur mendimi se besimi është një lloj njohurie e paqartë dhe e pasigurt. Sidoqoftë, në këtë varg të Biblës - ***Beso në Zotin Jezu Krisht*** - fjala "besoj" ka një kuptim krejt tjetër. Ç'do të thotë kjo? Po përpiqem ta bëj të qartë me anë të anekdotës së mëposhtme.

Sapo kisha mbaruar disa ditë seminaresh në Oslo, kryeqytet i Norvegjisë. Kisha planifikuar që të shkoja në shtëpi të shtunën në mëngjes, sepse një ditë më pas kisha për të folur në një miting të madh në Vupertal. Nga çasti që shkela në aeroportin e Oslos, gjërat filluan të shkonin keq. Së pari njoftuan se avioni im do të vonohej një orë për shkak të mjegullës. Më në fund aeroplani u nis për në Kopenhagen ku duhej të bënim një koordinim. Ishim duke fluturuar mbi kryeqytetin danez kur kapiteni papritur ndryshoi kursin dhe u drejtua për në Suedi. Ai na shpjegoi me anë të altoparlantëve se do të ishte e pamundur që të zbrisnim në Kopenhagen për shkak të mjegullës së dendur që mbulonte rajonin. Për këtë arsye ne ishim në rrugën për Malmö. Vendi i fundit që doja të shkoja ishte Malmö në Suedi. M'u desh të shkoja në Dyseldorf dhe prej atje në Vupertal ku isha planifikuar të flisja ditën tjetër!

Me kalimin e kohës u ulëm në aeroportin e Malmös, ku pamë që ziente nga njerëzit. Meqë ishte i vetmi aeroport në rajon që nuk ishte zënë nga mjegulla, kishte një vërshim të vazhdueshëm të aeroplanëve që vinin. Lehtësirat

aeroportuale në Malmö ishin modeste, dhe nuk kishte asnjë ndenjëse të lirë në të gjithë atë vend. Unë isha njohur me një biznesmen austriak. Po pyesnim veten se ç'do të ndodhte. "Me sa dimë, nesër në mëngjes mund të jemi akoma këtu duke qëndruar më këmbë. Do të përfundojmë që të mos rrimë dot në këmbë!" Të gjithë ankoheshin, turfullonin dhe rënkonin si gjithmonë në rrethana të tilla. Papritur nga altoparlanti erdhi një zë që njoftonte, "Pas pak minutash, do të ngrihet një avion me drejtim për në jug. Nuk e dimë nëse avioni do të ulet në Hamburg, Dyseldorf apo Frankfurt. Udhëtarët për në Gjermani mund të vazhdojnë për te dera e avionit." Ne nuk dinim ç'të bënim. Një grua afër nesh thirri, "Nuk do të më bëni kurrë që të hipi në atë avion. Është me shumë rrezik." "Zonjë," u përgjigja unë, "askush nuk po të detyron të hipësh në atë avion. Mund të rrish fare mirë këtu." Pastaj, miku im austriak dha mendimin e tij, "Një fluturim në mjegull të dendur nuk është zgjidhje ideale, veçanërisht në qoftë se ata nuk e dinë se ku do të ulen." Pikërisht atëherë pashë pilotin e fluturimit të saponjoftuar që po kalonte aty afër. Më bëri përshtypje shprehja serioze, dhe e vendosur në fytyrën e tij. Ishte e qartë që ai nuk po e merrte situatën lehtë por po vepronte me përgjegjësi. Përshtypjen time e ndava me mikun tim austriak, duke i thënë, "Ai pilot e ka mendjen top. Mund të kemi besim tek ai." Pastaj shtova, "Eja të hipim." Kështu hipëm në aeroplan. Që nga çasti që dera e kabinës u mbyll ne e dinim se jeta jonë ishte në duart e atij njeriu. Por ne kishim mirëbesim tek ai. Unë e kisha vënë jetën time në duart e tij.

Ky është kuptimi i fjalës "besoj": ajo do të thotë "të kesh mirëbesim te dikush".

Ç'duhet të bëj unë që të eci me Perëndinë? Beso në Zotin Jezus. Me fjalë të tjera: hip në aeroplan me Jezusin! Në atë rast, ndërsa po hipnim në aeroplan, pata përshtypjen se miku

im austriak do të kishte dashur ta kishte një këmbë në tokë dhe tjetrën në aeroplan. Por kjo ishte e pamundur! Çështja ishte ose të mos hipje ose ta vije gjithë jetën në duart e pilotit.

Është tamam e njëjta gjë kur bëhet fjalë për Jezusin. Nuk mundeni që me një këmbë të jetoni pa të dhe me tjetrën "të hipni në aeroplan" me të. Kjo thjesht nuk do të japë rezultat! Të besosh në Zotin Jezu Krisht, të ecësh me Perëndinë, kërkon një dorëzim të plotë të jetës suaj:

Merre jetën time dhe le të jetë
E gjitha vetëm për Ty, përjetë.

Nga ana tjetër, kush më mirë se Biri i Perëndisë mund të gjendet për t'i besuar? Asnjë njeri në botë nuk ka bërë ndonjëherë kaq shumë për mua se sa Jezusi. Ai më deshi aq shumë sa dha jetën për mua. Edhe për ju. Askush nuk na ka dashur ndonjëherë si Jezusi. Ai vdiq për ne por u ngrit përsëri nga të vdekurit. Kështu pse të mos ia besojmë jetën tonë atij që triumfoi mbi vdekjen? Do të ishte budallallëk që të mos e bënim këtë.

Që nga çasti që i dorëzohemi Jezusit, ne fillojmë të ecim me Perëndinë.

Po ju? Doni t'ia besoni jetën Jezusit, doni të "hipni në aeroplan" me të, ta vini jetën tuaj në duart e tij? Po ta bëni i thoni atij për këtë, ju lutem shumë. Ai është pikërisht aty pranë jush. Ai ju dëgjon. I thoni atij: "Zoti Jezus, tani ta jap ty jetën time. Merre."

Ditën që i dhashë fund jetës sime të mosbesimit dhe mëkatit - ditën e konvertimit tim - u luta kështu: "Zoti Jezus tani ta jap ty jetën time. Nuk mund të bëj asnjë premtim për t'u përmirësuar. Ti duhet të më japësh një zemër të re për këtë! Kam një karakter me të vërtetë të keq; sidoqoftë, unë vij te ti kështu siç jam. Zot, bëj diçka të dobishme nga jeta

ime." Ndodhi në këtë çast që unë "hipa në aeroplan" me Jezusin - me të dyja këmbët - dhe ia besova atij drejtimin e jetës sime.

Në qoftë se duam të përparojmë në ecjen tonë me Perëndinë, ç'duhet të bëjmë? Shumë herë e kam përsëritur se tri gjëra janë absolutisht thelbësore: studimi i Fjalës së Perëndisë, lutja, dhe bashkësia me besimtarët e tjerë.

Askush nuk mund të ecë me Perëndinë në qoftë se nuk ka bashkësi me të. Prandaj ju duhet të merrni një Bibël ose një Dhiatë të Re, dhe të lini mënjanë pesëmbëdhjetë minuta çdo ditë për *leximin dhe studimin* e një pjese të saj. Për momentin, thjesht lini mënjanë atë që nuk e kuptoni. Ndërsa përparoni në lexim, teksti do të bëhet më i qartë dhe mrekullitë e Perëndisë do të zbulohen para syve tuaj. Sa shpesh mbytet zemra ime prej gëzimit nga mendimi se i përkas këtij Shpëtimtari të mrekullueshëm dhe që kam privilegjin t'ua shpall të tjerëve!

Kërkesa e parë për rritjen e krishterë është studimi i Fjalës së Perëndisë; e dyta është *lutja.* Jezusi ju dëgjon. S'keni pse të mbani një fjalim të madh. Nëse jeni grua shtëpiake, mjafton të thoni, "Zoti Jezus, sot çdo gjë po shkon keq. Im shoq është me humor të keq, fëmijët nuk më dëgjojnë, është dita që kam për të larë dhe nuk kam as aq para sa duhet për të paguar qiranë. Zoti Jezus, t'i sjell ty të gjitha këto shqetësime dhe i lë ato para këmbëve të tua. Më ndihmo të jem megjithatë e gëzuar duke jetuar afër teje. Më ndihmo t'ia dal mbanë. Faleminderit Zoti Jezus sepse unë mund të të besoj ty plotësisht."

A e shihni se ku po përpiqem të dal? Ne mund t'i themi Jezusit çdo gjë që kemi në mendje - absolutisht çdo gjë. Gjithashtu mund të bëni këtë kërkesë: "Zoti Jezus, më ndihmo të arrij të të njoh më mirë ty dhe të ta jap jetën time më plotësisht."

Kërkesa e tretë për rritjen e krishterë është *bashkësia me të krishterët e tjerë*, me burra dhe gra që, ashtu si ju, duan të ecin me Perëndinë. Dikush më tha kohët e fundit, "Unë dua të besoj por nuk po bëj ndonjë përparim." Iu përgjigja, "Ajo që të nevojitet është bashkësia me të krishterët." "Por," kundërshtoi ai, "unë nuk shkoj mirë me ata njerëz." "Në këtë rast," ia ktheva, "nuk ke se ç'të bësh. Por nëse shpreson të jetosh me ta në parajsë një ditë, mund të ishte gjë e mirë të filloje ta praktikosh që tani! Perëndia nuk mund t'i presë njerëzit vetëm për të t'u përshtatur ty!"

Kur isha adoleshent i ri, njoha drejtorin e një banke në Frankfurt. Ishte një burrë i moshuar dhe shumë shpesh më fliste për rininë e tij. Pasi kishte mbaruar gjimnazin, i ati i tha një ditë, "Bir, këtu ke kaq e kaq para. Po të lejoj të shkosh jashtë shtetit dhe t'i shëtisësh të gjitha kryeqytetet e Evropës." Ç'lumturi e papritur për një djalosh të ri tetëmbë-dhjetë vjeçar që sapo kishte mbaruar shkollën!

Ja historia që më tregoi bankieri plak: "Isha thellësisht i vetëdijshëm se sa e lehtë do të ishte për mua të bija në mëkat dhe turp në ato qytete të mëdha. Unë isha i vendosur të ndiqja Jezusin. Kështu futa Dhiatën e Re në valixhe, dhe çdo ditë, kudo që të isha, para se të largohesha nga dhoma e hotelit, kaloja një kohë të qetë. Lexoja Biblën dhe kaloja një çast në lutje. Pastaj kudo që isha, përpiqesha të zbuloja të krishterë të tjerë. Takova të krishterë në Lisbonë, Madrid, Londër.... Qyteti ku pata më shumë vështirësi për të gjetur të krishterë ishte Parisi. Pyeta andej-këndej nëse kishte ndonjë dishepull të Jezu Krishtit. Më në fund pas një kohe të gjatë dikush më tregoi një farë këpucari, duke më thënë, 'Edhe ai njeri e lexon Biblën.'" Shpejt i riu i shquar mund të shihej duke ecur poshtë shkallëve që të çonin në dyqanin e këpucarit. Me të hyrë në dyqan, e pyeti këpucarin, "E njeh Jezusin?" Duke u

përgjigjur sytë e burrit filluan të shkëlqejnë. Kështu i riu i bëri atij këtë sugjerim: "Në qoftë se je dakord, unë do të vij çdo mëngjes të lutem me ty." Të kishe bashkësi me të krishterët e tjerë ishte me rëndësi shumë të madhe për të.

Dhe tani vij në çështjen kryesore:

3. Cila është dobia e ecjes me Perëndinë?

Në qoftë se do të dëshiroja të përshkruaja të gjitha përfitimet që vijnë nga jeta në bashkësi me Jezusin, do të isha këtu deri në mbarim të botës dhe as atëherë kjo temë nuk do të ishte sosur.

Nuk do ta harroj kurrë atë që më tha im at pikërisht para se të vdiste në moshën pesëdhjetë e tre vjeçare. Këto ishin disa nga fjalët e tij: "Vilhelm, dua që t'u thuash të gjithë miqve dhe të njohurve të mi se sa të lumtur më bëri Jezusi gjatë gjithë jetës e madje dhe tani në orën e vdekjes sime." Kur një njeri është në prag të vdekjes, ai nuk përpiqet më të tregohet i patrembur, ai nuk e humb kohën me biseda të kota. Dhe në qoftë se, në agoninë e tij, ai ende thotë se ka njohur lumturi të vërtetë në Jezusin, kjo na prek deri në zemër; më besoni. Në një kohë të tillë, askush nuk mund të mos mendojë, "Po unë? Si do të reagoj unë kur të më vijë ora?"

Në fillimet e shërbesës sime, qeshë dëshmitar i një skene të jashtëzakonshme në një rajon të Luginës së Rurit. Ishte rreth vitit 1925. U organizua një takim i madh gjatë të cilit një njeri shumë i ditur mbajti një fjalim prej dy orësh për të provuar mosekzistencën e Perëndisë. Ai kishte bërë një shfaqje të madhe të të gjitha atyre që kishte mësuar. Salla ishte plot me njerëz dhe atmosfera e mbushur me tym duhani. Duartrokitjet shpërthyen në të gjitha drejtimet. "Urra! Nuk ka Perëndi. Mund të bëjmë ç'të duam." Kur folësi u ul, kryetari u ngrit në këmbë dhe tha, "Debati është i hapur. Ata që kanë

ndonjë fjalë për të thënë mund të ngjiten në podium." Askush, sigurisht nuk kishte kurajë të ngrihej. Të gjithë ndoshta mendonin, "Kush mund ta kundërshtojë këtë njeri kaq të shkolluar?" Pa dyshim kishte shumë njerëz që nuk ishin dakord me folësin, por askush nuk dukej se ishte aq i guximshëm sa të ngjitej në podium dhe të tregonte papajtueshmërinë e tij para një turme prej një mijë vetash. Pastaj një zë gruaje u ngrit nga fundi i sallës. Ishte zëri i një gjysheje plakë, një nga ato gratë e Prusisë Lindore me kapelë të zezë në kokë që shihen shpesh në Luginën e Rurit. Kryetari e pyeti, "Do të thuash diçka, gjyshe?" "Po, do të dëshiroja të thosha disa fjalë." "Në rregull," u përgjigj ai. "Eja këtu lart në podium të lutem." Ajo u përgjigj, "Mos u shqetëso! Po vij!"

Zonja plakë e bëri rrugën për në krye me një hap të vendosur. Ajo u ngjit në podium dhe qëndroi prapa katedrës së folësit. Dhe ja se ç'tha ajo: "Zotëri, ti na ke folur për dy orë për ateizmin tënd. Më lejoni, për pesë minuta, të them pak fjalë për besimin tim! Do të dëshiroja të ndaj me ju gjithçka që Zoti im, Ati im qiellor, ka bërë për mua. Pak vjet pas martesës sonë, im shoq u bë viktimë e një aksidenti në minierë. E sollën në shtëpi - të vdekur! Papritur u gjenda e vetmuar me tre fëmijë të vegjël. Në atë kohë zor se kishte ndonjë sigurim shoqëror. Mund të kisha rënë në dëshpërim kur pashë trupin e pajetë të tim shoqi. Por Perëndia ndërhyri. Ai më ngushëlloi si askush tjetër. Ato që më thoshin njerëzit më hynin nga një vesh dhe më dilnin nga tjetri. Por Perëndia i gjallë dinte si të më ngushëllonte. Unë i thashë atij, 'Zot, ti ke për t'u bërë ati i fëmijëve të mi që tani e tutje.' (Ishte prekëse të dëgjoje mënyrën se si e tregoi historinë e saj plaka.) Shumë shpesh, unë nuk do të kisha asnjë ide në mbrëmje se ku do të shkoja t'i gjeja paratë për të ushqyer fëmijët ditën

tjetër. Kështu flisja me Perëndinë tim për këtë. 'Zot, ti di gjithçka për mjerimin tim. Më ndihmo të lutem!'"

Duke u kthyer nga folësi, ajo tha, "Ai kurrë nuk më ka braktisur. Jo, kurrë! Rruga ndonjëherë ishte shumë e errët, por ai nuk më zhgënjeu kurrë ndonjëherë. Dhe Perëndia bëri shumë më tepër se kaq për mua. Ai dërgoi Birin e tij, Zotin Jezu Krisht, në botë. Ai vdiq për mua dhe u ngrit përsëri nga të vdekurit për mua; dhe me gjakun e tij ai m'i ka larë të gjitha mëkatet. Tani unë jam plakë dhe shpejt do të vdes. Por, e dini, Perëndia më ka dhënë sigurinë e jetës së përjetshme. Dhe e di pa asnjë fije dyshimi se kur t'i mbyll sytë këtu poshtë, do të zgjohem atje në parajsë. Dhe
e gjitha kjo sepse unë i takoj Jezu Krishtit. Ky është vetëm një tregim i shkurtër për atë që ka bërë Perëndia për mua. Tani do t'ju bëj një pyetje ju. Pa na thoni, Zotëri, çfarë ka bërë ateizmi juaj për ju?"

Folësi u ngrit, i ra lehtë në sup plakës dhe u përgjigj, "Larg qoftë që unë të mendoj të shkatërroj besimin e kësaj gjysheje trime. Feja ka dobinë e saj për të moshuarit."

Duhet ta kishit parë reagimin e plakës! Duke ua përshtatur veprimet fjalëve të saj, ajo thirri, "Jo, jo, një mijë herë jo! Le të kapemi pas fakteve. Të bëra një pyetje të saktë dhe kërkoj një përgjigje të saktë. Të tregova se çka bërë Shpëtimtari im për mua. Tani e ke radhën ti të tregosh se çka bërë ateizmi yt për ty!"

Pati një heshtje që të vinte në pozitë të vështirë. Ajo gjyshe ishte një grua mendjemprehtë.

Sot, kur Ungjilli sulmohet nga të gjitha drejtimet, edhe unë duhet të bëj një pyetje: "Ç'përfitim keni nga mosbesimi juaj?" Kurrë nuk kam patur përshtypjen se njerëzit kanë paqe në shpirt ose janë të lumtur për gjithë mosbesimin e tyre. Jo, miqtë e mi.

Cila është dobia e ecjes me Perëndinë? Sa për mua, nuk

do të mund t'i përballoja vështirësitë e jetës nëse nuk do të kisha gjetur paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit. Ka pasur raste në jetën time kur mendoja se do të më copëtohej zemra. Vetëm sot mësova se, jo larg prej këtej, ka ndodhur një aksident i tmerrshëm, që i ka zhytur dy familje në zi. Nëse e kam kuptuar si duhet, fëmijët u shtypën nga një veturë. Aksidente ndodhin shumë shpejt. Dhe kur ndodhin, papritur të gjitha siguritë tona zhduken pa lënë gjurmë. Gjithçka që mund të bëjmë është të shtrijmë dorën në errësirë dhe të thërrasim, "Askush nuk ndodhet aty për të na ndihmuar?" Po, ndodh kur vijnë sprovat që ne vlerësojmë gjithçka që Jezusi është dhe bën për të vetët.

Kur u martuam i thashë gruas, "Do të dëshiroja të kisha gjashtë bij, dhe të gjithë të mësonin si t'i binin trumbetës!" Ëndërroja për të patur një orkestër të vetë familjes sime. Ne në fakt patëm një familje me gjashtë fëmijë: katër vajza dhe dy djem. Por dy djemtë i humba. Perëndia m'i mori në rrethana të tmerrshme. Nuk mund ta kuptoj. Si punëtor me të rinjtë, gjithë jetën më është dashur të kujdesem për bijtë e të tjerëve, kurse të mitë....

Kujtoj ditën kur mësova se djali im i dytë kishte vdekur. Ecja lart e poshtë, duke u ndier sikur dikush më kishte ngulur një thikë në zemër. Njerëzit u rreshtuan për të më shprehur ngushëllimet e tyre. Por fjalët e tyre nuk i flisnin zemrës sime, ato nuk depërtonin brenda meje. Në atë kohë isha punëtor me të rinjtë, dhe vazhdoja të mendoja, "Sonte duhet të shkosh në qendrën e të rinjve dhe me gëzim ke për t'u shpallur Fjalën e Perëndisë 150 të rinjve." Zemra më pikonte gjak. Shkova në dhomën time dhe mbylla derën. Duke rënë më gjunjë u luta, "Zoti Jezus, ti je i gjallë. Ki mëshirë për mua." Pastaj mora Dhiatën e Re, e hapa dhe lexova: ***Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, por jo***

JEZUSI FATI YNË

Любители
на Христијанското
Евангелие

Dashamirët e Ungjillit

ISBN 9989-837-06-6